

**Murteza Mutahhari**



**Tetovë 2004**

**RRËFIME SHPIRTËRORE**  
**Murteza Mutahhari**

**Përktheu:**  
**Prof. Mahir HASANI**

**Redaktor:**  
**Hamdi ILJAZI**

**Recensent:**  
**Nuredin AHMEDI**

**Lektor:**  
**Mr. Elez ISMAILI**

**Tirazhi: 1000**



*Shkupata*

*Fladi*

## FJALA E PËRKTHYESIT

*Falënderimi i takon All-llahut, Krijuesit të gjithësisë, ndërsa salavatet dhe selamet më të dashurit të Tij, Muhammedit s.a.v.s.*

*Njeriu, kjo krijesë më e përsosur e All-llahut Fuqiplotë, gjithnjë e më tepër ndjenë nevojë të patjetërsueshme për të ushqyer atë që është më esenciale e që kohë më parë sikur ishte lënë në harresë. Nuk është punë e vogël ajo t'i kushtosh rëndësi aspektit tënd fizik e të lëshë pas dore atë shpirtëror, e më pastaj të mos i përjetosh pasojat e atij lëshimi.*

*Autori i nderuar i këtij libri, prof. Murteza Mutahhari, si ndonjë mjek i specializuar, nëse jo edhe më tepër, dëshiron të vë dorë mbi plagët e njeriut bashkëkohor dhe t'i shërojë ato në mënyrën më të lehtë e më të qëlluar, duke mos i shkaktuar lëndime e dhembje dhe duke e shëruar një herë e përgjithmonë klientin e tij njeri.*

*Lexues i nderuar, po ta lexosh me një vemendje të madhe dhe me një përkushtim librin që e ke në duart tua të ndershme, me siguri do të fitosh bindjen se fjalët e tij nuk kanë për qëllim të hijeshojnë e zbukurojnë fjalitë, porse të ofrojnë një alternativë për të dalë, ky njeri i sotëm, një herë e përgjithmonë nga labirinthi i qahmotshtëm i kësaj jete që dita ditës sa vjen e rëndohet.*

*Këtu do të hasish në zgjidhjen e të ashtuquajturave “probleme të pazgjidhura” që, mbase rrallë mund ta hasish atë dikund tjetër. Nuk do ta teproj, nëse them se lexuesi i këtij teksti, do të mbetet gojëhapur në mënyrën se si autori në fjalë i qaset një problemi dhe si ai e zgjidhë atë duke mos lënë hapsirë për të thënë se mbase do të ishte më mirë sikur ta kishite thënë ndryshe.*

*Mbetem me shpresë se lexuesi i nderur do të përfitojë nga rreshtat e këtij libri dhe do t’u qëndrojë besnik fjalëve, qëllimi i të cilave, pa dyshim është udhëzimi i njeriut kah më e mira dhe më e dobishmja për këtë e për atë botë.*

*Zot, mos ma merr për gjuhah, nëse kam harruar ose kam gabuar-Amin!*



*Shoqata*

**Prof. Mahir Hasani**

*Fladi*

## LIRIA SHPIRTËRORE I

*“Thuaj: “O ithtarë të Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët edhe për ne edhe për ju, që të mos adhurojmë tjetër përveç All-llahut, asnjë send të mos ia bëjmë shok dhe mos trajtojmë njëri-tjetrin si zotër në vend të All-llahut. E nëse ata kthejnë kryen anash, thuani: “Dëshmoni se njëmend jemi muslimanë!” (3:64).*

Temë e bisedës sonë është liria shpirtërore. Sonte, në këtë tubim madhështor, kam zgjedhur të flas për temën e lirisë. Së pari, ç’do të thotë liri e pastaj se sa lloje lirish ka? Natyrisht, do t’i përmendim të dy llojet: lirinë shpirtërore dhe atë shoqërore, dhe në etapën e tretë, për varshmërinë reciproke mes këtyre dy lirive; për atë se a është, për shembull, liria shpirtërore e realizueshme pa lirinë shoqërore apo jo. Dhe anasjelltas, a është liria shoqërore e realizueshme pa lirinë shpirtërore? Pak më tepër do të diskutojmë në pjesën e dytë, lidhur me varshmërinë e lirisë shoqërore prej asaj shpirtërore.

Që në fillim do të them se për temë diskutimi të sotëm, me rastin e ditëlindjes së “Mevlal-muttekinë” (kreut të të devotshmëve), Aliut a.s., e zgjedha temën që ka të bëjë me këtë ngjarje.

Në mesin e shprehjeve që shpesh i përdorim, lidhur me qenien e tij të bekuar, ekzistojnë edhe shprehjet: “mevla”, “mevlal-muttekinë” (kreu i të devotshmëve).

Pejgamberi fisnik s.a.v.s. këtë fjalë për herë të parë e ka përdorur lidhur me Aliun a.s. në fjalinë e njohur: Atij që unë i kam qenë mevla, edhe Aliu do të jetë mevla i tij,<sup>1</sup> për të cilën

---

<sup>1</sup> Bahrul-envar, ekzemplari 36, f. 331.

gjë janë në pajtueshmëri sunnitët e shiitët. E tepërt është të bisedohet lidhur me atë se kjo fjalë është përdorur edhe në Kur'an. Ekziston një koment se fjala është për Aliun a.s. Në Kur'an thuhet: “...*All-llahu është Mbrojtës i tij, Xhibrili dhe besimtarët e ndershëm*”.<sup>2</sup>

Megjithatë, fjalia e parë e theksuar paraqet fjalë eksplicite të të Dërguarit a.s.

Ç'domethënie ka termi "*mevla*"? Nuk do të diskutoja gjerësisht rreth kësaj shprehje. Vetëm shkurtimisht do të përmendi se kuptimi kryesor i këtyre fjalëve është *kurb* (afirm). Ka të bëjë me dy gjëra që qendrojnë njëra pranë tjetrës. Në përdorim janë fjalët *vala*, *vali* ose *mevla*, të cilat përdoren krejtësisht në kuptime të kundërta. Për shembull, fjala *mevla* përdoret për All-llahun në lidhje me robërit dhe anasjallas; përdoret edhe për zotëriun edhe për robin. Njëri prej kuptimeve të kësaj shprehje për të cilën unë personalisht mendoj është termi *mutek*. Fjala *mevla* përdoret edhe për liruesin edhe për të liruarin.

Çka paraqesin fjalët e të Dërguarit a.s. “I atij që isha unë *mevla* edhe Aliu do të jetë *mevla* i tij”.

Qëllimi ynë është që të vërtetohet se në cilin kuptim është përdorur fjala "*mevla*". Nuk do të theksoj këtu se cili kuptim, sipas mendimit tim, është i vërtetë, por Mevlana të njëjtin hadith e përmend në Methnevi dhe ka treguar një elegancë duke përdorur fjalën "*mevla*" në kuptim të *mutek*-ut (liruesit). Më duket se kjo gjendet në kapitullin e gjashtë të Methnevisë. Ky është tregim i njohur. Tregimi për gjykatësin tradhëtar dhe gruan, ku gjykatësi don të fshihet në sanduk, ashtu edhe vepruan me të dhe e vënduan në shpinë të një hamalli. Pas kësaj iu lut gjykatësi hamallit të shkojë te

---

<sup>2</sup> Kur'an, 66: 4.

ndihmësi i tij në mënyrë që të vijë për ta marrë sandukun, ndërkaq ky do t'i japë gjithë çka do të dëshirojë. E thirri ndihmësin e tij dhe ai erdhi e mori sandukun dhe e liroi atë. Pastaj Mevlana flet me shprehje metaforike: “Të gjithë ne jemi robër të dëshirave në sandukun e trupit tonë, por nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Ne kemi nevojë për një lirues të na shpëtojë nga ky sanduk dëshirash shpirtërore e trupore. Të dërguarit dhe pejgamberët janë lirues dhe shpëtimtarë”. Pastaj thekson: “Për atë Pejgamberi i nderuar veten dhe Aliun i quan mevla. Ai ka thënë: I atij që isha unë mevla e dashamir edhe nipi im Aliu do t'i jetë mevla. Mevla është ai që të çliron, të heq zinxhirin e robërisë nga këmba”.

Vërtet, ky është me siguri një faktor i vërtetë, pa marrë parasysh nëse ky është kuptimi i vërtetë i kësaj fjalie apo jo.

Pra, Pejgamberi s.a.v.s. veten dhe Aliun s.a.v.s. i ka quajtur mevla qoftë në kuptim të çliruesit ose jo. E vërtetë është që secili pejgamber vërtetë ka ardhur për çlirimin e njerëzve, njëherit edhe karakteristikat e secilit imam të vërtetë kanë qenë identike.

Ndërkaq tani do të mundohemi të vërtetojmë se çfarë kuptimi ka fjala "liri". Çka paraqet liria dhe çlirimi? Liria është një prej kushteve të patjetërsueshme për jetë dhe zhvillim, pra është nevojë e çdo qenie të gjallë pa marrë parasysh se a ka të bëjë me llojin e bimëve, shtazëve apo të njeriut. Sidoqoftë, te të gjitha llojet e gjalla ekziston nevoja për liri. Njeriu ka më tepër nevojë për liri se sa bimët e shtazët. Karakteristikë e secilës qenie të gjallë është zhvillimi dhe evoluimi, e jo stagnimi dhe qëndrimi në një vend. Objektet pa shpirt nuk posedojnë evolucion dhe zhvillim andaj nuk kanë nevojë për liri. Liria nuk ka kuptim për qeniet e pashpirta. Por, bima duhet patjetër të jetë e lirë . Qenieve të gjalla për zhvillim dhe evoluim u nevojiten tri gjëra: edukim,

siguri dhe liri. Për shembull, një bime, për zhvillim dhe evoluim i nevojiten uji dhe toka, drita dhe ngrohja. Një shtaze i nevojitet ushqim.

Edhe njeriut i nevojiten të gjitha kushtet që i nevojiteshin bimës dhe shtazës plus edhe një sërë nevojash njerëzore që ngërthehen në nocionin arsimim.

Këto elemente janë sikur ushqimi që duhet të arrijë te një qenie e gjallë që ajo të zhvillohet. Mos besoni se ndonjë qenie e gjallë mund të zhvillohet pa ushqim. Ndjenja e urisë është njëri prej kushteve të patjetërsueshme të ekzistimit të qenies së gjallë. Tjetra gjë që i nevojitet qenies së gjallë është siguria. Ç'do të thotë siguri? Kjo do të thotë se qenia e gjallë posedon diçka që ka jetë. Gjithashtu që ka gjëra dhe mjete të patjetërsueshme për jetë. Patjetër të posedojë siguri në mënyrë që mos ta humbasë atë që posedon nga ana e armikut apo nga ndonjë fuqi e jashtme. Nëse e kemi parasysh njeriun, njeriu ka nevojë për arsimim si dhe për siguri, domethënë që të ketë jetë, të mos zhduket nga jeta, të ketë pasuri, të mos i merret pasuria, të ketë shëndet, të mos i merret shëndeti. Pra, të mos privohet nga ajo që ai e posedon.

Gjëja e tretë, që i nevojitet qenies së gjallë, është liria. Ç'do të thotë liri? Mos t'ia zënë rrugën dhe mos të krijojnë barikada para tij. E mundur është që një qenie e gjallë të ketë elemente për zhvillim, por edhe në të njëjtën kohë t'i pengohet zhvillimi. Paramendoni të keni dëshirë të kultivoni një bimë. Përkrah të gjitha kushteve tjera, kushtet në kuptim të mosekzistimit të pengesave duhet të jenë të përshtatshëm, në mënyrë që të mos ketë pengesa që do të pengonin zhvillimin e saj. Për shembull: nëse një dru dëshiron të rritet, patjetër rrethi i tij duhet të jetë i liruar. Nëse mbjellni ndonjë fidan dhe ndër të gjendet ndonjë barojë e madhe, po edhe sikur ai fidan të jetë ferrë s'ka mundësi të zhvillohet. Secilës



qenie të gjallë që dëshiron të ecë drejt rrugës së zhvillimit dhe evoluimit, njëra nga nevojat themelore i është liria.

Pra, atëherë ç'do të thoshte liri? Do të thotë mospasje liri. Njerëz të lirë janë ata që i luftojnë pengesat që u dalin përpara në rrugë. Këta janë njerëz që nuk dijnë për pengesa.

Ky është një përshkrim i shkurtër për lirinë. Por këtu do të flasim për llojet e lirisë.

Njeriu është një qenie specifike dhe jeta e tij është jetë shoqërore, dhe përkrah kësaj në jetën e tij individuale është qenie evolutive dhe me të madhe dallon nga bimët dhe shtazët. Përkrah lirisë që u nevojitet bimëve dhe shtazëve, njeriut i nevojiten edhe elemente tjera të domosdoshme, që i ndajmë në dy lloje. Njëri lloj është liria shoqërore. Ç'ka nënkupton liria shoqërore? Kjo don të thotë që njeriu në shoqëri duhet patjetër nga të tjerët t'i sigurohet liria, që të tjerët mos të jenë pengesë në rrugën e tij drejt zhvillimit dhe evoluimit-përkryerjes. Nuk guxojnë t'i vënë prangat dhe t'i krijojnë një gjendje qelie, të pengojnë aktivitetet e tij, nuk guxojnë ta shfrytëzojnë dhe ta shndërrojnë në plaçkë. Pra, nuk guxojnë ta shfrytëzojnë të gjithë energjinë e tij psikofizike në drejtim të interesave të tyre individuale. Këtë gjendje mund ta quajmë liri shoqërore. Vetëm liria shoqërore patjetër duhet ndarë në disa lloje, për të cilat tani nuk do të diskutojmë. Një lloj lirie është liria shoqërore, sepse njeriu patjetër duhet të jetë i lirë në raport me të tjerët.

Njëra nga vështirësitë e jetës njerëzore gjatë historisë kishte të bëjë me atë që disa persona të fortë e të fuqishëm shfrytëzojnë fuqinë e vet dhe i vënë të tjerët në shërbim të tyre. I marrin si robër dhe frytin e punës së tyre e vjelin në dobi të vet.

A e dini se ç'do të thotë eksploatim? Ajo do të thotë vjelje e fryteve të të tjerëve. Të qenit e një personi është sikur

një pemë frytdhënëse. Fryti i të qenit të çdo individi paraqet produktin e ideve të saj, punës dhe aktivitetit, dhe vlera e produktit të saj patjetër duhet asaj ti takoj. Kur ndonjë person vepron në atë mënyrë që të marrë fryte nga pema e të tjerëve, vjel pemët e të qenit të tyre, pastaj thuhet që ky person i eksploaton të tjerët. Njëra nga vështirësitë e gjinisë njerëzore gjatë historisë ka qenë edhe fakti që një person ka eksploatuar personin tjetër, ose një popull ka eksploatuar popullin tjetër, duke i shndërruar njerëzit në robër të vet, ose, më së paku, për t'i krijuar hapsirë vetes, u a ka marrë hapsirën të tjerëve. Me këtë rast, nuk e ka eksploatuar, por ia ka marrë territorin. Për shembull, paramendoni që ka ekzistuar një copë toke që u ka takur dy personave, dhe që të dy e kanë shfrytëzuar atë. I fuqishmi, për ta shtuar territorin e vet, përvetësoi token e tjetrit dhe e ka përzënë nga ajo, ose e ka vënë në shërbim të vetin që quhet konfiskim ose robërim.

Sipas Kur'anit, njëri ndër synimet që i kanë pasur pejgamberët ka qenë që njerëzve t'u ofrojnë liri, gjegjësisht, t'i çlirojnë njerëzit nga robërimi i njëri-tjetrit. Kur'ani është një libër i mrekullueshëm. Ekzistojnë disa mendime ose kuptime që rrapëllojnë, gjallërojnë dhe arrijnë kulmin në një periudhë kohore, por nëse i shikoni periudhat e tjera, do të shihni se nuk kanë patur aq ngritje. Në disa periudha shohim se disa fjalë me plot të drejtë arrijnë kulmin. Kur t'i kthehemi Kur'anit, do të shohim se kjo fjalë në Kur'an zë një vend të lartë, e kjo është për t'u habitur, bile njëri nga epet kur'anore për motiv e ka lirinë shoqërore. Mendoj që ju nuk mund të gjeni mendim më të gjallë e më shqetësues se sa ky që gjendet në Kur'an. Këtë fjali nuk mund, pra, ta gjeni në asnjë kohë, as në shekullin tetëmbëdhjetë, as në shekullin nëntëmbëdhjetë e as në atë njëzet. Don të thotë në asnjërin prej këtyre epokave në të cilat parullë e filozofëve ka qenë

liria e njeriut dhe në të cilat liria ka qenë më e njohur për njerëzit.

Gjeni (në qoftë se mundeni - sh.p.) fjali më të gjallë e më shprehjeplote se sa kjo që është në Kur'an:

***“Thuaju (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) në një fjalë që është e njejtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos All-llahut!” E nëqoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!”***

O pejgamber, thuaju ithtarëve të librit hyjnor – hebrenjve, të krishterëve, zoroastrasëve po bile edhe sabejve, emir i të cilëve përmendet në Kur'an dhe të gjithë atyre që janë ithtarë të librit të vjetër hyjnor: Ejani të bashkohemi rreth një fjale, nën një flamur. Cili është ai flamur? Nuk ka më tepër se dy fjali. Njera prej tyre është: “që askend mos ta adhurojmë përveç All-llahut dhe askend mos ta konsiderojmë rival të Tij”.

Fjalja tjetër është: “Të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin zotër përpos All-llahut”

Pra të mos ketë sistem sundimi e adhurimi as Jezusi e as jojezusi e as dreqi. Përveç të vetmit Zot të mos adhurojmë asnjë krijesë a person. Të mos ketë sistem eksploatuesish as të të eksploatuarëve. Të mos ketë mosbarazi. Që askush të mos ketë të drejtë të eksploatojë dhe nënshtrojë tjetrin. Megjithatë, ky nuk është ajeti i vetëm në Kur'an. Lidhur me këtë temë ka shumë ajete. Meqë ekspozenë time dëshiroj ta shprehë shkurtimisht, do të përmendi vetëm disa prej tyre.

Kur'ani përmes gojës së Musait a.s. na bën me dije se si ai ka biseduar me Faraonin dhe si Faraoni i ka thënë atij: “A nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet

të jetës sate. Dhe ti e bëre atë punën tënde që e bëre, pra ti je mohues (i të mirave që t'i bëmë)”.

Atëherë Musai a.s. i ka thënë Faraonit:

“Ndërsa mirësia që po ma përmend, mos është ajo që robërore izraelitët”.

Rahmetli ajetullah Naini në librin e tij, Tenzihul-ummeh (Pastrimi i ummetit), thotë: “Të gjithë e dinë popullin e Musait a.s. Pasardhësit e Jakubit a.s.kurrë s'e kanë adhuruar Faraonin sikur që kanë vepruar koptët, por njëkohësisht edhe për shkak se Faraoni i ka trajtuar ata si robër të vet. Kur'ani Famëllartë këtë e citon si fjalë të Musait a.s. me shprehjen *ta'bid* (robërim)”.

Njëri nga qëllimet e pejgamberëve ka qenë të sigurojnë lirinë shoqërore dhe të luftojnë kundër robërisë shoqërore dhe injorimit të lirisë në shoqëri. Shoqëria bashkëkohore, po ashtu, lirinë shoqërore e konsideron si diçka të shenjtë. Nëse e keni lexuar hyrjen e Deklaratës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, mu atëherë do të mund ta kuptoni këtë. Aty thuhet se bazë e shkakut të të gjitha luftërave, gjakderdhjeve dhe fatkeqësive që ndodhin në botë, është që njerëzit nuk respektojnë lirinë e tjetrit.

A përputhet logjika e pejgamberëve me logjikën bashkëkohore? A është liria diçka e shenjtë? Liria është e shenjtë, po bile edhe shumë e shenjtë. Pejgamberi s.a.v.s. gjithnjë ua ka pasur frikën emevitëve dhe e ka shqetësuar qeverisja e tyre ummetin. Ai tha:

“Nëse pasardhësit e Ebi Asit do të arrijnë të bëhen tredhjetë veta, robërit e All-llahut do t'i konsiderojë si pronë të tyre dhe do të bëjnë ndryshime në fenë e All-llahut, aq sa të kenë mundësi”.<sup>3</sup> Mu për këtë, e vërtetë është se liria shoqërore është e shenjtë. Por, liria shpirtërore është lloj i

---

<sup>3</sup> Mexhma ul-Bahrein Tarihi.

dytë i lirisë. Dallimi që ekziston në mes shkollave të pejgamberëve dhe atyre të njerëzve thjeshtë është se pejgamberët kanë ardhur, që përveç lirisë shoqërore, t'i sjellin njerëzimit edhe lirinë shpirtërore, ndërkaq liria shpirtërore vlen më shumë se gjithëçka tjetër. Nuk është e shenjtë vetëm liria shoqërore, e shenjtë është edhe liria shpirtërore; dhe liria shoqërore nuk mundet pa lirinë shpirtërore, dhe praktikisht, kjo është dhembja e shoqërisë bashkëkohore, që tenton të sigurojë lirinë shoqërore, por s'kërkon edhe lirinë shpirtërore. Pra, për këtë shkak, nuk mundet dhe nuk ka fuqi që liria shpirtërore të sigurohet, përveç me dërgimin e pejgamberëve, fesë, besimit dhe librave hyjnorë.

Në vazhdim do të shohim çka paraqet liria shpirtërore.

Njeriu është një qenie e përbërë dhe ai ka shqisa dhe instinkte të ndryshme. Në qenien e njeriut ka me mijëra ngacmime. Njeriu ndjen etje, hidhërim, lakmi, ambicje dhe dëshirë për të arritur sa më shumë. Përkundër kësaj, njeriu ka intelekt dhe esencë morale. Njeriu në kuptim të domethënies dhe në kuptim të rëndësisë shpirtërore mund të jetë njeri i lirë, por mund të jetë edhe i nënshtruar e i robëruar. Do me thënë, e mundur është që njeriu të bëhet rob i dëshirave, i lakmive, i hidhërimit të vet dhe ambicjeve për të arritur më shumë dhe e mundur është të jetë i liruar nga këto gjëra. Ashtu si shprehet një poet:

“Haptas them dhe i lumtur jam në fjalët e mia,  
rob jam i dashurisë, ndërsa nga dy botërat i liruar jam”.

Ekziston mundësia që të ketë njeri që në kuptimin shoqëror të jetë i lirë dhe që nuk është nën barën e nënçmimit dhe robërisë, që mirëmban lirinë e vet në shoqëri dhe që, njëherit, në kuptim të moralit ruan lirinë e tij. Kjo don të thotë se e ka ruajtur vetëdijen e vet dhe ka gjykim të pavarur.

Ky lloj shpirti i çliruar në fe quhet shpirtdlirësi ose pastrim i shpirtit (tezkijetun-nefsi).

A është e mundur që njeriu të ketë liri shoqërore, por të mos ketë liri shpirtërore? Që don të thotë, të bëhet njeriu rob i ambicjeve, zemërimit dhe dëshirave të tij, por njëkohësisht të respektojë lirinë e tjetrit?

Sot praktikisht thonë se njeriu dëshiron të jetë rob i ambicjeve, dëshirave, zemërimit dhe pasioneve të tij, dhe, njëkohësisht, njeriu i këtillë i cili e ka robëruar veten të respektojë lirinë shoqërore. Ky është një prej shembujve të paradoksit. Është një nga kundërthëniet e shoqërisë së tanishme njerëzore. Këtu do të flasim për të, lidhur me fjalët e dialektikut.

Njeriu në kohrat e më hershme nuk e ka respektuar lirinë dhe e ka shkelur atë. Vërtet, a thua vallë, për çfarë arsye e ka shkelur lirinë? A thua pse ka qenë i paudhëzuar dhe e ka mohuar lirinë e tjetrit? A thua mjafton të jetë i mençur në mënyrë që t'i respektojë të drejtat e tjetrit? Për shembull, kështu ndodh me sëmundjen. Njeriu parahistorik ka qenë i paarsimuar dhe i paudhëzuar. Kur është sëmurë, ilaçet e shfrytëzuara nuk i kanë dhënë rezultatet e duhura. Por, njeriu i sotshëm është bërë më i vetëdijshëm dhe ka arritur që metodat e vjetra të shërimit t'i zëvendësojë me metoda të reja. Ne dëshirojmë të dijmë se njeriu i dikurshëm që e ka shkelur lirinë e tjetrit, a thua vallë kështu ka vepruar vetëm pse nuk ka dijtur?! A thua lirinë e ka mohuar nga mosdija? Jo, mosdija e shkenca s'kanë ndikuar në të, kështu ka vepruar nga interesi i vet. A thua vallë njeriu i dikurshëm që nuk ka respektuar lirinë dhe të drejtën e tjetrit ka vepruar kështu pse nuk ka qenë i vetëdijshëm se si kanë qenë traditat? Dhe nëse e aplikojmë traditën, a thua gjithëçka do të zgjidhet, si në rastin e ligjeve obligative që i sjell njeriu? Për shembull:

nëse thuhet se në Amerikë është hequr ligji mbi robërinë, a thua vallë kjo do të thotë se robëria me të vërtetë është zhdukur? Apo, mbase, ka ndryshuar pamja dhe forma, ndërsa esenca ka mbetur e njëjtë.

A thua, njeriu parahistorik nuk i ka respektuar të drejtat dhe liritë e tjetrit, për shkak se mënyra e konceptimit të tij filozofik ka qenë e tillë? Assesi! Ka ekzistuar vetëm një gjë, e ajo është interesi. Njeriu i lashtë në natyrën e tij individuale ka qenë përfitues dhe në këtë drejtim i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet. Njëri nga ato mjete kanë qenë subjekti njeri. Ashtu siç ka dashur, për qëllimet e veta, të shfrytëzojë drurin, gurin, metalin, delen, lopën, kalin dhe mushkën, ashtu ka dashur ta shfrytëzojë edhe njeriun. Kur e ka mbjellë apo e ka prerë një dru, ajo për të cilën nuk ka menduar ka qenë druri. Ka menduar vetëm për vete. Nëse e ka kultivuar një dele, pastaj e ka therrë, çka i është sjellë ndër mend? Përveç dobisë së vet në asgjë tjetër nuk ka menduar. Gjithashtu, nëse për vete ka marrë robër dhe i ka privuar nga të drejtat e tyre, atë e ka bërë për interesin e vet. Mu për atë, shkak që njeriun, në të kaluarën, e shtyri t'i thejë të drejtat shoqërore të të tjerëve dhe të shkelë lirinë shoqërore, është ndjenja e tij vetëm për të shfrytëzuar e asgjë tjetër.

Pra, si do ishin ndjenjat përfituese të njeriut bashkëkohor? Ekzistojnë apo jo? Po, ekzistojnë! Ato nuk kanë pësuar ndryshim. Nëse goja e njeriut të sotëm, për shkak të gëlltitjes, nuk është e hapur më shumë se goja e njeriut të mëparshëm, nuk është e hapur as më pak.

As shkenca, as ndryshimi i ligjeve nuk kanë mundur ta pengojnë dëshirën. Përmbajtja është e njëjtë, vetëm se më bukur është shtjelluar. Njeriu i lashtë ka qenë një qenie e sinqertë që nuk kishte arritur ende afër dyfytërsisë. Faraoni i ka robëruar njerëzit dhe atë haptas ia ka shprehur Musait

a.s.:”Ç’je duke thënë? Ata janë robërit tanë”. Më nuk e fshehu eksploatimin dhe robërimin. Por, njeriu i sotëm në emër të lirisë së njerëzimit dhe mbrojtjes së paqes dhe lirisë, then të gjitha liritë dhe të drejtat dhe kryen robërimin. Pse? Sepse nuk ka liri shpirtërore. Për shkak se nuk është i lirë në suaza të shpirtit të vet, për shkak se nuk ka moral. Aliu a.s. ka një thënie që është me vlerë si dhe të gjitha mendimet e tij të tjera. Ajo ka të bëjë me vlerën, e cila , sipas mendimit të tjerëve, është e stërvjetruar. Ai thotë: “Devotshmëria është çelës i çdo rruge të drejtë. Pa vlera njeriu nuk mund të shkojë në rrugë të drejtë, por devijon nga ajo. Pa virtyte njeriu nuk mund të fitojë Ahiretin”.<sup>4</sup>

Njeriu pa vlera s'ka liri. Devotshmëria e çliron njeriun nga çdo shqetësim. Patjetër njeriu në suaza të shpirtit të tij të jetë i çliruar, në mënyrë që të tjerëve t’u japë lirinë. Andaj, kush është, me plot kuptim të fjalës, njeri i lirë në botë? Ali ibën Ebu Talibi a.s. apo ata që janë edukuar në shkollën e tij. Njerëzit e tillë me të vërtetë janë të shpëtuar nga robërimi i pasioneve të veta.

Personi i cili gjykon për pasionet dhe shpirtin e tij, mund të jetë çlirues dhe i çliruar, sikur Aliu, ose së paku të jetë ithtar i tij. Vetëm në mihrab të ibadetit Atij t’i drejtohet e të thotë: “Oj botë! Oj botë e verdhë dhe e bardhë, o ari dhe argjendi i kësaj bote, shko dhe mashtroji ata që nuk janë ithtarë të Aliut a.s, unë ty të kam dhënë shkurorëzim të përvokueshëm”.<sup>5</sup>

Ky person, seriozisht e jo për sy e faqe, i respekton të drejtat dhe lirinë e popullit që zë vend në shpirtin e tij. Esenca e vetëdijes shndërrohet në zë hyjnor dhe atë e thërret. Tani e shihni që personi i tillë që posedon vlera e moral,

---

<sup>4</sup> Shtegu i elokuencës.

<sup>5</sup> Po aty.



është i devotshëm kur qeveris me njerëzit, dhe kur populli është nën pushtetin e tij, asgjë nuk hetohet. Njerëzit në bazë të paragjykimeve të tyre subjektive dëshirojnë të gjejnë strehim te ai, ndërkaq ai u drejtohet: “Mos kërkoni strehim, rini me mua”.<sup>6</sup>

Kur shkoi në betejën e Sifinit, apo kur u kthye nga ajo, arriti në qytetin Anbar i cili sot është njëri prej qyteteve irakiane, e më parë ka qenë qytet i vjetër iranian, iranianët ishin aty. Disa njerëz më eminentë dhe disa robër i dolën në pritje halifit. Sipas mendimit të tyre, Aliu a.s. ishte trashëgimtar i mbretërve sasanidë. Kur arritën te ai dhe filluan të vrapojnë përpara kalit të imamatit, Aliu a.s. i thirri dhe i pyeti: “Pse veproni kështu?” Ata u përgjigjën: “Zotëri, ky është respekti që ua kushtojmë eprorëve dhe mbretërve tanë”. Imam Aliu u përgjigj: “Jo, mos veproni kështu! Këto sjellje ju nënçmojnë dhe u dobësojnë. Pse ju përpara meje, si halif, përuleni? Unë jam njëri prej jush, ndërkaq ju me sjelljet tuaja nuk më bëni mirë. Ka mundësi që përmes këtij akti, ruana Zot, më paraqitet një mburrje e rrejshme dhe të filloj ta konsideroj veten më të mirë se ju”.

Njeriun e këtillë e quajnë mendimlibër. Të atillë e quajnë njeriun që ka liri shpirtërore, personin që ka pranuar zërin e Kur'anit d.m.th që pos All-llahut të mos adhurojmë askend tjetër, asnjë forcë e fuqi, as një njeri, as gurin as tokën, as pezmatimin as dëshirat, as pasionet as ambicjet. Vetëm All-llahu duhet adhuruar. Vetëm atëherë Ai mund të dhurojë liri shpirtërore.

Imam Aliu a.s. mbajti një fjalim të cilin do ta përcjellë në këtë vend. Do të shihni si duket shpirti i njeriut që ka liri shpirtërore. A thua vallë, mund të gjeni në botë shpirt të këtillë? Nëse mund ta gjeni, lirisht, mund të ma tregoni!

---

<sup>6</sup> Po aty.

Fjalimi është tejet i gjerë dhe ka të bëjë me të drejtat e sunduesit ndaj popullit dhe, ansjelltas, të drejtat e popullit ndaj sunduesit. Aty ka çështje për të cilat diskuton hazreti Aliu. Në mesin tonë është e natyrshme të thuhet vetëm: “Mos rrini kështu përpara sundimtarit tuaj, rrini të lirë!” Aliu a.s. thekson: “Por mua mos më shprehni fjalë miradije për obligimet që i plotësoj ndaj All-llahut dhe ndaj jush, sepse kam frikë për ato obligime që s’i kam kryer dhe për ato detyra që është dashur patjetër të kryhen. Dhe mos më kushtëzoni ashu si kushtëzohen zullumçarët, mos më largoheni ashtu sikur largohen njerëzit nga pozitat, mos më bëni të lumtur duke më bërë lajka dhe mos mendoni se do ta marr për të keq nëse më thuhet e vërteta”. Andaj, mos nguroni ta thoni të vërtetën ose të këshilloheni në lidhje me drejtësinë, sepse nuk e mbaj veten përmbi mundësitë e gabimeve, po as që jam i sigurt që nuk do të gabojë gjatë veprave të mia, përveç nëse All-llahu i ndihmon shpirtit tim me superfuqinë e Tij. Unë dhe ju, në të vërtetë, jemi vetëm robër nën pushtetin e Perëndisë, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër.

Pastaj tregoi një rregull të përgjithshëm: “Sepse personi që ndjehet i pezmatuar kur t’i thuhet e vërteta, ose kur para tij ekspozohet një gjë e drejtë, vështirë se do të mund të veprojë në përputhshmëri me të vërtetën dhe të drejtën”.<sup>7</sup>

Kristijanseni shkruan se Anushirvani i tuboi disa njerëz për t’u marrë vesh lidhur me një çështje për të cilën u foli. Dha mendimin e vet. Të gjithë thanë: gjithëçka që thoni, tamam është. Njëri nga sekretarët u mashtrua, duke menduar se me të vërtetë ai ishte një tubim konsultativ dhe se ai ka të drejtë të shprehë mendimin e vet, andaj i tregoi vërejtjet e veta rreth mendimit të Anushirvanit. Atëherë Anushirvani tha: “O ti i paedukatë, ti, o njeri i paturp!” Dhe, menjëherë

---

<sup>7</sup> Po aty.

urdhëroi ta ndëshkojnë. I mëshonin kokës me bisht pene gjersa i doli shpirti. Atij që e vërteta i duket e hidhur dhe që vështirë e ka kur prej tij kërkojnë që të sillen drejt, drejtësia dhe e vërteta për të janë edhe më të vështira. Dhe në fund Aliu a.s. lutet: O njerëz, dashamirë të mi, o shokë të mi, ju lutem, kurrë mos nguroni në fjalët e vërteta dhe në kritika ndaj meje dhe ofroni këshillat tuaja.<sup>8</sup>

Ky është një shembull i përkryer i njeriut që ka liri shpirtërore dhe, ashtu nga pozita e pushtetarit, u jep liri të tjerëve.



---

<sup>8</sup> Po aty.

## LIRIA SHPIRTËRORE II

Diskutimi mbi lirinë shpirtërore përfshinë tri pjesë:

1. Ç'është liria?
2. Ekzistimi i dy lloj lirive: lirisë shpirtërore dhe lirisë shoqërore dhe
3. Lidhshmëria midis këtyre dy lirive.

Këtu diskutimin do ta përkufizojmë vetëm në lidhje me lirinë shpirtërore, kryesisht rreth çështjes së përcaktimit të lirisë shpirtërore: çka do të thotë liri shpirtërore, nëse është e patjetërsueshme që njeriu të posedojë liri shpirtërore, ose jo? Kësaj çështje po i kushtojë më tepër rëndësi nga shkakut që sot ka shumë pak liri shpirtërore dhe ky është njëri nga shkaqet e fatkeqësisë së sotme. Shumë vetë mendojnë se kjo çështje nuk është më aktuale. Përkundrazi, në kohën moderne nevoja e njerëzimit për liri, nëse më nuk është më e madhe, nuk është as më e vogël se në etapat e kaluara.

Ç'do të thotë liri shpirtërore? Liria gjithnjë kërkon dy palë, ashtu që njëra të jetë e liruar nga obligimet ndaj tjetrës. Nga cila gjë duhet të jetë i liruar njeriu në pikëpamje të lirisë shpirtërore? Përgjigjja është në atë se ç'është liria shpirtërore, përballë lirisë shoqërore. Ajo është çlirimi i njeriut nga vetvetja. Liria shoqërore është liria e njeriut nga robëria dhe robërimi i njerëzve tjerë. Por liria shpirtërore është një lloj lirie specifike, dhe në të vërtetë paraqet çlirimin e njeriut nga vetrobërimi të robëruarit (tjetrin - sh.p.).

Spontanisht parashtrohet pyetja: “A ka mundësi, vallë, që njeriu të vetrobërohet? Po a ka mundësi që një qenie të bëhet rob dhe pushtues, të vetrobërohet e të robërojë tjetrin? A thua vallë diçka e tillë është e mundur?” Përgjigjja është:

Po! Në qoftë se në rastet e tjera një gjë e tillë s'ekziston, për shembull, në qoftë se te gjallesat robërimi shpirtëror, edhe përkundër kësaj lirie shpirtërore, nuk kanë domethënie dhe nuk janë të mundshme; te njeriu, te kjo qenie e çuditshme, të vetrobërohesh ose të çlirosh vetveten, kjo ka domethënie. Në cilën mënyrë kjo do të ishte e mundshme? Shkaku qëndron në atë se njeriu në krahasim me qeniet e tjera është një personalitet i ndërlikuar. Kjo është e saktë! Feja dhe filozofia kanë vërtetuar se njeriu, pamëdyshje, është një qenie e përbërë, madje këtë e kanë vërtetuar edhe shkencëtarët edhe psikologët.

Së pari do ta shqyrtoj këtë çështje në bazë të komenteve kur'anore dhe ato që kanë të bëjnë me hadithe. Në Kur'an shihni që në lidhje me krijimin e njeriut (kryekëput të njeriut) thuhet kështu: “Dhe pasi që i kam dhënë fizionomi dhe i kam dhënë edhe shpirt, ju përluni!”

Thuhet se qenia njeri është krijuar nga toka (“Unë do ta krijoj nga toka”), d.m.th kjo është qenie natyrore e materiale. Por, kjo qenie e krijuar nga uji dhe toka posedon trup sikur edhe gjallesat e tjera, “Unë do t'i jap atij nga shpirti im”. Këtu s'është e patjetërsueshme ta kuptojmë shpirtin hyjnor, dhe çka quan All-llahu shpirt të Vetin. Shkurthëne, e dijmë se në këtë qenie të krijuar nga toka, ka diçka që nuk është tokë. Ka një hadith të njohur sipas të cilit Pejgamberi i ndershëm s.a.v.s. thotë: “All-llahu xh.sh i ka krijuar melekët e Tij dhe esencës së tyre i ka dhuruar vetëm të kuptuar, krijoi shtazët dhe u dha instinkt dhe krijoi njeriun, ndërsa në qenien e tij vëndoi mendjen dhe vullnetin”. Ndërsa Mevlana në lidhje me këtë recitoi nje varg: “Ka thënë Pejgamberi a.s. që Krijuesi Madhëriplotë krijoi tri lloj qeniesh në botë”.

Pastaj shtoi:

“Një grup melekësh, një grup kafshësh dhe një grup njerëzish”.

Tani është e mundur që ne të dëshirojmë ta kuptojmë këtë me një gjuhë më të thjeshtë.

Pa marrë parasysh temat dhe çështjet që ekzistojnë në Kur'an dhe në hadithe dhe të cilat gnostikët i kanë shprehur, ndërsa psiokologët i kanë vërtetuar, në këtë lëmi do të kishim dashur që çështjen e lirisë shpirtërore ta përkthejmë me një gjuhë të thjeshtë. Do të fillojmë me një temë që do të jetë e kuptueshme për çdo kend.

Padyshim se ne në këtë jetë kemi nevojë për çdo lloj ushqimi të mirë e më të mirë, kemi nevojë për tesha sa më moderne e kreative, kemi nevojë për banesë më të mirë e më luksose. Gjithashtu kemi nevojë për gra dhe fëmijë. Kemi nevojë për një jetë luksoze dhe jemi të interesuar për para dhe roba. Por, në një vend hasim në kthesë. Ndjejmë se këtu, patjetër, duhet ta ruajmë autoritetin dhe dinjitetin. Ose, të pajtohemi me varfërinë: të hamë bukë thatë, të vishemi me roba të vjetra, të kemi shtëpi të vogël, të mbetemi pa para, të jemi në gjendje varfërie, ose të heqim dorë nga autoriteti dhe dinjiteti jonë, të përulemi, të bëhemi shërbtorë, atëherë do të na sigurohej mirëqenia. Shohim shumë njerëz që nuk janë të gatshëm të përulen, as për shkak të rritjes së të mirave të tij materiale. Natyrisht, disa njerëz pranojnë një përulje të tillë, por njëkohësisht, thellë në qenien e tyre ndjejnë një turp.

Saadiu, në “Gjylistan”, thotë: “ Kanë qenë dy vëllezër, prej të cilëve njëri ishte i pasur, ndërsa tjetri dervish. Njeriu i pasur ishte i punësuar në oborrin mbretëror, ndërsa dervishi ka qenë punëtor dhe ka ngrënë bukë që e fitonte nga duart e veta. Një ditë, vëllai i pasur i tha vëllait të tij dervish: “ Pse edhe ti nuk shërbejsh në mënyrë që t’i ikish jetës së vështirë? Eja edhe ti të shërbejsh në oborrin mbretëror që të çlirohesh

nga kjo jetë e punëtorit, e nga prerja e drurëve dhe punëve tjera të rënda”. Vëllai dervish u përgjigj: “Pse ti nuk punon më mirë që të çlirohesh nga shërbimi i nënçmuar? Ti mua po më thua pse nuk shërbej që të jem i çliruar nga vuajtja dhe vështirësitë, ndërkaq unë ty të pyes se pse ti nuk punon dhe nuk duron lodhjen dhe vështirësitë në mënyrë që të jeshë i liruar nga shërbimi i nënçmuar? Një shërbim i këtillë, sado që të sjellë pasuri, meqë është robërim dhe humbje lirie, e konsideroj vepër e nënçmuar”. Madje tha: “Njerëzit e urtë kanë thënë që më mirë është të hash bukën tënde, se sa të ngjeshish rryp të artë dhe t’i shërbesh tjetrit”.

Është e mundur që ju vetë të dini mjaft gjëra lidhur me këtë lëmi. Dëshiroj që ju këtë gjë ta analizoni në aspektin psikik. Çfarë ndjenje e përshkon njeriun që më tepër dëshiron vuajtjen, mundimin, vështirësinë, të punojë si sharraxhi dhe të jetojë në varfëri, se sa të qëndrojë duarkryq përpara një individi siç është vetë ai. Dhe atë e quan robëri. Ai deklaron: “Unë nuk jam i gatshëm të bëhem rob i dikuj”. Megjithëse, kjo nuk është robëri materiale. Do të thotë energjia e tij nuk është e angazhuar, i angazhuar është vetëm shpirti i tij, e jo edhe trupi. Kjo është një lloj robërie. Por, robëria e cila nuk e ka robëruar trupin e njeriut, vërtetë e ka robëruar shpirtin e tij. Në përmbledhjen e njohur lidhur me Aliun a.s. thuhet: “Nëse dëshiron të jetosh i lirë, puno, angazhohu, vuaj si rob dhe mos i lakmo pasurisë së njerëzve, kushdo që të jenë ata, po bile edhe sikur të bëhet fjalë edhe për Hateme Tajin. Nuk them që nuk ke të drejtë të lakmosh në pronën e të njerëzve të varfër, jo, por nuk guxon të lakmosh në pronën e të pasurve siç ka qenë Hateme Taji”.

Për shembull, kur thuhet: “Bëhu punëtor dhe punoje token me shatë”, përgjigjja është: “Kjo është një punë e thjeshtë”. Secila punë, sado që ti e konsideron të thjeshtë,

është më e mirë se të shtrijsh dorën e të lakmosh në pasurinë e tjerëve”.

“Asgjë nuk ka më të thjeshtë se sa nga moskujdesi të lypish nga të tjerët e të shkosh te ata”.

“Për sa nuk je i varur prej të tjerëve, për aq je më i mirë se ata”.

Me sa më duket kam vërejtur në fjalët e Xhahidhit, që ishte letrar, (Xhahidhi ka qenë shumë gojtar dhe, dorën në zemër, orator që në veçanti i ka çmuar fjalët e Aliut a.s.dhe ndonjë herë flet gjëra të çuditshme) ose ndonjë tjetër prej dijetarëve sunnit të thotë se si në mes fjalimeve të Aliut a.s. nëntë sosh s'e kanë rivalin në botë. Prej atyre nëntë fjalimeve, tre prej tyre kanë të bëjnë me diskutimin tonë. Udhëheqësi i besimtarëve (Emirul-mu'mininë) thotë:

“Bëhu i varur prej cilit të duash, por dije se nëse varesh nga dikush, bëhesh rob i tij. Mos u bën i varur nga askush, e mu atëherë do të jesh sikur ai. Bëri mirë cilit do qoftë, dhe bëhu edheheqës i tij”.<sup>9</sup>

Kjo do të thotë të varesh nga tjetri është një lloj robërie, por varet se në cilën mënyrë? A thua ky është robërim i trupit? Jo, por kjo është robërim i shpirtit, gjegjësisht robërim shpirtëror. Sa fjalë të bukura janë thënë në këtë lëmi, por për fat të keq, sot pak e më pak zhvillohen diskutime të këtilla. Natyrisht, në një mënyrë kjo ndodh për shkak se tani janë aktuale gjërat tjera për të cilat njeriu dëshiron të flasë. Kështu pakohet numri i diskutimeve me karakter etik edhe pse për këto çështje duhet shumë të flitet. Ali a.s. thotë:

“Lakmia është robëri e përhershme”.<sup>10</sup> Kjo don të thotë se lakmia është më e keqe se robëria.

---

<sup>9</sup> Gurul-hikem, botues Universiteti i Teheranit, vëllimi 2, f. 564.

<sup>10</sup> Shtegu i elokuencës, hikmet 1717, f. 1170.



Në këtë mënyrë mund të kuptohet që pos robërimit të trupit ekzistojnë edhe lloje tjera robërie, ku në të njejtën kohë, trupi i njeriut është i lirë.

Në shembullin që e solli Sa'diju për dy vëllezërit, të pasurin dhe dervishin, vëllai i pasur kishte shumë më tepër mundësi materiale se sa dervishi. Trupi i tij ishte shumë më i liruar se sa ai i të vëllait. Trupi i këtij të gjorit gjithnjë ishte i ngarkuar me punë të rënda, por shpirti i tij ishte më i lirë nga trupi. Nga kjo mund të kuptoni se ekziston lloji tjetër i robërisë që nuk e robëron trupin. Pra, ekziston edhe lloji tjetër i lirisë që e liron trupin.

Shkoni edhe një shkallë më larg. Ekziston edhe një lloj robërie që ka të bëjë me pronën e pasurinë. Të gjithë dijetarët e etikës ia kanë tërhequr vërejtjen njerëzimit që mos të bëhen robër të gjërave dhe pasurisë. Sipas fjalëve të Aliut a.s.: “Bota për njeriun paraqet një qëndrim të përkohshëm e jo të përhershëm”.<sup>11</sup> Ai, gjithashtu thotë: “Njerëzit në këtë botë ndahen në dy grupe”. Pastaj: “Njerëzit që vijnë në këtë vendbanim të përkohshëm, në këtë panair botëror janë të ndarë në dy grupe, ashtu që vjen njëra, shet, robëron veten dhe shkon, pastaj vjen tjetra blen, çliron veten dhe shkon”.

Njeriu përsëri ndjenë që me pasurinë e kësaj bote mund të sillet në dy mënyrë, mund të bëhet rob dhe robëruar i pasurisë, por mund të jetë edhe i lirë. Poeti thotë: “Coptoi zinxhirët, të jeshë i lirë! O djalosh, gjer kur do të mbetesh i stolisur me ar e argjend?”

Njeriu thotë: “Si nuk bën që unë të bëhem rob i të tjerëve, ashtu edhe shpirti im nuk guxon të bëhet i robëruar (preokupuar- sh.p.) me pasurinë e kësaj bote”. Njeriu arrinë në pedestal e thotë: “Ç’do të thotë, përgjithësisht, të bëhesh

---

<sup>11</sup> Pa aty., 128, f.1150.

rob i psurisë së kësaj bote, po a ka mundësi që ana materiale e botës ta shndërrojë njeriun në rob të vetin?”

Prona e kësaj bote paraqet pasuri. Çfarë, në të vërtetë, nënkupton fjala pasuri? Me fjalën *pasuri* nënkuptohet ari, argjendi, shtëpitë, toka dhe të ngjashme. Po a kanë këto gjëra fuqi të robërojnë? Unë jam njeri i gjallë, ndërkaq ato janë objekte të pajetë e të vdekur, e si kanë mundësi të pajetët e të vdekurit të robërojnë një qenie të gjallë dhe ta shndërrojnë në rob të vetin? Jo! Atëherë cila është e vërteta? E vërteta është që edhe atëherë kur njeriu mendon se është rob i jetës dhe pasurisë së kësaj bote, ai s'është rob as i pronës, as i pasurisë. Ai është rob i tipareve të veta shpirtërore, rob i tipareve të veta shtazarake, rob i ambicjeve të veta dhe e di që vetë është robëruar. Përndryshe paraja s'mund ta robërojë njeriun. Toka s'ka fuqi ta robërojë njeriun. Veturat nuk kanë fuqi, janë të pajetë. Përgjithësisht gjërat e pajetë nuk mund ta ngadhënjë aspektin e brendshëm të njeriut. Kur njeriu ta analizojë mirë problemin, do të shohë se vetë është robëruar. Do të shohë se në vete mban fuqinë të quajtur “ambicje-lakmi”, fuqinë të quajtur “pasion”, fuqinë të quajtur “zemërim”. Do të shohë se ky pasion e ky zemërim e kanë robëruar atë, kanë ngadhënjyer ambicjet dhe se e ka robëruar epshi. Në Kur'an thuhet:

***“Thuaj: “Kush është Ai në duart e të cilit është pushteti mbi të gjitha, e që merr në mbrojtje dhe nuk ka nevojë për t'u marrë në mbrojtje, e dini?”***

***“A e ke parë ti (Muhammed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin, atë All-llahu e ka humbur, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij, i ka vënë perde para syve të tij, më thuaj, kush mund ta udhëzojë atë pos All-llahut? A nuk merrni mësim?” (45:23)***

Këtu njeriu zbulon të vërtetën e gjërave. Ai është ai i cili e robëron veten. Ai është ai i cili thotë se do ta liron veten

nga prangat e pasioneve dhe pastaj do të shohë se as pasuria e gjithë botës nuk është në shërbim të tij dhe do të kuptojë domethënien e këtyre fjalëve që i citon Kur'ani:

**“Ai është i Cili ka krijuar për ju gjithëçka që ka në tokë”.** (2:29)

Atëherë do të shihni që prona dhe pasuria janë robërit tuaj, dhe se ato janë në shërbimin tuaj e jo ju në shërbimin e tyre. Atëherë çfarë kuptimi do të kishte xhelozia? Ç’kuptim do të kishte gjurmimi juaj për më shumë pasuri? Po, njeriu vetë robëron veten gjegjësisht vetërobërohet. Njeriu ndërthen në vete dy nivele, dy shkallë, atë intelektuale-shtazarake dhe atë më të lartë-humane. Pejgamberët kanë ardhur në mënyrë që të ruajnë lirinë shpirtërore. Ç’do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ata të mos lejojnë që nderi, humaniteti, mendja dhe vetëdija e njeriut, të bëhen robër të pasionit, zemërimit dhe të interesave materiale të vetë njeriut. Ky është kuptimi i lirisë shpirtërore. Kur të vëreni se e keni sunduar zemërimin tuaj e jo të kundërtën, atëherë jeni të lirë. Kur të shihni se e keni sunduar pasionin, kur të shihni se mund të realizoni një fitim joligjor e pasioni juaj lakmon në të dhe ju thotë që ta merrni, ndërkaq besimi, logjika dhe vetëdija konsiderojnë se ajo është jolegjitime dhe se nuk duhet ta merrni, mu atëherë e keni frenuar vullnetin dhe dinie se, vërtetë, në kuptim të shpirtërores, ju jeni njeri i lirë.

Nëse shihni ndonjë grua të panjohur se si ecë, ndërkaq shqisat tua u nxisin t’i ngulitni sytë në të dhe ta ndiqni, kurse në anën tjetër vetëdija juaj sundon dëshirën tuaj të brendshme lidhur me atë, ju urdhëron e ju veproni sipas atij urdhëri, dinie se jeni njeri i lirë. Por, sa të shihni diçka dhe vraponi pas saj, sa të dëgjoni diçka dhe e ndiqni atë, sa të kërkojë gruaja diçka ia plotësoni dëshirën, nëse ju kërkon diçka barku dhe ju ia përmbushni atë kërkesë, atëherë të robëruar jeni, në

pranga. Njeriu është një qenie e ndërlikuar. Nuk mund të harrohet realiteti se njeriu ngërthen në vete dy “unë”: njëri “unë” është njerëzor, kurse tjetri shtazarak. “Unë”-i i vërtetë njerëzor është “unë”-i human. Sa bukur është i kënduar ky paradoks i brendshëm njerëzor në tregimin e Mexhnunit dhe deveve. Vërtetë njeriu është një manifestim kontradiktash. Te asnjë qenie nuk ekziston kaq thellë një paradoks i brendshëm. Tregohet që Mexhnuni për shkak të shkuarjes në shtëpi te Lejla hipi mbi deve që kishte të voglin e saj. Në mënyrë që devja sa më shpejt ta kalonte rrugën, Mexhnuni e mbylli të voglin e saj në shtëpi dhe u nis në rrugë vetëm me të. Mexhnuni ishte shumë i dhënë në dashuri pas Lejlës dhe në kurgjë nuk mendonte pos në atë. Në anën tjetër, devja me të gjitha shqisat e saja ishte me të voglin e saj, dhe në asgjë tjetër nuk mendonte pos në të. I vogli i deveve ishte në këtë, ndërsa Lejla në atë anë, ai ishte në një skaj, ndërsa ajo në skajin tjetër. Përderisa Mexhnuni ishte gjakftohtë, mirë e drejtonte deven, por kur filloi të mendojë për të dashurën e vet, e lëshoi frerin. E hetoi devja se kapistra u lëshua, andaj u kthye ngadalë kah shtëpia. Papritmas erdhi Mexhnuni në vete dhe vërejti se devja ishte nisur drejt shtëpisë së tij. Sërish e ktheu deven dhe u nis në rrugë. Udhëtoi një kohë, dhe kur sërish u zhyt në mendime, kafsha u kthye prapë. Kjo gjë u përsërit disa herë.

“Në luftë me deven, në moment, herë Mexhnuni ishte më i fortë, herë fitonte deveja. Mexhnunit i digjej shpirti për Lejlën, ndërkaq deveve për të voglin e saj”.

Mexhnuni, në një moment zbret në tokë dhe thotë: Oj deve, për shkak që të dy jemi të dashuruar por në drejtime të kundërta, jemi dy udhëtarë jo të denjë”.

Atëherë Mevlana u shpreh në mënyrë metaforike dhe tha:

“Shpirti ka hapur krahët drejt lartësisë, trupi me kthetra e gërvisht drejt tokës”.

Shpirti përmban në vete dy strehimore. Njëra është strehimore e shpirtit të njeriut, ndërsa tjetra është strehimore e trupit të tij.

“Dëshirë e shpirtit të njeriut është përparimi e dinjiteti, ndërkaq dëshirë e trupit është fitimi dhe ushqimi”.

Nëse ke dëshirë që shpirti yt të jetë i lirë, atëherë nuk bën të bëhesh grykës. Nuk mund të jesh i dashuruar e të kesh shpirt të lirë. S'mund të jeshë materialist, miklues dhe tërbues e që shpirti yt të jetë i lirë. Sa e sa shembuj të çuditshëm kemi në këtë sferë! Kam parë një hadith në komentin e “Shtegu i elekuencës” të Ibën el-Hadid-it lidhur me atë që Pejgamberi s.a.v.s. shkoi një ditë tek as'habi Suffe.<sup>12</sup> Njëri prej tyre tha: “O Pejgamber i All-llahut! Unë ndjej në vete se e gjithë bota për mua është e pavlerë. Tani, sipas mendimit tim, ari dhe guri, janë të njëjtë. Pra, asnjëri nuk mund të më tërheq”. Nga kjo kuptohet se shfrytëzimi i arit dhe gurit për të janë të barabartë (në vlerë - sh.p.) dhe se fuqia e arit dhe gurit njëjtë i pëlqejnë. Pejgamberi i ndershëm e shikoi dhe tha: “Unë mund të të them ty se je njeri i lirë. Singerisht liria shpirtërore është një e vërtetë”.

Tani do të sjellim disa argumente tjera morale se personaliteti i njeriut është i ndërlikuar dhe se njeriu, në aspekt të

---

<sup>12</sup> As'habi suffe kanë qenë as'habë të varfër të Pejgamberit s.a.v.s. që nuk ishin nga Medineja. Ishin të shpërngulur dhe pa pasuri e pa gra. Së pari Pejgamberi s.a.v.s. i vendosi në xhaminë e Medines, mirëpo meqë më vonë iu shpall Pejgamberit s.a.v.s. që xhamia nuk është vend për të fjetur e as për gjëra të ngjashme me të. Pejgamberi i vendosi në një plato afër xhamisë. Ata që kanë qenë në Medinen e ndritshme e dijnë se në anën veriore të shtëpisë së hazreti Zehrasë ekziston ajo plato, në të cilën tash rrijnë autoritarët dhe ai është po i njëjti vend ku kanë ndejtur as'habët.

shpirtërores, vërtetë mund të jetë i lirë, por mund të jetë edhe i robëruar.

All-llahu xh.sh. ia dha njeriut këtë mundësi që të mund të jetë gjykatës i vetvetes. Në prani të paditësit dhe të të paditurit gjendet edhe gjykatësi. Njëri person është që padit e tjetri i paditur dhe që të dy shkojnë te gjykatësi, e gjykatësi, patjetër, duhet t'i gjykojë drejt. Natyrisht se paditësi është një person, i padituri tjetër, ndërkaq gjykatësi një person i tretë. A keni menduar ndonjëherë, eventualisht, në atë se një person vetë mund të jetë edhe paditës edhe i paditur por edhe gjykatës. Do të thotë të vetëgjykohet? Ç'do të thotë drejtësi? Për dikë thuhet se është njeri i drejt, ç'do të thotë kjo? Kategorikisht, me person i drejt nënkuptohet personi i cili mund të gjykojë objektivisht lidhur me problemet e tij dhe aty ku nuk është në të drejtë, gjykon kundër vetes. Në cilën mënyrë? Kjo nuk është asgjë tjetër pos personalitet i vërtetë i njeriut të ndërlikuar. Sa raste drejtësie dini në botë, ku një person gjykon veten dhe më tepër don tjetrin kur pranon se tjetri person është në të drejtë? Rahmetliu sejjid Husein Kuhamari ka qenë njëri nga të mëdhenjt, alim (dijetar) dhe merxha e kohës së vet. I lindur është në Azerbejxhan. Është axha i rahmetli ajetullah huxhxe Kuhamarit, i cili gjatë studimeve të mia, ka qenë profesori im. Tek ai kam mësuar. Ishte shumë njeri i ndershëm. Tregohet për një ngjarje shumë të çuditshme që ka ndodhur gjatë jetës së këtij njeriu të madh. Ai ligjëronte një lëndë në qendrën teologjike në Kom, gjatë kohës së sahabiut Xhevahiri, edhe pas tij. Shejh Ensari A'laull-llah Mekame, në atë kohë nuk ishte shumë i njohur. Pak kohë qëndroi në Nexhd, ndërsa pastaj shkoi në Iran, ku vizitoi disa qytete. Aty e takoi dijetarin e njohur dhe një kohë e shfrytëzoi dijen e tij. Një kohë e kaloi në Meshhed, pak më tepër qëndroi në Isfahan, ndërsa një pjesë tjetër të kohës e

kaloi në Kashan, dhe atë kur aty ishte rahmetli Naraki. Në Kashan i kaloi tre vjet pastaj më vonë u kthye në Nexhef. Ai, vërtetë, ishte njeri i dalluar. Thuhet se rahmetli shejh Ensari ka qenë njeri i imët dhe se sytë i ka pasur të sëmurë. Ka pasur trakomë si shumë të tjerë nga Huzestani. Ka jetuar i veçuar, mbante tesha të vjetëruara e të coptuara dhe një çallmë të vjetëruar. Nuk ka pasur më tepër se dy-tre studentë. Ka ligjëruar në një xhami në të cilën, rastësisht, kishte ligjëruar edhe zotri Huseini. Mirëpo, ligjëratat e tij kanë qenë ashtu të caktuara që së pari ligjeronte Shejhu, e kur ai ta kryente ligjëratën, vinte zotri Sejjidi të ligjeronte. Një ditë zotëri Sejjidi hyri në xhami. U kthye nga një vizitë dhe kur pa se nuk kishte më kohë të kthehet në shtëpi, ashtu që kishte vetëm edhe një orë gjer në fillimin e ligjëratës së tij, tha në vete se do të qëndrojë në xhami gjer sa të vijnë studentët. Hyri në xhami dhe në të pa një shejh-dijetar me tesha të coptuara që qëndronte ulur në një skaj dhe u mbante ligjëratë dy-tre vetëve. U ul, dëgjonte dhe konkludoi që shumë mirë ligjeronte. Tani sejjid Huseini është dijetar i mirë dhe i famshëm, së shpejti do të bëhet edhe merxha. E dëgjoi këtë njeri të panjohur për të cilin kurrë më parë nuk kishte dëgjuar. Të nesërmen tha se përsëri do të shkojë pak më herët në mënyrë që të vërtetohet nëse me të vërtetë ishte ashtu si mendoi. Shkoi një orë më herët, u ul anësh dhe u bind se dje mirë e kishte vlerësuar. Vërtetë ky njeri ishte një **mulla** i dijshëm bile edhe më i dijshëm se vetë ai. Duke thënë në vete se do ta provonte edhe një herë, edhe ditën e nesërme e përsëriti veprimin. Tani më e kishte krejtësisht të qartë se ky njeri i panjohur është më dijetar i madh se ai dhe se nga ky mund të përfitonte. Pastaj shkoi në vendin e vet, e kur erdhën studentët e tij, njeriu ende vazhdonte të ligjerojë. Ai tha: ” O studentë! Kam një lajm për ju. Njeriu që rri ulur në atë skaj

është më i dijshëm se unë. Është dijetar. E kam vërtetuar këtë dhe unë do përfitoj nga ligjeratat e tij. Në qoftë se dëshironi realitetin, atëherë edhe ju edhe unë duhet së bashku të shkojmë tek ai në ligjeratë. Me ndihmën e All-llahut, unë shkoj”. U çua ai dhe të gjithë studentët shkuan në ligjeratë te dijetari.

Si duket kjo drejtësi që gjendet brenda njeriut? Ajo është kundërvënje absolute ndaj interesave individuale. Prej atij momenti, zotëri Huseini u bë nxënës i Shejh Ensariut. Don të thotë që një merxha (nëse njeriu shikon merxha-in në kuptim të njeriut të kësaj bote, ëshë një pozitë e lartë), në këtë mënyrë heq veten nga pozita dhe praktikisht ia lëshon tjetrit. Po, a thua vallë, ky njeri nuk e ka kuptuar se çka paraqet pozita e lartë? Ç’do të thotë të jeshë ligjerues? Më siguri, sikur neve ashtu edhe atij, na pëlqen respekti. Edhe atij i pëlqeu posti i lartë, udhëheqësia dhe të bëhet merxha. Nuk mund të thuhet se krejt kjo nuk i ka pëlqyer. Por ky njeri kishte një shpirt të lirë (liberal) që mundi të gjykojë veteveten dhe të sjellë aktgjykimin. Pra, njeriu është një personalitet i ndërlikuar. Njeriu bën gabim, pastaj gjykon veten. Ç’do të thoshte kjo ngrënie e ndërgjegjes? Ç’do të prezetonte ky mundim shpirtëror, të cilin e dëgjuat ju? Shtetet kolonialiste ashtu i ushtrojnë disa persona që ta zhdukin në vete krejt ndërgjegjen. Njëkohësisht, kur vjen momenti, ndërgjegjja për të cilën mendohej së është e vdekur, përsëri ndizet si një kandil i vogël brenda njeriut. Piloti i cili e hodhi bombën atomike në Hiroshimë, ka qenë i edukuar për një krim të tillë. Por, kur mbas hudojes së bombës e shikoi atë qytet se si digjej dhe si në të mundoheshin pleqt, plakat, fëmijët, njerëzit që nuk kishin marrë pjesë aspak në luftë, menjëherë i erdhi keq. Kur u kthye në Amerikë, e pritën me ngrohtësi dhe falënderime, por nuk mund ta pengonin dhembjen e shpirtit-



dhembjen e ndërgjegjjes së tij. Ai nga mundimet shpirtërore u çmend dhe përfundoi në çmenduri. E Kur'ani thotë:

***“Dhe betohem, seriozisht, në shpirtin i cili veten e qorton”.***(75:2).

Njeriu vetë bëhet gjykatës i vetes. Udhëheqësi i besimtarëve thotë: “Njeriut të cilit All-llahu nuk ia ka mundësuar udhërrëfimin, mësimet e huaja tek ai nuk kanë ndikim”.

Ç’do të thotë kjo? Kjo do të thotë që bëni gabim nëse mendoni se mund t’i dëgjoni këshillat e huaja dhe se do të mund t’i shfrytëzoni ato. Së pari duhet të formoni qëndrimet tuaja, të zgjoni vetëdijen e pastaj të pranoni këshillat e udhërrëfyesit tjetër.

Njeriu vetkëshillohet, vetkritikohet dhe vetgjykohet. Ai vetë vlerëson veten. Të menduarit rreth shpirtit është një prej normave të posaçme të fesë sonë. Thuhet: “Peshoje-vlerësoje veten!” Për fat të keq, këto fjalë harrohen. Vlerësonie veten sepse mundet dhe duhet ta vlerësojë vetë:

“Peshonie dhe matnie veten, para se të peshoheni ju dhe veprat e jauja në Ditën e Gjykimit!”<sup>13</sup>

Njeriu e peshon dhe vlerëson vetveten. Njeriu vetveten e ndëshkon. E gjithë kjo verteton atë se ai ka një personalitet të ndërlikuar. Ky personalitet i ndërlikuar ngërthen në vete një qenie të lartësuar e që është pjesa njerëzore e tij, por njëkohësisht posedon një qenie të ulët e që është pjesa shtazarake e tij. Liria shpirtërore ka të bëjë me pjesën njerëzore; ai duhet të jetë i lirë nga pjesa shtazarake e epshore të tij.

Thamë se njeriu ndëshkon vetë vetveten. M'u kujtua komenti i Udhëheqësit të besimtarëve, Aliut a.s. Erdhi dikush te udhëheqësi i besimtarëve dh u pendua. Ai, si shumë të tjerë, mendoi se pendimi qëndron vetëm në fjalët: “Kërkoj

<sup>13</sup> Vesailush-shia, vëllimi 11, f. 38, hadithi 9.

falje nga All-llahu Fuqiplotë”. Emirul-mu’mininë (udhëheqsi i besimtarëve) iu përgjigj ashpër: “Mos të pastë nëna! A e din ti se ç’është të kërkosh falje nga All-llahu? Kërkimi i faljes nga All-llahu është një e arritur në pozitën më të lartë!” Pastaj Aliu a.s. tha: “Kjo është një shprehje që përfshinë gjashtë kuptime”.<sup>14</sup>

Tani do t’i përmendi. Hazreti Aliu a.s. ka thënë që pendim është kur njeriu shpreh keqardhje dhe pendohet për një të kaluar të tij të erët.

E dyta, është një vendim i fortë që në atë kurrë më nuk do të kthehet.

E treta, është që të gjitha veprave t’ua japë hakun që e meritojnë.

E katërta, është ta plotësojë çdo obligim që e ka lënë pas dore.

E pesta, është t’i kundërvihet trupit që është zhvilluar si rezultat i veprimeve të paligjëshme, që ai trup të shkrihet nga brengosja gjer sa të mbetet kockë e lëkurë e që pastaj të zhvillohet mish i ri.

E gjashta, është që trupi të përjetojë dhembjen e dëgjueshmërisë ashtu siç përjetoj kënaqësinë e padëgjueshmërisë. Pra, a thua vallë ka patur njerëz të atillë që janë penduar në këtë mënyrë? Po. Ndërkaq sot pendimi është ndërprerë dhe ne kemi harruar se duhet të pendohemi.

Rahmetli Ahund Mulla Husein Kuli Hamedani ka qenë njëri ndër dijetarët e mëdhenj të etikës dhe sjelljes nga shekujt e kaluar dhe student i Mirza Shirazi Ala-Allah Mekamij shejhut të Ensariut, madje vetë Mirza i famshëm shumë e ka nderuar. Njëri nga dijetarët e mëdhenj që ka qenë student i tij, shkruan se ka ardhur një njeri te rahmetli Ahundi dhe është penduar. Pas disa ditëve është paraqitur po i njëjti

---

<sup>14</sup> Shtegu i elokuencës, Fejzul-Islam. Thënia 409, f.1281.

person, po ishte e pamundur të njihej. Ky person shumë shpejt ishte dobësuar nga trupi. Dëshiroj që këtë aspekt ta shpjegoj në aspekt psikologjik. Pyetem se ç'është kjo që gjendet brenda njeriut? Ahund Mula Husein Kuli Hamedani nuk ka patur as kamxhik, as thikë, as top, as sjellje arroganti. Ai ka patur vetëm fuqi udhëzimi, një fuqi shpirtërore me anë të së cilës në vetëdijen dhe zemrën e tij. Në atë njeri u ngjall vetëdija e shkelur, ashtu iu kundërvu vetvetes, dëshirave fizike dhe fundërive që ishin grumbulluar nga gjunahet. Pas disa ditësh, kur e panë, thanë se nuk e kanë njohur. Aq shumë ishte dobësuar!

Programi më i madh i Pejgamberit s.a.v.s. është liria shpirtërore. Pastrimi i trupit, përgjithësisht, nënkupton lirinë shpirtërore. All-llahu xh.sh. thotë:

***“Ka shpëtuar vetëm ai që atë e pastron. Ka mbaruar ai, i cili e ka shtrembëruar”.*** (91: 9-19)

Problem i kohës sonë është se gjithnjë flasin për lirinë, por, përveç lirisë shoqërore nuk flasin për asgjë tjetër. Me fjalë tjera, nuk flasin për lirinë shpirtërore dhe mu për atë edhe nuk mund ta arrijnë atë liri. Në këtë kohë, një krim i madh, që shqyrtohet në suaza të filosofisë dhe sistemit filosofik, është ai që në princip nuk bisedohet për njeriun, për personalitetin e njeriut dhe vlerës shpirtërore të njeriut. Shpirti është lënë në harresë.

Thonë se diçka e tillë aspak nuk ekziston. Njeriu nuk është një qenie me dy nivele ashtu që të këtë nivel të lartë e të ulët. Aspak nuk ka dallim mes njeriut dhe kafshës. Jeta është luftë për ekzistencë dhe, përveç kësaj, s'paraqet asgjë tjetër. Pra, jeta nuk është gjë tjetër përpos një luftë individuale për vete dhe për interesat e veta. A jeni të vetëdijshëm se kjo fjali sa i ka sjellë dëm njerëzimit? Thonë se lufta nuk është gjë tjetër pos një betejë dhe fushëbetejë. Shfrytëzojnë një

shprehje për të cilën mendojnë se është shumë e vërtetë: “E drejta duhet të merret e jo të jepet”. Mirëpo, e drejta edhe merret edhe jepet, madje përgjithësisht kjo shprehje, që patjetër të drejtën ta marrim e që askush mos të ta japë se, njëkohësisht, zotëri, don të thotë që ti patjetër ta marrish të drejtën tënde, por jo edhe t’i japish tjetrit. Ai që ka të drejtë, nëse mundet, patjetër duhet të vijë dhe ta marrë atë me fuqi, e nëse nuk është në gjendje, atëherë mbetet pa të. Mirëpo të dërguarit (e All-llahut - sh.p.) nuk kanë ardhur për ta thënë këtë. Ata kanë thënë se e drejta patjetër të merret e të jepet. Pra, i propozojnë të shtypurit të shkojë të marrë të drejtat e veta, e në anën tjetër e kanë detyruar tiranin të luftojë vetveten dhe tu jepen të drejtat të tjerëve, dhe në këtë mision ata kanë korrur sukses.



## IBADETI DHE DUAJA I

*“O besimtarë, kujtonie shpesh All-llahun! Dhe Atë adhuronie në mëngjes e në mbrëmje”*.<sup>15</sup>

Disa herë në komentet tona islame ballafaqohemi me faktin se disa gjera lidhur me ibadetin, disa njerëzve, u paraqiten si dilema. Për shembull, në lidhje me namazin na thonë se Pejgamberi fisnik s.a.v.s. dhe Imami i nderuar a.s. (me që kjo qëndron në thëniet e Pejgamberit s.a.v.s. dhe të Imamit a.s.) kanë thënë se është shtylla e fesë.<sup>16</sup>

Pra, nëse fenë e shohim si një tendë që përbëhet prej pëlhurës, litarit, hallkave, gozhdave e shtyllave që e mbajnë tendën, namazi mund të prezantohet si shtyllë e asaj tende. Veçanërisht kjo temë shprehet në atë mënyrë që u përmend në hadithin e Pejgamberit s.a.v.s.

Në lidhje me namazin është thënë që kusht i pranimit të ndonjë veprë të njeriut është pranimi i namazit.<sup>17</sup>

Kjo don të thotë që nëse njeriu bën vepra të mira por nuk falë namaz, apo falë namaz, por jo me korrektësi dhe si të papranueshëm, atëherë edhe veprat e tjera nuk do t'i pranohen. Kusht i pranimit të veprave tjera të mira të njeriut është pranimi i namazit të tij. Në një hadith tjetër qëndron: “Namazi është afrim i secilit njeri të devotshëm”.<sup>18</sup>

Përsëri, në një hadith tjetër qëndron që shejtani gjithnjë ikën nga besimtari përderisa ai përkujdeset për namazin e vet dhe e ruan atë (kohën e namazit - sh.p.). Për këtë ka shumë

---

<sup>15</sup> Kur'an, 33:41-42.

<sup>16</sup> Vesail, vëllimi 3, f. 23.

<sup>17</sup> Po aty, vëllimi 3, f. 22.

<sup>18</sup> Shtegu i elokuencës, tregime të zgjedhura 131, f. 1152.

hadithe e të dhëna, madje nga vetë Kur'ani mund ta kuptojmë domethënien e namazit. Pyetjet që disa herë i parashtrajnë, kanë të bëjnë me disa njerëz që vërtetojnë se nga të gjitha hadithet që ekzistojnë lidhur me domethënien e namazit, bile, më së paku disa sosh, patjetër të jenë të fabrikuar dhe të pavërtetë, joautentik dhe s'prezentojnë thëniet e Pejgamberit s.a.v.s. dhe Imamit a.s. Mbase ato gjëra janë vënë me rastin e paraqitjes masovike të asketëve dhe të adhuruesve të Allahut xh.sh., gjegjësisht kur ekzistonte kërkimi masovik i formave të asketizmit dhe kryerjes së ibadeteve. Ndërsa, veçanërisht, në shekullin e dytë dhe të tretë pas hixhretit, janë paraqitur disa persona nga radhët e asketëve që kanë qenë shumë ekstremë në ibadet dhe veprimtaria e tyre, pak a shumë, i përngjante jetës së murgjve. Prej atëherë kur në botën islame u paraqit misticizmi, vërehet paraqitja e disa njerëzve të cilët të gjithë energjinë e vet e harxhuan në ibadet e namaz, duke i lënë pas dore të gjitha obligimet e tjera islame. Për shembull, në mesin e as'habëve të Udhëheqësit të besimtarëve (Emirul-mu'mininë) kishte një njeri i quajtur Rebia ibën Hasim, për varrin e të cilit paramendohet se gjendet në Mesh'hed. Se a është, vërtet, varri i tij apo jo, nuk jam i sigurtë, marrë parasysh se të dhënat e mia lidhur me këtë nuk janë të mjaftueshme krejtësisht, por ekziston fakti që e konsiderojnë si njërin nga tetë asketët më të njohur të botës islame.

Rebia ibën Hasimi e tepronte me asketizmin dhe ibadetin e vet gjër në atë masë sa që pak para vdekjes, e hapi varrin vetë dhe disa herë shkante dhe hynte në të, duke e këshilluar veten e duke thënë: “Mos harro se këtu do të vijsh!” Të vetmet fjali, përpos dhikrit dhe lutjeve, që i kanë dëgjuar nga ai, kur dëgjoji se belbacakët e kanë vrrarë Husein ibën Aliun, nipin e dashur të Pejgamberit s.a.v.s. ishin ato pak fjali që i

citoi duke shprehur keqardhje për këtë rast: “Mjer për këtë popull që vrau fëmijën e Pejgamberit!” Pastaj u pendua pse i shprehu disa fjali që nuk përmbanin në vete dhikër dhe lutje.

Ky njeri në kohën e udhëheqësit të besimtarëve, Aliut a.s. ishte pjestar i ushtrisë së tij. Një ditë erdhi te udhëheqësi i besimtarëve dhe i tha atij: “O udhëheqës i besimtarëve, ne dyshojmë në këtë luftë, kemi frikë që kjo luftë nuk është sipas parimeve islame”. Me vetë faktin që thotë “ne” nënkuptohet se ka qenë anëtar i ndonjë grupacioni. Pse? “Sepse ne luftojmë kundër atyre që falin namaz nga kibleja, luftojmë kundër atyre njerëzve që edhe ata, sikur ne e shprehin shehadetin, falen sikur ne... “Nga ana tjetër, ishte pasues (shi’a) i udhëheqësit të besimtarëve dhe nuk dëshironte të ndahet. Ai tha: “O udhëheqës i besimtarëve, ju lutem më caktoni një detyrë në të cilën nuk do të dyshoja, më dërgoni diku ku nuk ka dilema”.<sup>19</sup> Udhëheqësi i besimtarëve tha: “Mirë pra, nëse vërtet ti dyshon, atëherë do të dërgoj në ndonjë vend tjetër. “Nuk e di nëse ai vetë kërkoi apo hazreti Aliu a.s. e dërgoi në një qytet kufitar ku edhe atje, përsëri, ishte ushtar. Ai dëshiroi të kryejë veprimtari ushtarake, por të jetë në qytetin kufitar të shtetit islam dhe nëse, rastësisht, fillon lufta dhe gjakëderdhja, armiq të tij të jenë jobesimtarët ose idhujtarët e assesi muslimanët.

Ky ishte një shembull lidhur me asketët dhe adhuruesit e All-llahut xh.sh. që jetuan në atë kohë.

Sa vlerë ka një ibadet dhe një asketizëm i këtillë? Aty ku duhet të përcillet një person sikur Aliu a.s., nuk sheh vlera, kurse në rrugën në të cilën ai çon dhe atje ku ai

---

<sup>19</sup> Në muajin Ramazan, vetë kam ligjeruar përpara një tubimi të nderuar mbi havarixhët, dhe kam shpjeguar se cilat janë ato rrjedha, shkaktarë e faktorë që bënë të paraqitet një grupacion i cili haptas dukej se është i devotshëm, por nuk e njihnte kulturën islame.

urdhëron për xhihad, dyshon se është e drejtë apo jo e drejtë e bëhet i kujdesshëm. Sikur me të duan të thonë: ”Pse të agjërojmë kur dyshojmë?” Me fjalë tjera, në mes njerëzve shpeshherë përmendet kjo thënie: “Pse të agjërojmë me një dozë dyshimi? Çfarë akti është ai? Pse të luftojmë aty ku dyshojmë? Çfarë vlere ka ajo? Për Islam duhet patur zgjuarësi, madje vepra dhe bindje. Ky njeri (Rebia) nuk është i bindur në atë që bën. Ai jeton në kohën e zullumqarit Jezid i cili kreu njërin nga krimet më të mëdha në historinë e Islamit, duke hedhur posht mundin e Pejgamberit s.a.v.s.

Zotëriu shkoi në një skaj dhe e pa të udhës të falet ditë e natë, pa ndërprerë dhe përveç emrave të All-llahut të mos përmend fjalë tjetër. Për një fjali që e shprehu në shenjë keqardhje për vrasjen e Husein ibën Aliut, më vonë u shpreh se ka gabuar dhe pyeste veten pse tha: “Subhanell-llah” ose : “Ja Hajju, ja Kajjumu” e nuk tha: “All-llahu ekber!” ose: “La havle ve la kuvvete il-la bil-lah?” Një qëndrim i këtillë s’është në përputhshmëri me mësimet islame. “Xhahili (inJORanti) lëviz shumë shpejt ose ngadalë”.<sup>20</sup>

Disa njerëz thonë që ky pohim sipas të cilit namazi është shtyllë e fesë, aspak nuk është në përputhshmëri me mësimet islame. Islami është fe e cila më tepër se gjithçka u jep rëndësi çështjeve shoqërore.

*“All-llahu urdhëron drejtësi dhe mirësi, ndihmë dhe respekt...”* (16:90)

*“Ne i kemi dërguar pejgamberët Tanë me argumente të qarta dhe me ata kemi shpallur librin dhe peshojën që njerëzit të sillen me drejtësi”.*(57:25)

Islami është fe e **emër bil-m’arufi** (të urdhëruarit në të mirë) dhe i **nehji anil-munkeri** (të ndaluarit nga e keqja).

---

<sup>20</sup> Shtegu i elokuencës, hikmet 67, f. 1116.



***“Ju jeni populli më i mirë i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqia dhe të besoni All-llahun”.***(3:110)

Islami është fe e aktiviteteve, praktikës dhe punës. Islami është fe madhështore. Si është e mundur feja e cila aq shumë u jep rëndësi çështjeve të praktikës, që lutjeve t’u kushtojë aq vemendje? Jo, atëherë në esencë, çështja e ibadetit në botën islame nuk do të ketë domethënie. Përcillni mësimet morale-islame si dhe mësimet shoqërore-islame. Çështjet e ibadetit u takojnë të papunëve. Ata që nuk kanë asnjë punë, patjetër të falen e të bëjnë ibadet, por njeriu që bën punë të rëndësishme, më nuk e ka të patjetërsueshme të bëjë ibadet! Edhe ky është mendim i gabuar, dhe atë shumë e më shumë i rezikshëm! Njeriu patjetër duhet ta njohë Islamin ashtu si është në të vërtetë. Fatkeqësisht, prej atyre që kanë entuziazëm islam, shumica (natyrisht, nuk them të gjithë) janë të ndarë në dy grupe. Njëri grup mendon sikur Rebia ibën Hasim. Për këta Islami nënkupton dhikër, lutje, falje të namazeve nafile, shkuarje në haxh, lexim të zijaretit “Ashure”. Islami për ta është libër Mefatih (çelësash) dhe libër i Zadul-mead (ushqim për Ditën e gjykimit). Për ata i tërë Islami është i përmbledhur në librin Mefatih dhe përveç saj, kryesisht, nuk ekziston gjë tjetër. Plotësisht mëndojnë sikur Rebia ibën Hasimi. Aspak nuk i kushtojnë rëndësi jetës së kësaj bote, nuk u kushtojnë kujdes rregullave shoqërore po as principeve dhe edukatës islame. Asnjë gjëje nuk ia vënë veshin. Si reaktion ndaj qëndrimit të tyre të këtillë, u paraqit një grup ekstrem që u kushton rëndësi çështjeve shoqërore-islame dhe shpreh ndjeshmëri. Njerëzit e këtillë, në këtë aspekt, janë shumë të shkathtë. Disa prej tyre janë të pasur por nuk shkojnë në Meke (haxh-sh.p.) duke patur parasysh se në atë nuk shohin diçka të rëndësishme. Këta njëerëz që

janë muslimanë të vërtetë kanë interesim për Islam dhe zemra u reh për Islam, por, përsëri, nuk shkojnë në Mekë. Nuk i kushtojnë rëndësi namazit. Nuk i kushtojnë rëndësi çështjes së domosdoshmërisë së taklidit (përcjellja e ndonjë muxhtehidi). Duke marrë parasysh se taklidi është një akt nacional, thonë: Zotëri, duhet që ose vetë t'i kuptosh disa çështje drejtëpërdrejt, siç është namazi dhe agjërimi; pra patjetër të jeshë aq ekspert ashtu që në mënyrë të pavarur në përputhshmëri me eksperiencën tënde t'i kuptosh; ose të jeshë i kujdesshëm, gjë që do ta vështirësonte punën tënde; ose të zgjedhish një dijetar të gjithanshëm e të drejt, sikur me rastin e ndonjë sëmundje kur të shkojsh te mjeku specialist dhe sillesh sipas mendimeve të tij. Nuk është e mundur që njeriu mos ta praktikojë taklidin. Kjo don të thotë nëse nuk përcjell ndonjë dijetar, do të hasish në vështirësi edhe më të mëdha. Ose ka njerëz që nuk i kushtojnë rëndësi agjërimit. Nëse, për shembull, nisin për rrugë dhe nuk agjërojnë, pastaj nuk duan t'i plotësojnë ditët që nuk i kanë agjëruar. Edhe ata konsiderojnë veten si muslimanë shembullorë, edhe pse as grupi i parë e as i dyti, nuk janë muslimanë të përkryer.

Islami nuk është fe që thotë:

“Disave u besojmë e disa i mohojmë”.

Njeriu në Islam nuk mund të bëjë ibadet e të mos i vë vesh moralit të vet, problemeve shoqërore dhe principeve të mënjanimimit nga veprat e liga dhe kryerjes së veprave të mira. Kur Kur'ani thotë: ”Falënie namazin!” pastaj shton: “Epnije zekatin!” Nëse thotë që patjetër duhet të kryeni faljen e namazit, e pastaj vazhdon që patjetër duhet të jepni zekat, atëherë falja e namazit do të bëhej një lidhje në mes robit dhe All-llahut, ndërkaq dhënia e zekatit do të paraqiste një lidhje në mes robit dhe robërve të All-llahut. Muslimani obligohet të vëjë lidhje të pandërprera e të pandryshueshme në mes

vetes dhe Krijuesit të vet dhe patjetër të vëjë marrëdhënie të përherëshme në mes vetes dhe shoqërisë-bashkësisë të cilës i takon. Pa ibadet, pa dhikër (të përmendurit All-llahun), pa lutje drejtuar All-llahut, pa praninë e zemrës, namazit, agjërimit, nuk mund të formohet një shoqëri islame, madje as vetë njeriu nuk mund të mbetet i shëndoshë. Njëherit, pa një shoqëri të mirë, midis të shëndosh, *emër bil-m'arufi-n ve nehji-n anil-munkeri*, pa lëmoshë, përkujdesje dhe solidaritet në mes muslimanëve, nuk mund të jeshë abid (adhurues-rob) i mirë. Nëse përmes një shikimi e vëreni Ali ibën Ebi Talibin a.s., do të shihni se ai është abid i vërtetë dhe i pari në mesin e abidëve të botës, ashtu që ibadeti i tij bëhet shembull për të gjithë, sepse ky nuk ishte vetëm ibadet i lëvizjeve fizike, por ibadet bekimi, entuziazmi, dashurie, i të qajturit e lotëve.

Kur Aliu a.s. ndërroi jetë, një njeri i quajtur Zarar u takua me Muaviun. Muaviu e dinte se ai është njëri prej shokëve të Aliut a.s. andaj kërkoi nga ai t'ia përshkruajë Aliun a.s. meqë ky kishte qenë në kontakt me të. Vetë Muaviu e njihte Aliun a.s. më mirë se cilido tjetër, njëkohësisht e donte atë njeri. Ai nga thellësia e shpirtit e nderonte Aliun a.s. ashtu si shejtani që i besoi Ademit a.s., por njëkohësisht nuk ngurroi të veprojë keq kundër tij.

Zarari, njëri nga dëshmitarët që e ka parë Aliun a.s., i tregoi Muaviut që e ka parë një natë Aliun a.s. në mihrab duke u falur. Tha se i përngjante një personit që e ka kafshuar gjarpëri dhe atij që prej frikës ndaj All-llahut ishte krusur në mihrab, duke qarë e lotuar si ndonjë njeri shumë i sëmurë, vazhdimisht duke thënë: “Medet nga zjarri i Xhehennemit!” Muaviu filloi të qajë. Gjithashtu, kur një rast u takua me Adij ibën Hatemin (pas vdekjes së Aliut) Muaviu u mundua ta nxisë kundër Aliut a.s. E pyeti Adiju: “Ku janë Tarifi, Turfi e Tarefi?” Adiju kishte tre djem të quajtur kështu, të cilët ranë

shehidë duke i shkuar pas Aliut a.s. Muaviu dëshironte ta ngacmojë dhe t'ia përkujtojë vdekjen e bijve të tij, në mënyrë që ai bile të thoshte një fjalë kundër Aliut a.s. Adiju tha: "Të gjithë janë vrarë në luftën e Sifinit, në shoqërim të Aliut a.s.". Muaviu ia ktheu: "Por nuk ka qenë i drejt ndaj teje, i fshehu bijt e vet, Hasanin dhe Huseinin, ndërsa fëmijët tuaj i nxori përpara në mënyrë që të vriten". Aliu në këtë u përgjigj: "Nuk kam qenë i drejt ndaj Aliut sepse sikur të isha, tani s'do duhej që Aliu të jetë nën tokë, e unë të mbetem gjallë". Muaviu e pa se shigjeta e tij s'e qëlloi cakun e tha: "Dua të ma thuash të vërtetën mbi Aliun". Adiju e përshkroi atë gjërësisht. Kur e përfundoi pa si ridhnin lotë nëpër fytyrë të Muaviut. Duke fshirë lotët me duar, tha: "Medet! Koha dhe bota janë sterile që të sjellin një njeri sikur Aliu". A shihni ku qëndron e vërteta? Ky ka qenë ibadeti i Aliut a.s. Por, a ka qenë Aliu i vetmi njeri i mihrabit dhe se pos tij nuk është paraqitur tjetër?

Sërish shohim se Aliu a.s. në çdo aspekt ka qenë njeriu më i shoqëruar, si dhe më i informuar mbi të ngratët dhe të varfërit si dhe mbi ata që ankoheshin. Me që ishte halif, kamxhikun e tij e vuri në krah dhe shkoi në mesin e njerëzve, duke u kujdesur për punët e tyre. Kur të takohej me tregtarët, do të thoshte: "Shkoni së pari mësoni zanatin e tregtisë, rregullat ligjore, e pastaj ejani të bëni tregti! Mos merreni me punë të ndaluara-haram! Mos fitoni pasuri të paligjshme".<sup>21</sup>

Kështu ka qenë ky njeri abid! Për këtë hadith për herë të parë kam dëgjuar nga rahmetli ajetullah Buruxherdiu. Një ditë prej ditësh e ndoqi pas një lypsak që lypte diçka nga ai. E shikoi në fytyrë dhe pa se ai mund të punojë e të fitojë dhe se lypjen e kishte bërë profesion. E këshilloi duke ia përkujtuar thënien e Aliut a.s. I tha se Udhëheqësi i urdhëronte njerëzit

---

<sup>21</sup> Vesail, vëllimi 12, f. 282.

që herët në mëngjes të shkojnë me mburrje të punojnë dhe të fitojnë bukën me djersën e vet. Njeriu është i çmueshëm kur ka pasurinë e vet dhe fiton për jetën e vet. Puna dhe veprimtaria janë mburrje e dinjitet. Thuhet se ky është një shembull i një muslimani të vërtetë. Në lutje është më i miri. Kur gjykon, është gjykatës i drejt i cili nuk lëshon pe në drejtësi, kur shkon në luftë, është ushtari i parë e kur të bëhet udhëheqës është i klasit të parë. Ai vetë thotë: “Që nga rinia e hershme kam luftuar dhe në të kam përvojë”. Kur merrte pozitën e predikueit-ishte më i miri, kur qëndronte në pozitë të mësimdhënësit-ishte më i miri mësimdhënës e ligjerues. I tillë ishte në çdo virtyt të tij. Ky është shembull i përsosur i Islamit. Islami kurrë nuk e pranon: “Disave u besojmë, disa i mohojmë”, me fjalë tjera, s'mund të pohojmë që nga një kënd të pranojmë Islamin, ndërsa nga këndi tjetër ta mohojmë, kështu që në këtë mënyrë, pashmangshëm, të shkatërrojmë gjithëçka. Sikur që është mënyra e shumë asketëve tanë nga e kaluara, edhe ky person bën gabim i cili tërë Islamin e sheh në librin Mefatih (Çelësat) dhe në duatë-lutjet ashtu sikur që është gabim edhe mënyra e personit që assesi nuk u kushton vemendje duave-lutjeve, nafileve dhe obligimeve fetare.

Në Kur'an thuhet: ***“Muhammedi është i dërguar i Allahut, kurse ata që janë me të janë të ashpër ndaj mosbesimtarëve, por të mëshirshëm në mes veti”*** (48:29).

Këtu është prezetuar pasqyra e shqërisë islame dhe çështja e parë që ka të bëjë me Pejgamberin .s.a.v.s. dhe me besimin në të. Çështja e dytë: “të ashpër ndaj mosbesimtarëve” është çështja e ngritjes kundër mosbesimtarëve. Këta besimtarë formal janë sikur qilimat e xhamisë që një mijë e një ushtarë mund t'i ketë para vetes dhe që assesi nuk bëjnë zë, s'mund të jenë muslimanë. Njëra nga vlerat e muslimanit, njëherit vlera e parë që përmendet në Kur'an është ashpërsia,

forca dhe fuqia kundër armikut. Islami s'e pranon muslimanin e dobët.

***“Dhe mos ligështoheni e as mos u pikëlloni. Ju jeni më të lartit, nese jeni besimtarë”*** (3:139).

Në Islam nuk ka vend dobësia. Vill Durant në librin “Historia e civilizimit”, thotë: “Asnjë fe nuk është si Islami, i cili i fton ithtarët e vet të jenë të fortë e të qëndrueshëm”.<sup>22</sup>

Të bëhesh lypsak, të nënçmosh vetveten, të bëhesh zullumqar, të bëhesh varfnjak, të kërkosh drejtësinë pa arsye, të gjitha këto janë në kundërshtim me Islamin.

***“Dhe për të mirat që të dha Zoti yt, trego!”*** (93:11)

All-llahu ty të ka dhënë shëndet, forcë e fuqi. Ti që mund të ecish drejt, përse, pa arsye ecish krusur? Përse rënkon pa arsye? Të rënkosh do të thotë të keshë ndonjë dhembje, ndërkaq All-llahu nuk të ka dhënë asnjë sëmundje, e pse, pra, rënkon? Kafshon dorën që të ushqen. A ka ecur Aliu a.s. kështu sikur ecim unë e ti? A thua Aliu e ka fshehur kokën nën zhgunë dhe ka ecur andej-këtej? Të këtillet (që veprojnë kështu - sh.p.) nuk janë muslimanë.

***“...kurse ata që janë me të janë të ashpër ndaj mosbesimtarëve”***.(48:29)

Si sillen mes vete, me muslimanët... po ata janë ndaj njëri-tjetrit të mëshirshëm... Sillen butësisht, miqësisht dhe përziemërsisht. Përsëri, kur interesohemi për njerëzit tanë që veten e paraqesin si kandilë, atë që fshehin në shpirt e që nuk mund ta shohim, është dashuria e dashamirësia ndaj të tjerëve. Gjithnjë janë të vrenjtur, të vrazhdë, nuk shoqërohen me askend, s'buzëqeshin fare. Të gjithë njerëzit u janë borxhlinj. Ata s'janë muslimanë, e paraqiten sikur janë. Kjo ishte karakteristika e dytë. Pra, a mjafton e gjithë kjo? Ashpërsia

---

<sup>22</sup> Po aty, vëllimi 12, f. 4.

ndaj mosbesimtarëve dhe dashamirësia e dashuria ndaj muslimanëve, a do të mjaftonin që ta formonin dikë musliman? Jo!

***“...i sheh si përkulen dhe bien me fytyrë për toke (bëjnë sexhde) duke dëshiruar mirësinë e All-llahut dhe kënaqësinë e Tij...”*** (48:29).

Njëkohësisht, kur këtë person që është i ashpër ndaj jobisimtarëve, ndërsa i dashur dhe dashamir ndaj besimtarëve, e shihni në mihrab e në ibadet, përkushtim ndaj All-llahut, në ruku (që përbëhet me krusje të pjesës së epërme të trupit, duke i kapur me dy duar gjunjë ashtu që shpina të jetë në linjë të drejtë me kokën), sexhde (lëshim me fytyrë në tokë, duke kërkuar shpërblimin dhe kënaqësinë e All-llahut), është lutja e tij. Natyrisht këtu s'do të tërheq vijë midis duasë dhe ibadetit. Duaja është ibadet, dhe e kundërta: ibadeti është dua, por ndonjëherë ndonjë veprim është vetëm dua. Do të thotë ka ibadet që është vetëm dua, e ibadeti tjetër përbëhet prej duave e lutjeve, por s'është lutje sikur namazi, ose ndonjë lloj ibadeti tjetër që në thelb s'është lutje, siç është agjërimi.

***“...Në fytyrë kanë shenjat, gjurmët nga të rënat me fytyrë për toke (në sexhde)...”*** (48:29).

Aq bën ibadet sa që ibadeti lë gjurmë, e vlera dhe devotshmëria shihen në fytyrë besimtarit dhe kushdo që e shikon, në të vërenë devotshmëri dhe përkujton All-llahun. Në një thënie, mbase është hadith i Pejgamberit s.a.v.s. qëndron se njëri nga apostujt e Isait, të birit të Merjemes, pyeti: “O Isa, me kend të shoqërohemi?” Ai u përgjigj:

“Shoqërohuni me atë person që kur ta shihni atë, e përmendni All-llahun. Kur në fytyrë të tij vëreni frikë ndaj All-llahut e devotshmëri, ndërsa kur flet, fjalët e tij u sjellin

dobi ashtu që dija juaj zgjerohet. Kur t'i shihni veprimet e tij, bëni vepra të mira. Shoqëroheni, pra, me njerëz të tillë!”<sup>23</sup>

Në vazhdim të ajetit (të lartëshënuar-sh.p.) thuhet:

**“...Ai është përshkrimi i tyre në Tevrat, kurse përshkrimi i tyre në Ixhil është: ata janë si bima kur lëshon filizin e pastaj e forcon, trashet dhe pjek frutin e vet duke nxitur entuziazëm të mbjellësit e për t'i zemëruar me të mosbesimtarët”. (48:29)**

Kështu përmenden në Tevrat dhe në Inxhil. Atyre u është thënë se kështu do të formohet një popull i këtillë. Në këtë mënyrë kanë shpjeguar ata. Shembulli i tyre mund të krahasohet me një shembull bujqësie, kur një farë gruri mbillet në tokë e pastaj mbinë nga toka dhe rritet. Në fillim bëhen gjethe të holla, por më pastaj gjethi rritet dhe forcohet ashtu që gradualisht bëhet kërcyll.

Ajo e merr formën në bazë të së cilës mund qëndroje e paravarur, edhe më parë ishte vetëm një gjeth jo i pavarur në tokë. Rritet ashtu që nxitë habinë e të gjithë bujqve dhe të ekspertëve antropologë. Sa popull i devotshëm është ky! Natyrisht, ai popull i cili është i ashpër ndaj mosbesimtarëve ndërsa i mëshirshëm është mes vete, madje bie në sexhde duke dëshiruar shpërblimin dhe kënaqësinë e All-llahut, patjetër të jetë i këtillë. E tani, tregoni, pse ne muslimanët aq shumë humbim? Përgjithësisht, cila prej këtyre tipareve, pra, gjendet në ne, dhe çka na pret?

Duke marrë parasysh se ne pranojmë që Islami është një fe shoqërore dhe se kjo është rezultat i normave të tij, nuk mund të lejojmë që e gjithë kjo të shkaktojë që ne mos të lutemi e të mos bëjmë ibadet si dhe të shikojmë me nënçmim atë që ka të bëjë me All-llahun, kurse faljen e namazit ta

---

<sup>23</sup> Usul kafi, v. 4; Fadlu-ilmi, kreu Mexhlisul-ulumi ve sahabetuha.



konsideojmë si të pavlerë. Njëri prej mëkateve është që namazi të konsiderohet i parëndësishëm. Të mos falësh namaz është mëkat i madh, ndërsa të falësh e namazin ta konsiderosh të parëndësishëm, është mëkati tjetër. Pasi ndërroi jetë imam Sadiku a.s., erdhi Ebu Besiri te Ummul-Hamide t'i shprehë ngushëllim. Ummul-Hamideja filloi të qajë, njëherit edhe Ebu Besiri, që ishte i verbër. Me atë rast Ummul-Hamideja i tha Ebu Besirit: “Ebu Besir! Nuk ishte të shohish çastet e fundit të imanit, ndodhi diçka e çuditshme. Imami, papritmas, u alivanos, pastaj i çeli sytë dhe tha: “Thirrni të gjithë të afërmit e mi, të vijnë te unë”. Iu përgjigjëm urdhërit të tij dhe i thirrëm që të gjithë. Kur u mblodhën të gjithë, gjer sa imami ishte në çastet e fundit të jetës së vet, menjëherë i çeli sytë dhe iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: “Kur shefa’ati (ndërmjetësimi) ynë s’do t’u arrijë njerëzve që nuk kushtojnë rëndësi namazit”. I tha këto fjalë dhe ndërroi jetë.

Imami nuk tha se shefa’ati i tyre nuk do të arrijë te njerëzit që nuk falen. Krejtësisht është e qartë. Ai tha që ai nuk do të arrijë te ata që nuk i kushtojnë rëndësi namazit. Ç’do të thoshte kjo “nuk i japin rëndësi namazit?” Me fjalë tjera, nëse njeriu ka rast e kohë të falë namaz mirë e qetë, por përsëri atë nuk e bën. Nuk e falë drekën e më vonë edhe ikindinë, e pastaj së shpejti merr abdes, falet shpejt e shpejt dhe pastaj ulet me një anë. Don të thotë e falë namazin pa qëllim, pa qetësi dhe pa zemër, duke i thënë vetes: “Paj, mirë, edhe kjo është një punë që patjetër ta kryejmë”. Kjo don të thotë se s’i kushton rëndësi namazit. Falja e këtillë e namazit shumë dallon nga ai namaz që e mirëpresim. Tamam në kohën e drekës shkon ngadalë të marrë abdes e pastaj shkon në musal-la (vendin e faljes), thërret ezanin dhe ikametin dhe në mënyrë të rehatshme falet. Nuk largohet menjëherë sapo të

thotë: “Esselamu alejkum”. Pas një kohe, me zemër të qetë, i bën dhikër All-llahut dhe bën duanë e namazit.

Kjo është një shenjë, pra se në këtë shtëpi respektohet namazi. Te ata njerëz që namazin e vet e konsiderojnë si të parëndësishëm, namazi i sabahut është para lindjes së diellit, i drekës dhe ikindisë është para perëndimit të diellit, ndërsa akshamin dhe jacinë e kanë katër orë pas fillimit të territ dhe falen me nxitim. Ju, nëse vërtetë dëshironi të faleni po edhe fëmijët tuaj të falen, atëherë nderoni namazin! Nuk them të faleni, por diç më tepër: ta respektoni namazin. Së pari caktoni në shtëpi një vend ku do kryeni faljen e namazit (kjo është mustehab, vepër e lëvduar sipas parimeve islame). Pra, zgjidhnie një vend në shtëpi për namaz. Rregulloni për vete një mihrab, në qoftë se keni mundësi, ashtu sikur që kishte Pejgamberi s.a.v.s. një musal-la- vend për faljen e namazit. Nëse nuk keni dhoma të mjaftueshme, aty në dhomën tuaj caktonia veten një vend për faljen e namazit. Patjetër duhet të keni një sexhade të pastërt. Kur të përgatiteni për namaz, vëndonie sexhaden e pastërt, lani dhëmbët e merrni tespihët. Kur të merrni abdes, mos nxitoni. Ne veten e konsiderojmë shiit-ithtarë të Aliut a.s. Vëlla, nuk mund të bëhemi shiit vetëm me emër. Ai që e shpjegoi abdesin e Aliut a.s., tha: Erdhi Aliu a.s. të marrë abdes dhe me të prekur të ujit tha: “Në emër Tënd dhe për ty, o All-llah! Më llogarit në mesin atyre që pendohen dhe janë njerëz të ndershëm!

Para dy ditësh fola për pendimin dhe thash që pendim don të thotë pastrim i vetes. Aliu a.s. kur e prekte ujin, duke ditur që uji është shenjë pastërtie, i përkujtonte pendimin. Me të larë të duarve, menjëherë i përkujtohej pastrimi i shpirtit të tij. Na thonë që kur ta shikosh ujin, këtë mjet që All-llahu e caktoi për pastrim dhe dëshiron t’i lajsh duart, kupto se ka edhe pastrime tjera edhe ujë tjetër, e ai pastrim është pastrimi

i shpirtit, ndërkaq ai ujë është uji i pendimit. “Pra, kur Aliu a.s. lanë dhe pastron fytyrën, nuk kënaqet vetëm me kaq, sepse Islami nuk është i kënaqur me atë. Kjo është një vepër e mirë dhe patjetër të jetë, por përkrah kësaj pastërtie duhet të ekzistojë edhe lloj tjetër pastërtie”.

Thuhet se Aliu a.s. kur i ka larë duart dhe fytyrën, ka thënë: “O All-llah, ma zbardho fytyrën time atë Ditë kur do të zbardhen fytyrat e robërve Tu të dashur, e mos ma nxijë fytyrën atë Ditë kur do të nxihen fytyrat e armiqve Tu!” Duke larë krahun e djathtë thoshte: “O All-llah! Ma jep në Ditën e Gjykimit fletdëshminë e veprave të mia në krahun e djathtë!” (njerëzve të mirë do t’u jepet fletëdëshmia në anën e djathtë).

“O All-llah ma lehtëso gjykimin në Ditën e Gjykimit!”  
(kujtoje gjykimin e asaj Dite)

Duke larë dorën e majtë, tha: “O All-llah! Mos ma jep fletëdëshminë e veprave të mia në krahun e majtë e as pas shpine. (Në Ditën e Gjykimit, njerëzve të ligë, fletëdëshmia do t’u jepet nga ana e majtë dhe pas shpine, dhe kjo ka fshehtësinë e vet). O All-llah! Mos ma lidhë për qafe, këtë dorën time, me zinxhirë të nxehtë! O All-llah! Prej Teje kërkoj mbrojtje nga zjarri i Xhennemit!” Thuhet se pastaj vetë e ka parë se si Aliu a.s. ka marrë mes-h (duke prekur me gishta një pjesë të kokës, si pjesë e abdesit) dhe ka thënë:

“O All-llah m’i përforco këmbët e mia në urën e siratit (sirat është ura e rrezikshme, rrugë e cila sipas besimit Islam çon drejt Xhehennemit, mbi të cilën, patjetër të kalohet për të shkuar në Xhennet, e mos lejo që atë ditë të dridhen kur duhet të ecin”.

“O Zot! Veprimet e mia dhe angazhimin tim, mënyrën dhe lëvizjet e mia udhëzoji në atë rrugë që Ti je i kënaqur”.<sup>24</sup>

---

<sup>24</sup> Vesail, vëllimi 1, f. 282; Arbain shejh Behai, hadithi 5.

Abdesi që lyp aq kujdes, do të pranohet në një mënyrë, kurse abdesi të cilin ne e marrim, do të pranohet në mënyrën tjetër. Prandaj s'mund ta kuptojmë lehtë namazin. Njeriu nuk mund të kënaqet vetëm me atë që të kryejë vetëm atë që është e domosdoshme në namaz. Të thotë se do të shkoj të shoh se ç'thonë fetvatë, merxha e taklidi (autoritet e mëdha islame që i pasojnë muslimanët). A është e domosdoshme që në namaz të shprehim diçka nga tri herë, apo mjafton vetëm një herë?

Pra, muxhtehidi patjetër ta thotë fetvanë e tij. Ai thotë se një herë mjafton, ndërkaq mustehab është, për shkak të precizitetit, të thuhet tri herë. Në bazë të kësaj, nuk guxojmë të themi se një herë mjafton, atëherë as ne nuk do ta shprehim më tepër. Kjo do të thoshte ikje nga namazi. Ne duhet patjetër të sillemi në atë mënyrë që, nëse muxhtehidi thotë se një herë është vaxhib ndërsa dy herët tjera janë mustehab, t'i shprehim, në mënyrë respekti edhe ato dy herët e tjera.

Gjithashtu nuk guxojmë këtë ta marrim me lehtësi dhe pa respekt. Diša njerëz ashtu agjërojnë që të thonë (këtu mahitem): "Sikur të isha në vend të Zotit, neudhu bil-lah (na e falë, o Zot), assesi nuk do ta pranoja agjërimin e tyre. Njoh diša njerëz që gjatë muajit të Ramazanit nuk flejnë tërë natën, gjer në mëngjes, por jo për të bërë ibadet, por vetëm që kohën të mos e kalojnë në gjumë. Gjer në mëngjes pinë çaj e duhan. Në mëngjes falen dhe bien në gjumë. Më vonë zgjohen që me nxitim ta falin namazin e drekës e më pastaj edhe të ikindisë e pas kësaj ulen pranë sofrës për iftar. Çfarë agjërimi është ky që njeriu gjatë natës të mos flejë, në mënyrë që gjatë ditës (agjërimin) të flejë e të mos përjetojë vështirësi nga agjërimi. Po a nuk është ky nënçmim i agjërimin. Sipas mendimit tim, sikur nënçmohet agjërimi, kjo i vjen sikur të thuash: "O agjërim aq të urrej sa që nuk dua të dëgjoj për ty!"

Shkojmë në haxh, por e nënçmojmë. Agjërojmë dhe e nënçmojmë, falemi, edhe atë, e nënçmojmë, thirrjmë ezanin dhe e nënçmojmë. Tani parashtrahet pyetja si e nënçmojmë ezanin? Mustehab është që muezini (lajmruesi për namaz) të ketë zë të bukur, siç është leximi i Kur'anit me texhvid (rregull fonetike për leximin e drejt të Kur'anit), don të thotë se shqiptimi i fjalëve që ndikojnë më tepër në zemër, është bërë traditë. Mustehab është që muezini të ketë zë të bukur në mënyrë që t'i kënaq njerëzit e t'i bëjë ta përkujtojnë All-llahun. Ka shumë njerëz që kanë zë të bukur, por, po t'u thuash ta thirrin ezanin, nuk pranojnë. Pse? Sepse mendojnë që kjo nuk u shkon për shtati. Po a kaq e parëndësishme qenka të bëhesh muezin? Zotëri!! Ti duhet të mburrësh me atë që je muezin. Ali ibën Ebi Talibi a.s. ka qenë muezin. Atëherë kur ishte halif, ishte dhe muezin. Është një nënçmim i ezanit që dikush të turpërohet nëse e ka patjetër ta thërret ezanin, ose konsideron që të jeshë muezin varet nga autoriteti i njeriut. Ai pyet veten pse unë, që jam i pasur ose funksionar, të bëhem muezin. E gjithë kjo është nënçmim, përbuzje.

Mu për këtë nuk lejohet ta nënçmojmë ibadetin dhe duhet të jemi muslimanë të përkryer. Vlera e Islamit shihet në gjithëpërfshirjen e tij. Nuk guxojmë të lejojmë që vetëm të bëjmë ibadet, ndërsa të gjitha të tjerat, përveç ibadetit, t'i lëmë pas dore, madje të mos bëhemi sikur ata që pak kohë më parë janë paraqitur, duke i vlerësuar mësimet shoqërore islame, kurse në anën tjetër e nënçmojmë ibadetin.

Në dhashtë Zoti, do ta vazhdojmë këtë diskutim. Do të flas për vlerat e ibadetit që kanë të bëjnë me obligimet e tjera islame. Krahas asaj që ibadeti bazë e afrimit drejt All-llahut, është me sa vijon:

***“...pranadaj vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më përkujtuar”. (20:14)***

Qëllimi i vetëm i namazit është që njeriut t'ia përkujtojë All-llahun dhe ta afrojë te Ai. Përveç kësaj, nëse e nënçmojmë ibadetin, do të ngecim në lidhje me obligimet tona të tjera. Ibadeti paraqet një fuqi zbatuese dhe garanci për kryerjen e dispozitave tjera islame.



## IBADETI DHE DUAJA II

Duaja-lutja mbronë nga korrupcioni dhe nga gjithë çka është e keqe; të bëjsh dua-lutje konsiderohet dëgjueshmëri më e madhe! "...e All-llahu e di se ç' veproni ju". (29:44)

Në Islam, krahas asaj që adhurimi dhe robërimi ndaj All-llahut është burimor, ai mund të numërohet edhe në programin edukativ. Kur thuhet se robërimi ndaj All-llahut përmban diç burimore, pa marrë parasysh se për ç'drejtim dhe për cilat çështje njerëzore është fjala, kjo do të thotë se ibadeti është njëri prej qëllimeve të krijimit.

***"Nuk i kam krijuar xhinnët dhe njerëzit pos për të më adhuruar Mua"*** (51:56)

Ibadeti është mjet për afrim te All-llahu xh.sh. dhe është i krijuar për një zhvillim të vërtetë të njeriut. Ajo që është vetë shprehje e zhvillimit njerëzor dhe që është qëllim në vete, nuk ka nevojë të bëhet shkas dhe mjet për diçka tjetër. Mirëpo, krahas saj, ajo që është autentike robërim ndaj All-llahut, njëherit është shkas për diçka tjetër, pra, ashtu si thash, ky është program edukativ islam. Kjo don të thotë se Islami që dëshiron të edukojë njerëzit në aspektin etik dhe të moralit shoqëror, zgjodhi njërin nga mjetet që është më efikas prej cilitdo mjet tjetër dhe më tepër ndikon në shpirtin dhe moralin e njeriut , e ky mjet është ibadeti.

Tani do ta shpjegoj këtë çështje.

Çështjet themelore etike janë flijimi, vetëflijimi dhe largimi nga interesat individuale. Ashtu sikur në aspekt të shëndetit që ka një princip që është fillimi dhe burimi i të gjitha të mirave e që është mënjanimi nga grykësia, ashtu

edhe në etikë ka një parim që është bazë për të gjitha çështjet etike e që është të larguarit dhe vetlargimi nga egoizmi.

Në çështjet shoqërore, ky parim, që është nëna e gjitha parimeve, është drejtësia. Drejtësi don të thotë respektimi i të drejtave të të tjerëve. Problemi që e ka njeriu edhe me etikën edhe me drejtësinë, është kryerja e këtyre parimeve. Pra, s'ka kush që s'e njeh etikën ose që s'e di se sa e patjetërsueshme është drejtësia. Problemi ëshë te etapat e kryerjes. Kur njeri dëshiron ta respektojë një parim etik, atëherë do të kuptojë se është interesi i tij, në një anë, ndërsa etika, në anën tjetër. Shihet se dëshira ndaj të vërtetës gjendet në njërin anë, ndërsa profiti dhe interesi nga ana tjetër; apo patjetër të rrejë dhe tradhëtojë që të përfitojë ose patjetër ta thotë të vërtetën e ta ruajë emanetin e t'i ik fitimit. Këtu shohim që njeriu i cili paraqitet si i moralshëm e i drejtë, kur vjen momenti për të ta shprehë atë, vepron të kundërtën. Ajo që garanton moralin dhe drejtësinë, nëse paraqitet te njeriu, në mënyrë që të ecë rrugës së etikës e të drejtësisë dhe t'i largohet interesit, është besimi. Çfarë besimi? Besimi në drejtësinë dhe besimi në etikën. Kur njeriu arrin besimin në etikën dhe drejtësinë si diçka të shenjtë? Mu atëherë kur beson në Zot e kur adhuron Atë. Andaj njeriu, aq është i lidhur ngusht me etikën sa edhe e ka besimin në Zot. Kjo është një problematikë e kësaj kohe. Njerëzit mendonin se shkenca është e mjaftueshme. Po ta njohim drejtësinë dhe etikën e t'i përvetësojmë ato, mjafton që të jemi të moralshëm e të drejtë. Praktika ka treguar se nëse shkenca ndahet nga besimi, jo vetëm që s'është e dobishme për etikën dhe drejtësinë, por është edhe e dëmshme. Atëherë do të ishte ashtu siç tha Sanai: "Nëse hajni hynë në ndonjë shtëpi me llambë në dorë, më lehtë do të shkojshin punët".

Por sikur të ekzistonte besimi, do të përforcohej morali e drejtësia. Morali e drejtësia pa një bindje fetare është e



ngjashme me farkimin e parave pa mbulesë. Kur të paraqiten bindjet fetare, vjen edhe etika edhe drejtësia. Kështu që shohim se në Islam çështja e adhurimit ndaj All-llahut, nuk është e ndarë nga morali dhe drejtësia. Kjo don të thotë: kur Islami urdhëron për ibadet, si mëlmesa për të përcakton moralin e drejtësinë, ose kur e pranon drejtësinë dhe moralin, si mëlmesë për ta përcakton ibadetin, sepse ndryshe nuk është e mundur.

Këtu do të sjell një shembull. Në cilin studim në botë keni parë që i dënuari, vetë me këmbët e veta, të vijë në vendin e ekzekutimit. Krimineli gjithnjë ikën nga dënimi. E vetmja forcë që mund ta detyrojë kriminelin që vetë me këmbët e veta e me dëshirë të vijë në vendin e ekzekutimit, është besimi e asgjë tjetër. Kur të shikojmë kohën e më hershme të Islamit, lidhur me këtë, kemi shumë shembuj. Në realitet, kur themi "në fillim të Islamit", kjo s'do të thotë se në kohërat tjera s'ka pasur të këtillë. Shembuj të këtillë ka patur edhe në periudha tjera kohore, sipas nivelit të besimit të atyre periudhave. Islami kundër delikuentëve ka caktuar ndëshkim. Për shembull, ka caktuar ndëshkim për kurorëshkelësin, të dehurin dhe hajnin. Në anën tjetër, në Islam ka një parim e që është: kufiri mund të lëviz në rast të dyshimit të vogël. Islami kurrë nuk e obligon një gjykatës ose sundimtar që të bëjë hetime për gjetjen e delikuentit, por në shpirt të delikuentit mbjellë një fuqi e cila e shpie që ai vetë të vijë për të marrë dënimin. Gjatë kohës së Pejgamberit s.a.v.s. dhe gjatë kohës së Aliut a.s. sa e sa herë ka ngjarë që personi vetë të vinte te Pejgamberi s.a.v.s. ose tek imami e të thoshte: "O Pejgamber i All-llahut (ose: o udhëheqës i besimtarëve) kam ardhur për këtë gabim, më dëno, i njollosur jam, më pastro!"

Erdhi një person te Pejgamberi s.a.v.s. dhe tha: "O i dërguar i All-llahut, kam bërë shkelje të kurorës, më dëno!"

Meqë në këto situata duhet që personi katër herë të pranojë gabimin e vet, sepse një herë s'mjafton. Pejgamberi s.a.v.s. tha:

“Ndoshta vetëm që e ke puthur e thua se ke bërë shkelje të kurorës”, duke ia lënë që ai të shprehet me fjalë të veta.

Nëse ai thoshte: “Po e kam puthur, tani deshta të pyes nëse është puthja sikur shkelja e kurorës?”, problemi do të ishte zgjidhur. Ai tha: “Jo, o Pejgamber i All-llahut, kam bërë shkelje të kurorës!”

“Ndoshta e ke pickuar (në mënyrë që ai të mund të thotë: “Po”, po e asgjë më tepër”.)

Ai u përgjigj: ”Jo, o i Dërguar i All-llahut, kam bërë shkelje të kurorës!”

Pejgamberi s.a.v.s. i tha: “Ndoshta ke qënë shumë afër shkeljes së kurorës, e nuk ke bërë tamam shkeljen e saj?”

U përgjigj: “Jo, o i Dërguar i All-llahut, unë jam i njollosur. Erdha të më gjykosh e të më dënosh në këtë botë, meqë nuk dëshiroj që dënimi të mbetet për në botën tjetër”.

Ngjarjen që po e përmendim është nxjerrë nga libri “Usulul-kafi”.<sup>25</sup> Erdhi një grua te Udhëheqësi i besimtarëve dhe tha:

“O udhëheqës i besimtarëve! Unë jam grua e martuar dhe në mungesë të bashkëshortit tim kam bërë shkelje të kurorës dhe kam mbetur shtatzënë. Jam njollosur, më pastro! (me ekzekutim - sh.p.)

Imami tha:

“Vetëm një pranim nuk mjafton, këtë duhet ta bësh katër herë”. ( Në Islam nuk është traditë që gjykatësi vetë të bëjë hetime ose të ofrojë zgjidhje me anë të dinakërisë, por nëse ndonjë person paraqitet nga vetë dëshira, ai në një farë mënyre nuk pranohet) dhe: “Mirë, nëse një grua e martuar

---

<sup>25</sup> Principet sekundare të Kafi-së, vëllimi 7, f. 185.

shkelë kurorën, patjetër të ekzekutohet me gurë. Nëse ne të ekzekutojmë me gurë, atëherë ç' do të ndodh me femijën që e ke në bark? Ne nuk mund ta ekzekutojmë me gurë femijën. Shko tani, dhe eja pasi të lindish, sepse tani nuk mund të të ekzekutojmë”.

Pas disa muajsh, e kanë parë se si ka ardhur me femijën në duar dhe tha: “O udhëheqës i besimtarëve! Pastromë!” Ky ishte pranimi i dytë.

Aliu a.s. tha: “Nëse të ekzekutojmë me gurë ty, ç' faj ka femija? Ai ka nevojë për nënë. Femija ka nevojë për qumësht e për përkujdesje. Tani shko, sepse i duhesh atij”.

Ajo u kthye e shqetësuar. Pas dy-tri vitesh erdhi përsëri me femijën.

“O udhëqës i besimtarëve! Femija më nuk është duke pirë qumësht e është rritur. Pastromë!” Ai u përgjigj:

“Jo, kësaj femije ende i duhet nëna. Shko!”

Këtë herë me lotë ndër sy e mori femijën për dore dhe tha: “O All-llah! Kjo më është hera e tretë që po vij tek imami, halifi i muslimanëve, në mënyrë që të më pastrojë, kurse ai për çdo herë më ka refuzuar me ndonjë fjalë. O Zot! S'dua ta bartë më këtë njollë. Kam ardhur të më ekzekutoni me gurë dhe në këtë mënyrë të pastrohem”.

Rastësisht, Amër ibën Hurejthi, hipokrit, e pa atë grua që fliste kështu. I tha asaj: “Ç' u bë?” “Për çka është fjala?” Ajo u përgjigj: “Kam një problem” Hurejthi iu drejtu: “Eja! Unë do ta zgjidh atë. Ma jep femijën, unë do të kujdesem për të”, duke mos dijtur se Aliu a.s. s' do ta pranonte as pranimin e katërt.

Menjëherë e panë gruan duke u kthyer me femijën dhe me Amër ibën Hurejthin.

“O udhëheqës i besimtarëve! Kam bërë shkelje të kurorës, ndërkaq problemi i fëmijës u zgjidh. Ky njeri mori për sipër të kujdeset për të. Tani, më pastro (ekzekuto)!”

Udhëheqësi i besimtarëve, Aliu a.s. shumë u shqetësua se pse patjetër u desht të vijë gjer te kjo.

Kjo është fuqia e besimit dhe e fesë që depërton në vetëdijen e njeriut dhe ia dorëzon drejtësisë dhe moralit. Ibadeti është për atë që të përtrihet jeta fetare, të përfitohet freski, forcë e fuqi. Sa më fuqishëm që të besojë njeriu, aq më tepër do të përkujtojë All-llahun xh.sh., njëkohësisht më pak gabime do të bëjë. Të bërit gabim, gjegjësisht ruajtja nga gabimi, s'bie në suaza të diturisë, por në suaza të pakujdesisë dhe harresës. Sa është njeriu i pakujdesshëm ndaj All-llahut xh.sh. aq më tepër do të bëjë gabime, dhe aq sa do ta përkujtojë All-llahun, aq më pak gabime do të bëjë.

Keni dëgjuar se pejgamberët dhe imamët janë njerëz që nuk bëjnë gabime. Do t'u pyesin se ç'do të thotë kjo? Kjo don të thotë se ata asnjëherë nuk bëjnë gabime. Tamam, kjo e ka këtë kuptim, por pastaj do t'u pyesin, pse ata nuk bëjnë gabime. Këtij “pse”-hit mund t'i përgjigjeni në dy mënyrë. E para, që pejgamberët dhe imamët janë të pastër dhe që nuk bëjnë gabime është thënë në atë kuptim se All-llahu me fuqinë e Tij i pengon me qëllim të mos gabojnë. Pra, kur dëshirojnë të bëjnë gabim, All-llahu xh.sh. i pengon. Nëse kjo është domethënia e pagabueshmërisë, atëherë nuk ekziston përkryerja dhe vlëra. Nëse është kështu, kur unë dhe ti duam të bëjmë ndonjë gabim, ndërsa një fuqi e jashtme neve na pengon, hynë në mes nesh dhe gabimit, e natyrshme është që të mos gabojmë. Atëherë, çfarë vlere kanë ata më tepër se ne? Në atë rast, i vetmi dallim është që ata janë robër, të cilët i ka veçuar All-llahu. Kur ata dëshirojnë të bëjë ndonjë gabim, Ai pengon, e kur të dëshirojmë ne të bëjmë gabim, neve nuk na

pengon. Jo, kjo është gabim! Ajo që ata janë të pagabueshëm nuk do të thotë se ata duan të gabojnë e që All-llahu i pengon. Atëherë ku qëndron puna?

*Ismet* (pagabueshmëri) paraqet shkallën më të lartë të besimit. Dhe në shkallë sa më të lartë të jetë besimi, aq më tepër njeriu përkujton All-llahun. Për shembull, personi që në parim nuk dëshiron të besojë, nuk do ta përkujtojë Atë as një herë në ditë, javë ose në muaj. Personi këtillë, absolutisht është i pavetëdijshëm. Ka njerëz të atillë që disa herë e përmendin All-llahun. Mendojnë: “Edhe ne kemi Zot, Ai është mbi ne dhe na sheh”. Në atë moment e përmendin All-llahun xh.sh. por pastaj sërish e harrojnë e sikur Ai aspak të mos ekzistojë. Mirëpo, disa njerëz që besojnë pak më tepër, disa herë janë të pakujdesshëm e disa herë vetëdijësohen. Kur janë të pakujdesshëm bëjnë gabime, e kur vetëdijësohen, nuk gabojnë. Kur e kanë ndër mend All-llahun, e pamundur është të bëjnë gabime.<sup>26</sup>

Kur në shpirtin e njeriut me të vërtetë ekziston dhe është prezent besimi, atëherë njeriu nuk bën gabim. Asht që nëse besimi i njeriut arrinë përsosmërinë, nëse mendja e njeriut gjithnjë është prezent, pra, që All-llahu gjithnjë të jetë prezent në zemrën e tij, atëherë kurrë nuk mund të jetë i pakujdesshëm. Në çdo vepër që bën, në të njejtën kohë do ta përkujtojë All-llahun xh.sh. Në Kur'an thuhet:

“Ka njerëz, të cilët puna dhe shitblerja nuk i pengon ta përmendin All-llahun dhe që e kryejnë faljen (namazin); japin zekatin...” (24:37). Nuk thotë ai (Kur'ani): “Njerëzit që nuk bëjnë tregti”. Islami nuk ka ardhur që t'u thotë njerëzve të mos bëjnë tregti. Përkundrazi, Islami e potencon një veprim të tillë, të veprohet, të tregtohet. Këtu thuhet - njerëzit që shitblejnë, tregtojnë e punojnë, por njëkohësisht, ata që i

<sup>26</sup> Vesail, vëllimi 1, fq. 24, hadithi 14.

posedojnë të gjitha këto në asnjë moment nuk e harrojnë All-llahun. Qëndrojnë pas peshojës në dyqan, gjithnjë flasin dhe venë kontakte, japinë mall ose marrin para, por All-llahu është Ai që kurrë nuk e harrojnë. Gjithnjë e kanë ndër mend All-llahun. Nëse dikush ëshë i vetëdijësuar dhe gjithnjë e përkujton All-llahun, e natyrshme është që mos të bëjë kurrë gabim. Natyrisht, ndër ne s'mund të gjejsh një person gjithnjë të vetëdijshëm përpos ma'sumit - të pagabueshmit a.s.

Të pagabueshëm konsiderohen ata njerëz që kurrë nuk e harrojnë All-llahun xh.sh. Do të sjell një shembull: A u ka ndodhur ndonjë herë ta futni dorën në zjarr e të shikoni drejt tij? Tani, nëse veni re mirë, ka edhe çështje tjera. Gjatë tërë jetës asnjëherë nuk ka ndodhur që ne dhe ju të hudhemi në zjarr, përpos nëse dëshirojmë të bëjmë vetëvrasje. Pse? Sepse kemi paranjohuri mbi zjarrin dhe e dijmë se, nëse gjuhemi në të, digjemi. Ky është një fakt i sigurt, andaj si ta shohim zjarrin, na kujtohet ky fakt dhe në asnjë moment nuk mund të jemi të pakujdesëm. Mu për atë, në aspekt të mosgjuajtjes në zjarr, jemi të pagabueshëm. Don të thotë se kjo njohuri, ajo bindje dhe ai besim që kanë të bëjnë me pasojat e djegies, gjithnjë na ruajnë që mos të gjuhemi në zjarr. Ashtu sikur që besojmë në djegien e zjarrit, njerëzit e devotshëm besojnë në veprimin e djegies nga mëkatet, dhe mu për atë nuk bëjnë gabime. Tani, pasi u shpjegua se ç' domethënie ka *të mos gabosh*, do të shpjegohet edhe kuptimi i fjalisë se ibadeti është pjesë e programit edukativ të Islamit. Qëllimi i ibadetit është që njeriu ta kujtojë shpesh All-llahun, dhe sa më tepër ta kujtojë, aq më tepër do të jetë i lidhur ngushtë me moralin, me drejtësinë dhe me të drejtën, pra kjo fjali është shumë e qartë. Tani veni re faktit se si në Islam janë të lidhura ngushtë jeta e kësaj bote me atë pas ndërrimit të jetës. Islami dallon nga Krishterzmi. Në Krishterizëm dhënia e llogarisë në këtë

botë është veç nga dhënia e llogarisë në botën tjetër. Ai pohon se gjatë kësaj bote dhe asaj pas ndërrimit të jetës u takojnë, veç e veç, kësaj apo asaj bote, gjersa në Islam nuk është kështu.

Islami botën tjetër-Ahiretin e vë në kontekst të jetës së kësaj bote, dhe anasjelltas: jetën e kësaj bote në kontekst të jetës së botës tjetër. Për shembull, aspekti i pastër hyjnor i namazit është që njeriu të përkujojë dhe t'i frikësohet All-llahut. Zemra që të jetë prezente dhe e kujdesshme ndaj All-llahut xh.sh. nuk ka nevojë për tërë atë ceremoni, për abdes e për pastrim. Po a ndikon pastrimi në afrimin ndaj All-llahut? Në shikim të parë, pastrimi dhe moskryerja e tij nuk ndikojnë në afrimin ndaj All-llahut, por All-llahu thotë:

***“O besimtarë! Kur të niseni të kryeni faljen (namazin) lani fytyrat tuaja gjer pas bërrylave, e kokën tuaj fërkoni (jepni mes'h), edhe këmbët tuaja gjer mbi zogjtë e këmbës. Nëse jeni të papastër (xhunub) atëherë-pastrohuni!”*** (5:6)

Këtu shohim se pastërtia është e lidhur me ibadetin. Nëse dëshiron të falesh, vendi i faljes të jetë mubah (ajo që është e lejuar sipas Islamit) e të mos jetë i konfiskuar. Tepiku në të cilin falemi, teshat me të cilat falemi, duhet të jenë hallall dhe mubah. Nëse në teshat tua gjendet, bile edhe një pe është i uzurpuar, namazi yt nuk do të pranohet. Ibadeti, këtu, sërish është i lidhur me të drejtën. Krahas asaj që thotë ta adhurosh All-llahun, thotë se patjetër ta respektosh të drejtën. Pra, Islami thotë: “Unë në esencë nuk e pranoj adhurimin, nëse në të nuk respektohen të drejtat shoqërore”. Prandaj ai që falet, kur dëshiron ta kryejë namazin, së pari duhet të mendojë: “Kjo shtëpi në të cilën gjendem, a mos vallë ua kam plaçkitur me forcë njerëzve, apo jo? Nëse e kam marrë me forcë, atëherë namazi im është i papranuar”. Madje, nëse don të falet, patjetër ta ketë shtëpinë hallall, pra ta ketë

blerë nga pronari i vërtetë ose ta ruajë atë në posedim të lejuar. Gjithashtu, kjo vlen edhe për tepikun e për teshat. Bile nëse edhe nga të varfërit ka marrë ndonjë të drejtë, patjetër duhet ta paguajë humusin dhe zekatin. Nëse nuk paguan, përsëri, namazi nuk i pranohet. Ne na thuhet: “Nëse dëshironi të faleni, patjetër e keni të ktheheni në drejtim të Ka’bes”. Ku gjendet Ka’beja? Ajo është tempulli i parë në botë që është ndërtuar për adhurim ndaj All-llahut.

***“Tempulli i parë i ndërtuar për njerëz është ai që u ngrit në Bekke-Meke, i bekuar dhe udhërrëfyes i botëve”.***  
(3: 96)

Të gjithë duhet të ktheheni kah tempulli i parë dhe xhamia e parë që është ndërtuar me duart e peygamberit të madh të All-llahut - Ibrahimit dhe të birit të tij Ismailit a.s. Tani, pse duhet të kthehemi kah Ka’beja? Po, a thua aty është All-llahu? Po a në Ka’be gjendet All-llahu, (Ruana Zot!)? Kur’ani thotë se All-llahu është kudo: “...kahdo që të ktheheni, atje është ana e All-llahut” (2:115).

Qoftë se u ktheve në këtë apo në atë anë, ti qëndron para All-llahut. Nëse shikon naltë apo poshtë, shikon drejt All-llahut. Peygamberi s.a.v.s. ka thënë: “Nëse me anë të litarit u lëshojnë në shtresën e shtatë të thellësisë së tokës, përsëri, përpara e keni All-llahun. Po të ecni në drejtim të lindjes, keni ecur drejt All-llahut, e po të ecni në drejtim të perëndimit, prapë, keni necur në drejtim të All-llahut. Kështu si jeni duke ndenjtur, ju jeni në prezencë të All-llahut. All-llahu nuk ka anë, atëherë pse vallë, na duhet të kthehemi kah Ka’beja? All-llahu thotë: “Ju që bëni ibadet, njëkohësisht duhet ta mësoni një sjellje shoqërore. Të gjithë duhet të ktheheni kah një pikë”. Nëse nuk veproni kështu, pra njeri qëndron në një anë e tjetri në tjetrën, ky është një plotësim i mosbashkimit dhe mospajtimit. Por nëse qëndroni kah një



pikë, atëherë do të njiheni në bazë të drejtimit, sepse të gjithë muslimanët kanë një drejtim. Tani cilin drejtim ta zgjedhim që në esencë s'do t'i vinte era mosbesim? Thuhet: “Zgjedhe një vend që nëse kah ai do të kthehesh, e ke respektuar ibadetin. Kthehu kah vendi që është tempull i vërtetë. Të respektosh tempullin don të thotë ta respektosh ibadetin”.

Përsëri thuhet që kur të bëjsh ibadet, duhet ta bëjsh atë në kohë të caktuar dhe të kihet kujdes për secilin minutë. Koha e faljes së namazit të sabahut është prej para agimit e gjer në lindjen e diellit, e nëse, me qëllim, fillon faljen e namazit vetëm një minut para agimit ose pas lindjes së diellit, namazi yt nuk është në rregull. Nuk është e vërtetë. Namazi patjetër duhet të kryhet midis këtyre dy kohëve, pra nuk mund të thuash: “Tani më flehet, mbrëmë kam ndejtur shumë vonë, ka mbetur edhe një orë gjer në lindjen e diellit”. All-llahu as nuk flen e as nuk zgjohet. Po, a thua All-llahu, në mes lindjes agimit dhe lindjes së diellit vesh teshat zyrtare dhe përgatit për kryerjen e namazit!? Për All-llahun orët ose momentet janë të barabartë.

***“All-llahu është- nuk ka zot tjetër përpos Atij- i Gjallë i Përvetshëm! Nuk e kaplon kotja as gjumi”. (2:255)***

Nuk bën të thuash: “Gjer në mëngjes nuk kam fjetur. Shumë jam i lodhur, më duhet patjetër të falem gjysëm ore më herët”. Patjetër të mësohesh në disiplinë dhe në njohjen e kohës. Domosdo të falesh tamam në kohë. A ka dallim te All-llahu kjo kohë nga ajo kohë? Jo, ky dallim vlen për ty. Ti duhet të jeshë i edukuar përmes këtij namazi. Nëse nuk ke fjetur gjer në ora dy, patjetër të zgjohesh e të falish namazin në mes agimit dhe lindjes së diellit, sepse para dhe pas kësaj kohe, namazi nuk është i pranuar. Të këtillë janë namazi i akshamit dhe jacisë. Do të thonit: “Namazi është ibadet ndaj All-llahut. Çfarë lidhje ka adhurimi me këto gjëra?” Jo, në

Islam adhurimi është e lidhur me këto çështje. Islami nuk bën dallim mes ibadetit, adhurimit dhe çështjeve tjera.

E mundur është që dikush të thotë: “Falem, por kam dëshirë që brenda namazit të qaj. Diçka më mundon dhe dua që brenda namazit të qaj, ose më kujtohet se shoh diçka që më bën të qeshem. Kjo nuk duhet jetë shumë me rëndësi”. Jo, nuk është ashtu! Namazi është manifestim i qetësimit të emocioneve. Nëse në mamaz je përqëndruar në një pikë, duhet t’i përmbahesh asaj e nuk bën të kthehesh herë andej e herë këtej apo të shikosh pas vetes. Nuk ke të drejtë që kokën ta kthesh djathtas a majtas. Ku mbeti çështja e të qajturit e të të qeshurit? Apsolutisht s’lejohet. Do të përgjigjet se asnjëra prej këtyre çështjeve s’shkojnë në kundërshtim me ibadetin: “Përkrah të qeshurit tim, e përkujtoj edhe All-llahun. Dua të qeshem. Nëse më qahet, të qaj ose gjatë namazit të ha diçka”. Nuk bën. Ti duhet të ushtrohesh që gjatë kësaj kohe sa je në namaz ta sundosh stomakun, të përmbahesh nga të qarit e të qeshurit, të sundosh mosdisciplinën tënde. Këto janë një sërë çështjesh shoqërore, por përsëri janë ibadet, sepse ibadeti në Islam është pjesë e programit edukativ. Ibadeti pa respektimin e këtyre parimeve, nuk do të jetë i pranuar.

Çka do të thotë qetësimi në namaz? Kjo gjë vërtet është e çuditshme”.Gjatë namazit, kur e lexoj Fatihanë dhe suret e tjera, u përmbahem të gjitha atyre kushteve, por lëvriti në namaz. Njëren këmbë e lëvriti ndërsa tjetren jo, lëvizi djathtas-majtas. Thonë që ky namazi im është i pa vlefshëm. Në ruku’ dhe sexhde lëvizi madje i lëvizi duart ose këmbët”. Namazi i këtillë është i papranuar. Namazin duhet ta kryejsh i qetë dhe i rahatshëm. Don të thotë, kur ngrihesh dhe dëshiron të thuash: “All-llahu ekber!”, atë nuk guxon ta thuash për derisa trupin nuk e ke të qetësuar. Nëse atë, përsëri, e thuash duke lëvizur, namazi i yt është i pa vlefshëm. Së pari duhet të

qetësohesh, e më pastaj të thuash: “All-llahu ekber”. Pastaj nëse dëshiron të lëvizish, lëviz, por mos fol dhe mos bën dhikër! Hesht, qëndro i qetë, e më pastaj thuaj: “Bismil-lahir-rahmanir-rahim, elhamduli-lahi Rabil-alemin... “Nëse gjatë namazit fillojnë të të dhëmbin këmbët, qetësohu pak, hesht, përqëndrohu dhe pastaj vazhdo. Namazi doemos të fillojë në qetësi. Edhe shpirti edhe trupi yt patjetër të jenë të qetësuar.

Tani do të flasim mbi pjesët e tjera të namazit. Namazi është respekt ndaj All-llahut. T’i kushtosh rëndësi diçkaje tjetër, pos All-llahut, është kufër-mosbesim, por në të njëjtën ne na rekomandohet që në namaz të themi:

“Selami-përshëndetja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të All-llahut”.

Me këtë shpall paqje dhe miqësi mbi të gjithë robërit e mirë të All-llahut. Siç do të thuhej me gjuhën e sotme, shpall koekzistencë paqedashëse për të gjithë njerëzit e mirë. Gjatë namazit shprehesh që nuk ke asgjë kundër njerëzve të mirë, meqë sikur të veprosh kundër ndonjë robi të mirë të All-llahut, atëherë vetë je i keq. Kur thua: “Selami-përshëndetja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të All-llahut”, kjo nuk ka të bëjë me shpirtin e ibadetit i cili është të qenit prezent të zemrës ndaj All-llahut. Por, në Islam, shpirti dhe trupi i ibadetit janë të lidhur ngushtë me çështjet edukative. E domosdoshme është që njeriu në aspekt të çështjeve shpirtërore të harrojë vetveten dhe të tjerët me aq sa ka mundësi, ndërsa në aspekt të çështjeve shoqërore e nevojshme është që njeriu të mos i harrojë të tjerët.

Në Suren Fatiha,<sup>27</sup> pjesë përbërëse e namazit, themi:

“Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”.

S'themi: “Ty të adhuroj dhe prej Teje ndihmë kërkoj”.

---

<sup>27</sup> Leximi i Fatihasë është i patjetërsushëm në namaz, pa të namazi s'është në rregull. Suret e tjera mund të zgjedhen, e Fatihaja është farz.

Pra nuk themi kështu, por:

“Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”.

Këtu nuk themi “unë” por “ne” që do të thotë: ”O Zot! Nuk jam vetë por jam me të gjithë muslimanët e tjerë”.

Krahas kësaj, njeriu gjatë ibadetit shpall lidhëshmërinë e tij me bashkësinë islame (Ummetin-sh.p.): “O All-llah! Unë nuk jam vetë, unë jam pjesë e tërësisë dhe trupit, “ne jemi” e jo “unë jam”. Në botën islame nuk ekziston “unë”, por “ne”. Ne Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Gjithashtu secila pjesë e namazit është mësim në vete, tërheqje vërejtjeje e përmendje.

Për shembull, merrnie parasysh fjalinë: “All-llahu ekber”. Po a është e mundur, dikush që mban emrin njeri, të kyqet në një punë si kjo e të mos frikësohet? Njeriu ngërthen në vete frikë. Kur njeriu sheh ndonjë mal të madh apo kur gjendet në majë të tij dhe shikon teposhtë, e kaplon frika. Kur shikon detin, frikësohet. Kur sheh ndonjë njeri të fuqishëm apo me ndikim e kur shkon tek ai, është e mundur që habitet e të belbëzojë para tij. Pse? Sepse frikësohet nga fuqia e tij. Për njeriun kjo është e natyrshme. Por ai që thotë: “All-llahu ekber” asnjëherë askujt e asgjëje s’do t’i frikësohet. Pse, “All-llahu ekber” do të thotë më i Madh nga gjithçka tjetër, e më e madhja e gjitha shprehjeve është qenësia e All-llahut. Unë e njoh All-llahun në bazë të Madhërisë dhe Lartësisë së Tij. Atëherë kur do ta njoh All-llahun në bazë të kësaj, gjithëçka tjetër do të më duket e vogël. Fjalja “All-llahu ekber” e bën njeriun personalitet dhe ia rrit shpirtin e tij njerëzor.

Aliu a.s. thotë:<sup>28</sup> “All-llahu me Madhërinë e Tij manifestohet në shpirtin e besimtarëve, dhe mu për këtë, gjithëçka tjetër pos All-llahut për ata është e pakuptimtë”.

Këtu do t’u shpjegoj diçka. Madhësia apo vogëlsia e ndonjë gjëje është relative. Për shembull ju që gjendeni në

---

<sup>28</sup> Shtegu i elokuencës, fjalimi 184.

këtë vend, në Huseinije, sikur përpara këtij momenti të ishit në ndonjë sallë më të vogël, sa një e treta e kësaj salle, kjo do t'u dukej e madhe. Ose e kundërta, të kishit qenë në ndonjë sallë tri herë më e madhe se kjo, e pastaj të vishit këtu, kjo do t'u dukej më e vogël. Gjthnjë kur njeriu sheh ndonjë krijesë afër ndonjë krijese tjetër, ku kjo tjetra është më e madhe se e para, të parën e sheh më të vogël, po nëse të dytën e sheh si më të vogël, të parën e sheh si më të madhe. Njerëzit që njihen me madhërimin që ia bëjnë All-llahut të vet dhe ashtu edhe ndihen, përgjithësisht gjithëçka tjetër u duket e vogël e nuk mundet për ta të jetë e madhe.

Saadiju në librin “Bostani” shumë bukur ka thënë:

“Për asketin, pos All-llahut, s'ekziston gjë tjetër; rruga e të kuptuarit është rrugë laqesh”.

Ai thotë se asketët, përpos All-llahut, nuk pranojnë objektivitet për asgjë tjetër dhe thonë se diçka tjetër nuk ekziston fare. Njëri nga kuptimet e “Njëshmërisë” është që atëherë kur asketi ta njohë Madhërinë e All-llahut, më nuk ka mundësi të thotë se pos All-llahut ekziston qenie tjetër. Thotë: “Nëse ekzistenca është Ai, atëherë gjithëçka tjetër, pos Tij, është inekzistent”. Saadiju lidhur me të ekzistuarit e shpreh këtë kuptim. Ai, pastaj, thotë:

Vërtetëdashësit kanë fuqi të thonë,

Por pasuesit e silogjizmit gjurmojnë imtësitë.

Vërtetëdashësit e kuptojnë atë që them unë, por sipas tij, ata që janë analitikë kërkojnë në përpikmëri të dinë në lidhje me atë se çdo të thotë Njëshmëri e All-llahut.

“E, ç'është qielli e ç'është toka,

kush janë njerëzit, xhinnët e gjallesat?”

“Me dinjitet lëvdojnë, ke pyetur, o njeri i mençur,  
do t'u përgjigjem me dinjitet njerëzve të mençur,

që dielli, deti, kodra dhe kupa qiellore,  
bukuroshja e Xhennetit, njeriu, xhinni dhe mbreti,  
të gjitha këto janë më pakë se ajo  
që krahas ekzistimit të Tij, të përmendin ekzistencën”.

Ai thotë se nuk pohon që nuk ekziston qielli, toka,  
njeriu dhe melekët, atëherë kur pohon se Zoti ekziston dhe  
gjithëçka tjetër s'ekziston. Thotë se nuk e mohon ekzistimin e  
gjërave tjera. Jo. Kur e njohta Madhërinë e Tij, gjithëçka  
tjetër shoh, përpos Tij, aq e vogël më duket që të them se  
ekziston.

“Ku ekziston det, ku jam unë?

Kur Ai ekziston, vertetë unë nuk ekzistoj”.

Kur të thoni ju “All-llahu ekber”, nëse atë e thoni nga  
thellësia e shpirtit dhe zemrës, në sytë tuaj reflektohet  
Madhëria e All-llahut. Nëse në zemrat tuaja paraqitet  
Madhëria e All-llahut, e pamundur është që dikush t’u duket i  
madh, e pamundur është t’i frikësoheni dikujt dhe që përpara  
dikujt të përuleni. Robërimi-adhurimi ndaj All-llahut është  
çlirim. Nëse njeriu e kupton Madhësinë e All-llahut, bëhet  
rob i Tij, ndërkaq domosdoshmëria e robërimit ndaj All-  
llahut është çlirim nga gjithëçka, pos nga All-llahu. Ka thënë:

Nuk do bëhesh rob, gjersa të mos bëhesh i lirë!

Nuk mund të mbushesh përplotë gjykim.

Sa herë pyet: “Ç’është robëri?”

Robëria nuk është gjë tjetër pos thyeshmëri.

Të jesh rob i All-llahut është barabartë në atë të jeshë i  
lirë nga të gjitha pos nga All-llahu, sepse të kuptuarit e  
Madhërisë së All-llahut është e barabartë me të kuptuarit e  
pakuptyeshmërisë së gjithëçkafit tjetër pos All-llahut. Dhe  
kur njeriu ta kuptojë se gjithëçka që nuk është Zot është e

parëndësishme, nuk është e mundur të përulet në atë kuptim që t'i bëhet rob të parëndësishmes. Njeriu gabimisht e sheh të përulurin sikur të madhin dhe i robërohet atij.

Dhikri i dytë nga namazi, si: subhanall-llah, el-hamdu-lil-lah, subhane rab-bijel-adhimi ve bi hamdihi, subhane rab-bijel e'ala ve bi hamdihi dhe tesheh-hudi, secila prej tyre ka fshehtësinë e vet.

Një njeri e pyeti Aliun a.s.: “Pse nga dy herë bëjmë sexhde?” Mirë, si e bëjmë rukunë një here, ta bëjmë edhe sexhden? Natyrisht se e dini që sexhdeja është pak më e vlefshme në aspekt të përuljes se sa rukuja. Sepse gjënë më të dashur të trupit të tij e vëndon në gjënë më të poshtme, don të thotë mbi tokë, si shenjë e përuljes së tij (gjëja më e çmueshme në trupin e njeriut është koka në të cilën gjendet truri e balli). Vëndon ballin mbi tokë dhe në atë mënyrë shprehë përuljen e tij ndaj All-llahut. Pyeti njëri: pse për çdo rekatë të namazit bëjmë nga dy sexhde. Çfarë karakteristike ka toka. Udhëheqësi i besimtarëve e lexoi ajetin që vijon:

***“Nga ajo (toka) u kam krijuar, në të do t’u kthej dhe nga ajo do t’u nxjerr për herë të dytë”.*** (20:55)

Së pari, shkuarja në sexhde dhe ngritja nga ajo, tregon se të gjithë ne jemi të krijuar nga toka. Burimi i trupave tanë është toka. Të gjithë ne jemi bërë nga toka. Kur ta vendosh kokën për të dytën herë në tokë, përkujton vdekjen dhe se asaj do t’i kthehesh. Kur ta ngritish kokën nga toka, përkujton se nga e njëjta tokë edhe një herë do të dalish.

Këtu do t’i kthehem edhe një pike. Shumë do të kisha patur dëshirë ta kuptoj rëndësinë e namazit, që është shtyllë e fesë. A e dini se ne jemi përgjegjës për faljen e namazit nga anëtarët e familjes tonë, gra e fëmijë? Çdo person është përgjegjës për namazin e vet dhe të familjes, që don të thotë për gruan dhe fëmijët. Pejgamberit s.a.v.s. i është thënë:

“Urdhëroje familjen tënde ta kryejë namazin dhe insisto në këtë!” (20:132) “O peygamber! Urdhëroje familjen tënde dhe insisto në të”. Ky ajet s’është ekskluzivisht vetëm për Pejgamberin s.a.v.s., por ky urdhër na obligon të gjithëve.

Si duhet vepruar me fëmijët? Fëmijët duhet, patjetër, t’i ushtrojmë në namaz që nga fëmijëria. Urdhër është që fëmijët prej moshës shtatë vjeçare, patjetër t’i mësoni ta ushtrojnë namazin eksperimental. Natyrisht se fëmija nuk mund ta mësojë me korrektësi namazin që nga mosha shtatë vjeçare, por mund të falet në suaza të ushtrimit, qoftë djalë apo vajzë. Pra, kur fëmija nis të shkojë në shkollën fillore, duhet ta mësojë namazin në shkollë dhe në familje, por duke patur kujdes se dhuna nuk jep rezultat. Ju e keni patjetër të mundoheni që fëmijët tuaj t’i nxitni në namaz, në mënyrë që ta duan atë. Patjetër fëmijët tuaj t’i nxitni në çfarëdo mënyre qoftë që me dëshirë e me kënaqësi ta falin namazin. T’i stimuloni, t’i shpërbleni, tu shprehni simpati, që nëse falen, ju do t’i doni edhe më tepër. Tjetra është që fëmijën ta çoni në atë mes ku falet namazi. Praktika ka treguar që nëse fëmija s’shkon në xhami, s’hyn në xhemat dhe nuk shkon në namazin e xhumasë, nuk do t’i kushtohet kësaj pune, ndërkaq prezentimi në xhemat është një nxitje për njeriun.

Nëse njeriu i rritur e sheh veten në mesin e një xhemati që bën ibadet, përfiton më tepër vullnet për ibadet, ndërsa fëmija edhe shumë më tepër. Fatkeqësisht, shkuarja jonë rrallë herë në xhami, në tempuj dhe në tubime fetare, dhe pjesëmarrja e vogël e fëmijëve në tubimet fetare, bëhet shkaktar që ai mos ta dojë ibadetin që nga fillimi, por ky është një obligim për ju. Kur Islami thotë që fëmijën tuaj ta urdhëroni ta falë namazin, me këtë nuk ka për qëllim ta frikësojë, ta urdhërojë e ta qortojë. Jo, duhet që patjetër t’i shfrytëzoni të gjitha mjetet për të cilat mendoni se janë të



dobishme për ibadet dhe namaz. Ne duhet të kemi program për sjelljen e fëmijëve tanë deri në xhami, në mënyrë që ata të njihen me xhamitë dhe faltoret. Vetë ne të cilët që nga rinia jemi të njohtuar mbi xhamitë dhe mesxhidet-faltoret, sa herë shkojmë në xhami, kur fëmijët tanë, që kanë mbushur shtatë vjet e kanë filluar të shkojnë në shkollë fillore, pastaj në atë të mesme e në fakultet, nuk kanë bërë asnjë hapë drejt xhamisë? Mirë, natyrisht, ata ikin nga xhamia. Tani mund të thoni se xhamitë nuk janë në gjendje të mirë, apo se një ligjëruer vjen e ligjëron kështu apo ashtu. Ne e kemi për detyrë që këtë ta rregullojmë sepse obligimi nuk kryhet vetëm në një vend. Ne duhet ta rregullojmë gjendjen e xhamive tona. Atëherë, mos harroni se e kemi për obligim të falemi, njëherit e kemi për obligim të veprojmë që familjet tona ta falin namazin, dhe që t'ua shpjegojmë fëmijëve tanë, me aq sa mundemi, dobënë, funksionin dhe filozofinë e faljes së namazit.

Në një ajet kur'anor thuhet se disa do t'i pyesin banorët e Xhehennemit, në momentin kur ata gjenden në agoni dhe mundime:

“Çka u solli gjer te ky Xhehennem?”

Ata do të përgjigjen se nuk janë falë dhe nuk u kanë ndihmuar të varfërve.

“Çka u solli në Sekar?”

“Do të thonë: “Nuk e kemi pasë falë namazin, dhe të varfërit nuk i kemi ushqyer dhe kemi llomotitur me llomotitësit”.

Jemi lëshuar në çdo absurditet, kudo që bëhej fjalë kundër fesë, kemi heshtur dhe kemi dëgjuar, ose vetë kemi folur kundër fesë, ndërsa këto janë pasojat.

Tash mund ta kuptoni pse namazi është aq i rëndësishëm në Islam, pse Pejgamberi s.a.v.s. thotë se namazi është

shtyllë e fesë. Sepse, po të kryhet namazi dhe po të kryhet në rregull, gjithëçka do të jetë në rregull.

Aliu a.s. këshillat e tij që shpesh i keni dëgjuar, fillojn me fjalët: “All-llah, All-llah!” Këto janë këshilla të cilat kur i përfundoi, nuk kaluan as disa sekonda, ndërroi jetë. Ai në lidhje me namazin ka thënë: “All-llah! All-llahu për namazin ka thënë që ai është shtyllë e fesë”.<sup>29</sup>



---

<sup>29</sup> Po aty.

## TEUBEJA I (Pendimi)

*“Edhe Dhun-Nuni, kur shkoi i zemëruar dhe mendoi se atij nuk kishim ç’ti bëjmë-po pastaj në errësirë klithi: “Nuk ka zot përveç Teje, Ti qofsh lëvduar! Unë me të vërtetë kam bërë padrejtësi ndaj vetes!” Iu përgjigjëm dhe e shpëtuam nga ajo që e shtërngonte; kështu ne i shpëtojmë besimtarët”. (21:87-88)*

Diskutimi ynë ishte për lutjen-duanë dhe për ibadetin. Thash se ibadeti dhe përlulja, nëse kryhen si duhet, dasht e padasht, tërheqin pas vetes afrim të vërtetë të njeriut ndaj All-llahut Para se të bëhet njeriu metaforë dyshimi, me anë të përluljes i afrohet All-llahut. Me fjalë tjera përlulja është “suluk”, rrugë kah All-llahu.

Do të themi diç për stacionin e parë të sulukut (rrugës). Pika e parë nga e cila duhet të nisët njeriu, nëse dëshiron të shkojë drejt kah Zoti i vet e t’i afrohet Atij, ky është stacion. Do të thotë, për ne që nuk kemi bërë asnjë hap drejt kësaj çështje, diskutimi për pozitat e larta të adhuresit është i padobishëm. Nëse jemi njerëz të fjalës, duhet ta shohim se cili është stacioni i parë e afrimit dhe rrugëtimi kah All-llahu, cili është ai vend dhe prej nga duhet të fillojmë me ibadetin dhe përluljen tonë.

Stacioni parë i nisjes kah All-llahu është pendimi nga gabimet-gjunahet.

Çka do të thotë teube? Cila është esenca e teubes për njeriun në aspektin psikologjik dhe çfarë efekti ka ajo në aspektin shpirtëror? Sipas mendimit të shumicës prej nesh, teubeja-pendimi është një vepër. Kurrë nuk mendojmë që pendimin ta analizojmë në aspektin psikologjik. Në parim

pendimi është një karakteristikë njerëzore në krahasim me kafshët. Do të thotë njeriu ka shumë karakteristika, cilësi dhe virtyte të larta të cilat nuk gjinden te asnjë kafshë. Njeri nga këto talente të larta të njeriu është aftësia për pendim nga gabimet. Pendimi nuk përbëhet vetëm nga të shprehurit e fjalisë: “Estegfirull-llahe rabbi ve etubu ilejhi!” (Kërkoj falje nga Zoti im dhe pendohem para Tij!) Pendimi është një situatë psikologjike e shpirtërore, njëherit edhe revolucion shpirtëror i njeriut që shpreh fjalinë: “Kërkoj falje nga All-llahu dhe pendohem para tij për gabimet!” Kjo është shprehje e kësaj situatë, jo vetëm situatë, jo vetëm teube, sikur të shumë gjëra të tjera të cilat nuk është vetëm shqiptimi ajo e vërtetë, por ajo që e shpreh atë të vërtetë. Nëse disa herë në ditë themi: “Kërkoj falje nga All-llahu dhe pendohem para Tij!”, s'guxojmë të mendojmë se disa herë jemi penduar gjatë ditës. Nëse një ditë prej ditësh vërtet pendohemi, me siguri i kemi kaluar etapat dhe pozitat e afrimit sa më afër All-llahut.

Veni re! Këtu në hyrje, sa për fillim dua të ekspozoj se dallimi që ekziston mes gjërave të pajetë dhe bimëve e shtazëve, qëndron në atë se gjërat e pajetë nuk e kanë këtë aftësi me anë të së cilës do të lëviznin veten drejtë ndryshimit të brendshëm dhe në drejtim të zhvillimit dhe lëvizjes së vet. Kjo është sikur lëvizja e tokës që e bën rreth diellit apo si lëvizja e gurit të hudhur në ajër që bie në tokë. Kjo është e vërtetë. Don të thotë, gurin që e gjuani lëviz në një drejtim të caktuar dhe kryen lëvizjen e vet në po të njëjtin drejtim dhe është i pamundur ndryshimi i lëvizjes ose drejtimin, që nxitet nga esenca e këtij guri. Patjetër të paraqitet ndonjë faktor i jashtëm që do të ndryshojë drejtimin e lëvizjes së këtij guri ose të gjërave të pajetë. Për shembëll ”Apolo” ose “Luna” që u lansuan në vasionë, kurrë nuk mund ta ndërrojnë drejtimin e vet prej brenda, nëse nga jashtë nuk bëjnë që ta ndryshojnë

drejtimin. Por, qeniet e gjalla, siç janë bimët dhe gjallesat, kanë atë mundësi ta ndërrojnë drejtimin e vet. Pra, nëse ballafaqohen me kushte që nuk u përshtaten jetës së tyre, ndërrojnë drejtimin.

Por në lidhje me kafshët çështja është krejtësisht e qartë. Për shembull: nëse një dash ose një pëllumb a një mizë që janë në lëvizje, si të hasin në ndonjë pengesë, menjëherë e ndryshojnë drejtimin. Bile është e mundur që ky ndryshim të ndodh për njëqindetëdhjetë shkallë, plotësisht në drejtim të kundërt nga lëvizja e fillimit. Madje edhe bimët janë të tilla, don të thotë edhe ato, në suaza të kufijve dhe kushteve, drejtojnë veten nga brenda dhe ndryshojnë drejtimin. Rrënja e një druri që lëviz në tokë, nëse has në ndonjë gur, vetë e ndryshon drejtimin. Meqë nuk gjejnë rrugë e vend, ndërrojnë drejtimin. Qartë shihet se edhe njeriu, përafërsisht sikur bima dhe kafsha, ndryshojnë drejtimin.

Pendimi për njeriun paraqet ndryshim të drejtimit, jo ndryshim i thjeshtë sikur që ndodh me bimën dhe kafshën, por një ndryshim i vogël drejtimi që është specifikë vetëm e njeriut dhe vlen të analizohet e të studiohet edhe në aspektin psikologjik, edhe në atë shpirtëror.

Pendimi është një lloj revolucioni i brendshëm, një lloj shqetësimi e një lloj evolucioni i njeriut kundër vetvetes. Bima, po, e ndryshon drejtimin, mirëpo nuk rebelohet kundër vetes sepse nuk posedon aftësi për këtë. Ashtu siç ekziston ky dallim mes bimëve dhe natyrës së pajetë, që natyra e pajetë për të ekzistuar, nuk mund ta ndryshojë drejtimin nga brenda, ashtu siç ekziston kjo aftësi e çuditshme te bimët dhe kafshët, te njeriu ekziston një aftësi edhe më e çuditshme e ajo është që njeriu nga brenda rebelohet kundër vetvetes. Vërtet rebelohet dhe ngrihet kundër vetvetes. Vërtetë bën revolucion. Rebelimi dhe revolucioni nga ana e dy qenieve të ndryshme

nuk ka pengesa. Për shembull: në ndonjë vend pushtetin e ka në dorë dikush, pastaj vijnë disa të tjerë dhe ngrihen kundër tyre dhe bëjnë revolucion. Mirë, këtu nuk ka problem sepse njerëzit s'janë të njejtë. Ata kanë bërë zullum dhe padrejtësi ndaj këtyre, ndërsa këta të fundit janë të pakënaqur dhe të revoltuar. Pa një-pa dy bëjnë revolucion, e marrin pushtetin nga pala e kundërt dhe zënë vendin e tyre. Këtu nuk ka kontest, por ç'është ajo që brenda shpirtit të një personi shtie në rebelim e revolucion dhe ç'vepron që njeriu të ngrihet kundër vetvetes? Po a ka mundësi që një person të ngrihet kundër vetvetes. Po, mundet.

Shkaku qëndron në atë se njeriu, përkundër asaj që mendon vetë, s'është një person. Ky është një njeri i vetëm, por i përbërë e jo i thjeshtë. Pra ne që jemi këtu, sipas komentit të një hadithi, jemi një gjë e pajetë që rri ulur këtu. Këtu ka qëndrur një bimë, ka ndenjur një gjallesë që ka patur pasion, ka ndenjur një bishë, madje një shejtan, njëkohësisht një melek. Don të thotë se njeriu, sipas fjalëve të poetit është një konglomerat i rrallë, në brendinë e të cilit ngërthehen të gjitha karakteristikat. Ndonjëherë bëhet si ndonjë gjallesë makute që manifeston derrin. Kjo natyrë thiu që ngërthehet brenda njeriut, merr pushtetin dhe atë nuk ia jep as bishës, as shejtanit e as melekut. Përnjëherë, nga ana e njërit prej këtyre plas revolucioni kundër tij, kështu ndërrohet krejt situata, kurse me qenien e brendshme të njeriut sundon një regjim i ri. Njeri gabimtar është ai që e sundon brendia e tij shtazarake, ajo djallëzore apo ajo e bishës, dhe mu atëherë fuqia e lartë dhe engjëjllore janë të mbyllura në brendinë-shpirtin e tij.

Pendim konsiderohet ai rebelim i brendshëm kur personaliteti i ngritur i qenies së tij të brendshme, menjëherë bën revolucion kundër personaliteteve të ulëta të qenies së tij që sundojnë atë "tokë" të brendshme, të cilët i nxënë dhe i

burgos, ndërkaq vet, me ndihmën e ushtrisë e merr pushtetin. Kjo formë e kjo situatë nuk gjendet te shtaza dhe bima. Poashtu, mund të ndodh e kundëta. Don të thotë se, disa herë, personalitetet e ulëta të qenies së brendshme të njeriut, ngriten kundër atyre të ngritura, të larta; i nxënë dhe i burgosin e pastaj e marrin pushtetin. Nëse keni provuar, ka njerëz që nuk e dijnë teknikën e edukimit. Nuk e dijnë që në edukim e gjithë forca që ekziston në shpirtin, në qenien e brendshme të njeriut ka filozofinë dhe harmoninë e vet. Nëse ne posedojmë instinktin e pasionit, ajo nuk është e kotë dhe jodomethënëse. Patjetër duhet që në suaza të nevojave natyrore t'i kënaqim këto instinkte makute - të pangopura. Ata kanë një kufi, kanë të drejtë dhe kanë pasion. Patjetër, në bazë të mundësive të tyre, t'ua plotësojmë ato kënaqësi.

Kjo i ngjanë asaj sikur ju të keni në shtëpi një kalë apo një qen, e nëse këtë kalë doni ta shfrytëzoni për kalërim ose qenin për ta ruajtur shtëpinë, atëherë këta kanë nevojë për ushqim dhe ju patjetër t'i ushqeni. Ka do njerëz që nuk posedojnë shije, të cilët ndaj vetes dhe ndaj fëmijëve që i kanë nën mbikqyrjen e vet, bëjnë presion. Fëmija ka nevojë për lojë dhe vetë kjo nevojë për të luajtur është një nga urtësitë e All-llahut. Te fëmija ekziston një energji e jashtëzakonshme të cilën ai mund ta harxhojë vetëm përmes lojës. Fëmija ka të zhvilluar instinktin për lojë. Tani njeriu sheh ndonjë person që thotë: “Dua ta edukoj fëmijën tim”. Mirë pra, po si don ta edukojë? Nuk lejon që fëmija prej pesëgjashtë vjet të shkojë të luajë me fëmijët tjerë. Kur shkon musafir, e merr fëmijën me vete në mënyrë që ta edukojë. Nuk i lejon të qeshet, nuk i lejon të hajë. Ose, kemi parë që ka të atillë që vetëm pse janë hoxhallarë, gjejnë ndonjë zhgunë apo çallmë dhe sandalle, ia vëndojnë çallmën në kokë dhe e shëtisin herë andej, herë këtej. Fëmija rritet, pa i

plotësuar nevojat e tij natyrore. Gjithnjë ia kanë shprehur fjalët: Zoti, Dita e Gjykimit, dera e Xhehennemit. Gjersa në moshën njëzet e sa vjeçare, kësaj fuqie të akumuluar, kësaj dëshire, këtyre prirjeve të pangopura, s'mundet, menjëherë, t'u shkatërrohen zinxhrrët. Ky fëmijë që e keni parë se si nën sugjestionin e babait të vet e falë namazin në një kohëzgjatje prej njëzet minutash, falën nafile namaz, bënë lutje-dua, përnjë herë e shihni se si në moshën njëzetepesë vjeçare bëhet i amoralsëm dhe jodinjitoz, dhe atë pa fund. Pse? Sepse ju nën pretextsin e ngritjes së lartë shpirtërore, ia keni ngulfatur instinktet tjera të tij. Natyrisht, në natyrën e fëmijës kanë qenë të regjistruara: Zoti, Dita e Gjykimit dhe ibadeti, por ju këto instinkte për Zot, për ibadet dhe për gjëra tjera aq shumë i keni forcuar te fëmija sa që ia keni penguar instinktet tjera, ia keni burgosur ato, ia keni shqetësuar, ia keni pezmatuar e ua keni marrë të drejtën e tyre. Nuk u keni dhënë leje të veprojnë. Një ditë kur fëmija do të shikojë ndonjë film, ose me rastin e ndonjë vizite njohtohet me ndonjë femër të re, do të mjaftonte që kjo fuqi e akumuluar dhe e ngulfatur t'i shkatërrojë zinxhirët dhe gradualisht ta rënojë atë ndërtesë që babai i tij me vite e ndërtoi gabimisht në shpirtin e tij. Do të eksplodojë tamam sikur barroti.

Te pendimi në të vërtetë është ndryshe. Njeriut, që bënë gabime dhe është thellë i zhytur në dëshira dhe në aspektin shtazarak, ku aq shumë e maltreton melekun e shpirtin e vet dhe nuk i kënaq ato, përnjëherë i ndodh katasrofë. Po ti dhe unë, a thua vallë, nuk jemi njerëz dhe nuk kemi nga një gojë? Gabon nëse mendon se ke një gojë dhe se kjo gojë duhet të të ushqejë. Ti ke njëqind gojë. “Dashuria i ka pesëqind krye, dhe secila kokë ka...” Ti ke pesëqind gojë, përmes të cilave të arrinë ushqimi. Njëra nga këto gojë është goja e ibadetit. Patjetër shpirtin ta kënaqësh me ibadet. Do të thotë patjetër



tua ofrosh këto të drejta e kënaqësi. Ti je një qenie me karaktersitika hyjnore. Duhet të fluturosh drejt asaj bote. Nëse e burgosish atë engjëll-melek, a din ti se kjo ka pasoja të rënda? Përnjëherë shihni se si një djalosh i pasur që i ka patur të siguara të gjitha, bën vetëvrasje për ndonjë gjë të parëndësishme. Të gjithë thonë se nuk e dijnë pse ka bërë vetëvrasje. O zotëri, shkakun pse ka bërë vetëvrasje ka qenë shumë i vogël. Ata nuk e dijnë se në shpirtin e tij kanë qenë të robëruara do fuqi të shenjta. Ato fuqi të shenjta kanë vuajtur nga një jetë e këtyllë, nuk kanë mundur ta durojnë dhe në fund ndodh në atë formë rebelimi. Ndonjëherë shihni se si dikush i ka të gjitha, por ndjehet i shqetësuar dhe vuan.

Siç thotë poeti:

“Njëri në skaj të burgut, i gëzuar e i pirë,  
tjetri në kopsht, i dëshpëruar e i pashpresë”.

E sheh, në kopsht është duke jetuar, ku i ka të siguruara të gjitha nevojat për jetë, por është i shqetësuar, jo i lumtur e i pakënaqur me jetën.

“Rrugën e kënaqësive konsideroje të brendshme, jo të jashtme, endjen nëpër oborre e pallate konsideroje marrëzi!”

Kjo është sepse ekzistojnë edhe disa kënaqësi që arrijnë te njeriu nga brenda e jo nga jashtë e ato janë kënaqësitë shpirtërore të njeriut.

Atëherë, pendimi është një reagim i shkallës së lartë e të shenjt të shpirtit të njeriut, kundër shkallës së ulët e shtazarake të tij. Pendimi është një rebelim dhe një revolucion e fuqisë engjëlllore të njeriut kundër karakteristikave djallëzore e shtazarake të njeriut. Tani, ç’ndodh që ky kthim e kjo ankesë të paraqiten te njeriu?

Së pari, duhet të dini që, nëse në esencë ndodh ndonjë veprim nga i cili ato elemente të shenjta të brendisë së njeriut

shkatërrohen tërësisht, ose janë të lidhur fortë me zinxhirë në mënyrë që më të mos jenë të lirë, njeriu më nuk mund të ketë sukses. Mirëpo, ashtu siç ndodh në ndonjë shtet revolucion, që disa njerëz, po sikur edhe të jenë pakicë, njerëzit e pastër mbeten në mesin e njerëzve të atij vendi, ashtu ndodh nëse në brendinë e njeriut mbeten elemente të larta, të pastërta e të shenjta, mu atëherë njeriu mund të pendohet. Përndryshe kurrë nuk do të mund të pendohet. Tani, nën cilat kushte njeriu kthehet e ankohet, nëse e njeh All-llahun, pendohet përpara Tij, ndërkaq nëse s'e njeh, paraqitet një situatë tjetër, mbase çmendurake?

Thamë se pendimi është një reaktion. Merrnie topin dhe goditnie atë drejt tokës. Topi çohet nga toka. Goditja juaj don të thotë lëvizje e topit drejt tokës, derisa ai goditet nga fuqia e dorës suaj. Ky është veprimi juaj, ndërkaq ngritja e topit nga toka është reaktion që vjen përmes përplasjes së topit me tokën. Atëherë, pra, e para është akcion ndërsa e dyta është reaktion.

Nëse ju e goditni topin, sa çohet lartë ai? Nga njëra anë varet nga madhësia e forcës që është përdorur gjatë atij veprimi, don të thotë nga fuqia e goditjes suaj, ndërkaq nga ana tjetër, varet nga përbërja e sipërfaqes së tokës. Aq sa është sipërfaqja e tokës e fortë dhe e rafshtë, reaksioni është më i madh. Andaj shkalla e reaksionit, nga njëra anë, varet nga fuqia e veprimit tuaj, ndërsa nga ana tjetër, varet nga fortësia dhe lëmueshmëria e sipërfaqes ku bie topi.

Reaksioni i shpirtit të njeriut kundër gjunaheve, po ashtu varet nga dy gjëra: nga njëra anë nga fuqia e veprimit, gjegjësisht, fuqia e gabimit dhe fuqia e goditjes që e kryejnë autoritetet e ulëta të shpirtit tuaj ndaj autoriteteve të larta të të njejtit. Sa më vogël që të jetë gabimi i njeriut, aq më pak do të reagojë në shpirt, ndërkaq nëse gabimi është më i madh, do

të shkaktojë reaktion më të madh. Andaj, te njerëzit që kanë zemër të ngurtë, dhe përkrah asaj që kanë zemër të ngurtë, nëse krimi i tyre është i madh, do të shohim se shpirti i tyre tregon reaktion. Shikoni se si piloti amerikan shkon në Hiroshimë dhe hedh bombën, pastaj kur kthehet dhe shikon pasojat e veprimit të vet, sheh se si e ka kallur tërë qytetin. Pleq e të rinj, femra e meshkuj, të vegjël e të mëdhenj digjen në zjarrin që ky e kalli. Në të njëjtin moment, zgjohet ndërgjegjia e tij, lëviz dhe e qorton, edhe njerëzit e këtillë i zgjedhin prej zemërngurtëve. Kthehet në vendlindje ku e presin me ngrohtësi, i varin në qafë kurorën e dafinës, e gradojnë, ia shtojnë pagën, ia nxjerrin fotografitë nëpër gazeta dhe i japin kurajo... Mirëpo tradhëtia ishte aq e madhe, gabimi ishte aq i madh që shqetësonin ndërgjegjen e tij, ndërgjegjen e një njeriu me zemër të ngurtë sikur që ishte ky. Pra, goditja në shpirt ishte aq e fuqishme që në një sferë mentale si kjo edhe njeriu me zemër të ngurtë të dijtë reagojë. Ky person edhe kur rri me musafirë qeshet e tregon: “Kështu ose ashtu kam vepruar...”, por kur është i vetmuar, kur bie në krevat, menjëherë parasysh i del ajo skenë: “O Zot! Jam unë që e bëra atë krim! O Zot! Çfarë krimi të madh kam bërë!” Në fund ky njeri çmendet dhe përfundon në shtëpinë e të çmendurve. Pse? Sepse krimi ishte shumë i madh.

Beshar ibën Artat, njëri nga komandantët e Muaviut ka qenë njeri i çuditshëm dhe zemërngurtë. Një nga veprimet që e zgjodhi Muaviu në mënyrë që ta pengojë Aliun a.s. ishte dërgimi i një zullumqari, sikur Beshari apo Sufjan Hamidiu, në krye të një ushtrie brenda kufijve të territorit të Ali ibën Ebi Talibit a.s. Do të thoshte: “Mos shikoni se kush është i pafajshëm e kush nuk është (ngjashëm me atë që vepron Izraeli sot me botën islame). Që t’i paaftësoni, shkoni natën,

sulmoni, kallni e vritni të pafajshmin. Mos të keni mëshirë ndaj të voglit e të madhit, plaçkitni ata! Kështu kanë vepruar. Një herë e dërgoi Bashar ibën Artatin. Ai shkoi andej këndeje dhe arriti gjer në Jemen. Bëri shumë vepra të këqia. Mes tjerash, i zuri fëmijët e Ubejd ibën Abbas Abdulmutalibit, djalit të axhës së Emirul-mu'mininit-udhëheqësit të besimtarëve që ishte guvernator i Jemenit. Gjeti dy fëmijë të vegjël të cilët i therri. Me që krimi ishte shumë i madh, u zgjua ndërgjegjia e këtij njeriu zemërngurtë. E brente ndërgjegjia. Kur të ëndërronte, i paraqitej përpara ky zullum i madh. Kur shëtiste, këta dy fëmijë i dilnin përpara syve. Mendonte rreth këtyre fëmijëve dhe viktimave të tjera. Dalëngadalë u çmend. Hipte mbi një kalë prej druri dhe mbante në dorë shpatë druri. Vraponte rrugëve e turrej. I mblidheshin fëmijët rreth e rrotull dhe e përqeshnin.

Thamë se faktori i dytë i reagimit të shpirtit të njeriut është se ka të bëjë me atë që sipërfaqja e cila goditet të jetë e rafshhtë dhe e fortë, don të thotë që vetëdija, shpirti dhe besimi i atij njeriu të jenë të fortë. Në këtë rast, bile nëse goditja është e dobët, reagimi do të jetë relativisht i fuqishëm. Andaj, shihni se gabimet e vogla, bile edhe veprimet që janë mekruh e që në esencë nuk trajtohen gabime, nga ana e njerëzve me besim, njerëzve që kanë shpirt të fortë, madje shpirt engjëllor, besimi dhe vetëdija shpirtërore është e fortë, qortohen dhe nxisin reaktion. Veprimin që unë dhe ju e kryejmë me qindra herë dhe kurrgjë nuk hetojmë lidhur me të, njerëzit e ndershëm, kur kryejnë një vepër mekruh, u shqetësohet shpirti i tyre dhe shpesh herë bëjnë teube. Një njeri shumë i madh në aspektin shpirtëror, emrin e të cilit e përmenda në vitin e kaluar, në muajin e shenjtë të Ramazanit, ishte profesori im i madh, rahmetli haxhi Nirza Ali Shirazi Isfahani. Është njëri ndër komentatorët më të mëdhenj që i

kam parë në jetën time. Një natë ishte musafiri im në Kom, dhe sipas traditës, u ftuam nga ana e një alimi-dijetari prej Komi. Aty, gjithashtu, ishin edhe disa dashamirë të poezisë dhe të letërsisë në përgjithësi. Atë natë e kuptova se sa ky njeri ishte dashamirë i letërsisë dhe poezisë dhe sa e njihte letërsinë arabe dhe persiane. Të tjerët recituan disa poezi, natyrisht, prej më të thjeshtave si dhe disa poezi nga Saadiju, Hafizi dhe... Ai recitoi dhe shpjegoi se disa ishin më të mira se disa të tjera, ose se ndonjë kontekst ishte i shprehur më mirë. Pastaj komentoi atë që dikush kishte thënë se recitimi i poezive, si këto, nuk është gjuhah, ndërkaq recitimi i poezive gjatë natës është mekruh (e papëlqyer). Zoti e di se kur kemi dalë prej aty. Ky njeri ishte shumë i shqetësuar. Ai tha: “Gjithnjë vendosi që gjatë natës të mos recitoj poezi, më në fund s'mundem, s'kam durim e s'mundem ta pengoj veten”. Gjithnjë është penduar, si një person që ka bërë gjuhah të madh.

O Zot, prej Teje kërkoj shpëtim! A thua vallë, sikur të kishim pirë verë, do të ishim kaq shumë të shqetësuar? Ky njeri vetëm për shkak të një veprimi mekruh aq shumë është shqetësuar. Njerëzit e këtillë, nga shkak që janë dashamirë të All-llahut, do të kenë nga All-llahu një lloj dënimi, të cilin ju dhe ne nuk e meritojmë. Ky njeri, për çdo natë gjer para lindjes së diellit ka qenë i zgjuar, pa gjumë në sy. Atëherë e kuptova domethënien e pagjumësisë: “Nata për njerëzit e devotshëm është ditë që shndërrit botën”. Atëherë e kuptova. Atëherë e kuptova domethënien e ibadetit dhe devotshmërisë. Aty e kuptova rëndësinë e pendimit, madje, aty e kuptova përkushtimin ndaj All-llahut. Atë natë ky njeri u zgjua atëherë kur u thirr ezani i sabahut. All-llahu e dënoi. Si u zgjua vetë na zgjoi edhe neve dhe tha: “Murteza, kjo është pasojë e poezisë së mbrëmshme!” Shpirti që e ka aq shumë

besimin e fortë, kur merr ndonjë goditje të dobët sikur kjo, don të thotë kështu një sulm të vogël nga ana autoritetve të ulta kundër atyre të larta, ato autoritete reagojnë, shqetësohen, bile u paraqitet dënimi. Nuk mbetet pa u dënua, sepse njeriu i cili gjatë natës reciton poezi duke shpenzuar dy orë kohë për një gjë të tillë, nuk është i gatshëm t'i kushtojë All-llahut dy orë ibadet.

T'u tregojë një shembull tjetër. Nëse një pasqyrë të lëmuar, pas pastrimit, e leni në një vend të pastër që ju pëlqen juve, e vendoni mbi ndonjë tavolinë, pas një kohe të konsiderueshme do të vëreni se është pluhurosur. Para kësaj ju nuk e keni vërejtur këtë pluhur, nuk e keni vërejtur atë as mbi tavolinë, as në mur. Sa më tepër ndotet muri, aq më pak do të vërehen në të ndotja dhe njollat e zeza. Pra, nëse ai është esmer dhe i zi dhe nëse është tymosur nga tymi i fenerit, nuk të shihen në të gjurmë. Pejgamberi i ndershëm s.a.v.s. nuk ka ndodhur të qëndrojë në ndonjë tubim e të mos bënte taube shtatëdhjetë herë. (Ç'është kjo? Përgjithësisht, çmendojmë?). Ai thotë: “Ndjej në zemër pasojat e hidhërimit, andaj për çdo ditë, shtatëdhjetë herë pendohem në mënyrë që t'i largoj këto hidhërime”. Çka janë këto hidhërime? Këto hidhërime për mua janë pasqyrë. Ne vërejmë në të shkëlqimin, ndërsa ai hidhërimin. Ai kur flet me ne, edhe pse atë e thotë për hirë të All-llahut dhe e sheh Atë në pasqyrën e shpirtit tonë, sërish sipas tij ajo është hidhërim.

Ummi Seleme dhe të tjerët kanë thënë se dy muaj para vdekjes së Muhammedit a.s. qe një person që s'kishte shkuar askund dhe s'kishte bërë ndonjë vepër, përpos që shqipëtoi:

“Subhanall-llahi ve estagfirull-llahe rabbi ve etubu ilejh?”

“Falenderoj All-llahun dhe kërktoj falje prej All-llahut, Zotit tim dhe pendohem përpara Tij”. Ky ishte një dhikër i ri.

Ummi Seleme thotë: "Pyeta: O i dërguar i All-llahut, pse aq shumë pendohesh?" U përgjigj: "Kështu më është urdhëruar". Më vonë e kuptuam se i është shpallur sureja e fundit". Don të thotë: sureja En-nasër. Kur u shpall kjo sure, i dërguari i All-llahut s.a.v.s. e kuptoi se kjo shpallje është paralajmërim për vdekjen e tij. Pra, sikur t'i ishte thënë:- të ka kaluar koha e duhet të shkosh. Sureja En-nasër është:

"Kur vjen ndihma e fitorja e All-llahut dhe i sheh njerëzit që po hyjnë në fenë e All-llahut grupe-grupe. Ti madhëroje Zotin Tënd me lëvdata e lyp falje nga Ai! Ai me të vërtetë e pranon pendimin".

Ç'është lidhja në mes asaj hyrje e këtij përfundimi? Atëherë, pse, pas fitimit, çlirimit dhe hyrjes së njerëzve në fenë e All-llahut grupe-grupe, duhet të falenderohet All-llahu? Kjo do të thotë se misioni yt është kryer. Kjo është sureja e fundit që i është shpallur Pejgamberit s.a.v.s. Më vonë janë shpallur këto dy ajete të cilat i citon Emirulmu'mininë, Aliu a.s.

*"...Tani ua kam plotësuar fenë tuaj..."*

*"O pejgamber, kumto atë çka të shpallet nga Zoti yt! Nëse nuk e bën, atëherë nuk e ke transmetuar porosinë e Tij" (5:67).*

Ti e ke kryer obligimin tënd, e tani, falënderoje All-llahun. Pejgamberi s.a.v.s. e vërejti se i ka ardhur fundi. Kjo don të thotë: pas kësaj, mendo për vete. Kështu ndodhi që ai, menjëherë, e falënderoi All-llahun dhe kërkoi falje.

Mirëpo, ne të pafatshmit, i kemi zemrat njëjtë sikur ai muri i zi. Gjithnjë duke bërë gabim pas gabimi, shpirti ynë nuk tregon ndonjë reagim. Nuk e dijnë se ku janë dhe sa janë të ngatërruar melekët e shpirtit tonë, me çfarë zinxhirë i kanë të lidhura duart dhe këmbët që zemrat tona nuk po i lëvritin e s'po i tronditin. Pikënisja e parë e përuljes tonë është përulja.

Nëse keni ndier lëvizje në shpirtin tuaj, nëse keni ndier keqardhje, nëse keni ndier pendim, nëse e kaluara u duket e zezë, nëse keni vërejtur se rrugën që e keni trasuar gjer më tani ka qenë e gabuar dhe se ka marrë teposhtëzën dhe nëse vevetes i keni thënë: “Duhet të kthehem dhe të eci përpjetë kah All-llahu”, atëherë keni arritur në vatrën e parë të përuljes e të pendimit dhe me të keni bërë hapin e parë, dhe prej këtu mund të niseni. Përndryshe, zgjidhje tjetër nuk ka.

Një person erdhi tek Aliu a.s. dhe i tha: “O udhëheqës i besimtarëve, më jep një këshillë!” Aliu a.s. i dha një mori këshillash. Këtu do t’i përmendi vetëm dy fjalitë e para të cilat tani për tani do të mjaftojnë. Ai tha: “Mos u bën prej atyre që besojnë në Ditën e Gjykimit e që duan të arrijnë gjer te ajo pa ndonjë vepër”. Të këtillë jemi të gjithë ne. Ne shprehemi duke thënë se mjafton ta duash Ali ibën Ebi Talibin a.s. edhe pse dashuria jonë nuk është reale. Sikur kjo të ishte dashuri e vërtetë, do përcillej me vepra. Ne themi se mjafton kjo lidhje sipërfaqësore. Mendojmë se Aliu a.s. është prej atyre që ka nevojë (për një lidhje si kjo-sh.p.), po edhe sikur të ketë dikush lidhje sipërfaqësore, atëherë kjo është shumë mirë. Hazreti Aliu s’ka nevojë për ithtarë të rrejshëm. Mendojmë se një e qajtur jo reale për imam Huseinin a.s., mjafton, por udhëheqësi i besimtarëve ka thënë se ajo është e rrejshme. Nëse ajo dashuri ndaj Ali ibën Ebi Talibit nxitë në vepra, dije se dashuria yte është e sinqertë dhe e vërtetë. Nëse vaji për Husein ibën Aliun të nxitë në vepra, dije se ke qajtur për Husein ibën Aliun dhe se të qarit tënd është i vërtetë. Nëse s’është kështu, atëherë është mashtrim i shejtanit.

Fjalía e dytë është: “O njeri! Mos u bën prej atyre që gjatë jetës duhet të pendohen, dhe gjithnjë thonë: “Nuk është vonë. Ka kohë”. O vëlla! nëse Aliu a.s. vjen e na pranon mua e ty, dhe ne kërkujmë nga ai të na këshillojë, kështu do të



thoshte. Gjer kur do të themi se nuk është vonë dhe se ka kohë? Gjer sa jemi të rinj, themi: O vëlla! Për të riun nuk është koha për betim. Për çudi disa njerëz pleq, kur ta shohin ndonjë të ri se i kushton rëndësi ibadetit dhe ruhet nga mëkati dhe se është i gatshëm të pendohet, i thonë: “O zotëri! Ende je i ri. Mos i përdor më këto fjalë”. Mu atëherë në rini koha është më e përshtatshme. Dega e drurit gjersa është e re, më tepër ekziston mundësia të drejtohet, ndërkaq kur të vjetërohet-trashet, forcohet edhe më tepër e kështu mundësia është më e vogël. Krahas kësaj, kush i ka premtuar këtij të riu se do të plakët, se do të mbrijë moshën e burrisë e pastaj edhe atë të pleqërisë? Kur jemi të rinj, themi se jemi të rinj, ndërkaq kur kalojmë në një moshë mesatare, atëherë themi se kemi kohë dhe se pleqëria është koha për pendim. Kur plakemi dhe nuk funksionojmë si duhet dhe humbim krejt fuqinë, atëherë kryejmë pendimin, ndërkaq nuk e dijmë se kemi bërë gabim. Mu atëherë nuk do ta kryejmë atë. Atëherë nuk do të kemi më fuqi për t’u penduar; aq do të jemi të ngarkuar me barën e gabimeve saqë zemra jonë nuk do të jetë e gatshme për pendim. Zemra e një të riu është më e gatshme për pendim se zemra e një plaku. Sa bukur shprehet Mevlana:

“Rënja nga ferra e fortë, edhe përpjetë,  
Mbjellësi i ferrës i dobët, edhe tatëpjetë.

Ai sjell shembull. Thotë se një person kishte mbjellë një ferrë në rrugën ku kalonin njerëzit. Ferra u rrit. I thanë: “Zotëri, eja ta largosh ferrën!” U përgjigj: “Nuk do të jetë vonë”. Ajo është vetëm një berunxë, lehtë mund të shkulet”. Përsëri thanë, e ai, përsëri u përgjigj se nuk është vonë: “Tani do ta shkuli, vitin e ardhshëm do ta shkuli!” Vitin e ardhshëm ferra u rrit, por ç’ndodhi me mbjellësin e ferrës? Tani ishte plakur edhe më shumë. I thane atij: “Eja ta mënjano!” U përgjigj: “Pastaj do ta kryej atë”. Për çdo vit ferra gjithnjë e

më shumë rritej, trangu trashej më shumë, ferrat iu bënë më të mprehta, kështu rreziqet u shtuan, ndërkaq mbjellësi i ferrës plakej e dobësohej gjithnjë e më tepër.

Poeti këtu don të tregojë se këto shpirtligësi e çoroditje, në qenien tënde, për çdo ditë rriten sikur ajo ferra dhe gjithnjë e më tepër lëshon rrënjë. Trangu do t'u rritet, ferrat do t'u mprehen më shumë dhe do të krijohet më tepër rrezik, ndërsa ti, ditë për ditë do të plakesh, do të dobësohesh dhe ato fuqi pozitive që i posedon do të dobësohen. Kur je i ri je një person që ka mundësi ta rëzojë një dru dhe atë shumë shpejt, dhe gjithashtu, t'ia shkulë rrënjët e ta hedhë. Kur të plakesh, dobësohesh, ndërkaq dëshiron që me duart tua ta rëzosh ndonjë dru. Kushedi sa herë ta provosh, s'do të keshë mundësi. Të betohem në All-llahun se një ditë është një ditë, e një orë, është një orë. Nëse edhe një natë e prolongojmë, bëjmë gabim. Mos thoni: Nesër mbrëma (do të pendohem-sh.p.), në njëzetetretën natë të Ramazanit-Lejletul-kadrin, kur është rasti më i mirë për pendim”.

Jo! Sonte është më mirë se nesër mbrëma. Ky moment është më i mirë se sa një orë më vonë. Çdo moment i tanishëm është më i mirë se një orë më vonë. Ibadeti pa pendim është i papranuar. Njeriu së pari duhet të pendohet.

Poeti shprehet:

“Pastroju së pari, pastaj në kopsht të Xhennetit”

Njeriu së pari duhet të pastrohet, e pastaj të hyjë në atë vend të pastërt. Përderisa nuk pendohemi, pse bëjmë ibadet? Nuk pendohemi, e agjërojmë. Nuk pendohemi, e falemi. Nuk pendohemi, e shkojmë në haxh dhe lexojmë Kur'an, bëjmë dhikër dhe falim namazin e xhumasë. Betohem në All-llahun, nëse bëni teube në mënyrë që të pastroheni, pastaj, një natë e një ditë ashtu në atë gjendje pendimi falni namaz, ajo ditë do

t'u shpie përpara për dhjetë vjet dhe do t'u afrojë ndaj All-llahut. Ne kemi devijuar nga rruga.

Një njeri shkoi te udhëheqësi i besimtarëve, Aliu a.s. dhe u pendua. Ai, sikur ne, mendoi se pendim bëhet vetëm me të shqiptuarit e kësaj fjalie: “O, Zot! Ty të kërkoj falje dhe Ty të përulem”. Mendon poqese këtë fjali e shqipton më fuqishëm së është shumë më mirë. Aliu a.s. e kuptoi se ky i ngratë sa ka devijuar. Shumë rrallë ndodhte të bëhej i ashpër e të shprehej ashpër, por me këtë rast u shpreh ashpër: “Mos të past nëna! A e din ti se ç' do të thotë të kërkoj falje nga All-llahu? Të kërkoj falje nga All-llahu është një gradë e lartë. Ajo është situatë e shenjtë dhe pendimi. Ajo ndodh në një atmosferë të shenjtë. Nëse sinqerisht pendoheni, do të gjendeni të përfshirë në një atmosferë të shenjtë, do të ndjeni se mëshira e All-llahut dhe mbështetja në Atë do ta përfshijë shpirtin tuaj, se rreth jush janë tubuar një grup melekësh, do të pastroheni, sepse njeriu gjatë pendimit, hedh mendjemadhësinë, gjykon veten dhe u kushtohet gabimeve të veta.

Në Islam thuhet se nëse dëshiron të pendohesh nuk ka nevojë të shkosh te ndonjë njeri i fesë apo te hoxha në mënyrë që t'ia rrëfesh gabimet tua. Gabimet tua rrëfej para All-llut, pse t'ia rrëfesh ato para ndonjë qenie njerëzore? Rrëfej gabimet përpara All-llahut xh.sh.! Ja ç' thotë All-llahu: **“O robërit e mi të cilët keni bërë gabim ndaj vetes, mos e këputni shpresën nga mëshira e All-llahut! All-llahu, me siguri, do t'ua falë të gjitha mëkatet; Ai, një mend, falë shumë dhe është i Mëshirshëm”**. (39:59)

Ky hadith i ndershëm, sa bukur e përshkruan pendimin:  
**“Të qarit e atij që pendohet është i dashur tek All-llahu si dhikri i të devotshmit”**.

Shkoni dhe në prezencë të All-llahut rënkoni, mendoni gjersa të mos ju kujtohen gabimet-gjunahet tuaja. Askujt mos

i tregoni, por vështroni gabimet tuaja. (Ju vetë e dini, bëheni gjykatës i vetvetes dhe vetëgjykoheni). Pastaj, gjunahet tua nxirrni përpara All-llahut dhe tregoni lëshimet dhe gabimet tuaja, rënkoni, qani e kërkoni falje. Kërkoni të pastroheni nga gjunahet, All-llahu do t'ua falë, do t'ua pastrojë shpirtin e zemrën, madje mëshira-rahmeti i Tij do t'ua përfshijë qenien tuaj. Do ta ndjeni shijen e bukurisë së ibadetit në shqisat tuaja. Gabimi dhe të kënaqurit me gabimin, në sytë tuaj, do të jenë të nënçmuar. Më s'do të keni dëshirë të shikoni ndonjë film porno, nuk do t'i shikoni gratë e huaja, nuk do të keni vullnet për të përgojuar, për të rrejtur apo për t'i akuzuar njerëzit. Do të shihni se i gjithë vullneti juaj do të drejtohet kah bamirësia.

Aliu a.s. pas kësaj i përmendi gjashtë kushte që kanë të bëjnë me pendimin, prej të cilave dy janë bazë e pendimit, dy të tjerë janë për t'u pranuar pendimi, ndërkaq dy të fundit janë për përsosmërinë e tij.

Ju e vëreni se kënaqësia e njerëzve më të pastërt e më të ndershëm qëndron në të biseduarit me Zotin e vet, që gjithnjë flasin për lëshimet dhe gabimet e veta, kurse gabimet e tyre, në krahasim me gabimet tona, konsiderohen lëshim i gabimit të vërtetë. Ekziston edhe një gradë më e lartë se sa lëshimi i gabimit të parë. Po ta lexoni lutjen e Ebu Hamzës, do të shihni se si Ali ibën Huseini ka biseduar me Zotin e vet. Si ka rënkuar! Lutja e Ebu Hamzës është një rënkimi i Ali ibën Huseinit. Tani, të njohtohemi pak me dënesjen e këtij robi të ndershëm të All-llahut. Kënaqësia e tyre është shprehur në atë mënyrë, që kur flasin me Zotin e tyre, gjithnjë flasin për mosekzistimin e tyre, për varfërinë e për nevojat dhe lëshimet. Gjithnjë kanë thënë: “O Zot! Gjithëçka që vjen nga unë është lëshim, ndërsa gjithëçka që vjen nga Ty është mëshirë-rahmet e begati-ni'met”.

Fjalia që vijon është e Ali ibën Huseinit: “O All-llahu im! Mevlaja-mbikqyrësi im! Zoti im!, kur i shoh gabimet e mia më kap frika e trishtimi, por ku hedhi një shikim në Ty, vërej rahmetin Tënd. Në shpirt më paraqitet aspirata dhe shpresa. Gjithnjë qëndroj në mes frikës dhe shpresës. Kur e shikoj veten më kaplon frika. Kur të shikoj Ty më përfshinë shpresa”. Po, ata kanë qenë të këtillë.



## TEUBEJA II

*“O Zoti ynë - thanë ata - bëme mëkat ndaj vetes, dhe nëse Ti nuk na e falë dhe nuk na mëshiron, ne, me siguri, do të jemi të humbur”.* (7:23)

Diskutimi ynë ka të bëjë me pendimin. Thamë se pendimi është stacioni-pikënisja e parë për ata që duan ta pastrojnë shpirtin dhe për të bërë ibadet e për t’u përlurur. Nëse dikush ka për qëllim t’i afrohet All-llahut, nëse dëshiron ta përgatitë vetveten, patjetër t’i kthehet të kaluarës së tij zezë dhe të bëjë teube- të pendohet.

U kam premtuar se do t’u përcjell shpjegimin që e ka dhënë udhëheqësi i besimtarëve, Aliu lidhur me pendimin, ku shpjegon vërtetësinë, kushtet dhe shkallët e përsosjes së teubes. Në fjalën hyrëse, para se ta paraqes shpjegimin e hazreti Aliut a.s., do të përgjigjem në një pyetje. Ajo është: kur do të pranohet pendimi i njeriut e kur është koha për pendim? Don të thotë, njeriu gjer kur ka afat për pendim?

Gjer sa ekziston në këtë botë e është i gjallë dhe gjersa nuk është ballafaquar drejtëpërdrejtë me vdekjen, njeriu e ka rastin për t’u penduar. Vetëm kur njeriu është nën kthetrat e vdekjes dhe nuk ka shpresë për shpëtim, pendimi i tij s’do të pranohet. Ato momente dhe çaste të fundit, sipas shpjegimit të haditheve, janë çaste të përqëndrimit të shikimit, që do të thotë se njeriu në ato momente sheh vdekjen dhe botën tjetër. Kur ende është i gjallë, e sheh botën tjetër përpara vetes. Para këtij momenti, njeriut i pranohet pendimi, ndërkaq në momentin e fundit të jetës, më nuk i pranohet ashtu sikur pendimi në botën tjetër-Ahret që nuk vlen gjë. Njeriu atje më nuk është në gjendje të pendohet, po sikur edhe të dëshirojë.

Ky (pendim në çastet e fundit të jetës-sh.p.) nuk është pendim i sinqert, por vetëm se një veprim sipërfaqësor. Pendimi i tij nuk do të jetë i pranuar. Por, pse të jetë kështu? Përgjigjja në këtë pyetje është plotësim i diskutimit të mëparshëm, dhe mu për atë e fillojë këtë. Pse pendimi nuk është i pranueshëm në momentin kur njeriut i hiqet perdja syve?

Kur'ani thekson që:

“Besimi i tyre, kur të përjetojnë dënimin tonë, s'do t'u sjellë aspak dobi, sipas ligjit të All-llahut që është aplikuar për robërit e Tij, dhe atëherë pësojnë mosbesimtarët”.

Pse? Sepse pendimi s'është vetëm keqardhje dhe kthim. Do të thotë: nëse njeriu, në çfardo kushte qoftë, vetëm kthehet nga rruga e gabuar, ajo nuk numërohet pendim. Pendim është ajo kur në qenien e njeriu paraqitet një revolucion i brendshëm.

Njeriu kur të arrijë gjer te shkalla në të cilën vëren se është nën kthetrat e vdekjes dhe e sheh dënimin e All-llahut, atëherë, sigurisht do ta shpreh besimin e vet, por një shprehje e këtillë nuk është ndonjë revolucion i brendshëm i shenjtë.

Kur'ani për Faraonin thotë:

***“Dhe ne i transferuam izraelitët përtej detit, kurse Faraoni dhe ushtarët e tij i ndoqën pas me urrejtje e armiqësi, derisa filloi të përmbytet, dhe tha: -Unë besoj se nuk ka Zot tjetër përveç Atij të Cilit i kanë besuar Izraelitët, edhe unë jam nga muslimanët!”*** (10:90)

Faraoni, gjersa është gjallë dhe jeton në jetën e kësaj bote, sillet si Faraon, e pamundur është ta bindish, në çfarëdo mënyre qoftë dhe nuk pranon këshillë e mësim. Qëndron në mes magjistarëve dhe Musait a.s., ndërkaq vetë magjistarët bëhen muslimanë. Ai edhe më tepër kërcënohet, synon t'i përndjekë Musain dhe popullin e tij e t'i mbysë ata. Por kur e mbuloi uji dhe filloi të mbytet, pa se i erdhi fundi i jetës dhe u

bë i sigurt se më nuk ka shpëtim, tha: “Unë besoj se nuk ka Zot tjetër përveç Atij...” Këtu pendimi nuk u pranua. Pse All-llahu nuk e pranoi? Po, a thua vallë, All-llahu posedon diç nga “koprracia”. Jo, po të jetë pendim, Ai e pranon, por ky s’është pendim. Pendim don të thotë revolucion i brendshëm. Ky nuk është një revolucion i brendshëm i shenjtë. Te njeriu, i cili, kur të gjendet në fund të detit, kurse rretheqark tij ka vetëm ujë, ngado që të shikojë sheh ujin dhe në këtë hall shpreh dëgjueshmëri, ndërgjegjja e tij nuk është zgjuar. Nuk i është ngjallur ndërgjegjja, nuk është ngritur kundër vetvetes. Por, tani, e sheh veten si të gJORë dhe të pandihmuar, nga frika dorëzohet. Prandaj atij i thuhet: “Tash, a! Para kësaj ishe i padëgjueshëm dhe a bëje përçarje”? Përse para një ore, kur ishe i lirë, nuk e shqiptove këtë? Sikur, vetëm një orë më parë, kur ishe i lirë, ta kishe shqiptuar këtë fjalë, haptas do të shihje qartë se në ty është paraqur revolucioni i brendshëm hyjnor, kurse tani kur po e shpreh këtë fjali, ky nuk është revolucioin hyjnor, por është pamundësi dhe kukamë. Po kush do të ishte ai kriminel që s’do të ishte ankuar, në momentin kur të kapej nga ana e Drejtësisë? Po ky nuk është ankim. Nuk është shenjë përmirësimi. Sikur krimineli, para se të kapet, ndryshon nga brenda dhe nëse i jepet rasti për të bërë vepër të keqe, i largohet, ky është pendim dhe këthim i vërtetë. Prandaj shkaku që në momentet e fundit, atëherë kur përqëndrohet shikimi në botën tjetër, nuk i pranohet njeriut pendimi, qëndron në atë se ky pendim nuk është pendim. Nuk ka të bëjë me atë se është pendim e nuk është i pranuar, nga se ky assesi nuk është pendim.

Pse pendimi i njeriut nuk pranohet në botën tjetër? Në këtë pyetje jemi përgjigjur. Sepse në atë botë të gjitha gjërat janë të kontrolluara dhe të dukshme. Sikur atje të shprehej pendimi e të thuhej: “O Zot, pendohem!”, ai pendim s’është



revolucion i brendshëm hyjnor, nuk është revolucion i lirë. Tjetra, a e dini se ç'është njeriu kur vdes. Ai është si një pemë që ka qenë në dru, pa marrë parasysh se është pjekur apo jo, e ndahet nga ai dhe bie në tokë. Gjersa fruti është në dru, ai varet nga rregulli i drurit. Nëse piqet fryti, piqet nëpërmjet drurit të pemës. Nëse i arrinë uji, i arrinë përmes rrënjëve. Nëse i arrijnë materiet ushqyese, i arrijnë përmes drurit. Nëse shfrytëzon ajrin, e bën përmes drurit. Nëse ka shije të ëmbël, atë e ka për shkak të akcionit dhe reacionit që ndodh me drurin. Nëse e ndryshon ngjyrën, edhe këtë e bën përmes drurit. Me të rënë të pemës nga druri i vet, i humb të gjitha mundësitë që i ka patur. Për shembull, gjer para një ore, molla që ka rënë nga druri, në degë ka qenë e pjekur ose gjysëm e pjekur dhe ka patur mundësi të përparojë edhe për një shkallë; ta ndryshojë ngjyrën, ta shtojë peshën, të jetë më me shije, më e ëmbël dhe më me aromë të këndshme, por si të bjerë nga druri, i humb të gjitha mundësitë. Don të thotë, rastin e fundit e në momentin e rënies nga druri.

Njeriu është fryt i drurit të natyrës, fryt i drurit të botës. Të gjitha mundësitë që ekzistojnë për njerëz, ekzistojnë në natyrën e botës. Për t'u përmirësuar ne, mundësia ekziston vetëm në këtë botë. Gjithashtu për ne në botë ekzistojnë gjëra që na mundësojnë të bëhemi më të këqinj. Ne që jetojmë në këtë botë, qëndrojmë në drurin e kësaj bote dhe të natyrës, jemi frut i këtij druri.

“O i dashur kjo botë është sikur druri,  
Ne në të jemi fruta gjysëm të pjekura”.

Përderisa gjendemi te druri i natyrës, të gjitha mundësitë i kemi. Nëse bëjmë ibadet, piqemi sikur që piqen pemët. Në qoftë se bëjmë gabime, jemi sikur pema që sulmohet (nga sëmundja-sh.p.), edhe ne krymbemi, sikur që krymbat ose morat sulmojnë pemën përmes drurit. Pendimi është njëra

nga këto mundësi. Kjo është sikur uji ose ushqimi që përmes drurit të natyrës patjetër të na arrijnë. Andaj kur të vdesim, më s'ka si të na arrijnë. Pse? Thash se pendimi është një revolucion hyjnor dhe të gjitha ndryshimet, revolucionet e lëvizjet i takojnë kësaj bote, ngritja lartë apo lëshimi poshtë i takojnë kësaj bote. Me të venduar këmbën në prag të botës tjetër, do të mbetemi në atë pozitë që e kemi marrë dhe aty do të mbetemi. Kufiri më i madh i objektivizmit është arritur. Ja edhe një shëmbull. Përderisa fëmija është në embrion, ai varet nga jeta e nënës së vet. Përmes saj ai pranon: ushqimin, ujin e shëndetin. Por si të lindet, më nuk varet nga ajo. Disa rregulla tjera dominojnë mbi të dhe ai më asnjë moment nuk mund të jetojë në embrion, ku ka patur rregulla të tjera. Kur kalon nga kjo botë, njeriu pëson ndryshim mbi rregullat e jetës dhe nuk ekziston mundësia të shfrytëzojë as dispozitën më të vogël të rregullave që kanë qenë në këtë botë. Akti i pendimit, zhvillimi, ngecja, ngritja, zbritja, ndërimi i rrugës e drejtimit, të gjitha kanë të bëjnë me këtë botë.

Ja çka thotë hazreti Aliu:

“O njerëz! Sot dita është për të vepruar e nuk është ditë për dhënien e llogarive. Bota nuk është vend ndëshkimi e as vend për dhënien e llogarive”.

Nuk thotë se nuk ekziston asnjë dënim në këtë botë. Disa veprime në këtë botë janë dënime, disa janë fatëkeqësi që ndodhin në këtë botë, janë pasojë e veprimeve njerëzore. Por, mos mendoni se All-llahu e merr në llogari çdo veprim të keq në këtë botë, madje mos mendoni që çdo situatë e keqe që e godet njeriun se është pasojë e veprimeve të tij. Nuk është ashtu. Andaj, nëse një njeri në këtë botë assesi nuk ka përjetuar ndonjë dënim, a thua vallë, kjo don të thotë se llogaria e tij ka qenë e pastërt? Jo. Po a thua vallë, nëse dikush në këtë botë ka përjetuar vështirësi, se është pasojë e

vperimit të tij të keq? Don të thotë se All-llahu i ka dënuar në këtë botë? Jo, nuk është ashtu. Mësimet islame na thonë: “O njerëz! Kjo është ditë për veprim e jo ditë për dhënien e llogarisë. Puna qëndron dryshe ashtu që bota tjetër nuk është vend veprimi, ai kryekëputë është vend dhënie llogarishë”.

Atëherë, ajo që tregon se pendimi i njeriut është i kufizuar me kohën para se njeriu ta shohë vdekjen dhe pasojat e saja, e që, pasi ta shoh vdekjen, sikur që ndodhi me Faraonin, pendimi më nuk i pranohet dhe, njëherit që në botën tjetër nuk ka pendim, të gjitha këto ishin gjërat që ua theksova. Çka mund të konkludojmë në bazë të këtyre gjërave? Fjalët e Aliut a.s.: “O, njerëz...” Ne duhet patjetër ta shfrytëzojmë rastin dhe të mos bëhemi prej atyre që e vonojnë pendimin duke llogaritur se ka kohë. All-llahu xh.sh. thotë:

***“Ai u premtonte dhe i tërheq ata me shpresa të rrejshme, e atë që u premtonte shejtani nuk është asgjë tjetër vetëm gënjeshtëri, iluzion”.*** (4:120)

Ky premtim nuk do të vonojë, ende ka jetë, ende nuk ka lulëzuar një lule nga qindra lule, krejt këto janë mashtrimet e shejtanit, mashtrimet e shpirtit të mëhershëm. Njeriu nuk guxon ta vonojë pendimin.

Këtu përfundova hyrjen time, ndërsa tani do t’i qasem diskutimit rreth fjalëve të Aliut a.s.

Ai person kur u pendua dhe kërkoi falje në prezencë të Aliut a.s., ndjeu në vete se ai nuk ia di kuptimin, nuk e di të vërtetën dhe vlerën e kërkimit të faljes, andaj, me të drejtë, i tha: “Mos të pastë nëna! A e di ti se ç’do të thotë të kërkosh falje nga All-llahu? Të kërkuarit falje nga All-llahu është një gradë për ata që janë të ngritur (ilijjinë)!” *Ilijjinë* konsiderohen njerëzit që në atë akt hyjnor kanë pozitën e fatbardhëvetë lumturve. Pastaj i shprehu fjalët e kërkimit të faljes. Edhe teubeja është një fjalë në kuadër të gjashtë bazamenteve të

pendimit. Këto gjashtë bazamente që i thekson Aliu a.s., dijetarët i kuptojnë kështu: dy janë baza e pendimit, dy të tjerët janë kushte për t'u pranuar pendimi (don të thotë dy përbëjnë esencën, e dy të tjerët përbëjnë kushtet e pranimet të pendimit që përmban esenca), ndërkaq dy bazamentet e fundit janë kushtet e plotësimit të pendimit. Tani të shohim se ç'janë këto bazamente.

Bazamenti i parë i teubes është keqardhja dhe prekja e thellë shpirtërore për atë që ndodh. Don të thotë se teubeja është vërtetë pendim vërtetë atëherë kur të hidhni një shikim në listën e veprave tuaja nga e kaluara dhe automatikisht në shpirtin tuaj paraqitet një keqardhje. Shpirti përvëlohet: “Pse e bëra?” A keni parë që njeriu, ndonjë herë bën diçka duke menduar se ajo do të jetë në dobinë e tij? Pastaj, pasi e kryen veprën, menjëherë e vëren që ai veprim i ka sjellë një dëm të konsiderueshëm. Kur e kupton se ka gabuar, thotë: “Ah” dhe then gishtat: “Pse e bëra këtë?” Kjo quhet keqardhje, mosdisponim. E ndonjë herë thotë: “O zotëri, kam bërë diçka që tani aq shumë më vjen keq sa që sikur keqardhja të shkaktonte që njeriut t'i dalin brina, unë do kisha tani brina”. Kushti parë i teubes është keqardhja. Mos dhashtë Zoti t'i keni përlyer buzët tuaja, për shembull, me birë, dhe menjëherë t'u shkojë mendja te Kur'ani. Ç'thotë Kur'ani për të dehurit? Ai thotë: ***“O besimtarë, nuk ka dyshim se alkooli edhe loja me para edhe idolatria edhe shigjetat për fall janë të ndyra, nga punët e djallit, prandaj largohuni prej tyre në daçi të jeni të shpëtuar”***. (5:90)

Përdorimi i verës s'shkon krahas mirqenies e lumturisë. Bixhozi në Islam është haram, i ndaluar dhe një prej gabimeve të mëdha, sido që të jetë ai. Muslimani nuk bën të luajë bixhoz. Çfarë muslimanësh jemi ne nëse bëjmë gabime të mëdha? Sa është përgojimi i sanksionuar në Kur'an, i cili në

mesin tonë është bërë i zakonshëm? Betohem në All-llahun, njeriu habitet me të gjitha këto akuza që ekzistojnë në mesin e njerëzëve. A e dini ç'do të thotë të akuzosh? Kemi dy gabime të klasit të parë, njëri është rrena, kurse i dyti është përgojimi. Gabim i madh është ai gabim nga i cili njeriu meriton Xhehnemin.

***“...Dhe mos spiunoni njëri-tjetrin e as mos e përqeshni njërin-tjetrin! A don dikush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?!...”*** (49:12).

Sa i gërditshëm është mishi i kufomës, veçanërisht nëse njeriu e njih trupin e atij personi që e ka patur shok. A ka koment më të madh se ky?

Shpifje don të thotë rrenë plus përgojim. Pra, dy gabimet së bashku quhen shpifje, e sa kjo është bërë traditë në mesin tonë! Disa prej nesh dëshirojnë t'i imitojnë njerëzit e devotshëm dhe në fillim të bisedës së tyre shtojnë fjalën “thonë”. Për shembull, kur ndonjë person është shpifës dhe dëshiron përgjegjësinë ta hedh te tjetri, mendon se mund ta mashtrorë All-llahun. Themi: “Thonë ky person është kështu ose ashtu”. Personi tjetër dëgjon nga ne dhe dikund tjetër e përcjellë duke thënë: “Thonë kështu...” Pastaj i drejtohet vetes: “Mirë pra, po s'e them unë këtë, unë them se të tjerët kanë thënë”. Kur'ani edhe këtë e ndalon dhe e konsideron mëkat-gabim të madh. Kur'ani thotë: ***“Ata të cilit dëshirojnë që në mesin e besimtarëve të përhapet amoraliteti i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu e di por ju nuk e dini”***. (24:19)

Nëse nga ndonjë person i marrë ose nga ndonjë tjetër i njëanshëm, dëgjoni ndonjë fjalë për ndonjë person tjetër, nuk keni të drejtë të thoni: “kam dëgjuar”, “thonë” sepse këto fjalë përhapin vepra të këqia, njëherit mëkate tjera. Ata që nuk e respektojnë nderin e tjetrit, duhet ta dijnë se Pejgamberi

s.a.v.s. ka thënë: “Ngulitja e shikimit është zina”. Njëherit këtë duhet ta dijë edhe ai që nuk falet dhe nuk agjëron.

Kur synojmë pendimin duhet të kemi kujdes në gabimet tona. Pejgamberi i ndershëm s.a.v.s. thotë: “Gjatë kohës së mi’raxhit pashë disa gra të varura për flokësh, të cilat i rrihnin me thupra zjarri. E pyeta Xhibrilin, i habitur: “Kush janë këto njerëz?” Xhibrili u përgjigj: “Këto janë disa gra nga ummeti yt që nuk i kanë fshehur flokët e tyre nga meshkujt e panjohur”. Atëherë ende nuk ishte i njohur xhihadi, por Pejgamberi s.a.v.s. këto gjëra i shihte me syrin e brendshëm. Këto gjëra ekzistojnë në libra që prej njëmijë e katërqind vjetësh. Ai tha: “Kam parë gra të varura për gjinjsh e duke u rënë gjinjve me thupra të nxehta...” Pastaj vazhdoi: “Më thanë se këto janë gra të ummetit-popullit tënd të cilat janë zhveshur në sy të njerëzve!” Po a thua vallë, për këto “katër ditë” jetë ja vlen që njeriu për gjithnjë të përjetojë dënimin nga ana e All-llahut xh.sh.? U betohem në All-llahun se kjo është e vërtetë që nuk ka fare dyshimi në të. Po deri kur do të vazhdojë shpifja? Deri kur do të vazhdojë kundërshtimi ndaj All-llahut? Deri kur do të shahet Pejgamberi s.a.v.s. Tani sharja bëhet gojarisht dhe në formë të shkruar. Aliu a.s. ka thënë: “E para është që shpirti yt të digjet dhe është në flakë dhe të mbytesh në keqardhjen tënde. Hapi sytë drejt mëkateve tua. Formo një dhomë gjyqi për vete dhe gjykoje veten. Shiko sa mëkate të mëdha bëjsh për çdo ditë”.

Shejh Behai thotë:

Vendi i paraardhësit tënd ishte Xhenneti,

melekët i bënë sexhde,

për një gabim, i thanë:

“U bë, o gabimtar, dil jashtë i përulur!

Ti, o fytyrëzi, pret që me një sërë mëkatesh të shëtisish nëpër Xhennet!”

Cili është kushti i dytë i pendimit? Ai tha: “Ky është një qëndrim burrëror, qëndrim serioz: unë më nuk do ta përsëris këtë vepër të keqe”.

Natyrisht shpresoj se nuk u kam shqetësuar me këto vargje që ua theksova. Mos thoni:” Shkuam kot?” Jo

***“Thuaj: - O robërit e mi të cilët keni bërë gabim ndaj vetes, mos e këputni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut? All-llahu, me siguri, do t’ua falë të gjitha mëkatet; Ai, njëmend, falë shumë dhe është i Mëshirshëm”.*** (39:53)

Nga cilido mëkat të hiqni dorë dhe të largoheni nga ai, All-llahu e pranon atë. Të gjitha kushtet janë të përmendura, por nuk janë të përmendura kufiri dhe sasia e mëkatit. Nuk kanë përmendur, nëse gabimi yt ka arritur gjer në atë shkallë që pendimi yt do të pranohet; e nëse e kalon atë, nuk do të pranohet, por thanë: “Pendohu e ai pendim do të pranohet por nëse vërtetë pendohesh”. Nëse brenda shpirtit tënd paraqitet një dëshirë e zjarrtë, në qoftë se në shpirtin tënd ekziston një revolucion i brendshëm hyjnor dhe vendosish që mos ta përsërisish, pendimi yt do të jetë i pranuar, por me kusht që të jeshë vërtetë i vendosur. E jo të vish këtu e të pëshpëritish e ti thuash vetes se në ç’gjengje të keqe je, e kur të dalish, t’i harrosh të gjitha. Kjo nuk bën, bile edhe më keq është kështu. Imam Aliu a.s. ka thënë: ”Ata të cilët pendohen dhe e përsërisin gabimin, më mirë të mos ishin pendua se sa që u penduan. Sepse kjo është një tallje me All-llahun dhe me pendimin”. Këto dy gjëra janë bazament i pendimit: e para është keqardhja, zjarri i brendshëm, pakënaqësia nga e kaluara, ndërsa e dyta është qëndrimi serioz dhe i fuqishëm që mëkati të mos përsëritet më. Megjithatë, pendimi ka dy kushte:

Kushti i parë është t’ia kthesh të drejtën-hakun njeriut. All-llahu është i drejtë, nuk i mohon të drejtat e robërve të

Vet. Ç'do të thotë kjo? Nëse ke marrë pasurinë e popullit, duhet të ua kthesh pronarëve të saj, ose t'ua kompenzosh atyre. Nëse i ke përgojuar njerëzit, duhet të shkosh te ata, të nënshtrohesh e tu thuash: “Zotëri unë u kam përgojuar, kërkoj falje”.

Më ka ndodhur një rast. Nuk di se a është në rregull ta përmendi këtu apo jo. Isha talebe (nxënës i shkollës fetare islame) dhe gjatë atyre ditëve, natyrisht më pak përgojoja se dikund tjetër, por disa herë ndodhte kur tuboheshim, që dikush ta përgojonte këtë e tjetri atë njeri. Njeriu menjëherë e vëren se edhe vetë ka rënë në atë kurthë. All-llahu xh.sh. e mëshiroftë ajetull-llah udhma Huxhe-xhe. Një herë në një rast vetë isha i rrethuar me njerëz të cilët e përgojnin atë. Ky ishte profesor te i cili kam mësuar vite të tëra, bile një herë, nga lënda e tij fitova shpërblim në gara publike. Menjëherë e kuptova se kjo nuk ishte në rregull dhe e pyeta veten pse të gjendem në rrethana të këtilla. Ai shkoi një herë në mauzoleun e hazreti Abdulazizit. Një ditë, pas mesdite, shkova te ai dhe trokita në derë të shtëpisë së tij dhe porosita: “Thuani se erdhi filan filani!” Ishte në shtëpi dhe më dha leje të hyjë brenda. Më kujtohet se hyra brenda. Ishte me kapelë mbi kokë dhe i mbështetur në jastëk. Atëbotë ishte i moshuar dhe i sëmurë, kështu që pas dy-tri vitesh vdiq. Iu drejtova: “Zotëri, kam ardhur të ju them diçka”. Pyeti se çka, e unë i tregova: “U kam përgojuar juve, natyrisht se pak, mirëpo kam dëgjuar shumë përgojime kundër jush dhe më vjen keq pse isha në atë mes ku u përgojuat dhe i dëgjova ato përgojime. Rastësisht edhe unë ju përgojova, dhe meqë kam vendosur që kurrë më mos ta përsëris këtë dhe që mos të dëgjoj më përgojime kundër jush, erdha që t'ua them këtë në mënyrë që të ma falni”. Ai njeri mu drejtua me zemërgjerësinë që kishte: “Dy lloje përgojimesh ka kundër nesh. Njëra është në formë



të mosrespektit ndaj Islamit, ndërsa tjetra është kundër personalitetit tonë”. E kuptova se ç’mendonte ai, andaj i thash: “Jo, unë s’kam folur gjë dhe s’marr guxim të shprehi mosrespekt ndaj Islamit, gjithë ajo që u tha kishte të bëjë me ju”. Ai tha: “ Falë të qoftë!”

Nëse njeriu dëshiron të pendohet, patjetër duhet që ta pranojë të drejtën e ta pagujë borxhin. Ai që duhet të paguajë zekatin dhe nuk e ka paguar, është i ngarkuar me borxhin e huaj që patjetër ta paguajë atë. Ai që nuk e ka paguar humsin, patjetër ta paguajë. Ai që ka marrë ryshfet, patjetër t’ia kthejë pronarit. Secili njeri që nëpërmjet haramit ka fituar pasuri, patjetër e ka ta kthejë atë. Nëse dikush i ka bërë keq dikujt, patjetër ta kënaqë atë. Nuk mundet vetëm të shprehet kështu: “U pendova!” Aliu a.s. ka thënë: “Kusht i pendimit është ta pranosh dhe t’u kthesh të drejtën njerëzve. Për shembull, nëse ke marrë pasurinë e popullit dhe tani nuk posedon gjë për ta kthye atë, ose gjendesh në ato rrethana që nuk mund ta gjesh njeriun, sepse, për shembull, ka vdekur, pendohu këtu, dhe kërko falje nga ai. Inshaall-llah, All-llahu do ta bëjë të kënaqur atë”.

Kushti dytë i pranimit të pendimit është që t’i aplikosh ligjet e All-llahut. Ç’do të thotë kjo? Për shembull, agjërimi i takon All-llahut. Ato ditë që nuk i ke agjëruar, patjetër duhet t’i plotësosh. Namazet që nuk i ke falur, duhet t’i plotësosh me falje. Nëse ke qenë i pasur dhe nuk ke shkuar në haxh, duhet të shkosh në haxh. Këto gjëra nuk janë për t’u tallur. Lidhur me haxhin shkruan se nëse dikush bëhet i pasur dhe nuk ka ndonjë pengesë fetare, don të thotë ka mundësi normale, nuk ka pengesa as në aspekt të udhëtimit, posedon pasuri, është i shëndosh e jo i sëmurë, ka aftësi për të shkuar atje, dhe prapë nuk shkon në haxh gjer në vdekje, personi i

këtyllë nuk ka mundësi të shkojë në botën tjetër si musliman. Kur do t'i vijë (pak para vdekjes), do t'i thonë:

“Ti që nuk e ke kryer këtë obligim islam, tani mund të zgjedhësh, dëshiron të vdesësh si hebre ose si krishter, ti më nuk mund të vdesësh si musliman”.

Pastaj hazreti Aliu a.s. paraqiti dy tema që janë kusht i pranimit të plotë të pendimit. Ai theksoi: “Pendim është t'i kundërvihesh trupit tënd që është zhvilluar si pasojë e deprimeve joligjore (haram) e ta shkriësh atë duke rënkuar e dënesur gjersa lëkura nuk i ngjitet për ashti e që pastaj t'i zhvillohet mish i ri”. Çdo të thotë kjo? Këtë dhjam që e ke vënë në trup gjatë gostitjeve të mbrëmjeve, këtë trup që e ke trashur me haram ( ashtin, mishin e gjakun i ke nga harami), patjetër të mundohesh t'i shkriësh. Në vend të atij mishi haram të vesh mish hallall. Duhet ta shkriësh veten.

Më ka treguar babai im që rahmetli haxhi Mirza Habib Razavi Horasani, poezinë e të cilit shpesh e dëgjoni dhe i cili ka qenë njëri nga muxhtehidët e mëdhenj të Horasanit, madje edhe filozof, hakim dhe arif. Ka qenë njëri shumë i trashë dhe trupmadh. Kah fundi i jetës së tij është shoqëruar me një njeri që ishte dashamir i së vërtetës dhe gnostik. Haxhi Mirza Habibi, me atë pozitë shkencore e sociale që kishte, si muxhtehid i klasit të parë të Horasanit, shkoi te ky njeri i devotshëm dhe u ul në gjunj para tij. Ai tregon se pas një kohe të konsiderueshme e pa Haxhi Mirza Habibin se si ishte dobësuar nga shëndeti. Këto janë fjalët evidente të Aliut a.s. që ky mish i cili është shtuar në situatë pakujdesie, të shkrihet. (Natyrisht, këtu nuk dëshiroj të mos e respektoj atë, e të them: përmes haramit)

Këtu do t'ua përmendi edhe kushtin e gjashtë. Aliu a.s. ka thënë: “Të bësh që trupi ta shijojë dhembjen e dëgjueshmërisë ashtu siç e ka shijuar kënaqësinë e padëgjueshmërisë”.

Njeriu nuk mund të bëhet rob i All-llahut nëse është përkëdhelur sepse njeriu i përkëdhelur nuk është njeri. Agjërosh. Ashtu duhet! Në të vërtetë vetëm pse është punë e rëndë, duhet të agjërosh. Që nga mëngjesi duhet të zgjohesh dhe të lutesh-falesh, por të vjen rëndë. Bëre këtë vetëm për shkak të asaj që është rëndë. Mundohu një kohë të caktuar, jeto në vështirësi, dënoje veten”.

Kur’ani ka dy komente që kanë të bëjnë me kohën pas pendimit. Njëri e krahason pendimin me pastërtinë. Për shembull, thotë: **“All-llahu me të vërtetë i do ata që pendohen dhe i do ata që pastrohen”**. (2:222).

Ç’ dëshiron të thotë me këtë Kur’ani? Ai do të thotë: Pendohu dhe pastrohu me ujin e pendimit në mënyrë që të keshë sy që shohin. Pastrimi nuk i takon vetëm trupit. Ne mirë e kemi kuptuar pastrimin e trupit. Natyrisht se kjo nuk është mungesë por është përsosmëri dhe këtë duhet ta kuptojmë. Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka qenë njeriu më i pastër në përgjithësi. Ne për çdo ditë lahem, ndërrojmë këmbishat, rregullojmë teshat të mos kenë asnjë njollë. Pse? Sepse duam të jemi të pastërt. Po ti a vetëm trupin e ke? Pastroje veten, pastroje shpirtin edhe zemrën tënde. Ky shpirt e ky trup pastrohen me “ujin” e pendimit.

Komenti tjetër i Kur’anit është ai që në rastet e tjera e lidh pendimin me fjalën “përmirësim”.

**“E kush pendohet, pas veprës së vet të keqe dhe përmirësohet, All-llahu me siguri e falë, All-llahu njëmend falë dhe është Mëshirëplotë”**. (5:39)

Thash se njëra nga karakteristikat e njeriut është se ndonjë herë një gjysëm e natyrës së njeriut rebelohet dhe ngritet kundër gjysmës tjetër të natyrës së tij, dhe thash se ky rebelim e revolucion, disaherë vjen nga ana e disa fuqive të ulëta të qenies njerëzore. Rebelohen ambicjet, rebelohet

hidhërimi, rebelohet shejtani... Ndërkaq disa herë rebelimi vjen nga aspektet e larta të shpirtit njerëzor duke u rebeluar brendia, vetëdija, zemra e thellësia e shpirtit.

Në qoftë se rebelimi vjen nga ana e fuqive të ndyta të brendisë së njeriut dhe nga ana e elementeve shtazarake, pasojë e këtij rebelimi dhe e këtij revolucion i do të jetë parregullsia. Më herët kam dhënë një shembull. Njerëzit të cilët në emër të pastërtisë, të asketizmit dhe të devotshmërisë janë të privuar nga dëshirat-ambicjet, pa një-pa dy rebelohen dhe i kaplon një parregullsi e çuditshme. Ajo, përpos eksplodimit dhe parregullsisë nuk është asgjë tjetër. Por kjo është krejt ndryshe nga rebelimi dhe revolucion i që vjen nga elementet hyjnore të natyrës së njeriut. Revolucion i që në natyrën e njeriut e kryen mendja është rebelimi që te njeriu të aplikohet esenca e teizmit-besimit e ky është një revolucion hyjnor. Ky është një revolucion hyjnor i gërshtuar me përmisim. Revolucion i hyjnor mënjanon pasojat e kobshme të së kaluarës. Revolucion i hyjnor ndëshkon.

*“Në hakmarrje keni jetë, o të mençur, ndoshta do të ruheni!” (2:179)*

Theksova se Aliu a.s. ka thënë: “Hakmerru ndaj trupit tënd, dënoje atë, shkrije dhjamin që është shtuar me haram!” Kjo është një hakmarrje dhe dënim për pasionet e shpirtit. Kur revolucion i është hyjnor, vepron t’i zhdukë pasojat e kobshme të së kaluarës dhe do t’i zhduk. Në Kur’an thuhet:

“Ai që pendohet edhe përmirësohet...”

Në parim taubeja-pendimi është një nxitje përmirësuese e asgjë tjetër.

Thash se pendimi është një karakteristikë e njeriut, njëherit thash se ndryshimi i kursit dhe i drejtimit nuk janë veçori vetëm të njeriut, ato ekzistojnë edhe të kafshët edhe, përafërsisht, te bimët, por ndryshimi i drejtimit që quhet tau-

be e që don të thotë një lloj revolucion i brendshëm hyjnor, i takon kryekëput njeriut. Këtë patjetër duhet ta kemi parasysh.

Njëra nga veçoritë dhe dallimet e të Dërguarit a.s. në krahasim me udhëheqësit tjerë qëndron në atë se ata bëjnë revolucion në shoqëri dhe korrin sukses ta nxisin më tepër një grup, një shtresë, apo një shtresë kundër shtresave tjera, të krijojnë dy fronte në shoqëri dhe të nxisin njërën palë kundë tjetrës. Si të thuash, njërës palë i japin shkopinj dhe armë dhe i detyrojnë t'u bien të tjerëve në kokë. Natyrisht ky është një veprim i mirë. Pse? Dikund, ku kryjohet një shtresë tiranësh (zullumqarësh) dhe një shtresë e të shkelurve, thirrja e të shkelurit-të nëpërkëmburit për realizimin e të drejtave të tij është një akt njerëzor që ekziston në Islam. Pejgamberët, gjithashtu, janë marrë me këtë, dhe në programin e Islamit ekziston një nxitje dhe forcim i posaçëm i të shtypurve kundër shtypësve. Në mesin e këhillave të Aliut a.s. drejtuar fëmijëve të tij të ndershëm, Hasanit a.s. dhe Huseinit a.s., thuhet edhe kjo: "Bëhuni gjithnjë armiq të zullumqarit, e miq të të shkelurit dhe hakmarrës kundër zullumqarit".

Por, ekzistojnë mundësi tjera që udhëheqësit tjerë të revolucioneve botërore mos jenë të aftë për to. Për këtë kanë qenë të aftë vetëm pejgamberët. Për veç atyre, askush tjetër nuk ka aftësi ta nxisë njeriun kundër vetvetes, do të thotë të bëjë diçka që njeriu vetë ta vërejë gabimin dhe që pastaj të bëjë kundër vetes një revolucion hyjnor që quhet pendim.

Përveç Pejgamberit nuk mund të gjeni askënd që do të kishte mundësi t'i nxisë njerëzit kundër veprave të tyre të këqija. Pejgamberët e All-llahut jo vetëm që e kanë nxitë të shkelurin kundër zullumqarit, por kanë mundur që edhe zullumqarin ta nxisin kundër vetvetes. Nëse e lexoni historinë islame, do të shihni se në Islam edhe i nëpërkëmburi edhe i varfëri edhe i persekutuari edhe i ashtuquajtimi i nënçmuar,

nxisin kundër zullumqarit, sikur që ishte Ebu Xhehli dhe se personat që ishin të interesuar për ata, kanë nxitur kundër vetvetes dhe se kanë qenë të reshtuar në të njëjtën vijë me të këqinjët. Këtë kanë mundësi ta bëjnë vetëm pejgamberët e All-llahut. Nxitjen e njeriut kundër veprave të tij të liga nuk mund ta bëjë askush përpos pejgamberëve.

Imam Musa ibën Xhaferi a.s. kaloi pranë tregut të Bagdadit. Ne e dijmë se në ç'gjendje ishte imami. Nuk e pëlqente zhurmën që e bënin muzikantët. Dëgjoji një zë të lartë muzike që vinte nga një shtëpi. Kur kaloi imami pranë asaj shtëpie, amvisja e asaj shtëpie doli t'i hedhë mbeturinat. Imami e pyeti: "Pronari i kësaj shtëpie është rob apo i lirë?" Amvisja u habit nga kjo pyetje dhe tha: "Dihet që është i lirë. Pronari i kësaj shtëpie është Bushri që është njëri nga personalitetet dhe funksionarët e këtij qyteti. Çfarë është kjo pyetje që po parashtroni?" Mbase ata mes vete kanë ndërruar edhe pyetje dhe përgjigje tjera, por në histori dhe në tregime nuk ceken ato, përpos që biseda mes tyre ka zgjatur aq sa amvisja u vonua pak për në shtëpi. Kur e pyetën se pse ishte vonuar, u përgjigj se si një zotëri, dhe i përshkroi tiparet dhe bisedën që zhvilloi me ë, dhe se si në fund ai i ka thënë se normalisht nuk është rob, por i lirë, sepse sikur të kishte qenë rob nuk do të bënte kaq shumë zhurmë, nuk do të ishte krejt kjo muzikë dhe ky lloj dehje e çoroditje. Si dëgjoji se për cilin njeri bëhej fjalë, Bushri e kuptoi se ai ishte Musa ibën Xhaferi a.s. (Tani, ky detyrim për pendim dhe për nxitje të revolucionit të brendshëm është në duart e pejgamberëve të All-llahut ose të rrobërve të Tij të afërt, askush tjetër përveç tyre nuk e ka këtë mundësi). Bushri nuk pati mundësi as këpucët t'i veshë dhe ashtu këmbëzbathur shpejtoi kah dera. Pyeti se në cilën anë shkoi imami. Tha: "Po shkojë pas tij". Shpejtoi drejt imamit, u hodh para këmbëve të tij dhe tha

“Zotëri, ju tamam keni thënë, unë jam rrob por nuk e kam vërejtur se jam rrob. O zotëri, prej këtij momenti dua të bëhem rob i vërtet, erdha që të pendohem”. Aty bëri taube, u pendua dhe i shkatërroi krejt ato instrumente dhe elemente dhe prej asaj ngjarje më nuk veshi këpucë, por rrugëve të Bagdadid ecte këmbëzbathur. E thirrnin: “Bushër Hafi” që do të thotë Bushri këmbëzbathur. E pyetëm pse ecë këmbëzbathur, e ai u përgjigj: “Sepse kur u pendova te imami isha këmbëzbathur e s'ma don shpirti më që të mbathi këpucë, dua që kujtimin në atë që më ndodhi mua ta ruaj për gjithnjë”.

Fisi Beni Kurejdha e tradhëtoi Islamit dhe muslimanët. Pejgamberi i ndershëm a.s. vendosi t'i çfarrosë. Ata thanë: “Na e dërgo Ibën Lebabin te ne, atë e kemi aleat, duam të konsultohemi me atë”. Por ai, meqë kishte marrëdhënie të veçanta me hebrejt, gjatë konsultimit s'i respektoi interesat e muslimanëve. Kur doli jashtë, e vërejtë se ka tradhëtuar. Atëherë askush nuk dinte gjë për atë. Kur u nis drejt Medinës, kjo flakë gjithnjë e më tepër ia kaplonte zemrën. Arriti në shtëpi, por nuk shkoi ta shohë bashkëshorten dhe fëmijët, mori një litar dhe shkoi te xhamia e Pejgamberit s.a.v.s. dhe u lidh fortë për një shtyllë. Vetëm bija e tij, para namazit ose pasi që njerëzit dilnin nga xhamia, vinte dhe ia zgjidhte litarin. Pak hante, ndërkaq gjithë kohën kërkonte falje: “O Zot, më falë se kam gabuar! O Zot, kam tadhëtuar Islamit! O Zot, kam tradhëtuar Pejgamberin Tënd! O Zot, nuk do të zgjidhem nga kjo shtyllë gjer në vdekje, gjer sa ta pranosh pendimin tim!” Shkuan disa te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i thanë: “O i dërguar i All-llahut, Ebu Lebabë ka vepruar kështu”. Pejgamberi tha: “Të kishte ardhur te unë dhe ta shpallonte problemin, unë do të kërkosha falje për të nga All-llahu, por ai ka shkuar drejtëpërdrejtë te All-llahu dhe All-

llahu Vetë do ta marrë parasysh”. Nuk e di sa zgjati kjo, dy netë apo më tepër.

Pejgamberi i nderuar ishte te Ummi Seleme, kur iu shpall se atij njeriu i është pranuar pendimi. Ai i tregoi Ummi Selemes se i është pranuar pendimi Ebu Lebabit. Ummi Seleme e pyeti: “O i Dërguar i All-llahut, a më jepni leje t’i tregoj për këtë sihariq-lajm të mirë?” Pejgamberi u përgjigj: “Pse jo”. Dhomat e shtëpisë së Pejgamberit s.a.v.s. kishin nga një dritare përballë xhamisë ndërsa xhamia ishte e ndërtuar përreth shtëpisë së Muhammedit s.a.v.s. Ummi Seleme zgjati kokën në dritare dhe tha: “O Ebu Lebabe po të tregoj një lajm të gëzueshëm se All-llahu ta ka pranuar pendimin”. Ky lajm që All-llahu e pranoi pendimin e Ebu Lebabit jehoi në Medine sikur topi. Shpejtuan muslimanët ta zgjidhin atë, e ai u tha: “Jo, askush nuk guxon ta bëjë këtë. Dua që këtë ta bëjë Pejgamberi i nderuar me duart e veta të bekuara”. I thanë: “O Pejgamber i All-llahut, Ebu Lebabe lutet që ju të shkoni ta zgjidhni atë me duart tua të bekuara” Ai tha: “O Ebu Lebabe pendimi yt është i pranuar. Je pastruar si fëmija i posalindur. Në shpirtin tënd nuk ka më asnjë njollë”. Ata që kanë shkuar në Medine e dinë që në njërin nga shtyllat e xhamisë së Pejgamberit shkruan: “Shtylla e pendimit” ose “Shtylla e Ebu Lebabes”. Kjo shtyllë, natyrisht, përpara ishte prej druri, po vendi i saj s’ka ndryshuar. Kjo është e njëjta shtyllë nga e cila Pejgamberi s.a.v.s e zgjidhi me duart e veta Ebu Lebaben. Pastaj Ebu Lebabe tha: “O i Dërguari i All-llahut, dua që në shenjë falënderimi tërë pasurinë time ta jap sadakë në rrugë të All-llahut”. Pejgamberi tha: “Mos vepro ashtu”. Ai ia ktheu: “O i Dërguari i All-llahut, më lejoni që dy të tretat e pasurisë sime t’i jap në shenjë falënderimi, në rrugë të All-llahut”. Ai tha: “Jo!” Ebu Lebabe shtoi: “Më lejoni të jap një të tretën e pasurisë si sadakë në rrugë të All-llahut. “Pejgam-



beri s.a.v.s. ia ktheu”. “Si jo”. Ky është Islami, llogaritë e të cilit janë të pastërta. Përse dëshiron që gjithë pasurinë tënde ta japish si sadakë, pse dëshiron që gjysmën e pasurisë tënde ta shpenzosh në rrugë të All-llahut? Ç’do të ndodh me bashkëshorten tënde dhe fëmijët e tu? Diçka nga pasuria yte, një të tretën jepe në rrugë të All-llahut, tjetrën ndale për vete”.<sup>30</sup>

Dikush vdiq e Pejgamberi s.a.v.s. për të fali namaz, pastaj pyeti: “A ka patur fëmijë dhe e ka bërë diçka për ata?” I treguan: “O Pejgamber i All-llahut, ka patur pak pasuri, por gjithë atë, para vdekjes, e ka lënë në rrugë të All-llahut”. Pejgamberi s.a.v.s. ua ktheu: “Sikur të më kishit treguar më parë, s’do të falja namaz për një njeri si ky. Ka lënë pas vete fëmijë të uritur”. Thuhet nëse dëshiron të lëshë testament që pasurinë tënde, pas teje, ta shpenzojnë në rrugë të All-llahut, bëre atë me një të tretën e pasurisë. Më tepër se një e treta nuk ka efekt. Bile në një fetva (përgjigje islame) të disa ulemave qëndron që nëse njeriu i sëmurë, gjatë sëmundjes e cila do t’i shkaktojë vdekjen, dëshiron të lejë më tepër se një të tretën e pasurisë së vet në rrugë të All-llahut, meqë atë e bën gjatë sëmundjes dhe para vdekjes, ndërkaq nuk ka lënë porosi dhe e ka lënë me duart e veta, kjo nuk i lejohet. Pse? Sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë një të tretën e pasurisë.

Natyrisht, pendimi ka gradë, ndërsa ne nuk guxojmë të humbim shpresën. Vëllëzër! Pikë së pari kërkoni falje për vetveten dhe mundohuni të pastroheni prej mëkateve të bëra. Pastrimi juaj qëndron në atëtë shprehni keqardhje dhe të njëjtin gabim të mos e përsëritni, të vendosni njerëzve t’ua ktheni hakun, t’ia ktheni hakun All-llahut. All-llahun e kam dëshmitar: nëse e pastroni vetveten, do të shihni se si do t’u pranohen të gjitha lutjet-duatë tuaja.

---

<sup>30</sup> Sefinetul Bahr, vëllimi 2, f. 503.

## SHPIRTMADHËSIA DHE FISNIKËRIA

*“Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar! Hyn në mesin e robërve të Mi! Dhe hyn në Xhennetin Tim!”* (89: 28-30).

Nëse dikush arrin të ketë shpirt të madh, don apo nuk don, trupi i tij do të jetë në vuajtje e mundime. Vetëm ai trup që posedon shpirt të vogël, kënaqet duke jetuar në komoditet, madje edhe mund të jetojë gjatë, kënaqet duke fjetur e duke ngrënë ushqime të këndshme, po ai që ka shpirtmadhësi, ai shpirt i tij i madh i shkakton trupit vuajtje, madje, ndonjëherë edhe jetë të shkurtër. Ai trupit i shkakton sëmundje.

Do të flasim diçka për madhësinë dhe fisnikërinë e shpirtit dhe do të shpjegojmë dallimin mes këtyre dy gjërave, sepse madhështia e shpirtit është diç tjetër, ndërsa fisnikëria e shpirtit është gjëja tjetër më e përsosur. Pra, secila madhësi shpirti nuk është fisnikëri.

Çdo fisnikëri është shpirtmadhësi, e çdo shpirtmadhësi nuk është fisnikëri.

Tani, të kalojmë në temë.

Me siguri, ambicjet e mëdhaja janë shenjë e shpirtit të madh, ndërsa ambicjet e vogla janë shenjë e shpirtit të vogël.

“Kij ambicje të mëdha, sikur njerëzit e mëdhenj për shkak të ambicjeve të mëdha kanë arritur gjer diku!”

Një poet tjetër, thotë:

“Bilbili në kopsht e laraska në gërmadha, secili sipas sasisë së ambicjeve të veta, shtëpi ka ndërtuar”.

Kjo mund të aplikohet në cilindo profesion të njeriut. Për shembull, ambicjet në shkencë dallojnë. Dikush është i kënaqur me diplomën e shkollës së mesme dhe të ketë një

profesion gjer në atë nivel sa që të dijë të shkruajë e të lexojë, e personi tjetër e shihni, me plot arsye, se nuk është i kënaqur me asnjë nivel shkencor, ai ka ambicje që gjer në momentin e fundit të jetës së tij të mos lëshojë mundësinë për të arritur njohuri shkencore dhe zbulime të të vërtetave shkencore.

Me siguri keni dëgjuar për tregimin e Ebu Rejhan Biruniut. Ky është një njeri për të cilin studiuesit pohojnë se ende nuk i është gjetur rivali atij. Ka qenë shkencëtar, matematikan, sociology, historian dhe njeri i dalluar, ndërsa dikush e konsideron si më të mirë se Ibën Sinai. Natyrisht, nëse i marrim parasysh disa segmente dhe lëmenj, me siguri se Ebu Rejhani ka qenë më i mirë se Ibën Sinai. Këta të dy kanë qenë bashkohanikë. Ai ka qenë i fascinuar me shkencën, me kërkimet dhe zbulimet e reja. Një herë e thirri mbreti Muhammed dhe ky iu përgjigj thirrjes së tij dhe shkoi te ai, por si çdo njeri ambicioz, e shfrytëzoi rastin. Kur mbreti Muhammed e pushtoi Indinë, edhe ky shkoi me të në Indi. E kuptoi se e ka zbuluar një pasuri informacionesh shkencore, por s'e njihte sanskritishten. Këtë gjuhë shumë mirë e mësoi në pleqëri. Atje disa vite me radhë u muar me hulumtime. Shkroi një vepër të titulluar: "Hulumtimet në Indi..." Sot ky libër konsiderohet si një prej burimeve kryesore për indologët e botës.

Kur ky njeri ishte në prag të vdekjes, një fekih (jurist islam) që ishte fqinj i tij, mori vesh se Ebu Rejhani ishte në atë gjendje. Shkoi ta vizitojë. Ai ende nuk e kishte humbur vetëdijen. Me të parë fekihun, i parashtrroi pyetje në lidhje me ngrirjen (nga të ftohtit - sh.p.) ose për diçka tjetër.<sup>31</sup> Fekihu u

---

<sup>31</sup> Veprat e Ebu Rejhanit tregojnë, po duke u bazuar në biografinë e tij që kanë shkruar studiuesit, se ka qenë një besimtar shumë i fortë, musliman me besim të fortë. Në librat e tij të cilat, nuk kanë të bëjnë me shkencat fetare, siç është "El asrul-baki" dhe të ngjashëm, sikur edhe

habit dhe protestoi: “Po a ti po përgatitesh për të vdekur, ke gjetur kohë të më parashtrosh këso pyetjesh!?” Ebu Rejhani u përgjigj: “Ty po të parashtroj një pyetje. Nëse unë vdes, (nuk e di se a do të vdes tash shpejt) a është më mirë të dije apo të vdes duke mos dijtur?” Fekihu u përgjigj: “Paj, natyrisht, se më mirë është të dijsh”. Ai ia ktheu: “Mu për atë shkak të pyes”. Fekihu tregoi se posa doli nga shtëpia e tij, nuk shkoi shumë kohë, dëgjoi një piskamë dhe vaj. Vdiq Ebu Rejhani dhe u dëgjuan të qarat e fëmijëve të tij. Thanë për këtë se ka qenë një njeri i madh me ambicje të mëdha për shkencë.

Tjetri, për shembull, është i madh që vepron për fitimin e pasurisë. Po a thua vallë, ambicjet janë të njejta edhe në aspekt të grumbullimit të pasurisë? Disa njerëz, natyrisht, nuk kanë asnjë ambicje për grumbullim të pasurisë dhe qëllimi i tyre është të jenë të ngopur, të kenë ndonjë kore buke, po edhe sikur atë ta arrinte përmes shërbimit, nënshtrimit ose lypjes. Por, dikush dëshiron të ketë, don të tubojë para. Tani, a janë të barabartë ata që dëshirojnë të tubojnë pasuri me të tjerët? Apsolutisht jo.

Te disa njerëz, nga vetë natyra, ekziston dëshira për grumbullim të pasurisë dhe nuk kënaqen me pak. Po e them këtë. Ndonjëherë disa njerëz që s'kanë ambicje, nga shkak se nuk janë njerëzore, kur e shohin dikend se si grumbullon pasuri, e nënçmojnë dhe e përqeshin, sikur vetë ata na qenkan të devotshëm. Duan të jenë të pastër. Jo, zotëri! Ai që mundohet të tubojë pasuri me një vullnet të tillë, është më i mrë se ti që ke ambicje të dobëta dhe karakter lypësi, dhe është personalitet se ti. Ky, në krahasim me atë njeri që ka më shumë ambicje, meriton të qortohet. Një zahid-asket i vërtetë

---

Ibën Sinai, kudo që të përmendej Islami, Kur'ani dhe Sheriati, ai jep ashtu mendim të devotshëm, me përujë dhe me besim, sa që njeriu nuk mund të dyshojë në qëllimet e tij të pastërta.

mund ta qortoje atëherë kur të bëhet njeri ambicioz, sikur Aliu a.s. që është njeri punëtor dhe që mundohet për pasuri, por nuk është lakmues, nuk e ruan për vete, nuk është i lidhur ngushtë për ato para. Fiton , por përse? Për shpenzim dhe për të ndihmuar të tjerët. Ai ka të drejtë të qortoje dhe të thotë: “I mjeri ti, o lakmues, që ke ambicje , vendosmëri, ti që ke entuziazëm dhe fuqi, pse harxhon fuqinë tënde për grumbullim të pasurisë? Pse pasuria të është bërë qëllim? Për ty pasuria duhet të jetë mjet”.

Por unë që nuk kam ambicje, ndërkaq pasurinë e marr duke lypur nga të tjerët të cilëve ua puthi duart e këmbët që të më japin një të mijetën apo një të miliontën pjesë të pasurisë së vet, nuk kam të drejtë ta kritikoj.

Tjetri person ec rrugës së ambicjeve, madhësisë dhe pozitës. Po a janë gjithë njerëzit në këtë drejtim të barabartë? Jo. Pa dyshim se Aleksandri i Madh ka qenë njeri ambicioz. Ka qenë një njeri që ka patur ndër mend ta sundojë botën. Aleksandri është më i mirë se dikush që ka karakteristika të shërbëtorit, në të cilin, në të vërtetë, nuk ekziston ndjenja për zotërim apo për diçka më mirë. Dhe ai që në vete nuk ka asnjë ambicje. Mbreti Nadiri, e të tjerë sikur ky, të gjithë kanë qenë të njëjtë. Këta njerëz kanë patur shpirt të madh, por nuk mund të thuhet për ta se kanë patur shpirt fisnik. Aleksandri i Madh ka qenë tejet ambicioz, ka patur shpirt të madh, por ai shpirti i madh ç’ka bërë të zhvillohet në të? Cila është ajo lëmi që është zhvilluar në këtë shpirt? Kur ta analizojmë natyrën e tij, do të shohim se ky shpirt është rritur, ajo lëmi që është zhvilluar në shpirtin e tij është ambicja, fama dhe autoriteti. Ai dëshiroi të bëhet njëra nga fuqitë më të mëdha të botës, dëshironte të bëhej njëri ndër pushtuesit më të famshëm të botës, dëshiroi të bëhet njëri më dominues në botë. Trupi në të cilin gjendet ky shpirt që është i

madh, por në aspekt të ambicjeve, nuk do të jetë i qetë. Po trupi i Aleksandrit, mos vallë, ka gjetur rahat në këtë botë!? Po a ishte e mundur që Aleksandri të bëhej Aleksandër e të jetonte në rahat. Po a do të mundej Nadiri, ai zullumqar i cili me kokat e njerëzve që ua kishte nxjerrë sytë ndërtoi minare, ai i njëjti Nadir që ishte ambicioz i çmendur, të mbetej Nadir e që trupi i tij të mos vuajë? Disa herë ka ngjarë që me dhjetra ditë të mos i z bathë këpucët, sepse aspak nuk kishte kohë. Tregohet se Nadiri një natë kaloi pranë një karvan-saraji. Bënte mot shumë i ftohtë. Kujdestari i karvan-sarajit ka treguar se ka qenë mesnatë dhe se përnjëherë ka dëgjuar një trokitje të fuqishme në derë: "Me të hapur të derës pashë se si një njeri i madh e i fuqishëm i hipur mbi një kalë të fortë hyri brenda. Menjëherë pyeti: 'Ç'ke për të ngrënë?' Përveç vezëve nuk kisha asgjë tjetër. Më tha që të përgatis më shumë vezë. I përgatita për të vezët. Më tha: 'Më sill bukë, ndërsa për kalin tim elb!' Ia ofrova të gjitha. Pastaj e kashaisi kalin. Qëndroi dy orë dhe e mori pak kotja. Kur deshti të niset e futi dorën në xhep dhe nxori një grusht eshrafë (monedhë e vjetër ari iraniane). Më tha ta kapi fustanin tim. E kapa fustanin, ndërsa ai m'i lëshoi ato (paratë) në prehër, më pastaj tha: 'Nuk do të zgjasë shumë kohë, pas meje do të vijë një ushtri. Kur të vijnë, thuaju se Nadiri ka shkuar atje dhe që menjëherë të vijnë pas meje atje'. Kujdestari tha: 'Si e dëgjova emrin Nadir, duart filluan të më dridhen dhe fustani më ra prej dore'. M'u drejtua: 'Hip lartë në kulm! Sa t'i shohish, thuaju që mos të vonohen dhe të vijnë pas meje (u nis në mesnatë, dy orë para se të arrinte ushtria)!' Arriti ushtria mbretërore këtu. Unë nga kulmi bërtita se Nadiri ka dhënë urdhër që ushtria patjetër të shkojë në atë vend. Murmuritën disa, por asnjëri nuk mori guxim të mos shkojë atje. Shkuan të gjithë.

Nëse njeriu dëshiron të bëhet Nadir, nuk mund të flejë në krevat me pupla mjellme, nuk mund të hajë ushqimin më të mirë. Nëse dëshiron të bëhet ambicioz, të luftojë për pozitë, bile nëse bëhet një zullumqar i madh, trupi i tij nuk mund të ketë rahat. Personi i tillë në fund edhe përfundon tragjikisht dhe se çdo person që kërkon në cilën do lëmi të ketë ambicje të mëdha dhe shpirt të madh, trupi i tij nuk do të ketë rehati. Por, asnjë person që i përmenda nuk ka patur shpirt fisnik. Shpirti i tyre ka qenë i madh, por nuk kanë qenë zemërgjerë.

Ç'është dallimi mes madhësisë dhe zemërgjerësisë? Të supozojmë që një person është dijetar i madh dhe që nuk ka virtyte tjera përveç madhësisë së shkencëtarit, do të thotë të jetë një person i cili dëshiron të zbulojë vetëm diçka të re, të hulumtojë. Ky është një intelekt-tru i madh, don të thotë një dëshirë e madhe dhe një ambicje për shkencë. Tjetri njeri është një grandioz i cili gjithnjë vrapon pas pasurisë dhe pasurisë e ka qëllim, është dashamir dhe lakmues i madh i saj. I dyti është rival i madh, i treti është hakmarrës i madh, i katërti është njeri shumë xheloz, i pesti ka ambicje të mëdha. Të gjithë këta janë egoistë të mëdhenj për asnjërin prej tyre nuk mund të thuhet se është zemërgjerë. Madhësi po, por zemërmadhësi e fisnikëri jo.

Ekziston një pyetje që meriton t'i kushtohet kujdes në aspektin filozofik dhe psikik e ajo është që njeriu në vetëdijen dhe shpirtin e tij, sipas komentit kur'anor, në natyrën e tij, përveç këtyre madhësive që ndërtohen mbi egoizmin, ka një ndjenjë tjetër të madhe në natyrën e tij që dallon nga këto lloje që i përmendëm. Kjo quhet humanitet i madh. Ndërkaq unë ende nuk mund ta kuptoj se si këta zotërinj materialisht mund ta shpjegojnë këtë, cila është ajo ndjenjë te njeriu, bile te disa njerëz, që ndonjëherë ndejnë mburrje në shpirtin e

vet, don të thotë ndjejnë madhësinë si mburrje? (Natyrisht se këto ndjenja ekzistojnë te një numër i madh njerëzish, por te disa prej tyre kjo dritë është e zbehur, ndërkaq te të tjerët shndëritë). Ky është një njeri madh e jo një egoist. Është larg egoistëve. Për shkak të ndjenjës për mburrje dhe për shkak të zemërmadhësisë, e shkel egoizmin e vet. Si? Ky njeri dëshiron të bëhet i madh, por nuk vrapon të bëhet më i madh se ky apo ai njeri.

Dikush ka pasuri më shumë se unë, unë patjetër të kem më shumë se ai. Filani e fallani vetëm le të më bëhen të dëgjueshëm, që unë të urdhëroj e ata të veprojnë dhe të më nënshtrohen. Patjetër që unë të bëhem urdhërdhënës, ndërsa ata të dëgjueshëm. Në ballafaqim me veprat e liga, ndjen një madhësi në shpirtin e vet. Në të vërtetë, shpirti i një njeriu nuk lejon të rrejë, ai rrenën përgjithësisht e konsideron si vepër të ligë, e në shpirt ndjen epërsi. Ajo është zemërgjerësi, e kundërta e zemërngushtësisë dhe mangësisë. Kjo është madhësi që ne e quajmë zemërgjerësi e kundërta e ultësisë dhe shpirtligësisë. Njëri në shpirtin e vet ndjen zemërgjerësi, don të thotë ndjen mburrje andaj i largohet ultësisë. Ky njeri ambicioz aq shumë i jep rëndësi pozitës sa që thotë: “Jeta është vetëm një, andaj më mirë njeriu të jetojë sikur luan e jo sikur dash”. Pra, të shqyejë e jo të shqyhet. Musolini, diktari i njohur italian, i ka thënë njërit prej miqve të tij: “Më tepër do të kisha dashur të jetoj një vit si luan, se sa njëqind vjet si dash. Të jem luan një vit e t’i ha të tjerët, është më mirë se të jem njëqind vjet dash e të bëhem ushqim për gojën e luanit”. E tha këtë dhe gjithnjë miqve të vet u jepte para që këtë fjali mos t’ia tregojnë askujt gjersa të jetë gjallë. Pse? Për shkak se unë mund të bëhem luan me kusht që njerëzit të bëhen dhen, por nëse njerëzit e kuptojnë këtë fjali edhe ata do të kishin dëshirë të bëhen sikur Musolini, të bëhen luaj. Ata patjetër



duhet të bëhen dhen që unë të bëhëm luan. Këtu qëndron një madhësi por nuk ka zemërgjerësi. Por, ç'është zemërgjerësia? Njeriu zemërgjerë do të kishte patur dëshirë që të gjithë njerëzit të bëhen luaj, që don të thotë mos të bëhen dhen që do të mund t'i hanë të tjerët. Absolutisht, dëshirojnë që në botë të mos ekzistojë grykësi. Kjo don të thotë ndjenjë zemërmadhësie dhe humaniteti. Sipas Kur'anit, ndjenja e madhësisë dhe famës është ndjenjë e shpirtmadhësisë së shpirtit. Në literaturën islame, fjala *keramet* që do të thotë fisnikëri shumë është përdorur. Ka një thënie të Pejgamberit:

Shpesh kam thënë se gabim e përkthejnë kur thonë: “Jam dërguar ta përsosi moralin”. Ky s'është përkthim i mirë, sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë më tepër se kaq. Sikur ai të kishte thënë: “Jam zgjedhur pejgamber t'ua përsos moralin e mirë”, kjo nuk do të ishte asgjë e re. Çdo njeri që ka sjellë ndonjë lloj etike, konsideron se ajo që ai thotë, është etikë e mirë. Ai tjetri, sikur Niçe, thotë: “Njeriu patjetër duhet të shpresoj në fuqinë, asnjë mëkat s'është më i vogël se dobësia. Mos të keni mëshirë ndaj të dobtëve dhe mos ua jepni dorën”. Mendon se është etikë e mirë ajo që ai e predikon. Pejgamberi s.a.v.s. jo vetëm që ka folur për moralin e mirë, por edhe mirë e ka shpjeguar në këtë mësim: “Nuk them vetëm mirësi. Të gjithë thonë mirësi e kjo nuk është gjë e re. Jam bërë Pejgamber që t'ua përsos moralin në të cilin ka shpirt fisnikërie, etikë të udhëheqjes, por jo në atë kuptim të udhëheqjes që të dominojë mbi të tjerët, por që shpirti im të jetë fisnik e që t'u ikë gjërave të ulëta, rrenës, përgojimit dhe të gjitha veprave të liga, që veten ta konsideroj më lartë e më të mirë se të gjitha këto gjëra..” Në këtë lëmi, falë Zotit xh.sh., ka mjaftë të dhëna nëpër literaturën islame.

Aliu a.s. i tha birit të vet, Imam Hasan Muxhtebiut a.s.: “Djali im! Ruaje shpirtin tënd pastër dhe ngrite atë përmbi të

gjitha gjërave të ndyta. Mendo rreth çdo gjëje të ndyrë se shpirti yt është përmbi ato, për mos ta ndytur atë me ato”.<sup>32</sup> Tamam si një njeri që ka një fotografi shumë të bukur, kur në të paraqitet ndonjë njollë e zezë, ose pluhur, vetvetiu e merr leckën dhe e pastron atë. Po ta pyesish atë se pse e bën këtë, do të përgjigjet: “Dëm është që një fotografi kaq e bukur të ketë këtë njollë”. E vëren se fotografia është aq bukur dhe e mirë sa që dëm është të mbetet njolla e zezë. Aliu a.s. thotë: “Ti në shpirtin tënd duhet të keshë ndjenjën për të bukurën, autoritetin dhe virtytin, ashtu që pa marrë parasysh të gjitha, konsideroje veten përmbi të gjitha në mënyrë që mos u dorëzohesh ndytësive”. Ndodh rrena. Rrena është e ndytë dhe e ligë. Ti je shpirtmadh, i lartësuar, i bukur. Konsidero veten më të mirë nga ajo që mund të ulish veten me anë të rrenave. Mos kërko asgjë prej njerëzve. Të lypish nga njerëzit është vepër e poshtër, e ndytë, ndërkaq ti je i ngritur, shpirtmadh, i bukur. Ti je njeri. Pozita njerëzore është më e lartë nga ajo që njeriu të lypë nga tjerët për nevojat e veta. Aliu a.s. ka thënë: “Bëhu i kënaqur me pak, mos shtrij dorë të lypish nga tjerët!”

Veçanërisht në këtë fushë ka shumë këshilla të Aliut a.s.. Ai ka një thënie të çuditshme në të cilën thotë: “Një njeri i ndershëm kurrë nuk bën shkelje të kurorës, pa marrë parasysh që shkelja e kurorës është e ndaluar-haram, sipas dispozitave të fesë dhe pa marrë parasysh se All-llahu a do ta dënojë apo jo atë që ka bërë shkelje të kurorës”. Njeriu i cili në vete ndjen mburrje dhe autoritet, asnjë herë nuk bën shkelje të kurorës. Në “Shtegu i elokuencës” qëndron një ep, e kur një musliman e dëgjon, patjetër në shpirtin e vet të ndjehet epik. Tregimi është i njohur, mbase e keni dëgjuar. Aliu a.s. në përleshjen e parë me ushtrinë e Muaviut, në betejën e Sifinit, në fillim s'dëshironte të luftojë, por së pari të

---

<sup>32</sup> Shtegu i elokuencës, letra 31.

ndërrojnë letra dhe delegatë, në mënyrë që ky problem të zgjidhej e që muslimanët mos të ngrenë shpatat kundër njëritjetrit. Kur erdhën Muaviu dhe përcjellësit e tij, menduan se kanë arritur dhe e zunë vendin për blokimin e ujit afër lumit Euftrat, në mënyrë që kur të arrijë ushtria e hazreti Aliut a.s. të mos ketë mundësi t'i afrohet ujit e të mbeten pa ujë dhe kështu në këtë mënyrë të pësonte disfatë. Kur erdhi Aliu a.s. dhe pa se ç'kishin vepruar, dërgoi një letër në të cilën shkroi: "Mos veproni ashtu! Ende nuk kemi ndërmend të bëjmë luftë, ne jemi të gatshëm të zhvillojmë bisedime, të dërgojmë delegatë e të takohemi. All-llahu dhashtë ndihmë që në mes muslimanëve të mos vijë gjer te lufta". Muaviu assesi nuk dëshironte të bëjë negociata. Ai tha: "Nuk do ta humbim këtë shansë". Hazreti Aliu disa herë e përsëriti këtë. Dhe sado që i foli Muaviut për të bërë lëshim dhe se ata nuk do të mund të durojnë pa ujë, andaj, nëse e harxhojnë ujin për një apo dy ditë, do të detyrohen t'i nxjerrin shpatat, ndërsa ky dëshiron të bëjë negociata. Muaviu u përgjigj se kjo assesi nuk do të ndodh. Aliu a.s. e pa se s'ka solucion tjetër përveç luftës. U mbajti një fjalim njerëzve të vet, ku tha: "Ata do t'u nxënë si pengj lufte. Andaj ose qëndroni të turpëruar e të nënçmuar ose përgjakni shpatat tuaja dhe shuanie etjen me ujë. Vdekje është të jetosh i nënçmuar, e jetë është të vdesësh fitimtar".

Aliu a.s. në këtë mënyrë i frymëzoi ithtarët e vet me shpirt krenarie dhe me shpirtmadhësi. Udhëheqësi i besimtarve çdo moral të dobët e konsideron nënçmim. Për shembull, për përgojimin, thotë: "Pëgojnë të paaftët, njerëzit pa ambicje, njerëzit e ngratë". Një njeri i guximshëm, njeriu që ndjen krenari dhe shpirtmadhësi në shpirtin e vet, nëse ka për ta kritikuar dikënd, patjetër t'ia thotë në fytyrë, ose, më së paku të hesht përpara atij".

Ndërsa tani, ajo që disa njerëz flasin e bëjnë lajka, kjo është bisedë tjetër. Fillojnë të përgojnë pas shpine e të flasin fjalë të liga. Aliu a.s. thotë se gjërat e këtilla janë përpjekja e fundit e njerëzve të paaftë dhe se këto janë si rrjedhojë e poshtërsisë. Personi që ndjehet krenar, s'përgojn. Aliu a.s. thotë: “Ai që lakminë e përvetëson si traditë, ia humb vlerën vetvetes. Ai që e shpreh hidhërimin e vet, pranon nënçmimin. Ai që gjuhës së vet i jep shumë përparësi, e nënçmon shpirtin e vet”.<sup>33</sup> Një njeri i ndershëm, ai që ndjen krenari dhe njerëzi, nuk është i gatshëm që as vuajtjet e veta, tua tregojë të tjerëve. Ngërthen në vete sëmundjen dhe vuajtjen, e nuk i lodh me këtë të tjerët

Erdhi dikush tek imam Sadiku dhe nisi të tregojë për varfërinë e vet. Ai tha: “Aq jam varfëruar sa që fitimi im nuk mjafton as për t'i mbuluar harxhimet e jetës. Punojë këtë, punojë atë...”. Imam Sadiku i tha njërit prej të afërmëve të tij: “Shko, përgatit kaq para dhe epja këtij”. Pasi shkoi ky, njeriu tha: “Vërtetë nuk kam patur ndër mend të kërkoj prej jush diçka”. Imam Aliu tha: “As unë nuk mendova se ti do të kërkosh nga unë diçka, por do të jap një këshillë, mbaje mend këtë këshillën time, që për çdo brengë dhe vuajtje, mos t'u flasish të tjerëve sepse do të jesh i nënçmuar”.

Islami nuk ka dëshirë që njeriu të jetë i nënçmuar në sy të të tjerëve. Don të thotë, nëse ka nevojë, skuqe fytyrën tënde me shuplakë e ruaje krenarinë. Aliu a.s. thotë: “Ai që dhembjen dhe skamjen e vet ua shpreh të tjerëve, do ta ulë veten”. Siç shprehen sot njerëzit: situatën e kemi dramatike, kështu është, ashtu është. Mos folni kështu. Fytyra yte është më e dashur se gjithçka tjetër. Krenaria për besimtarin është më e dashur se gjithçka tjetër. Ai që shkon pas dëshirave të veta, le ta dijë se, së pari, e ka nënçmuar veten. Pangopësia

---

<sup>33</sup> Po aty, tregimi 2, f. 229.

është një lloj poshtërsie. Sipas logjikës së Aliut a.s. të gjitha veprat jomorale përmbledhen në një fjalë, e ajo është ultësia-poshtërsia e shpirtit, mungesa e shpirtmadhësisë. Aliu a.s. të gjitha vlerat morale i përmbledh në një fjalë, ajo është shpirtmadhësia. Patjetër në shpirtin tuaj duhet të ndjeheni shpirtëmadh kështu s'do të rreni, do ta thoni të vërtetën e do të jeni të fuqishëm. Kur të ndjeni në vete shpirtëmadhësi, do ta shihni se jeni të përmbajtur. Nuk do të bëni asnjë vepër të poshtër. Për shembull, nuk do të pini verë, sepse kjo e bën njeriun të dehur, ndërsa të dehurit, sado që shkurt të zgjatë, ia merr mendjen njeriut dhe në fund e privon nga dinjiteti dhe harmonia. Sikur njeriu, edhe për një moment ta humb njerëzinë, shndërrohet në një gjallesë që nuk posedon të kuptuar.

Aliu a.s., në fjalinë e dytë thotë: “Shpirti im s'bazohet në të tepruarit, tejkalinin e normave”. Ka disa çështje shumë të mira në mësimet e arifëve-gnostikëve dhe asketëve tanë, por njëri nga dëmet që Islami ka përjetuar nga mësimet e gnostikëve dhe asketëve vjen nga ajo që ata, nën ndikim të krishterizmit, mësimëve budistike dhe monistike, lidhur me luftën kundër pangopësisë, kanë humbur orientimin. Po të hedhin pak një shikim në mësimet islame do të shohim se Islami është për zhdukjen e një lloj egoje dhe ngjalljen e një egoje tjetër. Ai thotë: ”Veten edhe harroje edhe mos e harro”.

Islami porosinë që t'i harroni veset shtazarake, ndërkaq dëshiron që në shpirt të ngjallni diç të re, pra dëshiron që në shpirtin tuaj të ringjallë ambicje tjetër.

Para shumë vitesh, kur e kuptova këtë çështje dhe kur më vonë e lexova librin “Ikbllname” (Letra e Ikbllit), nga zotëri Golamrez Sajid) pash që Ikbali ishte i vëtdijshëm për këtë. Ai shqyrtonte një temë me titull “Filozofia e veçantë”, dhe konsideron se njeriu duhet kërkuar “unë”-in e vet dhe “unë”-in njerëzor. Islami si njërin nga gjykimet e All-llahut e

Ilogarit edhe atë që All-llahu e shndërron njeriun në atë formë që mos ta harrojë vetveten. Në Kur'an thuhet: **“Mos u bëni si ata që e harruan All-llahun dhe ai i bëri të harrojnë vetveten. Ata janë të mbrapshtë”**. (59:19)

Dënohen pse e kanë harruar vetveten. Thotë “vetveten”, por ç’është ajo “vetvete” që e thekson Kur’ani? Nuk thotë që të mos harrohet dëshira, ambicja dhe adhurimi i parasë, por thotë që gjërat harrohen, e mendo për vetveten. Ti nuk je ai. Ti je më i mirë se ai, ti je njeri, je një personalitet, ti je i natyrshëm, e kur ta gjesh në vetveten tënde atë brendi, do ta gjesh vetvete në dritë, do ta gjesh vetveten të lartësuar, të fuqishëm dhe krenar. Mos e harro këtë, përndryshe, ku mund të gjesh në botë njeri që i ka thirrë njerëzit në devotshmëri më shumë se Aliu a.s.? (Njeriu duhet të mendojë mirë rreth këtyre gjërave). Cili është ai që ka thirrë më tepër se Aliu a.s. në luftë kundër epsheve? Cili është ai që thirrë më tepër se Aliu a.s. në lënien e jetës së kësaj bote. Askush, por i njëjti ky Ali, në mësimet e tij, i thërret njerëzit në krenari dhe dinjitet.

Në vazhdim të të njëjtës porosi, që e prezentova, duke iu drejtuar imam Hasanit a.s, thotë: “Djali im, mos u bën rob i tjetrit. All-llahu të ka krijuar të lirë. Ruaje vetveten!”

Aliu a.s. që thërret në modesti, Aliu që është njeriu më modest në botë, Aliu që gjithnjë i thërret njerëzit në luftë kundër pasioneve, si është e mundur që këtu të thërras në kryelartësi? Jo, kjo kryelartësi është ndryshe. Kjo don të thotë ruajtje dhe patjetër të jetë e ruajtur. Mu për atë thotë: “Kurrë mos u bën rob i tjetrit!” Të bëhesh rob i tjetrit, të shprehish përuļje përpara një robi të All-llahut, është në kundërshtim me fisnikërinë hyjnore dh me dinjitetin tënd njerëzor.

## BESIMI NË BOTËN E PADUKSHME (GAJB)

*“Të cilët besojnë në të padukshmen, kryejnë faljen dhe japin sadakë nga ajo që u kemi dhënë Ne” (2:3).*

Në kulturën tone islame është e njohur që disa njerëz t’i quajmë besimtarë. Themi filan falani është besimtar. Kjo don të thotë që është njeri fetar, pra, që i kryen obligimet fetare dhe bën shumë vepra të mira (mustehab). Shkon në haxh, falë namaz nafile dhe bën shumë dhikër. Por për njeriun që nuk i ka këto veti, themi se ai njeri nuk është besimtar apo nuk është fetar. Këto janë termine nga praktika, por në Kur’an qëndrojnë termine tjera. Kur’ani për disa njerëz thotë se janë besimtarë, kurse për të tjerët thotë se janë qafira ose jobesimtarë. Ç’do të thotë besimtar, sipas Kur’anit, në kuptimin terminologjik? Don të thotë ai që ka besim. Jobesimtar quhet personi që nuk ka besim. Ç’do të thotë besim? Do të fillojmë nga vetë nocioni "besim".

Besimi ka të bëjë me zemrën dhe kjo qëndron në tekstin kur’anor. Erdhën një grup beduinësh te Pejgamberi s.a.v.s. dhe thanë: “Besojmë” dhe atëherë u shpall ajeti:

***“Disa beduinë thonë: “Ne besojmë”! Thuaj: “Ju nuk besoni, por thuani: ne nënshtrohemi!” sepse ende në zemrat tuaja nuk ka hyrë besimi. Por nëse e dëgjoni All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, Ai aspak nuk do t’ua zvogëlojë shpërblimet për veprat tuaja. All-llahu, vërtetë, falë dhe është shumë i Mëshirshëm”.*** (49:14)

Nga kjo kuptojmë se imani është një realitet dhe një e vërtetë që ka të bëjë me shpirtin e njeriut e jo me trupin e tij, po as me ballin që ka shenjë nga të rënit në sexhde. Nuk ka të

bëjë me gjuhën e njeriut që i bën apo nuk i bën dhikër All-llahut (xh.sh.) por ka të bëjë me esencën e këtij veprimi që është një gjendje e kënaqshme, mendore dhe fetare. Do të pyetni, në çka të besohet? Të themi në All-llahun (xh.sh.)? Të themi në cilësitë e Tij? Të themi besim në pejgamberllëkun e Pejgamberit s.a.v.s. dhe në Shpalljen që i zbriti? Të themi besim në ekzistimin e Ditës së Gjykimit? Po të gjitha këto janë të vërteta dhe të gjitha në Kur'an janë të përmbledhura në një fjalë, që dëshiroj ta shpjegoj. Ajo fjalë gjendet në ajetin e tretë të sures-kaptinës Bekare:

“Të cilët besojnë në të padukshmen, kryejnë faljen e namazit dhe japin sadakë nga ajo që u kemi dhënë Ne”.

Në fjalinë “të cilët besojnë në të padukshmen” fjala “gajb” është një fjalë në vend të shumë fjalëve. Kjo don të thotë të besosh në All-llahun, në cilësitë e All-llahut, në ndihmën e padukshme në kushte të caktuara. Tani do ta shpjegoj kuptimin e fjalës “gajb” e më pastaj do të vazhdoj me ekspozenë time.

Çka është dallimi në mes besimtarit dhe jobesimtarit? Kam thënë që fjala "gajb" don të thotë "i padukshëm", "i fshehtë". Sërish çështja s'është e sqaruar. I fshehtë prej kujt? Tani, për ne që gjendemi në këtë vend, e fshehtë konsiderohet ajo që është pas këtij muri. Atëherë, nëse besojmë në atë që mund të ngjajë pas këtij muri, a konsiderohet kjo besim në gajb? Nëse tani na pyesin, për shembull, se çfarë ka ne thellësi prej 500 metrash nën këtë tokë ku ne gjendemi? Gjë e fshehtë është, nuk e dijmë. Po sikur ta dijmë, a thua vallë kjo konsiderohet besim në botën e padukshme? Jo. Dita e nesërme për ne është gjë e fshehtë. Nëse besojmë në ngjarjet që do të ndodhin nesër, dhe që prej tani i parashikojmë dhe besojmë në atë që do të ndodhë, a thua, vallë, konsiderohet besim në botën e padukshme? Jo. Bile edhe e kaluara për ne



është e fshehtë. A thua besimi në të kaluarën konsiderohet besim në gajb? Jo. Atëherë, ç' do të thotë besimi në botën e padukshme? Ç' është besimi në të fshehtën? Çka konsiderohet fshehtësi? Këtu duhet të keni kujdes.

Në këtë botë ka disa gjëra të cilat shqisat tona të të dëgjuarit, të të parit, të prekjes, të nuhatjes e të shijuarit, nuk mund t'i përceptojnë. Dikush thotë se kemi më tepër shqisa, por janë të njëjta.

Tani, ajo pas këtij muri për ne është e fshehtë, por ekziston mundësia për ne që me sytë tonë të shohim se çka ngjanë pas këtij muri. Don të thotë se nuk mund të fshehet nga sytë tanë, ngase sytë tanë mund ta shohin atë. Veshët tanë kanë mundësi t'i dëgjojnë disa gjëra, ose shqisa jonë e të shijuarit, mund t'i shijojë, shqisa e të nuhaturit, mund t'i nuhatë. Këto gjëra quhen dëshmi, që don të thotë gjëra që njeriu mund t'i përceptojë me anë të shqisave të veta. Kemi një shqisë njështrësëshe që është e vendosur në sipërfaqen e trupi tonë, po edhe shtazët e kanë në të njëjtën masë. Pra shqisat që i kemi ne, i kanë edhe shtazët, dhe mbase ndonjë shqisë prej këtyre, te kafshët është shumë më e mprehtë se sa te ne. Sytë e disa shtazëve janë më të mprehtë se sa sytë tonë. Veshët e disa shtazëve, për shembull, të qenit, janë më të ndieshëm se sa veshët e njeriut: shqisa e të nuhaturit te disa gjallesa, siç është miza përdhese, kjo gjallesë e dobët, është shumë më e ndieshme se sa te njeriu. Nëse vendoni mbi tavolinë një enë me mish dhe nëse sytë tuaj nuk e shohin kur të hyni në dhomë, nuk mund ta dini se sa mish ka në dhomë. Por miza përdhese me shqisën e vet të të nuhaturit mund ta përceptojë atë me precizitet. Këto quhen shqisa. Thuhet se ajo që njeriu e përcepton përmes shqisave të veta, nuk konsiderohet gajb sepse këto janë gjëra të dukshme. Me këtë shqisë unë mund t'i kuptoj ngjarjet. Don të thotë, mundem me

sytë e mi ta shoh formën që do të marrë e nesërmja. Kënga që do të këndohet nesër mund ta dëgjoj me veshët e mi. Ushqimi që do të gatuhet për nesër, mund ta shijoj me shqisën e të shijuarit. Këto s'janë gjëra të padukshme. Sipas Kur'anit këto janë dëshmi. Atëherë, kush konsiderohet botë e padukshme?

Botë e padukshme është ajo që njeriu duhet ta pranojë dhe të besojë se nën botën e ekzistencës ka një realitet të cilin ai nuk mund ta ndjejë në lëkurën e vet, po edhe sikur të ishte prezent këtu. Sytë e veshët e mi, shqisa e të nuhaturit e të shijuarit tim, s'mund t'i kuptojnë këto gjëra. Pra unë mendoj për vete se këto shqisa që i posedoj tejet shumë janë të përkufizuara dhe më janë dhuruar që me to të mbaj kontakt me botën e jashtme (jashtë meje, pra që më rrethon mua - sh.p.). Pse, në të vërtetë, unë i kam sytë? Për atë që, kur të dua, të vë kontakt me këtë botë, përmes ngjyrave e figurave dhe për ta gjetur rrugën. Dhe kjo është krejt. Pse më janë dhënë veshët? Sepse ekzistojnë disa valë që quhen tigur të cilët mund t'i përceptoj përmes veshëve. Andaj, nëse në këtë botë duhet t'i kryej punët e mia, më duhet të kem vesh dhe shqisa të tjera. Po a janë këto shqisa që unë i posedoj si instrumente përmes të cilave e kuptoj gjithë atë që ekziston në këtë botë, dhe nëse diçka nuk mund ta kuptoj përmes shqisave të mia, nuk është e patjetërsueshme edhe ta pranoj? Jo, ky është gabim. Gabimi më i madh që njeriu mund ta bëjë në jetën e vet dhe që i jep ngjyrë shkencore është ajo se mendon se shqisat patjetër e kanë të zbulojnë gjithëçka ka në botë e në natyrë. Andaj, nëse diçka nuk mund ta kuptojë përmes shqisave të veta, atë duhet ta mohojë dhe të thotë se nuk ekziston. Përndryshe sikur të ekzistonte, do ta preksha me dorën time, do ta shihja me sytë e mi, do ta dëgjoja me veshët e mi, ose do ta hetoja përmes shqisës së të shijuarit.

Të gjitha gjërat që njeriu duhet t'i besojë, Kur'ani i ka shpjeguar me fjalën "gajb", besimi në atë që ekzistojnë të vërteta dhe realitete të cilat janë jashtë kufijve të shqisave tona. Si mund ta kuptoj ekzistimin e tyre? Njeriut i janë treguar rrugë të tjera, i janë dhënë arsye përmes të cilave njeriu mund ta njohë botën e padukshme. Natyrisht, këtu bëhet e qartë se kuptimi i asaj që Kur'ani thotë se "besimtarë janë ata që i besojnë të padukshmes" nuk nënkupton ato që secila gjë për të cilën na thonë se është në formë të fshehtë, të themi se jemi besimtarë andaj e pranojmë atë. Për shembull, dëbuesi i xhinëve vie e thotë: "Kam një ushtri xhinësh dhe se ato janë kështu apo ashtu". Ndërkaq ne ia kthejmë: "Ne na është thënë të besojmë në botën e fshehtë, andaj i pranojmë fjalët e dëbuesit të xhinëve". Ajo se çka është gajbi, është e shpjeguar në vende tjera në Kur'an dhe jashta tij.

Nuk kam thënë që njeriu të besojë në çdo pohim që ka formën e gajbit, por që njeriu nuk guxon ta mohojë gajbin. Nuk guxojmë t'i mohojmë të vërtetat e fshehta. Tani, nëse pyetni se në cilën mënyrë njeriu duhet të besojë në gajbin, unë po them se ai i ka statet e veta. I pari është ai që në botë ka me mijëra argumente, që së paku, pengojnë mohimin. Don të thotë e çojnë njeriun prej stadiumit të mohimit në atë të dyshimit. Sot është bërë krejtësisht e qartë se në botën tonë të dukshme dhe të prekshme ka me mijëra gjëra që nuk i vërejmë, as që i perceptojmë me shqisat tona. Këtu do t'u sjell një shembull shumë të qartë.

Në të kaluarën, njerëzit, nga të gjitha valët që kanë ekzistuar, i kanë njohur vetëm valët e zërit. Shumë kohë më parë në mes dijetarëve është diskutuar për çështjen e zërit. Njeriu flet, të tjerët e dëgjojnë zërin e tij; ndeshen dy gurë mes vete, njeriu e dëgjon zërin e ndeshjes së tyre. Si? Thonë se ky është ajri që ju e ndjeni, ekzistimin e të cilit e kuptoni

gjatë lëvizjes ose në ndonjë rast tjetër. Sikur kur e hedhni gurin në ndonjë pishinë e shihni se si uji krijon valë dhe se valët zgjerohen dhe sa më shumë zgjerohen aq më shumë dobësohen. Gjithashtu kur flitni apo kur ndeshen dy gurë, në ajër krijohen valë të cilat arrinë gjer te veshi juaj. Aty ka një aparat, timpani, eshtrat, nervat, të cilët dridhen, më në fund vëreni diçka nga ajo që quhet zë. Njerëzimi nuk ka mundur më tepër të dijë për valët. Sot, me anë të shkencës, pra, me anë të shenjave që njeriu i ka arritur përmes shkencës, është bërë e qartë se përveç valëve të zërit ka edhe valë tjera që nuk kanë të bëjnë me valët e zërit, madje as veshi ynë dhe asnjë shqisë tjetër nuk është në gjendje t'i kuptojë ato valë, por ato ekzistojnë. Sikur valët e elektrecitetit, valët që i emitojnë stacionet e radios, ndërkaq radiomarrësi i radios suaj këto valë i shndërron në valë. Ato valë që emitojnë stacionet nuk janë valë zëri. Sikur të ishin në formë të valës së zërit dhe të emitohet, për shembull, nga Teherani për të arritur gjer në Horasan, mbase do të zgjaste një orë e gjysëm e më tepër. Pohojnë që vala e zërit, për njëzet minuta, kalon një distancë prej Komi në Teheran që ka afro 130 km. Shpejtësia e saj në krahasim me shpejtësinë e valës elektrike, është më e vogël. Nëse për shembull, unë flas këtu, ekziston një autoparlant në një distancë prej 200 m. prej këtu, dhe nëse ju e dëgjoni edhe zërin tim edhe zërin nga autoparlanti, me atë rast do t'i dëgjoni fjalët me ndërprerje. Don të thotë, një herë e dëgjoni fjalën drejtëpërdejtë nga goja ime, ndërsa pak më vonë të njëjtën e dëgjoni nga autoparlanti. Pra, zëri nga autoparlanti vjen më vonë. Por ju e shihni se kur ndonjë program emitohet nga radiostacioni, e dëgjoni menjëherë, ose kur folni në telefon me Horasanin, u duket se aty jeni duke folur. Zëri me atë shpejtësi, në formë të valës elektrike, me apo pa tel, shkon gjer në Horasan dhe me të njëjtën shpejtësi kthen prapë.

E njohur është shprehja që thotë se njerëzit e botës e dëgjojnë zërin e orës së njohur të Londrës përpara atyre që jetojnë afër saj. Nëse ju e dëgjoni radioprogramin e Anglisë, zërin e asaj ore do ta dëgjoni përpara njerëzve që jetojnë në Angli, afër asaj ore. Pse? Sepse për njerëzit që dëshirojnë ta dëgjojnë zërin e kësaj ore përmes ajrit dhe valëve të zërit, ajo mund të zgjatë një apo dy minuta, por njerëzit që e dëgjojnë zërin përmes valëve elektronike, për shembull në Iran, mbase ai zë mund të dëgjohet për një të njëmijetën apo një të njëmiliontën pjesë të sekondit. Prandaj ju do ta dëgjoni këtë zë më shpejt se një anglez.

Valë të këtilla ka në ajër. Me cilën shqisë mund t'i vërejmë? Me asnje shqisë, por me anë të faktorëve shkencor. Me siguri këta shkencëtarë mund ta vërtetojnë gjatësinë e këtyre valëve, e të mos i shohin. Atëherë, shkurtimisht, ne i kuptojmë se këto valë ekzistojnë. Mu për atë është e pakuptimtë që njeriu ta përkufizojë besimin dhe pranimin dhe të pohojë: “Besoj vetëm në ato gjëra që i përceptoj drejtpërdrejtë nëpërmjet shqisave të mia”.

Ç'do të thotë: “të cilët besojnë në të padukshmen...?” A thua vallë, kjo don të thotë që patjetër të besojmë se ekziston botë e padukshme, se ekziston Zot, ekziston shpallja, melekët? A thua librat hyjnorë vijnë nga një burim i padukshëm? A ekziston Dita e Gjykimit? Ose të besojmë se ekziston një imam i fshehtë? A konsiderohet ky besim në të padukshme dhe a përfundon aty. Jo, kjo është më tepër se aq. Besimi në të padukshmen arrihet atëherë kur njeriu beson në lidhjen në mes tij dhe botës së padukshme. Besojmë se nuk është ashtu që bota e padukshme të ekzistojë e ndarë dhe se ne të jemi të ndarë nga ajo. Patjetër të besojmë në ndihmën e padukshme. Në suretul-fatiha lexoni: “...Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”. Kjo don të thotë të kërkuarit ndihmë. Në

rrugën që jemi duke trasuar, shfrytëzojmë këto fuqi që Ti na i ke dhuruar, por e dimë që Ti je burim i të gjitha fuqive, prej Teje kërkojmë fuqi, ndihmë dhe udhëzim.

Në lutjen “Kumejl” lexojmë: “O Zot, o Zot, o Zot! Ma forco trupin në shërbim Tëndin dhe forcoma zemrën në qëllimin tim. Më dhuro sinqeritet dhe frikërespekt ndaj Teje. Më dhuro vendosmëri e fuqi që gjithnjë të jem në shërbimin (Tënd)”. Në të vërtetë, ç’do të thotë lutje? Shumë mirë, ai beson në botën e padukshme për vete edhe unë besoj për vete? Thonë se ka një dallim i cili ekziston në mes filozofisë hyjnore dhe fesë-religjionit, bile filozofia hyjnore (natyrisht, filozofia hyjnore që nuk kërkon ndihmë nga feja, siç është Islami) më tepër beson në Zotin, të ndarë nga universi, ndërsa botën e padukshme e beson të ndarë nga ajo e dukshmja. Kjo ndodh sikur një astronom i cili, për shembull, thotë se është zbuluar një planet në sistemin diellor, të quajtur Neptun ose që në vasionë është zbuluar diç tjetër. Mirë pra, po çka nëse ekziston? Çfarë lidhje ka ajo me mua? Mirëpo, në fe lidhja kryesore është ajo që ekziston në mes krijesës dhe Krijuesit, pra në mes nesh dhe botës së padukshme. Në një aspekt feja ne na detyron të angazhohemi dhe të aktivizohemi e sipas mendimit të Aliut a.s. në shërbim të All-llahut, ndërkaq në aspektin tjetër thotë se ka lidhje shpirtërore dhe bashkim në mes të padukshmes dhe kësaj bote. Ti kërko, lyp ndihmë nga një rrugë e padukshme që vetë nuk e dijs, do të arrish te qëllimi dhe rezultati. Thotë: “Jep sadakë”, dhe nga një kanal që vetë nuk e dijs, do të pengohen fatkeqësitë tua. Bën dua, natyrisht që ka kushte, dhe nëse ajo kryhet në ato kushte, ajo do të merret parasysht nga një drejtim i fshehtë.

Vendos që nga All-llahu xh.sh. të kërkosht frymëzim për veprat tua. Pastaj do të shohish se një herë, në kohë, All-llahu do ta frymëzojë zemrën tënde. Ty do të arrijë ndihmë

nga bota e padukshme. Natyrisht, ndihma nga bota e padukshme ka kushte. Kjo nuk do të thotë që të qëndrojmë në shtëpi e të themi: “Oj botë e padukshme, më ndihmo!” Jo. Ndhma nga bota e padukshme ka rregulla dhe kushte. Kryesorja është që ne të besojmë në botën e padukshme dhe në ndihmën e padukshme në ca kushte të caktuara. Përgjithësisht, Shpallja është një ndihmë nga bota e fshehtë, por në suaza të shoqërisë njerëzore. Aty ku nuk mund të mbrijë këmba e njeriut, mendja, aktiviteti, shqisa dhe logjika, All-llahu nëpërmjet të ndonjë personi, të quajtur pejgamber, e udhëzon njeriun dhe i dhuron ndihmë nga bota e padukshme. Aty ku njeriu nuk ka mundësi, pasi të ketë kryer aktivitetin dhe punën e vet, vendin e ka ndihma nga bota e padukshme. Kur’ani, në lidhje me Pejgamberin fisnik s.a.v.s., thotë:

***“Të gjithë së bashku mbajuni për litarin e All-llshut dhe mos u përçani! Pastaj përkujtonie dhuntinë e All-llahut ndaj jush kur ishit të armiqësuar e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ju me mëshirën e Tij u bëtë vëllezër. Ishit buzë greminës së zjarrit e Ai u shpëtoi prej tij. Ashtu All-llshu ua shpjegon argumentet e veta, mbase do të merrni të mbarën!”*** (3:103)

Kjo quhet ndihmë nga bota e padukshme. Po sa është i dobishëm një besim i tillë për jetën shoqërore dhe individuale të njeriut?!

Nuk e di se a jeni ballafaquar me njerëzit e atillë apo jo, ndërsa unë jam ballafaquar dhe vetë në jetën private kam provuar që njeriu disa herë ndjehet se, nëse shkon rrugës që ia ka caktuar All-llahu, ekzistojnë disa konfirmime dhe mbështetje të padukshme, që janë më të vlefshme se të kuptuarit dhe logjika të cilat veprojnë për njeriun. Sa e ruan ky iman- besim njeriun dhe sa i dobishëm është për jetën e tij!

Tani më kujtohet një ngjarje dhe do të ishte dëm sikur të mos e rrëfeja. Këtë ngjarje e kam treguar dy herë gjatë diskutimeve të mia, e ajo ka të bëjë me rahmetli ajetull-llah Burexherdiun. Para se të vinte në Kom, unë e kam njohur mirë dhe kam qenë te ai në Buruxherd. Me të vërtetë ishte njeri i devotshëm. Natyrisht do të thoni: “Kush është merxha ai është edhe njeri i devotshëm”. Tevhidi, gjithashtu ka gradë. Po, nëse e llogarisim atë që unë edhe ju mendojmë, merxha-të kanë gradë më të larta nga ato që ne i kemi, por kur them njeri i devotshëm, mendoj në një gradë shumë të lartë. Ai ka qenë një njeri që në esencë e ka prekur tevhidin. Gjatë jetës së tij ka pasur një besim shumë të çuditshëm dhe shpresë për ndihmë nga ana e All-llahut (xh.sh.). Para një viti, kur erdhi në Kom, vendosi të shkojë në Mesh'hed. Kur ishte i sëmurë, kishte nevojë për një intervenim kirurgjik, kështu Buruxherdin e dërguan në Teheran dhe e operuan. U betua se nëse All-llahu i jep shëndet, do të shkojë për zijaret në mauzoleun e hazreti Ridasë. Pas gjashtë muajsh që erdhi në Kom, kur erdhi vera, vendosi të shkojë në Mesh-hed. Një ditë, para një grupi të shokëve, tha: “Dua të shkojë në Mesh-hed. Kush dëshiron të vijë me mua, le të paraqitet”. Shokët u përgjigjën: “Mirë, ne do të lajmërojmë për këtë”. Njëri prej shokëve të tij më të afërt që ishte merxha (autoritet i lartë fetar) më tregoi se kishin biseduar lidhur me këtë: “Kemi menduar se s'do të ishte mirë që zotëriu të shkojë në Mesh-hed”. Pse? Sepse ne e njihshim zotëriun, ndërsa në atë kohë, populli i Teheranit, Horasanit dhe, në përgjithësi, i Iranit ende nuk e njihnte mirë. Andaj populli në ato qytete nuk do ta pritte ashtu si i takon një njeriu të madh. Lerenie le të qëndrojë edhe një vit, ndërkaq betimin që e bëri, nuk i ka dhënë karakter fetar, por vetëm një premtim i shprehur në zemrën e tij, kur të bëhet i njohur në Iran, le të shkojë. Vendorsëm që



nëse edhe një herë na pyet, ta ndalojmë. Pas disa ditësh përsëri e bëri të njejtën pyetje: “Kush nga zotërinjtë do të vijë me mua?” Secili prej nesh tha nga diçka dhe dha nga ndonjë përgjigje. Njëri tha: “O zotëri, ju vetëm sa jeni ngritur nga shtrati i spitalit (në atë kohë kishte vetëm vetura e s'kishte aeroplanë), s'do të jeni të rahatshëm dhe vara do t'u hapet”. Tjetri tha diçka tjetër. Por njëri nga shokët nuk mundi të durojë dhe tregoi se pse ai nuk guxon të shkojë në Mesh-hed. E tha në atë mënyrë që zotriu e kuptoi: “Nga shkaku që populli iranian nuk u njeh dhe nuk do t'u presë si duhet”. Ai zotëri më tregoi se që nga momenti kur z. Buruxherdi e dëgjoi atë fjali, u hidhërua (në atë kohë kishte shtatëdhjetë vjet). Ai tha: “All-llahu më ka dhënë shtatëdhjetë vjet, kurse në këtë kohë kryejmë vepra bamirësie. As njëra nga bamirësitë nuk ka qenë në plan, por të gjitha kanë qenë paracaktimet e All-llahut (xh.sh.). Gjithnjë kam menduar të shoh se cili është obligimi im në rrugë të All-llahut (xh.sh.). Asnjëherë nuk kam menduar se në rrugën në të cilën jam duke shkuar që do të përparoj, apo do të humbas; që do të fitoj ose s'do të fitoj merita. Gjithnjë kam menduar ta kryej obligimin tim. Gjithëçka ndodh, është me parapërcaktimin e All-llahut. Nuk është në rregull që në moshën shtatëdhjetë vjeçare të bëj plan për vete. Kur kam All-llahun, kur kam ndihmën e Tij, kur veten e konsideroj si një rob e si njeri, as All-llahu s'do të më harrojë. Jo, unë do të shkoj”. Qyshse vdiq ky njeri, All-llahu gjithnjë e më tepër e rriste respektin e njerëzve ndaj tij. Më fal, o Zot, mos vallë ajetullah Buruxherdi kishte ndonjë “farefisni” me All-llahun, që kishte përkrahjen dhe ndihmën e Tij? Në asnjë mënyrë. Ndihma e All-llahut ndaj njerëzve, shoqërive dhe njerëzimit e ka qëllimin e vet.

Pejgamberi i ndershëm, në lidhje me Mehdiun e premtuar a.s., thotë: “Asnjëherë All-llahu nuk e ka lënë botën pa

udhëheqës po as që do ta lërë ndonjëherë. Kur njerëzimi dhe bota do të vijnë buzë shkatërrimit, All-llahu do ta shpëtojë njerëzimin përmes një njeriu”.A e dini se si tani është paraqitur në mesin e intelektualëve të botës në lidhje me ardhmërinë e njerëzimit, dhe a e dini se ky lloj pesimizmi ka lindur nga vlerësimet e shkaqeve e faktorëve sipërfaqësorë? Ne si muslimanë nuk e vlerësojmë këtë dhunti, si njerëzit e para njëqind vjetëve, që të themi, përshembull, se jeta e njeriut do të vazhdojë edhe pesëqind vjet, ose njëmijë, ose ndoshta njëqindmijë. Them i se nuk eksizton arsye që bota të zhduket, nuk ka arsye që njerëzimi të shkatërrohet, por sot, një grup i ashtëquajtur intelektualë të botës (mes të cilëve edhe Raseli me librin “Shpresa të reja”) konsideron se njerëzimi e ka përfunduar epokën e vet dhe se ka ardhur koha e shkatërrimit të tij. Njëri nga ata që kanë një pesimizëm të këstillë ndaj ardhmërisë së njerëzimit është edhe Ajnshtajni. Ai thotë që bota, sipas të gjitha gjasave, do ta shkatërrojë vetveten me anë të shkathtësisë së saj mahnitëse, ngase sipas produktit të fuqive të ndryshme ka arritur gjer aty të ketë fuqinë e shkatërrimit. Në të kaluarën nuk ka qenë kështu. Në të kaluarën, populli më i rrezikshëm, njeriu më i njohur, sikur të kenë fuqinë më të mëdha të kohës së vet, ç’do të mund të bënin? Për shembull, do të vritnin pesëdhjetmijë apo njëqindmijë njerëz. Kanë thënë: “I lëvduar qoftë All-llahu, shikoni si Haxh-xhaxh ibën Jusufi ka vrarë tridhjetmijë njerëz”. Paj mirë, më tepër se kaq nuk ka patur mundësi të mbysë. Civilizimi i asaj kohe nuk ka lejuar më tepër se kaq. Sa njerëz mund të vriten me shpatën dhe fuqinë e xhelatit? Sikur njeriu të sundojë njëzet vjet dhe vret tre deri në katër veta në ditë, nuk do ta kalonte shifrën e tridhjetmijë njerëzve. Apo ai gjakpirësi diktator romak, sa krime ka mundur të bëjë, madje edhe të bëhet kriminel i paracaktuar dhe të qëndrojë

mbi kodër e të urdhërojë: “Kallnie këtë qytet!” Qyteti do të digjej, kurse ai do të kënaqej. Mirëpo a do të mund ta kallë tërë botën? Në asnjë mënyrë. Qytetin që do ta kallte a mund të ishte i madh sa Teherani? Assesi. Mjetet e asaj kohe nuk kanë lejuar. Por, nëse civilizimi i tanishëm ka arritur gjer në atë shkallë, dhe paraqitet një Neron, bëhet fuqi e parë në botë dhe e kaplon çmenduria, do të shkatërronte tërë njerëzimin. Një kancelar gjerman ka thënë: “Nëse ndodh lufta e tretë botërore, nuk do të ketë më fitues dhe humbës. Gjer më tani nëpër luftëra ka patur fitues e humbës, po, nëse ndodh edhe një luftë botërore, më nuk do të ketë fitues e humbës dhe që të dy palët do të shkatërrohen”. Vërtetë, në bazë të proceseve sipërfaqësore, kush ka të drejtë? Pesimistët kanë të drejtë. Nëse llogarisim se vërtetë gjendemi në fuçi baroti dhe në diçka shumë më të rrezikshme se baroti (ç’do të thotë barot), qind për qind digjesh nga baroti ashtu që me shtypjen e disa kopsave mund të zhduket bota, atëherë, pra, kanë të drejtë pesimistët lidhur me ardhmërinë e botës. Vërtetë, në bazë të treguesve sipërfaqësorë, nuk ekziston asnjë arsye të mos bëhemi pesimistë. Nuk është e thënë që të shpresojmë që fëmijët tanë të jetojnë në një jetë normale e të natyrshme, dhe të arrijnë t’i shohin fëmijët e vet.

Sot shohim se njeriu shkon në hënë. Mendojmë në vetë se dalëngadalë atje do të banojmë, e nëse çmendet, hëna do ta shkatërrojë botën. Vetëm një gjë është e evidente e ajo është frymëzimi që e fitojmë nga feja: “...të cilët bësojnë në botën e padukshme dhe falin namazin...”

Themi, natyrisht, njeriu në të kaluarën ka besuar në gjëra të thjeshta. Rreziqe të këtilla kanë ekzistuar, por universi e ka pronarin e vet që quhet Zot i cili e ka mbrojtur nga disa gjëra. Nëse ndodh ndonjë rrezik me përmasa botërore, universit, përsëri, nuk do t’i mungojë mëshira e All-llahut

(xh.sh.). Sa bukur shprehet Gandi: “Evropa është përplotë me të marrë e gjeni në të njëjtën kohë, gjenitë e saj janë të marrët, gjenialiteti i tyre është i përzier me çmendurinë”.

Sipas logjikës së fesë, sipas mendimit kur'anor, i cili thotë: “të cilët besojnë në botën e padukshme...” dhe nga të dhënat që i kemi marrë nga feja, jo në bazë të principeve sipërfaqësore, themi: “Jemi të qetë në aspekt të asaj që njerëzimi do të shkatërrohet tërësisht. Gjithëçka që ka qenë në të kaluarën është shkaktar i asaj që do të ndodhë në të ardhmen”. Para nesh e kemi ardhmërinë në të cilën, sipas shpjegimeve islame, truri do të përsoset. Ka hadith që thotë: “All-llahu në atë kohë do të vëdojë dorën e Tij të mëshirës mbi kokën e robërve të vet. Përsëri njeriu do të fitojë mençurinë e vet dhe më nuk do të veprojë kokë në vete për vepra të pakuptimta. Në atë kohë, jeta do të jetë më e gjatë, higjena do të jetë më e përkryer, plotësisht do të vendohet siguri. Të gjallët do të pajtohen mes vete”.<sup>34</sup>

Falë Zotit, toka ka shumë burime dhe rezerva energjie. Ju jeni krejtësisht në zanafillë dhe çka dini për të? Ju pohoni se katër-pesë miliardë njerëz janë shumë? Jo, toka ka kapacitet edhe për më shumë se aq. Toka i është lënë njeriut në disponim; bashkë me energjinë më të madhe që ka, me begatitë që vijnë nga qielli.

Nëse ne, në bazë të frymëzimeve religjioze, i studiojmë këto gjëra dhe e shikojmë botën e tanishme, të ashtuquajtur botë e shkëlqyer, do të shohim se shembulli ynë në këtë botë në krahasim me botën që feja na premtonte, është sikur një tunel nëpër të cilin kalojnë njerëzit. Ky tunel, në të vërtetë, është i errët, por në të kanë venduar një llambë artificiale. Posa kanë filluar që patjetër të dalin nga ky tunel, dhe kur të dalin, do të arrijnë në një vend shumë të gjerë dhe të

---

<sup>34</sup> Muntehabul athar.

shkëlqyeshëm, shkëlqimi i të cilit është natyror. Në radhë të parë vëndohet drejtësia, siguria dhe liria. Tevhidi (besimi në njëshmërinë e All-llahut-sh.p.) do të shfaqet në formën e tij të vërtetë dhe do ta ndriçojë botën. Kur'ani thotë: ***“Dijeni se All-llahu e ngjallë tokën pasi të ketë vdekur! Ne ua kemi shpjeguar argumentet, mbase do të mendoni”*** (57:17). Ky ajet, sipas komenteve tona, është shpjeguar ashtu sikur kjo temë nuk ka të bëjë me jetën e kësaj bote. Shoqëria njerëzore e tillë është: kur sheh se një ditë botën e kaplon bastardhimi, nëse bota “vdes” sikur gjatë stinës së dimrit, mos humbasni shpresën! Sërish vjen pranvera.

Domethëni e kësaj “për ata të cilët besojnë në botën e padukshme..” dhe për ndihmën nga bota e padukshme, është e qartë se ndihma vjen për individ, sipas peshojës individuale: për shoqëri të vogla, sipas peshojës shoqërore, ndërsa për mbarë njerëzimin, sipas peshojës botërore. I vetmi sundim i kësaj bote do të sigurohet me bereqet, begati, komoditet, mirësi dhe me përparim.



*Shoqata*

*Fladi*

## CILA ËSHTË PESHOJA E NJERËZISË - HUMANIZMIT

Dëshiroj t'i shqyrtoj çështjet të cilat do ta nxisin trurin tuaj, andaj diskutimi im më tepër ka karakter pyetjesh e shqyrtimelesh. Tema e diskutimit është peshoja e njerëzisë-humanizmi. Për peshojën e njerëzimit nëse dëshirojmë të diskutojmë në aspektin biologjik, kjo është një punë e lehtë. Biologjikisht është shqyrtuar vetëm ana fizike e njeriut. Aty është diskutuar se njeriu bën pjesë në njëerën nga kategoritë e ndryshme të gjallesave dhe se në cilën kategori bie ai. Për shembull, se ai është sisorë, një qenie në mesin e llojit të qenieve e cila quhet njeri përkundër qenieve tjera, siç janë shpendët, rëshqitësit shtazët me katër këmbë, insektet etj. Sipas peshojës së biologjisë të gjithë njerëzit që janë në tokë ecin me dy këmbë, kanë thonjë të rrafsh dhe flasin, dhe në aspektin biologjik-human nuk ekziston ndonjë dallim në mes njerëzve. Për shembull, sipas peshojës së biologjisë dhe mjekësisë, madje dhe psikologjisë Moiz Çombe është po aq njeri sa edhe Lumumbe. Do të thotë në biologji, e sipas mendimit të një mjeku apo të një psikologu të cilët flasin për organet e trupit ose për dallimet psikologjike, në mes këtyre dy personave nuk ekziston dallim, kështu që s'do të mund të dallonim as imam Husenin nga Jezidi. Sipas psikologjisë, mjekësisë dhe biologjisë, të dy janë njerëz. Mirëpo, humanizmi njerëzor dhe ajo që quhet krenari dhe përsosmëri njerëzore, a thua ka të bëjë me këtë? Në shkencat humanitare shohim se fjala është për njeriun e përkryer dhe të papërkryer, pra fjala është për njeriun me vetëdije të ulët dhe atë me vetëdije të lartë.

Cili është ai njeri i cili sipas shkencave humanitare, shkencës mbi etikën dhe shkencave shoqërore, mund të jetë i përkryer, dhe të mund të jetë pa të meta, të meritojë nder dhe respekt, ose aspak të mos jetë kështu, por edhe të jetë që meriton përbuzje. Ç'është peshoja e njerëzisë dhe ku është? Si mund ta dallojmë, për shembull, Çamberin, Lumumbën? Sipas çkafit mund t'i dallojmë? Cila është ajo që te ndonjë njeri shkakton nënçmim e poshtërsi, madje edhe varje, ndërkaq te tjetri bën të meritojë lëvdata, marrë parasysh që në aspektin biologjik kanë një përbërje dhe janë të ngjashëm njëri me tjetrin, madje edhe strukturën nervore e kanë të ngjashme! Që të dy kanë zemër, sistem nervor, mëlçi, veshkë, muskuj, lukth dhe... Mbase organet e njeriut që meriton qortim punojnë më mirë se sa organet e një njeriu meriton. Atëherë ç'është ajo që gjendet te njëri apo te tjetri që e dallon njërin nga tjetri.

Kjo gjithashtu është çështje shumë e rëndësishme për të cilën është diskutuar në shkencat humanitare, në fetë dhe religjionet e ndryshme. Kur'ani, për shembull, disa njerëz i konsideron më të mirë dhe i vë në shkallën më të lartë se melekët, madje këto edhe t'i përuken atij. Në Kur'an thuhet: "E kur u tham melekve: Bëni sexhde Ademit (njeriut-sh.p.)!" Lidhur me disa njerëz ai, Kur'ani, thotë se katërkambshit janë më të mirë se ata. Me cilën peshojë është bërë ky dallim i ashpër? Kjo, bile s'ka lidhje me fenë dhe religjionin. Madje edhe çështja e njeriut është në nivel që plotësisht nuk ka të bëjë me çështjen e All-llahut. Filozofët e njohur materialistë, të cilët nuk besojnë All-llahun, fenë dhe religjionin, e kanë shqyrtuar çështjen e njeriut dhe njerëzisë dhe çështjen e njeriut të poshtër dhe atij të fisnik. Parashtrohet pyetja: Si duket, sipas mendimit materialist, njeriu i poshtër dhe ai fisnik? Ku bazohet fisnikëria e ku poshtërsia? A mundet që

shkencën ta konsiderojmë peshojë e njerëzisë dhe të thuhet se njerëzit janë të njëjtë në kuptimin biologjik, por që ekziston një gjë e cila është e fituar, në bazë të së cilës dallohet peshoja e njerëzisë nga ajo e jonjerësisë dhe se ka një kufi në mes të njeriut fisnik dhe atij të poshtër? Sa më shumë njeriu të arrijë dituri dhe shkathtësi aq më i mirë është, e nëse këtu nuk i posedon, atëherë më pak ka njerëzi, andaj nxënësi i klasës së parë është më i mirë se ai që nuk ka hyrë ende në shkollë, madje nxënësi i klasës së dytë është njeri më i mirë se ai i klasës së parë e kështu me radhë. Në fakultet, studenti që është apsolvent është njeri më i mirë se ai që është para tij me semestra. Në mes nxënësit dhe shkencëtarit, gjithashtu, dallimi është në atë se më i miri prej tyre është më i dijsلمي. A është dituria dhe shkathtësitë masë për matjen e njerëzisë dhe a mundet të pranohet si e tillë? A i çmoni ju njerëzit apo i kritikoni sipas njohurive të tyre? A mendoni njëjtë si për Çomberin edhe për Lumumbën? Nuk mendoj që shkenca dhe dituria të jenë peshojë për matjen e njerëzisë, dhe se njeriu, nëse është dijetar më i madh, është edhe njeri më i ngritur-më fisnik. Sipas kësaj peshoje do të mund të thonim se Ajnshtajni që është më i njohuri shkencëtar i cili, mbase ka dijtur më shumë se të gjithë dijetarët tjerë, ka qenë njeriu më human i kohës sonë.

Mendimi tjetër është se shkenca nuk është peshojë e njerëzimit. Natyrisht, shkenca është njëri prej kushteve të njerëzisë. Ne nuk mund ta mohojmë diturinë në botë, si në ne si në shoqëri, kjo nuk është e lejuar. Nëse ajo ka ndikim, atëherë ai është vetëm njëri prej bazave të njerëzisë. Bile ekziston një vërejtje në lidhje me principin e bazueshmërisë së saj. Sipas këtij mendimi njerëzishmëria ka të bëjë me karakterin dhe temperamentin, e jo me diturinë. Karakteri dhe temperamentin janë diçka, ndërkaq dituria, diçka tjetër.



E mundur është që njeriu të jetë i mençur e të ketë dituri, të dijë shumëçka, por që karakteri (natyra) i tij të mos jetë njerëzor, por shtazarak. Si? Për shembull, një gjallesë sipas natyrës (karakterit) pason instiktin me të cilin është e krijuar. Fuqia e instiktit sundon mbi atë. Don të thotë, që përpos instiktit ajo nuk posedon ndonjë dëshirë, ajo është e barabartë me instiktin dhe asgjë tjetër përveç instiktit. Nëse themi se qeni është një gjallesë e rreptë, njëkohësisht besnike, rreptësia e besikëria janë instinkte të kësaj gjallese. Nëse themi se miza përdhese është një gjallesë tamahqare dhe kursimtare, tamahqarllëku e kursimi janë instikte të saj. Me ato udhëheq fuqia e instiktit dhe kjo është krejt. Ka njerëz që kanë natyrë të njëjtë si të shtazëve, ose ndryshe thënë, apriori kanë karakter të njëjtë natyre; nuk e kanë formuar veten në bazë të projekteve njerëzore, nuk e kanë edukuar veten. Ata gjithnjë janë njerëz të natyrës, qind për qind në pajtueshmëri me natyrën, njerëz që janë të gjykuar nga vetë natyra e tyre e brendëshme. Çka ndodh me diturinë e njeriut. Shkenca dhe dituria janë llambë-kandil. Njëherit ai që është i gjykuar me natyrën e vet, thjerëzën e shkencës e ka në dorë. Në atë kuptim manifestohet dallimi në mes tij dhe shtazës, që rrethi i njohurive të shtazës për plotësimin e instinkteve të saj është i dobët, i përkufizuar në hapsirën dhe kohën e vet, ndërsa dituria njeriut i jep fuqi, ashtu që njohuria mbi të kaluarën e tij, parasheh ardhmërinë, del nga rrethi i vet dhe shkon dikund tjetër, madje del jashtë planetës së tij dhe udhëton në ndonjë planetë tjetër. Mirëpo, çështja e karakterit-natyrës dhe temperamentit është diçka tjetër, jashtë suazave të diturisë. Me fjalë tjera, dituria ka të bëjë me të mësuarit e njeriut, ndërsa karakteri dhe temperamenti kanë të bëjnë me edukimin njerëzor. Nëse dëshirojnë që njeriu të arrijë dituri, patjetër duhet ta mësojnë, kurse nëse dëshirojnë t'i dhurojnë

karakter specifik, patjetër ta formojnë në atë drejtim, të ndikojnë në shprehjet e tij dhe ta edukojnë atë. Ajo, përveç faktorit mësim, kërkon një sërë faktorësh tjerë. Në atë rast, faktori i të të mësuarit është faktor i edukimit, por është një faktor i patjetërsueshëm, e jo i mjaftueshëm.

Në ralitet, mendimi që shkencën e konsideron peshojë të njerëzisë, nuk mendoj se është aq i pranuar. Më vonë do t'i përmendi personat që kanë përkrahur këtë mendim. Por mendimi tjetër, që shqyrton këtë karakter dhe temperament, ka më tepër ithtarë. Këtu, po ashtu ekzistojnë disa mendime. Njëri prej tyre është që karakteri i cili është peshojë e mirësisë është dashuria, dashuria ndaj njerëzve. Nëna e të gjitha karaktereve është dashuria. Andaj, nëse dikush sipas karakterit është filantrop, njeri është. Don të thotë, mendon për jetën e tjetrit sikur për të veten, madje për fatin e tjetrit mendon më tepër se për fatin e tij. Sipas logjikës së fesë kjo quhet kurbanizim. Në një libër shkruante se një princip i cili ekziston në të gjitha fetë e botës është që të dëshirosh për tjetrin ata që dëshiron për vete e të mos ia dëshirosh tjetrit atë që nuk ia dëshiron vetvetes.<sup>35</sup> Logjika e këtillë është logjikë e dashurisë. Siç e dini, në hinduizëm si dhe në mësimet krishtere, fjala dashuri është shumë e theksuar. Shprehnie dashurinë tuaj në të gjitha sferat. Në përgjithësi, s'ekzistojnë çështje tjera pos dashurisë. Natyrisht, në këto mësimet ekziston një shtrembërim. Don të thotë, ata përmendin dashurinë, por dashuria për të cilën ata flasin është një lloj mjeti dehës. Mirë, edhe ai është një lloj mendimi, ne pastaj patjetër duhet të diskutojmë lidhur me këtë. A mjafton vetë dashuria si peshojë për njerëzishmërinë, apo jo? Kemi thënë se në lidhje me mendimin mbi karakterin dhe temperamentin, fjala e parë që është shqyrtuar mbi peshojën e njerëzishmë-

---

<sup>35</sup> Shtegu i elokuencës, letra 31.

risë, është filantropia. Njeriu me moral dhe etikë, ose njeri i ngritur-fisnik konsiderohet ai që është filantrop. Me një peshojë të tillë vështirë se mund të zgjidhen problemet tona.

Përse Aliun a.s. e konsiderojmë njeri të përkryer? Sepse ai i ka ndjerë vuajtjet e shoqërisë, sepse “unë”-in e vet e ka shndërruar në “ne”. Sepse ka qenë një person që i ka tërhequr të gjithë njerëzit. Nuk është veçuar nga të tjerët, vërtetë e ka konsideruar veten si një element, një gisht.

Kur sëmuret një nerv si një pjesë e trupit, trupi nuk do të ketë qetësi dhe do të ndjehet jo i rahatshëm. Edhe këto fjalë i takojnë atij. Aliu a.s. i ka thënë këto fjalë, përpara se t'i sjellë ato filozofia humaniste. Kur u njohtua se mëkëmbësi i tij, guvernatori të cilin ai e emëroi, kishte marrë pjesë në një gosti, i shkroi një letër të ashpër që ciolet në librin “Shtegu i elokuencës”. Po çfarë do të kishte qenë ajo gosti? A mos ky guvernator kishte marrë pjesë në gostinë, në sofrën e së cilës kanë servuar alkool? Jo. Aty, a kishte patur bixhos? Jo. A kishte patur aty valltare? Jo. Atëherë, përse e kritikoi dhe i dërgoi letër të ashpër? Ai thotë: “Kurrë s'kam menduar se do të pranosh gostinë e njerëzve që i përzënë lypsit e i ftojnë pasanikët”.<sup>36</sup> Aliu a.s. thotë: “S'besoj që guvernatori im të shkojë atje ku janë prezentë vetëm njerëzit e pasur”. Pastaj i tregon aty guvernatorit për vetveten dhe jetën e vet. Thotë për veten se më tepër ka ndier vuajtjen e popullit se sa vuajtjen e vet, dhe dhembja për popullin i shkaktoi të harrojë dhembjen e vet. Fjalët e Aliut a.s. tregojnë se ai ka qenë vërtetë njeri i urtë, shkencëtar dhe hakim. Por, Aliun a.s. nuk e çmojmë për shkak se ka qenë derë e diturisë së Pejgamberit a.s.<sup>37</sup> Atë e çmojmë më tepër se ka qenë njeri. I ka përvetësuar ato bazamente humaniteti në atë mënyrë që ka menduar për fatin

---

<sup>36</sup> Po aty, letra 45.

<sup>37</sup> Gajetul-Meram, kreu 29.

e njerëzve që kanë qenë të privuar nga të drejtat. Nuk ka ndenjur indiferent, ndjente vuajtjet e tjetrit. Ka patur edhe karakteristika tjera humaniteti.

Studimet tjera pohojnë se peshojë e njerëzisë është vullneti. Vullneti është faktori dominues i njeriut në lidhje me shpirtin e tij. Me fjalë tjera, peshojë e njerëzisë është të sunduarit e njeriut vetveten, shpirtin e vet, nervat e veta, instinktet dhe pasionet e veta, ashtu që secilën vepër që do ta bëjë njeriu duhet të jetë sipas logjikës dhe vullnetit, e jo sipas dëshirës. Ka dallim në mes dëshirës dhe vullnetit. Dëshira te njeriu është një lloj tërheqjeje, ka pikëpamje të jashtme. Don të thotë është një lidhje në mes njeriut dhe çështjeve të jashtme të cilat e tërheqin njeriun drejt vetes. Siç është rasti me njeriun e uritur i cili dëshiron ushqim, kjo dëshirë është tërheqje e cila e tërheq njeriun kah vetja. Ose për shembull, dëshira për marrëdhënie seksuale, është një tërheqje që e tërheq njeriun kah vetja. Kështu është, bile, edhe gjumi. Gjumi e tërheq njeriun kah vetja e ai shkon drejt gjendjes që quhet gjumë. Dëshira për post e tërheq njeriun kah vetja e të ngjashme.

Ndërsa vullneti më tepër ka aspektin e brendshëm. Është e kundërta e dëshirës, çliron njeriun nga tërhequrit e dëshirës. Pra e vëndon dëshirën nën kontrollin e njeriut. Do të veprojë ashtu sikur do vullneti e jo sikur do dëshira. Të ndjekësh vendosmërinë dhe logjikën është ndryshe nga ajo të ndjekësh dëshirën. Ky është një lloj dominimi mbi dëshirën. Nëse keni vënë re, shkencëtarët që merren me etikën, theks të veçantë i kanë vënë vullnetit. Kanë pohuar se vullneti është peshojë dhe masë për njerëzinë. Kafsha është një qenie që shkon pas fuqisë së instinktit që poashtu është dëshirë, por njeriu është një qenie që me anë të vullnetit dhe vendosmërisë mund të çlirohet nga fuqia e instinktit. Mund të

vendosë, të veprojë, dhe të sillet kundër dëshirave të tij. Atëherë, ky person është ai që sundon vetveten dhe për aq sa njeriu nuk e sundon vetveten po aq është larg humanitetit-njerëzisë. Edhe ky është një mendim. Edhe kjo është një peshojë e njerëzshmërisë-humanitetit. Do t'u flas edhe për një dy peshoja dhe me këtë do ta përfundoj diskutimin tim.

Peshojë e dytë për njerëzinë është liria. Ç'do të thotë kjo? Don të thotë se njeriu është njeri në atë masë sa nuk duron asnjë fuqi, nuk është i gjykuar dhe as i robëruar nga ana e asnjë fuqie, dhe vepron i lirë. E dini, sipas studimeve më të reja, gjithnjë e më tepër theksohet liria si peshojë e njerëzshmërisë-humanizmit. Pra, njeriu është njeri deri në atë masë sa mund të jetojë i lirë. Andaj liria është peshojë e njerëzisë. Çfarë mendimi është ky? A është ky mendim i qëlluar apo jo? Edhe ky mendim është sikur mendimi i mëparshëm, edhe është e qëlluar edhe nuk është. Don të thotë është e qëlluar si pjesë e njerëzshmërisë së njeriut, por si peshojë e vetme e njerëzisë, s'është e qëlluar. Sipas Islamit, në bazë të asaj që dashuria mes njerëzve është e stimuluar, dhe se edukimi e kontrolli mbi shpirtin është gjë e shenjtë, gjithashtu edhe liria është gjë e shenjtë.

Në Islam shumë është e theksuar të sunduarit e epshit të trupit. Do t'u rrëfej një ngjarje të shkurtër lidhur me këtë, të cilën mbase e keni dëgjuar më parë. E kanë parë Pejgamberin s.a.v.s. duke kaluar nëpër Medine. Një grup të rinjsh që provonin fuqinë e tyre, ashtu që e ngritnin një gurë të madh në mënyrë që të shohin se kush është më i fortë. Mirë, në këtë garë, si dhe në çdo garë duhet arbitër për shkak se dy persona bënin gara në peshëngritje. Kur kaloi Pejgamberi s.a.v.s. pranë atij vendi, rinia tha se nuk ka gjykatës më të mirë se Pejgamberi s.a.v.s. : “O i Dërguar i All-llahut! Qëndroni këtu e gjykoni se kush prej nesh e ngre më mirë peshën!”

Pejgamberi s.a.v.s. e pranoi. Ata filluan. Në fund Pejgamberi s.a.v.s. tha: “A dëshironi ta dini se cili prej jush është më i forti?” U përgjigjën: “Po, o i Dërguar i All-llahut!” U përgjigj se më i fuqishmi person prej të gjithëve është ai që nëse hidhërohet, s'lejon që ta sundojë hidhërimi, por ai e sundon hidhërimin dhe hidhërimi i tij nuk e çon në atë drejtim që All-llahu s'është i kënaqur. Ai që e kontrollon hidhërimin e tij, dhe kur diçka i pëlqen, ajo gjë e çon ku nuk ekziston kënaqësia e All-llahut, dhe ai që mund ta sundojë dëshirën e vet. Don të thotë se Pejgamberi s.a.v.s. menjëherë atë garë të fuqisë fizike e shndërroi në një garë shpirtërore dhe çështjen e fuqisë së muskujve e analizoi si fuqi vullneti. Ai tha se, natyrisht, ajo është një vepër, e kush i ka muskujt më të fortë, është burrë më i fortë, por burrëria nuk qëndron vetëm në muskuj. Muskujt janë vetëm një shenjë e saj. Bazë e burrërisë është fuqia e vullnetit. Mevlana Rumi, thotë:

“Ku është ai njeri që gjatë hidhërimit  
dhe gjatë pasionit sundon veten?  
E kërkoj atë njeri prej rrugë në rrugë”.

Ne Aliun a.s. e konsiderojmë luan të All-llahut, njeri të All-llahut ngase ai në dy fronte ka qenë më burri nga të gjithë. Në frontin e parë, në mejdanet shoqërore e luftarake, çdo hero e ka gjuajtur në tokë, madje edhe më tepër, në frontin e tij të brendshëm e ka sunduar veten. Vullneti i tij ka dominuar mbi çdo dëshirë, pasion e mendim. Sa fantastik është ky tregim që Mevlana e rrëfen në Methnevinë lidhur me burrërinë dhe fuqinë e vullnetit! Çfarë pamje e bukur dhe prekëse është ajo kur një djalosh njëzetekatër ose njëzetepesë vjeç (Aliu - sh.p.) e gjuajti në tokë armikun e tij shumë të fuqishëm dhe u ul mbi gjoksin e tij, në mënyrë që t'ia presë kokën. Ai e pshtynë Aliun a.s. në fytyrë. Natyrisht Aliu a.s. u shqetësua. U përmbajt për pak kohë. Shëtitet disa minuta

pastaj kthehet. Armiku i drejtohet: “Përse u largove?” Aliu a.s. u përgjigj: “Sepse sikur të të kisha mbytur në atë moment, atë do ta bëja nga hidhërimi im e jo nga kryerja e obligimit, jo në rrugë të qëllimit tim e as në rrugë të All-llahut”. Ja pra, njeriu mund ts sundojë veten, hidhërimin dhe dëshirën? Fjalën e kishim për lirinë. Islami është shumë i çuditshëm ashtu që në çdo lëmi e ka thënë fjalën e vet. Në “Shtegu i elokucencës” dhe në porosinë të cilën Aliu a.s. ia shkroi djalit të vet Hasanit a.s., qëndron: ”Ngrite veten dhe shpirtin tënd përmbi çdo vepër të ulët-poshtër. Mos bën vepra të poshtra, sepse shpirti yt është mbi ato. Nëse shpirtin tënd ia shet dëshirës-epshit, asgjë nuk do të fitosh. Atë që e paguan me krenarinë e me shpirtin tënd për hirë të një dëshire a pasioni, nuk ka zëvendësim”. Më pastaj shton: “Asnjë herë mos u bën rob i tjetrit, sepse All-llahu të ka krijuar të lirë”. Nuk dëshiron të thotë se All-llahu e ka krijuar të lirë pse është djali i tij. Që liria është peshojë e njerëzisë, është një mendim. Kështu është edhe te mësimet ekzistencialiste ku akcenti më i madh i është dhënë çështjes së lirisë, si peshojë e njerëzisë. Peshojë tjetër e njerëzisë është çështja e përgjegjësisë dhe e obligimeve, për të cilat, natyrisht, më së shumeti ka folur Kanti. Pastaj për këtë është insistuar edhe në kohën tonë. Thonë se njeriu është një person që ndien përgjegjësi përpara njerëzve të tjerë (kjo ndryshon nga dashuria, mos gaboni) ndien se mban përgjegjësi për bashkësinë e vet dhe që, madje, është përgjegjës për vetveten dhe për familjen e tij. Çështja e përgjegjësisë në kohën tonë mjaftë shumë është duke u përdorur, shumë vetë insistojnë në atë, por pyetja është se prej nga buron përgjegjësia. E këtillë, gjithashtu, është edhe liria. Nga mund t’i fitojmë ato? Si mundet që njeriu të arrijë ndjenjën e përgjegjësisë? Ç’ndodh kur një njeri ndjen përgjegjësi? Nga buron kjo ndjenjë a do të

mundeshte kjo të zgjidhej gojarisht? Për shembull, nëse një njeri thotë: “Jam përgjegjës,” a thua në vetëdijen e tij do të krijohet përgjegjësia? Cila fuqi krijon vetëdijen për përgjegjësi? Kjo është një temë interesante.

Po përmendi edhe një mësim tjetër. Ky mësim vëndon akcentin në bukurinë. Platoni e shpjegon etikën në bazë të bukurisë. Ai thotë se ajo që është e bukur, është njerëzore. Për shembull, të gjitha mësimet e duan drejtësinë. Njëri nga mësimet e don drejtësinë në bazë të dashurisë, tjetri e don atë në bazë të peshojave etike. I treti e don drejtësinë sepse ajo ndërlidh drejtësinë dhe lirinë. Është e mundshme që i katërti ta çmojë drejtësinë në bazë të përgjegjësisë. Platoni e shikon drejtësinë përmes syzave të drejtësisë. Ai thotë që drejtësia është e mirë, qoftë ajo drejtësi etike individuale, qoftë drejtësi shoqërore në bashkësi dhe se për atë shkak është mirë të bëhet çertifikatë baraspeshe e të krijojë bukuri. Shoqëri e bukur është vetëm ajo në të cilën ka drejtësi. Ajo ndjenjë për bukurinë që e posedon njeriu, bën që ai të jetë i drejtë.

Njeriu në qoftë se dëshiron të jetë njeri dhe të arrijë veti njerëzore, patjetër duhet ta forcojë në vete ndjenjën e bukurisë. Natyrisht, Platoni këtu më tepër mendon se bukuria njerëzore është bukuri shpirtërore.



## HIXHRETI DHE XHIHADI I

### (Shpërngulja dhe lufta për mbrojtjen e fesë)

Njëra nga temat të cilave Kur'ani u kushton rëndësi dhe e cila zë vend specifik në jurisprudencën islame, është çështja e shpërnguljes (hixhretit). Sipas mendimit të shumicës së muslimanëve, shpërngulja është një ngjarje historike e cila ka ndodhur në fillim të Islamit, atëherë kur Pejgamberi s.a.v.s., as'habët, (shokët) e vet u shpërngulën prej Meke në Medine dhe që njihet si fillim i historisë, që ka filluar me hixhretin dhe kjo, natyrisht është ngjarje e madhe në historinë islame dhe ka një vlerë të veçantë historike. Por, a thua hixhreti është vetëm një ngjarje historike?

Në Kur'an shumë herë përmendet hixhreti-shpërngulja dhe muhaxhirët vendohen në radhët e muxhahidëve, ndërsa muhaxhirllëku (shpërngulja) vëndohet krahas muxhahidllëkut (luftës për mbrojtjen e fesë). A janë këto disa dëshmi të një ndodhie specifike? Të një ndodhie, ecila ka të bëjë me të kaluarën. Edhe sot, në përgjithësi, pas asaj periudhe, hixhreti në Islam s'ka tjetër kuptim. Ose hixhreti është edhe si besim, edhe si xhihad? Ashtu sikur besimi dhe xhihadi që nuk i takojnë vetëm Islamit të hershëm, gjithashtu edhe hixhreti nuk ka të bëjë vetëm me Islamin e hershëm. Hixhreti që ka ngjarë në kohën e hershme të Islamit, është sikur xhihadi i kohës së hershme të Islamit, i cili është kuptim i një imperativi në Islam. Kjo është vetëm një çështje.

Aliu a.s. në "Shtegu i elokuencës" e ka shqyrtuar këtë çështje dhe në mënyrë të qartë thotë: "Hixhreti, sipas dekretit të tij, ka mbetur në gjendjen e tij të mëparshme, që don të

thotë se hixhreti nuk i takon një periudhe e as një vendi të caktuar”. Pejgamberi s.a.v.s. u shpërngul prej Meke në Medine. Në atë kohë hixhreti për Pejgamberin e All-llahut. ka qenë i patjrtërsueshëm, ndërsa ata të cilët e kanë përcjellë gjer në Medine quhen muhaxhirë. Pas asaj kohe hixhreti nuk ka domethënie dhe nuk është lëndë studimi.

Ç’do të thotë hixhret? Nëse dëshirojmë ta shpjegojmë hixhretin, atëherë si duhet ta bëjmë atë? Hixhret don të thotë shpërngulje, të lëshuarit e vendlindjes, të larguarit nga dashamirët dhe të lënit pas vetes gjithëçka. Pse? Për të shpëtuar besimin. E qartë është se një qëndrim i këtillë nuk është e mundur, sipas logjikës së Islamit, të përkufizohet në kohë e vend, por natyrisht ekzistojnë kushte. Hixhret don të thotë të largohesh nga vendlindja dhe jeta në të dhe të gjitha këto t’i lëshë për shkak të ruajtjes së besimit (imanit). Pra, nëse gjendemi në ato rrethana kur besimi ynë është në rrezik, kur besimi i bashkësisë sonë është në rrezik, kur Islami është në rrezik, atëherë jemi të detyruar që në mes qytetit e vendlindjes, në një anë, dhe imanit, në anën tjetër, të zgjedhim njërën. Ose të mbetemi në shtëpinë tonë e ta humbasim besimin (e ta zëvendësojmë atë më një besim tjetër) ose për hirë të ruajtjes së besimit ta lëshojmë shtëpinë tonë. Islami e përkrah zgjidhjen e dytë. Ekziston një ajet në Kur’an i cili nuk e pranon arsyen e një personi që i nënshtrohet presionit të rrethit, sikur që ngjanë te shumë njerëz të kësaj kohe. Tani çështja e presionit të rrethit është bërë arsye për shumë njerëz. (Nëse dikush pyet: -sh.p.) “Pse je i këtillë, zotëri?”, ose “Zonjë, pse del jashtë pa hixhab (veshje islame) dhe e zhveshur?” Ata përgjigjen: “I tillë është rrethi, ashtu e lyp vendi”. Tjetrin e pyesin: “Pse merr pjesë në tubimet që janë haram?” Të ulurit pranë tryezës ku shërbehet alkool, madje sikur edhe ushqim hallall të hashë, haram është. E pyesish se

pse merr pjesë nëpër këto gosti, përgjet se kushtet dhe situata e jetës janë të atilla: “Ç’ të bëjmë, rrethi është degjeneruar”. Pse fëmijët tuaj shikojnë filma të rrezikshëm?” Përgjigjet: “Paj, mirë! Kështu është rrethi, e s’mund t’i pengoj?” “Pse s’shikojnë ata në xhami?” Përgjigjen: “Mjedisi është i korruptuar”. Çështja e ndikimit të rrethit, për disa, është bërë arsye.

Sipas Islamit arsyeja e këtillë nuk është e pranuar. Se rrethi është i korruptuar, se nuk lejon rrethi, se në rrethin e këtillë nuk mund të bëjmë aktivitete më të mira, të gjitha këto arsye për Islamin nuk janë të pranuar.

Don të thotë, ne në radhë të parë e kemi për obligim që rrethin tonë ta bëjmë të përshtatshëm, por nëse gjendemi në një mes, të cilin nuk kemi mundësi të shndërrojmë në një mes islamik e të krijojmë atmosferë islame, dhe nëse vërejmë së në atë mes do ta humbasim besimin tonë, besimin e fëmijëve tonë, të grave tona dhe të gjeneratës së ardhshme, Islami thotë që nga ai mes duhet larguar. Të lëshuarit e vendit nuk nënkupton të largohesh nga njëri e të shkosh në tjetër qytet, apo prej një shteti të shkosh në tjetër shtet, por kjo mund të bëhet edhe në aspekt të lagjeve. Në të kaluarën qytetet kanë qenë më të vegjël, por qyteti i madh, siç është Teherani, ka shumë komuna (ka mundësi shpërnguljeje-sh.p).

Kur’ani thotë:

“Kur do t’ua marrin shpirtin atyre që kanë bërë gabim ndaj vetvetes, melekët do të pyesin: ”Ç’ u bë me ju?” - “Kemi qenë të shtypur në Tokë (botë)”- do të përgjigjen. “Po toka e All-llahut a nuk ishte e gjerë e të shpërnguleshit në të?”- do të thonë melekët, andaj vendqëndrimi i tyre do të jetë Xhehen-nemi, sa qëndrim i keq që është ai!”

“Ne kemi qenë do njerëz të hedhur në një skaj të botës, s’kemi mundur t’i afrohemi shkencës, s’kemi pasur dijetarë. Ku kemi ditur se ç’është Islami? Ç’është e Vërteta ? Askush

asgjë nuk na ka treguar. Kemi jetuar në një vend që kemi qenë larg gjithëçkafit. Rrethin e kemi pasur të prishur, nuk kemi pasur mjedis të përshtatshëm” A thua, vallë, melekët do t’i pranojnë arsyet e tyre e t’i marrin parasysht ato dhe t’u thonë se All-llahu nuk do t’i dënojë? A do t’u thuhet: “Pse mjedisi juaj ka qenë i degjeneruar, nuk jeni fajtorë ju?” Jo, atyre do t’u thuhet: “Po toka e All-llahut a nuk ishte e gjerë?” Mos ju kanë ngujuar në atë tokë të degjeneruar? A kudo në botë gjendja ka qenë kështu? Apo mos ka ekzistuar ndonjë vend në botë, në të cilin, po të ishit shpërngulur, qindpërqind do të ishit më të rahatshëm? Pse nuk vepruat kështu? A nuk ishte e gjerë toka e All-llahut. Nuk kishit mundësi të shpërnguleni - të bëni hixhret? Pse nuk shkuat në ndonjë mjedis, rreth tjetër?” Islami çështjen e shpërnguljes, prej një vendi në një vend tjetër, për hirë të ruajtjes së fesë, e konsideron si njërën nga çështjet elementare dhe kjo vlen për gjithnjë, nuk është zhdukur dhe nuk ka të bëjë vetëm me muhaxhirët e parë. Por Kur’ani, në këtë ajet, këtë çështje e ka shpjeguar në atë mënyrë sa që për disa njerëz të cilët besojnë në misticizmin ekstrem, ka krijuar një mosmarrëveshje në atë mënyrë që ajetin e kanë komentuar ndryshe. Ajeti pohon: “Secili person që del nga shtëpia e vet dhe niset drejtë All-llahut dhe pejgamberit...”

Thonë që, si për fillim, e vërtetë është se përmendet shtëpia e individit, por qëllimi është All-llahu dhe Pejgamberi s.a.v.s. dhe kjo ka të bëjë me zemrën e njeriut dhe me etikën-moralin e njeriut. Të udhëtosh kah All-llahu don të thotë të keshë lëvizje të zemrës e të shpirtit e të keshë rrugë, të kalosh sinqeritetin absolut e të ngrihesh kah pozita e afrimit ndaj All-llahut. Për t’u ngritur kah pozita e afrimit, nuk është e nevojshme që njeriu ta lëshojë shtëpinë. Njeriu mund të qëndrojë ulur mbi krevat dhe në të njejtën kohë ta pastrojë

shpirtin, ta sjellë veten gjer te sinqeriteti dhe t'i afrohet esencës hyjnore; të falet, të agjërojë, të lutet dhe të kryejë vepra që shkaktojnë afrimin ndaj All-llahut (xh.sh). Thuhet se pikësynim i kësaj lëvizje është All-llahu, hapërimi drejt All-llahut. Atëherë qëllimi i Kur'anit që thotë se secili që del nga shtëpia konsiderohet muhaxhir i All-llahut dhe Pejgamberit s.a.v.s. është një qëllim i lidhur me shtëpinë vetanake si shtëpi e shpirtit. Pra, secili që del nga egoizmi i vet, bën hixhret drejt All-llahut, e shpërblen atë All-llahu. Por ky konstatim është gabim dhe s'është i vërtetë. Kur'ani në këtë ajet i shpjegon të dy hixhretet. Çudi e shprehjes kur'anore është ajo që së pari e përmend shtëpinë në të cilën njeriu jeton. Kur'ani thotë: “O ti që dëshiron të shpërngulesh prej një shtëpie në tjetër...”, ti zotëri që don të shpërngulesh prej një qyteti në tjetrin, duke u arsyetuar se shpërngulesh për hirë të ruajtjes së besimit tënd, njëkohësisht duhet ta dijs se cili është qëllimi yt kur kalon prej një vendi në një vend tjetër. Nëse qëllimi yt nuk është All-llahu, atëherë sikur edhe ta shkelish gjithë rruzullin tokësor, ta lëshosh shtëpinë, bashkëshorten, fëmijët, nënën, babain, vëllanë dhe sikur të ecish këmbëzbathur, e gjithë kjo nuk vlen asgjë. Andaj Pejgamberi fisnik s.a.v.s. ka thënë: “E dua muhaxhirin, por të sinqertë. Nuk kërkuj që vetëm një grup njerëzish të vijnë në Medine nga Meka apo nga vendet e tjera, por dëshiroj që veprimi i tyre të bëhet për hirë të All-llahut”.

Xhiahadi islam është i njëjtë. Ai nuk është vetëm luftë kundër armikut të fesë, por është gjakim në rrugë të All-llahut dhe për hirë të kënaqësisë All-llahun (xh.sh.). Përndryshe ekziston mundësia që dikush të tregojë me tepër ashpërsi se sa ushtarët e tjerë e të ngrejë pluhur, por po t'i hapish zemrën, do të vërejsh në të dëshirën për famë e afirmim. Që fotografia dhe emri i tij të shihet në faqet e historisë: “Mbase nuk do të

vritemi, e nëse mbetemi gjallë, do të bëhemi heronj. Madje nëse bëhemi heronj, do të fitojmë shpërblime e para dhe do të martohemi me femra të bukura. Kështu do ta fitojmë edhe këtë edhe atë botë së bashku. Edhe kemi marrë pjesë në xhihad, në rrugë të All-llahut, po edhe do të kemi jetë me autoritet”. Jo, natyrisht. Do ta fitosh këtë botë, por me kusht që qëllimi yt të mos jetë ajo.

U pa se në betejën e Uhudit, njëri nga ensarët, don të thotë musliman i Medines, tregoi një trimëri të madhe në luftë dhe shumë armiq i gjuajti në tokë. Në momentin kur vetë ai ra në tokë, pati dhembje të mëdha dhe këto ishin çastet e fundit të tij. Disa erdhën te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i thanë: “O i Dërguar i All-llahut, ai njeri ka qenë shumë muxhahid dhe ushtar trim, sot ka qenë shumë aktiv”. Pejgamberi s.a.v.s. aspak nuk ua vuri veshin këtyre fjalëve. Ata edhe një herë e përsëritën të njëjtën fjali, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. përsëri nuk ua vuri veshin. Kjo ishte për t’u habitur. Pse Pejgamberi s.a.v.s. nuk i kushton rëndësi këtij luftëtari trim e të sakrifikuar? (Në momentet e fundit të jetës së këtij ushtari-sh.p.) Erdhi një musliman dhe i qëndroi mbi kokë duke i thënë: “Të lumtë, ti që luftove në rrugë të All-llahut, tani do të bëhesh shehid në rrugë të All-llahut. Ai u përgjigj: “Nuk i kuptoj këto fjalë, nuk e kuptoj vdekjen në rrugë të All-llahut. Pse po luftojnë në mes vete populli i Mekes dhe ai i Medines, në njërën anë medinasit, ndërsa në anën tjetër Mekasit. Paragjykimet atdhetare dhe patriotizmi më detyruan ta bëj atë. Këto që po i thua ti, unë nuk po i kuptoj. Atë e bëra në emër të nacionalizmit dhe patriotizmit”. Pastaj kur ndjeu dhembje, tha se nuk mund t’i duroj ato. Mezi lëvizi dhe majën e shpatës e vëndoi mbi zemër, e nguliti në zemër dhe me të bëri vetëvrasje. Mu tani e kuptuan muslimanët se pse Pejgamberi s.a.v.s. nuk i kushtoi rëndësi atij. Meqë xhihadi,

patjetër duhet të jetë në rrugë të All-llahut. Madje njeriu duhet të jetë edhe muhaxhir edhe gnostik. Islami i kërkon që të dyja këto së bashku.

Në suren “En-nisa”, ajeti 100, të dyja këto gjëra janë shprehur njëra pranë tjetrës: “Ai që shpërngulet për hirë të All-llahut, do të gjejë në Tokë shumë vend dhe liri, përkundër armiqve të tij. Kurse ai që lëshon vendlindjen e vet për hirë të All-llahut dhe të Pejgamberit të Tij...”, don të thotë, bën dy hixhrete përnjëherë: atë shpirtëror e trupor. Trupi i tij shpërngulet prej një qyteti në një tjetër, njëherit edhe shpirti i tij ngrihet prej shkallës së egoizmit gjer në shkallën e sinqeritetit. Në Kur’an thuhet se All-llahu do ta shpërblejë një muhaxhir të tillë. Komentin e këtij ajeti e kanë gjeneralizuar (mbase për këtë ekziston ndonjë hadith). Një gjeneralizim i këtillë është shumë i qëlluar, me vend dhe i vërtetë. Ky ajet përfshinë edhe një grup, e ata janë dashamirët e shkencës, të cilët shpërngulen prej një qyteti dhe vendi në qytet e vend tjetër. Pse? Për të mësuar shkencën islame e për të nxënë dituri. Cili është qëllimi i një mësimi të këtillë? Mos është kjo për të bërë emër? Jo. Po për hirë të famës? Jo. Për hirë respekti? Jo. Për të udhehequr të tjerët? Jo. Për t’ua puthur njerëzit dorën? Jo. Për hirë të pagesës? Jo. Qëllimi i tyre i vetëm është udhëzimi dhe këshillimi i popullit, madje forcimi i besimit të tyre dhe orientimi i popullit. Nëse gjenden njerëz të këtillë, e që ka shumë, ata janë muhaxhirë. Kështu janë këta të huaj, të cilët janë larguar nga qytetet dhe vendet e tyre për hire të nxënies së ditorisë, ndërkaq qëllimi i tyre me këtë nxënie të ditorisë është përmbushje e nevojave islame dhe të kënaqurit All-llahun (xh.sh.) Madje s’është e patjetërsueshme që ky njeri të shkojë për të mësuar për besimin islam, për komentet (kur’anore-sh.p.) dhe për dispozitat e tij. Dikush mund të zgjedhë ndonjë lëndë tjetër, dhe në përputhshmëri

me kuptimin e këtij ajeti, qëllimi i tij të jetë përmbushja e një nevoje islame. Për shembull, një person mund ta zgjedhë mjekësinë. Por, pse ta zgjedh këtë drejtim? Nga ndenja se bashkësisë islame i duhet një mjek musliman. Shkon ta studiojë mjekësinë, por jo pët t'u pasuruar, jo për të marrë titullin mjek, por vetëm se është një nevojë e doemosdoshme e botës islame e cila ka nevojë për shumë mjekë që do t'i përmbushnin nevojat e muslimanëve dhe për t'i shëruar pacientët e tyre. Personi i këtillë konsiderohet muhaxhir në rrugë të All-llahut dhe të Pejgamberit të tij. Nëse një person i këtillë vdes gjatë kohës së shpërnguljes - hixhretit të tij, ai konsiderohet një vëlla i ri shehid (dëshmor), sepse muhaxhiri është vëlla më i vogël i muxhahidit, ndërsa ky i fundit është vëllai më i madh i muhaxhirit.

Kur'ani thotë: "...Ai që lëshon vendlindjen për hirë të All-llahut dhe të Pejgamberit të Tij, dhe i arrin vdekja, shpërblimin nga All-llahu e ka të sigurt". Në disa vende tjera kemi thënë se muhaxhiri dhe muxhahidi gjithnjë janë bashkë. Tani, ai që është edhe muhaxhir edhe muxhahid, kush është ai? Për këtë flet ajeti i poshtëshënuar:

***"All-llahu ka blerë nga besimtarët shpirtërat dhe pasuritë e tyre me Xhennet - ata do të luftojnë për hirë të All-llahut, dhe do të vrasin e do të vriten. Ai këtë ua ka premtuar me siguri në Tevrat dhe Inxhil edhe në Kur'an. Pra, kush i plotëson premtimet e veta më mirë se All-llahu? Prandaj gëzohuni pazarit që e keni bërë me Të, dhe Ai është shumë i Madh". (9:111)***

Sipas kësaj logjike, Hasan ibën Aliu a.s. është edhe muhaxhir edhe muxhahid. Ai ka lëshuar vendlindjen e vet sikur Musa ibën Imrani a.s. Ky i fundit e ka lëshuar qytetin dhe vendlindjen, pra, Egjiptin dhe shkoi në Medjen, por ky ishte muhaxhir e jo dhe muxhahid.



Ibrahimi a.s. ka qenë muhaxhir, e lëshoi vendlindjen e tij, Babilonin. Husejn ibën Aliu ka një përparësi ngase ka qenë edhe muxhahid edhe muhaxhir. Muhaxhirët në kohën më të hershme të Islamit kanë qenë muhaxhirë. Por nuk u bënë muxhahidë, sepse ende nuk e kishin marrë urdhërin për xhihad. Kemi qenë muhaxhirë. Më vonë, kur erdhi urdhëri për xhihad, këta muhaxhirë u bënë muxhahidë. Por, ai që prej ditës së parë ka qenë muhaxhir dhe muxhahid, ka qenë hazreti Husein ibën Aliu a.s. Pejgamberi s.a.v.s., në ëndërr, i ka thënë imam Huseinit: “Huseini im i dashur, ekziston një shkallë e gradë të cilën ti nuk do ta arrijsh, përpos nëse ngjitesh shkallëve të shehidllëkut- martirizimit”. Husein ibën Aliu ka udhëtuar njëzetë apo njëzetetri ditë. Që prej asaj dite që është nisur nga Meka, don të thotë ditën e tetë të muajit dhil-hixhxe, ka udhëtuar gjer në atë ditë që ka arritur në Kerbela. Aty e kishte stacionin dhe vendin ku duhej të arrijë. Atë ditë që u nis nga Mekja, e mbajti hutben e tij të njohur. Aty i përmendi bashkë xhihadin dhe hixhretin: “O njerëz vdekja është hijeshia e (birit të Ademit) njeriut, ashtu sikur që është qaforja për një femër të re. Njeriu nuk guxon t’i frikësohet vdekjes. Xhihadi-martirizimi në rrugë të Allahut dhe në rrugë të besimit, për njeriun është kurorë nderi dhe për mashkullin është sikur një qafore e zburuese në qafën e një femre të re. O njerëz, tani, prej këtuhit, sikur po e shoh me sytë e mi se si ujçit e uritur e kanë sulmuar atë tokë dhe dëshirojnë të më copëtojnë. Ne, të Ehlul-bejtit, nuk jemi të kënaqur me vetveten, kënaqësi jona është atëherë kur All-llahu është i kënaqur. Atë që e don All-llahu, po ashtu edhe ne e duam. Nëse ai na dëshiron shëndet, edhe ne i dëshirojmë shëndet. Nëse ai dëshiron sëmundje, edhe ne dëshirojmë. Po të dëshirojë heshtjen, edhe ne do të dëshironim, e nëse e dëshiron të folurit, edhe ne e dëshirojmë. Po të dëshirojë

moslëvizjen, edhe ne e dëshirojmë, po të dëshirojë lëvizje, edhe ne e dëshirojmë atë”.

Në fjalinë e fundit ai e shpall shpërnguljen-hixhretin e vet. “Gjithkush që është krejtësisht i gatshëm t’i dhurojë zemrës së vet gjak, gjithëkush që është i gatshëm së bashku me mua ta këndojë të njëjtën këngë, dhe sikur unë, në këtë rrugë, dëshiron t’i dhurojë gjakun zemrës së vet, e dhuratën e këtyllë t’ia falë All-llahut, ai është i gatshëm për hixhret-shpërngulje, ndërsa unë do të nisem herët në mëngjes”.

Shumë vetë u nisën pas Husein ibën Aliut a.s. Në fillim disa ende mendonin se është e mundur që ta ketë tepruar në fjalimin e tij, e ndoshta kishte edhe gjëra të mira. Gjatë rrugës iu bashkangjiten edhe disa njerëz, por Husein ibën Aliu a.s. s’dëshironte ta ndiqnin pas të dobët. Imam Huseini në disa vende i rregullonte radhët e shoqëruesve të tij. Personat që s’ishin dinjitoz, u ndajtën. Mbetën ata që ishin të pastër dhe të sinqertë. Për personat që mbetën, Husein ibën Aliu a.s. nuk din për njerëz më të mirë e më të besueshëm se ata.

“Pra, o as’habë të mi! Nëse dikush më thotë të zgjedh në mes as’habëve të Bedrit, të Uhudit dhe të Sifinit, unë do t’u zgjidhja juve. Ju jeni kurora e të gjithë shëhidëve”. Në natën e ashurasë, më dhjetë të muajit muharrem, kur imam Huseini a.s. i la të gjithë, u tha: “E prisha betimin e marrur”. Armiku u premtoi se nuk do t’i prekë, nëse heqin dorë nga përkrahja e imam Huseinit a.s. Ata në të njëjtën kohë i thanë: “O zotëri ne kemi zgjedhur shëhidllëkun- martirizimin në rrugën tënde, pak është vetëm një jetë, mirë do të ishte të kishim nga një mijë jetëra dhe krejt t’i flijonim në rrugën tënde”. Personi i parë që i shprehu këto fjalë ishte vëllai i tij, Ebu el-Fadël Abbas. Sa shumë u gëzua zemra e imam Huseinit a.s. kur i pa as’habët se ishin të një mendimi, se ishin me besim të njëjtë, se pajtohen me atë dhe se janë ata që kanë

qëllim të njëjtë. Pastaj u mbajti një fjalim, ku tha: “Tani pasi kemi arritur gjer në këtë shkallë, do ta shpreh shkurtimisht ngjarjen e ditës së nesërme. Nesër nuk do të mbetet gjallë, madje, asnjëri prej jush”. Imam Huseini në ditën e ashurasë dha një shembull krenarie, shpërblimin që e regjistroi historia. Kjo ngjau në momentin e fundit. Të gjithë ranë shehidë. Nuk mbeti asnjë njeri, përpos imam Zejnul-Abidinit që ishte i sëmurë dhe ishte i shtrirë në tendë. Imam Huseini mbeti në një botë armiqësh. Mbeti i vetmuar në mejdan, shesh. Shikon e nuk sheh asnjë nga as'habët, përveç trupave të tyre të masakruar. Atëherë e tha këtë fjali: “Nuk shoh asnjë njeri të gjallë, përveç këtyre trupave të masakruara”.

Një poet thotë:

“Kanë mbetur në tokë njerëzit,  
zemrat e të cilëve kanë vdekur.

Pse, pra të shoqërohem me të vdekurit?”

Ata që janë në tokë ose që janë shtrirë në brendësinë e saj, të gjallë janë. Husein ibën Aliu a.s., në gjendjen kur lyp ndihmë, atë e lyp nga disa njerëz të gjallë. Kush do të ishin ata njerëz të gjallë? Ata janë mu ato trupa të masakruar. Ai thërret: “O vëlla i sinqert, o njerëz të besueshëm! Zgjohuni nga ky gjumë i rëndë, nisuni. Po a nuk e dini se këta njerëz të poshtër dhe të ndytë kanë ndër mend ta sulmojnë haremin e Pejgamberit s.a.v.s.? Fleni, fleni, keni të drejtë, keni të drejtë. E dij se trupat tuaj dhe kokat tuaja të ndritshme janë larguar”.

O Zot, na i ndriço zemrat tona me dritën e besimit! Na i njohto zemrat tona me të vërtetat e shenjta islame. Na mundëso t'i çmojmë begatitë e Kur'anit dhe mirëqenien e Pejgamberit s.a.v.s. dhe të as'habëve të tij. Na i përmirëso qëllimet tona. Fali dhe bekoji të vdekurit tanë!

## HIXHRETI DHE XHIHADI II

*“Ai që shpërngulet për hirë të All-llahut, do të gjejë në tokë shumë vendstrehime e liri” (4:100).*

Feja e shenjtë islame në aspektin e saj shoqëror bazohet në dy shtylla: në xhihad dhe hixhret. Kur’ani fisnik me një kujdes të veçantë dhe mirënjohje flet për këto tema, ndërkaq luftëtarëve në rrugën e All-llahut xh.sh. dhe të shpërngulurve-muhaxhirëve u shpreh nderim të jashtzakonshëm.

Hixhret do të thotë t’u shprehish të afërmëve dhe kësaj jete lamtumirën, ndarje, largim dhe shkuarje në një tokë ose vend ku ka liri besimi.

Në shumë ajete kuran’ore hasim në shprehje “ata të cilët luftojnë” dhe “ata të cilët shpërngulen”.

*“Ndërsa ata të cilët besojnë dhe shpërngulen edhe luftojnë për hirë të All-llahut, edhe ata që japin strehim dhe ndihmojnë-ata janë me siguri besimtarë të njëmendtë-për ata ka falje dhe shpërblime fisnike” (8:74).*

Në fillim të Islamit ekzistonin dy grupe muslimanësh: njërin e përbënin muhaxhirët, gjegjësisht të shpërngulurit, ndërsa tjetrin ensarët, don të thotë ndihmësit. Ensarët ishin banorët e Medines, e muhaxhirët ishin muslimanët e Mekes, të cilët për hirë të ruajtjes së fesë së vet lëshuan qytetin e lindjes dhe kërkuan strehim në Medine. Hixhreti, gjegjësisht shpërngulja si dhe xhihadi janë një nga shtyllat e Islamit dhe gjithnjë janë një princip aktual. Kjo don të thotë se gjithnjë ekziston mundësia të ngjajnë kushte e situata siç ishin më parë, në të cilat muslimanët ishin të obliguar të emigrojnë. Në mënyrë që të mënjanojmë disa gabime që mund disa herë të

paraqiten në të dy anët, do të flasim diç për hixhretin dhe xhihadin.

Ekzistojnë edhe disa shpjegime si dhe ndarje tjera të xhihadit, e ajo është që hixhreti shpjegohet si shpërngulje, gjegjësisht lënia e mëkateve. Sipas një shprehje muhaxhir është ai që shpërngulet, gjegjësisht ai që i shmang mëkatet. A është ky shpjegim i drejtë dhe i mjaftueshëm? Edhe ai që përlyhet me gabime dhe më vonë i mënjanon e shmanget nga ato, gjithashtu është një lloj muhaxhiri, sepse i ka ndërprerë gabimet. Të gjithë ata që janë penduar në pajtueshmëri me këtë gjykim, kanë qenë muhaxhirët. Me që e kanë lënë një fazë gabimesh, janë të ngjashëm me Fudejl ibën Ajaz dhe me Bushër Hafiun. Fudejli ka qenë i pari që është marrë me vjedhje. Pastaj ndryshoi, u penduar sinqerisht dhe i mënjanoi të gjitha gabimet që i kishte bërë dhe u bë njeri i madh. Njeriu që më parë ishte hajdut dhe prej të cilit druanin njerëzit tjerë, jo vetëm që u bë i devotshëm dhe i dhënë pas fesë, por u bë edhe mesues dhe pedagog. Kur një natë u përgatit ta këcej një mur, iu ngulit shikimi në një njeri të devotshëm i cili tërë natën nuk kishte fjetur duke u falur, duke lexuar Kur'an e duke u lutur, i erdhi rasti ta lexojë këtë ajet: "A sështë koha që zemrat e atyre, kur u përmendet All-llahu dhe e Vërteta që u shpallet, të zbuten...", gjegjësisht, deri kur më padëgjueshmëri, mohim me zemërngurtësi dhe ikje nga besimi në Zotin? Po a nuk është momenti për lëvizje dhe kthim kah All-llahu? Po a nuk është momenti për mënjanimin e gabimeve?

Kur njeriu i cili qëndronte afër murit i dëgjoi këto fjalë, sikur t'i ishin shpallur drejtpërdrejtë atij, sikur t'i ishin drejtuar atij, thirri: "O Zot! Koha është, me të vërtetë erdhi ai moment!" Zbriti nga muri dhe më vonë i mënjanoi të gjitha veprat e këqia: vjedhjen, pijet alkolike dhe bixhozin. U largua

nga të gjitha ato vepra, të gjitha ato që i kishte fituar në atë mënyrë, ua ktheu pronarëve, u lirua nga borxhet. Pra, edhe ai është muhaxhir, sepse i lëshoi, mënjanoi mëkatet.

Kështu, përafërsisht thuhet dhe për xhihadin. Muxhahid është ai që lufton kundër pasioneve të veta. Muxhahid është ai që në luftën e brendshme, e cila vazhdimisht ekziston te çdo qenie njerëzore (në njërin anë është egoja kurse në tjetrën logjika), lufton kundër të këqiave, natyrës sensuale dhe pasioneve. Imam Aliu a.s. thotë: “Më guximtari është ai që i sundon epshet e veta”. Në të fshihet esenca e guximit. Ekziston një tregim për pehlivan Purjai Valinë, heroin dhe kampionin që pehlivanët - mundësit e tjerë e konsideronin simbol i fisnikërisë, heroizmit dhe gnostik të vërtetë. Transmetohet se një herë shkoi në një vend tjetër ku do të duhej që një ditë ta masë fuqinë me ushtarët tjerë. Në mbrëmje e takoi një plakë e cila ndante hallvë dhe kërkonte prej njerëzve të bëjnë lutje për të. Plaka nuk e njihte Purjai Valinë, andaj iu afrua, i dha pak hallvë e i tha: “Kam një nevojë, bëje një lutje për mua”. “Çfarë nevojë ke? - pyeti - Purjai. “Djalin e kam kampion, kurse nesër do të garojë me kampionët e një vendi tjetër. Gjithë këtë që e posedon e ka fituar nga garat, e nëse tani dështon, do të kemi një jetë të mjerueshme, do ta humb autoritetin, ndërsa unë plaka do të shkatërrohem”. Pirjai Vali tha: “Jij e sigut se do të lutem për ty”. Kur mbeti vetë, mendoi: “Ç’ të bëj nesër? Po të jem më i fuqishëm se ai, ata munda apo jo?” Dhe erdhi në përfundim se kampion është ai që i mund epshet e veta. Kur ditën e paraparë dolën në mejdan - shesh, e vërejti se forca është në anën e tij dhe se, menjëherë, mund ta gjuajë në shpinë e ta fitonte. Duke mos dashur që kjo të vërehej, një kohë vazhdoi të ngatërohej me të, dhe i lejoi kundërshtarit ta fitojë, e rrëzoi dhe iu ulë në gjoks. Transmetohet se në atë moment ndjeu sikur All-llahu i

Lartëmadhërishtëm ia hapi zemrën dhe ia mundësoi që me të ta shohë botën e melekëve. Pse? Sepse, bile, për një moment arriti ta sundojë egon e vet. Më vonë ai u bë njëri nga dashamirët e All-llahut, don të thotë velijjull-llah. Pse? Sepse muxhahid është edhe ai që lufton kundër vetvetes dhe se hero është ai që i mposhtë epsheet e veta, ndërkaq, si thotë Pejgamberi s.a.v.s se nuk është fuqishëm ai që ngre barën, por ai që i mund epsheet e veta.

Shpjegimi tjetër për hixhretin është lëshimi i qytetit në të cilin është përhapur mëkati. Ndërkaq tjetri koment për xhihadin është lufta kundër epsheve. A thua, vallë, ky është shpjegim i drejtë? Në një farë mënyre po, por kjo është komentuar në mënyrë të gabuar. Fjalinë se muhaxhir është ai që i lë mëkatet, ndërsa muxhahid është ai që lufton kundër epsheve të veta, e kanë thënë juristët e fesë. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Xhihad i madh është lufta kundër epsheve”. Ajo që është shtrembëruar dhe që gabimisht është komentuar është që disa, duke u mbrojtur me atë se hixhreti paraqet lënien e gabimeve, ndërsa xhihadi, kryekëputë, luftën kundër epsheve e nxitjeve të brendëshme, e hudhën posht hixhretin fizik, gjegjësisht shpërnguljen me plotëkuptim të fjalës dhe hoqën dorë nga xhihadi i vërtetë, ose luftës fizike kundër armikut, duke thënë: Në vend që ta lëshojmë shtëpinë, familjen dhe të afërmit, vendin dhe mjedisin e të bëhem refugjatë në një mjedis tjetër, ne do të mbetemi nëpër shtëpitë tona dhe do t’i lëmë mëkatet, ashtu që edhe në këtë mënyrë do të bëhemi muhaxhirë.

Të tjerët thonë: Në vend të mundimit në rrugë të All-llahut, në luftë kundër armiqtë të fesë, do të qëndrojmë nëpër shtëpitë tona dhe do t’i kushtohemi energjisë shpirtërore dhe ta çrrënjoshim nxitjet e brendëshme, kështu bile mund të jemi edhe më të mirë se ata tjerët!

Hixhreti në kuptim të mënjanimimit të mëkateve, gabimeve dhe xhihadi si luftë kunder egos, nuk mund të jetë arsye për refuzimin e hixhretit fizik dhe xhihadit fizik.

Në Islam ekzistojnë dy lloj hixhretesh, e jo vetëm një, po ashtu edhe dy lloj xhihadesh. Sa herë që përmbajmë njërin dhe hedhim tjetrin, kemi shtrembëruar mësimet islame.

Juristët e fesë tonë, Pejgamberi fisnik s.a.v.s., Aliu dhe imamët kanë qenë muhaxhirë në të dyja mënyrët - edhe si shpërngulës për hirë të fesë edhe si ata që i kanë mënjeluar mëkatet. Pastaj kanë qenë muxhahidë - edhe si luftëtarë në fushëbetejë edhe kundër epsheve dhe nxitjeve të brendshme. Edhe në pikëpamje shpirtërore kjo është një shkallë që nuk mund të tejkalohet përveç se në atë mënyrë. Nuk mund të arrijë shkallën e muxhahidit një person që nuk ka marrë pjesë në ndonjë luftë të vërtetë, ashtu sikur që nuk mund ta arrijë shkallën e muhaxhirit ai që nuk është shpërngulur fizikisht.

E këtillë, pra, është psikologjia e njeriut, don të thotë ekzistojnë faktorë të caktuar, dhe nëse njeriu nuk i kalon shkallët e tyre, ai nuk mund të arrijë atë përvojë të cilën duhet ta ketë. Për shembull, sipas Islamit, kurorëzimi në shumë aspekte paraqet një gjë të shenjtë. Pse është kështu? Njëri nga shkaqet është edukimi i shpirtit të njeriut. Ekziston një lloj i veçantë përvojë dhe gjendje të përsosmërisë së shpirtit njerëzor të cilën mund ta hasim vetëm në kurorë.

Kjo don të thotë: nëse një femër ose një mashkull mbeten gjer në fund të jetës të pamartuar, në shpirtin e njeriut të tillë ndjehet një lloj papjekurie, edhe pse ai tërë jetën bën ibadet, kallogjerizohet, agjëron dhe lufton kundër dëshirave trupore. Arsyeja e këtyre papjekurive është se njeriu i tillë, mashkull ose femër qoftë, nuk janë në kurorë. Prandaj Islami konsideron se martesë është traditë (sunnet) , ndërkaq njëri nga aspektet e martesës është ndikimi i saj në edukimin dhe



pjekurinë e shpirtit të njeriut. Mbase disa pohojnë që nëse nuk jemi të martuar, nuk jemi as vetë; kjo nuk është e vërtetë, sepse martesë don të thotë zgjedhje e bashkëshortit, të mbash përgjegjësi ndaj shokut të kurorës, ndërsa më vonë ndaj fëmijëve. Kjo është ajo që e përsos shpirtin e njeriut dhe asgjë nuk mund ta zëvendësojë. Çdo faktor që ndikon në edukimin e njeriut, vepron vetëm për vete dhe faktori tjetër s'mund të veprojë në vend të tij. Hixhreti dhe xihadi, po ashtu, janë faktorë që nuk mund të zëvendësohen me faktorë tjerë. Lufta kundër nefsit, gjegjësisht epshit, vlen për vete sikur edhe largimi nga mëkatet. Megjithatë, hixhreti praktik (largimi nga venbanimi) s'mund të zëvendësohet me largimin nga mëkatet, ndërkaq xihadi (lufta) me armikun nuk mund të zëvendësohet me xihadin kundër nefsit dhe anasjelltas, xihadi me armikun nuk mund të zëvendësohet me zhihadin e nefsit. Islami i vëndon njërin pranë tjetrit.

Meqë të gjitha kushtet nuk janë të volitshme për xihad e për hixhret, atëherë cilat janë obligimet dhe detyrat e njerëzve në rrethana të ndryshme? Pejgamberi s.a.v.s. ka caktuar obligime për njerëzit dhe ka thënë: “Obligim i një muslimanit është që gjithnjë të ketë qëllim e qëndrim serioz dhe të sinqert që nëse e lyp nevoja, ta lëshojë venbanimin (të bëjë hixhret) e nëse e lyp nevoja të luftojë (të bëjë xihad)”.

Kur të vdesë ai që nuk ka bërë xihad ose nuk ka menduar për të, vdes si një lloj munafiku (hipokriti). Ata njerëz, qëllimi i të cilëve, në rast nevoje, është të shkojnë në xihad ose të shpërngulen nga vendbanimi, mund të arrijnë statusin e muhaxhirëve dhe muxhahidëve të vërtetë.

Kur’ani thotë:

***“Besimtarët, të cilët nuk luftojnë - përveç atyre që janë të paafitë për luftë - nuk janë të barabartë me ata që luftojnë në rrugë të All-llahut me pasurinë dhe jetën e vet.***

*Ata që luftojnë, te All-llahu janë një shkallë më lart. All-llahu të gjithëve u ka premtuar mirësi. All-llahu do t'u japë luftëtarëve, jo atyre që s'luftojnë,shpërblim të madh". (4:95)*

Muslimanët që luftojnë në rrugë të All-llahut xh.sh. me pasurinë dhe jetën e vet, assesi nuk janë të barabartë me ata muslimanë të cilët qëndrojnë në shtëpi (bëhet fjalë për muslimanët e mirë) vetëm nga shkak se ka kush të luftojë. Kur'ani nuk mohon ata të cilët, për shkaqe shëndetësore dhe pleqërie, nuk kanë mundësi të shkojnë në xhihad në rrugë të All-llahut. Kur'ani konstaton se njerëzit e këtillë janë në nivel të muxhahidit në rrugë të All-llahut.

Kur hazreti Aliu u kthye nga beteja e Sifinit, dikush i tha: "O udhëheqës i besimtarëve, kisha patur dëshirë që vëllai im, filani e fallani, të ishte prezent e të shihte se si All-llahu të ka bërë ngadhënjimtar kundër armikut". Hazreti Aliu a.s. pyeti: "A është dashuria e vëllait tënd në anën tonë?" Njeriu u përgjigj: "Po". Udhëheqësi i besimtarëve tha: "Atëherë, ai është prezent. Aq më tepër, në ushtrinë tonë janë prezent, edhe ata që ende janë në boshtin kurizor të mashkullit dhe në anin e gruas (të palindurit -sh.p.) Shkurtimisht, koha do t'i nxjerrë në shesh dhe feja , me ndihmën e tyre do të forcohet".

Ç'do të thotë të presish "paraqitjen" (ardhjen e imam Mehdiut a.s.) ? Çfarë kuptimi ka hadithi që thotë se "vepra më e mirë është pritja e dhuhurit?"<sup>38</sup> Disa mendojnë se ky hadith don të thotë se duhet të presim që të paraqitet imam Mehdiu a.s. me shokët e tij të veçantë dhe me përcjellësit etij (313 veta) se dhe me përcjellësit e tjerë, e të zhdukë armikun e Islamit nga faqja e dheut e të sjellë një rahati e siguri, kurse më pastaj të na thotë: "Urdhëroni!" Ne jemi duke pritur një paraqitje të këtillë dhe pohojmë se është puna më e mirë! S'është e vërtetë, pritje don të thotë pritje ku do të qëndrojmë

<sup>38</sup> Sefinetul-behar, vëll. 2, f. 697.

me imamin krah për krah dhe të luftojmë pranë tij dhe eventualisht mund të bëhemi shehidë. Kjo don të thotë se është një dëshirë e sinqert të bëhemi muxhahidë në rrugë të Madhëriplotit. Nuk don të thotë kjo: “Shko ti e kryej punët, e kur të kryhen ato dhe të vijë koha e shfrytëzimit dhe kënaqësisë, atëherë do të vij edhe unë!” Kjo do t’i ngjante popullit të Musait a.s.për të cilët, shokët dhe ithtarët e Muhammedit s.a.v.s., kanë thënë: “O i Dërguar i All-llahut, ne jemi sikur populli i Musait a.s., të cilët kur arritën afër Palestinës, ku ishin Amlikët, panë se aty ka luftëtarë, i thanë Musait a.s.:

***“O Musa - thanë ata - deri sa të jenë ata në atë vend, ne kurrë s’do të hyjmë aty! Shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni, ne do të qëndrojmë këtu!”*** (5:24)

Kjo don të thotë: O Musa! Ne të rrijmë këtu, ndërsa ti dhe Zoti shkoni luftoni, pastroni atë vend nga armiku dhe pastroni shtëpitë. Kur do të marrim vesh se atje nuk ka rrezik dhe se mund lirisht të vimë dhe të kënaqemi me të mirat, atëherë edhe ne do të vijmë! Musai u tha: “Po ju çka dë të bëni? Ju, gjithashtu e keni obligim ta dëboni armikun që ua ka konfiskuar shtëpitë tuaja”.

Disa shokë të Muhammedit s.a.v.s. sikur Midadi, thanë: “O i Dërguar i All-llahut! Ne nuk do të themi ashtu sikur që thanë bijt e Israilit, ne themi: O i Dërguar i All-llahut, po të na thoni të hedhemi në det, do ta bënim atë, ose po të thoni të hidhemi në zjarr, do të hidheshim”.

Pritja e imam Mehdiut a.s. nënkupton qëllimin të jemi pranë tij dhe se bashku me të ta rregullojmë botën.

### HIXHRETI DHE XHIHADI III

Gjer më tani kemi diskutuar për dy parime të hixhretit dhe xhihadit që ekzistojnë në Islam dhe për të cilat shpesh herë së bashku përmenden në Kur'an. Në vazhdim do të plotësojmë diskutimet e mëparshme dhe do të bisedojmë për kuptimin e këtyre dy principeve dhe për edukimin e përsosjen e shpirtit të njeriut dhe, eventualisht, për aspektin shoqëror.

Më parë kemi shpjeguar kuptimin e veçant të xhihadit dhe hixhretit në një mënyrë më të përgjithëshme e pastaj edhe realitetin lidhur me të.

Po të dëshirojmë ta analizojmë hixhreti në aspektin shpirtëror, qoftë në aspektin material apo në atë shpirtëror, do të shohim se hixhret don të thotë ndarje e largim nga ajo që është e lidhur ngusht me njeriun ose anasjelltas: njeriu është i lidhur ngusht me të. Xhihad don të thotë përleshje e luftë, qoftë me armikun apo me dëshirat vetanake.

Pa hixhret e xhihad nuk mbetet për njeriun asgjë tjetër pos nënçmimit dhe robërisë. Kjo don të thotë se njeriu është njeri vetëm atëherë kur nuk është i nënçmuar nga ajo që e rrethon ose nga që ka të bëjë me të. Përndryshe, nëse njeriu është i përbuzur nga rrethi material apo ai shpirtëror ku ai jeton, nuk është njeri i lirë me plotë kuptim të fjalës. Njeriu i tillë është i robëruar e i pashpresë.

Po ta analizojmë aspektin e jashtëm të hixhretit, parashtrahet pyetja se a do të ishte më mirë për njeriun të udhëtojë apo të mbetet në një vend. (Natyrisht këtu nuk mendojmë se njeriu vazhdimisht duhet të ecë dhe kurrë të mos qëndrojë në një vend e të mos ketë shtëpinë e vet). A është më mirë për njeriun të jetojë përherë në një shtëpi e të mos udhëtojë apo të

udhëtojë është më e dobishme për njeriun dhe se ai është një lloj hixhreti?

Në Islam, kryesisht, preferohet udhëtimi, me atë që kjo nuk don të thotë se dikush duhet gjithnjë të udhëtojë e të shpërngulet prej një vendi në një vend tjetër. Megjithatë, të jetuarit vazhdimisht në një fshat, qytet ose shtet e mosdalja nga ai rreth i vendbanimit, dobëson e zbeh shpirtin e njeriut.

Shumë është e dobishme dhe efikase nëse njeriu arrinë të udhëtojë dhe të shohë gjithë atë që nuk ka arritur ta shohë në vendlindjen e vet, veçanërisht duke shfrytëzuar njohuritë shkencore që i ka fituar duke qëndruar në vendbanimin e vet (sepse nëse njeriu udhëton pa patur njohuri, ai udhëtim nuk do të ketë asnjë efekt) e pastaj të kthehet në shtëpinë e vet. Asnjë faktor tjetër, madje as leximi i librave s'mund të ketë ndikim në shpirtin e njeriut dhe në pjekurinë e tij, poqese udhëtimi dhe largimi nga shtëpia ndikojnë në të.

Nëse njeriu, për shembull, nuk udhëton në ndonjë shtet islam dhe thotë se në vend të saj do të lexojë libra, ai nuk mund të arrijë rezultat adekuat. Pa dyshim se leximi i librave është shumë i dobishëm, por leximi kurrë nuk mund ta zëvendësojë udhëtimin që don të thotë ndryshim i klimës dhe mjedisit si dhe vëzhgim e shikim i drejtëpërdrejtë i mjedisit. Në Kur'an ka ajete të cilët i urdhërojnë njerëzit për udhëtim:

***“Thuaj: “udhëtoni nëpër tokë...” (27: 69)***

***“Pse nuk udhëtojnë nëpër tokë...” (30:9)***

Të gjithë komentatorët e Kur'anit janë të një mendimi lidhur me atë se këtu është fjala për studimin e historisë. Megjithatë, Kur'ani për studimin e historisë nuk preferon librat historik, por fton në studimin e monumenteve dhe thesarit historik, sepse kjo është më meritore se sa leximi i librave historik. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë udhëtimin.

Ka një strofë në përmbledhjen e poezive të cilat i përshkruhen hazreti Aliut a.s:

“Udhëto, e qëllim ta keshë arritjen e më të mirës dhe përsosmërisë, udhëto sepse në udhëtim fshihen pesë dobi:

1. Çlirimi nga brengat dhe mërzitë. Udhëtimi pakëson apo mënjanon dëshprimet, brengat dhe mërzitë. Njeriu jeton në një rreth ku ka kujtime dhe ato gjithnjë asocojnë në dëshprim, brengë dhe probleme. Udhëtim, natyrisht, don të thotë të braktisësh vendqëndrimin dhe lënien pas vetes të brengave e problemeve. Andaj dobia e parë është ajo që njeriu çlirohet nga brengat dhe problemet dhe kështu shpirti i tij, bile një kohë më së paku, do të jetë i liruar nga bara e brengës.

2. Të fituarit e pasurisë - Nëse jeni intelektual, mund të fitoni pasuri duke udhëtuar. Njeriu nuk guxon të jetë i përkufizuar, në aspekt të fitimit të pasurisë, vetëm me atë që në suaza të rrethit të vet. Ndoshta njeriu, në bazë të aftësive që ka, mund të jetë shumë i suksesshëm nëse e braktis mjedisin dhe mund t'i sigurojë vetes jetë më të mirë.

3. Të arriturit e diturisë. Secili shkencëtar për vete është botë e veçantë. Mbase në rrethin tuaj mund të ketë ndonjë shkencëtar kulmor, por secila lule e ka aromën e vet të veçantë. Shkencëtari që jeton në një rreth tjetër, mbase në ndonjë aspekt nuk është sikur shkencëtari i mjedisit tuaj, por ai për vetveten është botë e veçantë. Kur të njiheni me botën e tij që dallon nga e juaja, do të njiheni me shkencën e re dhe do të përfitoni njohuri të reja.

4. Njohtim me tradita të tjera. Njerëzit në qytetin apo shtetin e vet nuk i njohin të gjitha traditat. Po të udhëtoni në ndonjë vend tjetër, do të njohoheni me tradita të tjera prej të cilave disa janë më të mira se tuajat, njëherit do të njiheni edhe me mënyrat e të sjellurit. Ashtu që përmes traditave që

janë shumë të mira, mund të merrni mësim, ndërsa më së paku, mund t'i krahasoni ato tradita më tuajat dhe kështu të zgjidhni atë që është më e mirë.

5. Shoqërim dhe biseda. Gjatë udhëtimit do të keni mundësi të njiheni e të shoqëroheni me njerëz të mëdhenj. Një shoqërim i tillë do t'ua përsos shpirtin tuaj.

Natyrisht, udhëtim nuk do të thotë të shikojmë ku janë hotelet më të shtrenjtë, ku mund të hamë ushqim më të mirë ose ku mund të gjejmë dëfrim më të mirë, por ajo don të thotë që të udhëtojmë e të braktisim rrethin dhe shtëpinë në mënyrë që të arrijmë shkencë e njohuri më të mirë dhe që të përsosemi.

Historia tregon se shkencëtarët dhe të mëdhenjt të cilët kanë udhëtuar dhe atë, veçanërisht, në vitet e pjekurisë, kanë arritur pjekuri dhe përsosmëri të veçantë. Shejh Behai zë një vend meritor në mesin e dijetarëve, sepse ka qenë njeri i gjithanshëm dhe ka qenë i udhëzuar në shumë disciplina shkencore dhe teknike të kësaj kohe. Prej poetëve, aty është Saadiu që është një poet i gjithanshëm dhe që ka shkruar poezi në të gjitha stilet e mundshme.

Saadiu është një njeri i cili tridhjetë vjet të jetës së vet i ka kaluar duke udhëtuar. Ka jetuar nëntëdhjetë vjet. Saadiu tridhjetë vjetët e jetës së vet ia kushtoi studimit, tridhjetë vjet ka udhëtuar, ndërsa tridhjetë vjetët e fundit që janë periudha e pjekurisë së tij, është marrë me shkrime. Andaj Saadiu ka qenë njeri i pjekur. Në librin e tij "Bostani", thotë:

"I kam shëtitur të gjitha viset e botës, dhe kohën time e kam kaluar me çdo kend. Nga secili vend kam mësuar diçka dhe nga secili burim kam përfituar diçka".

S'ka dyshim se shpirti i poetit përsoset me këto njohuri. Andaj në poezinë e Saadiut vërehet një lloj gjithanshmërie, por kjo s'vlen për poezinë e Hafidhit. Gjithanshmëria vërehet

edhe në poezinë e Mevlanës ngase ai shumë ka udhëtuar, është shoqëruar me lloj-lloj popujsh, ka njohur shumë gjuhë, ka përdorur lloj-lloj fjalësh e ka njohur shumë lloj kulturash. Por, Hafidhi ka qenë njeri i njëanshëm dhe njëdimensional, edhe pse është një gnostik i mirë që shumë e respektojmë. Poezia e Hafidhit është e jashtëzakonshme nga aspekti i gnosticizmit, por posedon vetëm atë dimension, kjo nga shkakun se Hafidhi nuk deshti ta braktisë qytetin e vet Shiraz. Ai thotë:

“Edhe pse Isfahani është uji i gjallërisë,  
Shirazi ynë është më i mirë se Isfahani”.

Hafidhi ka qenë i lidhur ngusht me qytetin e vet dhe nuk ka dashur ta braktisë atë. Thuhet se një herë ka udhëtuar dhe ka ardhur në Jazda, po aq shumë ka qenë i shqetësuar sa që vazhdimisht dëshironte të kthehet në Shiraz:

“Ditë e lumtur do të jetë ajo  
kur do ta braktis këtë shtëpi të rrënuar,  
e të kërkoj liri për shpirtin tim  
duke hulumtuar të dashurën,  
frikësohem nga ky burg i Iskenderit  
të palohem e të shkoj në tokën e Sulejmanit”.

Ky varg, edhe pse ka përmbajtje gnostike, njëkohësisht prezenton gjendjen e tij. Në shpjegimin e vargut të dytë duhet të theksojmë se tregohet historikisht që Aleksandri - Leka i Madh kur erdhi në Iran, qytetin Jazd e shndërroi në qytet burgu, don të thotë - çdo i burgosur dërgohej në Jazd. Në anën tjetër, në kohët e lashta Shirazin e kanë quajtur edhe Persepolis dhe toka e Sulejmanit.

Po ta analizojmë kuptimin gnostik të kësaj poezie, do të shohim se burgu i Iskenderit don të thotë trup, bota e natyrës dhe e materies, ndërsa me fjalën toka e Sulejmanit mendohet



në botën shpirtërore. Megjithatë, kjo poezi flet edhe për dëshirën e Hafidhit që sa më shpejt të kthehet në Shiraz.

Me siguri shejh Behai, i cili e ka shëtitur gjithë botën, dallohet nga ai dijetar i cili tërë jetën e kaloi në një vend. Kjo vlen për të gjithë dijetarët. Gjatë historisë vërejmë se ata dijetarë që kanë udhëtuar dhe që kanë pasur kontakte me njerëz të ndryshëm dhe që kanë mësuar te profesorë të ndryshëm, posedojnë ide dhe botëkuptime të gjithanshme në krahasim me ata dijetarë të cilët kanë pasur nivel të njejtë të diturisë dhe besimit, por gjithë jetën e kanë kaluar në një vend. Me siguri pjekuria e shpirtit të këtyre të fundit nuk mund të jetë sikur e atyre që kanë udhëtuar.

Siç theksuam, nëpër hadithe qëndron edhe komenti shpirtëror lidhur me hixhretin: “Muhaxhir është ai që braktis të keqen”. Natyrisht, kjo nuk don të thotë se mohohet shpërgulja fizike, ky është argumentim i hixhretit në nivelin shpirtëror. Kjo don të thotë se hixhret islam nuk don të thotë vetëm braktisje e shtëpisë dhe vendit, sepse siç thamë, njeriu s'duhet të bëhet rob i vetive dhe karakteristikave shpirtërore për të cilat është i lidhur ngusht, ose i faktorëve tjerë shpirtëror të rrethit ku ai jeton. Ky hixhret është një lloj lirie dhe mohim i robërisë: gjithashtu njeriu nuk bën të bëhet rob i shprehive dhe vetive shoqërore të cilat i ka pranuar, as rob i rrethit shpirtëror në të cilin jeton po as edhe i shpirtit të vet.

Njeriu adaptohet në disa gjëra të caktuara. Një traditë shoqërore për të bëhet princip dhe paraqitet tek ai si shprehi shpirtërore dhe fizike. Shprehia fizike është sikur shprehia e pirjes duhan. Shumë duhanxhinj të dhënë pas pirjes së duhanit, porosive të mjekut që të shmangin duhanin, u përgjigjen: më ëshë bërë shprehi, nuk mund ta mënjanojë. Këto janë fjalë të pabaza. Muhaxhirë është ai që është në gjendje ta braktisë një gjë që është e lidhur ngusht me të. Nëse nuk mund ta

braktisë një gjë të thjeshtë siç është pirja e duhanit, atëherë nuk është njeri.

Thuhet se Me'muni (halif i dinastisë abasite) e ka pasur si shprehi të hajë dhe. Mjekët e njerëz të tjerë tubohen të gjejnë zgjidhje që Me'muni ta zhdukë këtë shprehi. I provuan të gjitha metodat, por nuk patën sukses. Një ditë u zhvillua një bisedë lidhur me këtë. Një njeri i ngratë që rrinte ulur te dera tha: “Unë e di ilaçin”. E pyetën se cili ishte ai, e ai u përgjigj: “Vendosmëria mbretërore!” Kur e dëgjoji këtë Me'muni, tha: “Ky njeri ka të drejtë”. Dhe kështu e largoi këtë shprehi.

Njeriu nuk guxon të bëhet rob i shprehive të veta. Për fat të keq, duhet të themi se traditat shoqërore me tepër janë të theksuara te gratë se sa te burrat. Për shembull thonë, se traditë është që ashtu të veprohet në vorrim, pas tre ditëve, pas shtatë ditëve dhe pas dyzetë ditëve, pas vdekjes së burrit. Gjegjësisht, traditë është që në dasëm të sillemi ashtu siç sillemi dhe shumë tradita e shprehi të tjera. Të tillët thonë: kjo është traditë, e tradita nuk bën të shkilet. Kjo don të thotë nënçmim dhe paaftësi. Njeriu s'guxon të jetë rob i traditave gjer në atë masë. Njeriu duhet ta pranojë dhe ta përcjellë logjikën dhe të kuptuarit. Natyrisht, kjo nuk don të thotë, sikur disa njerëz të kësaj kohe që nuk pranojnë traditën dhe thonë: unë jam kundër çdo tradite dhe zakoni! Përgjigja është jo! Duhet të themi: unë pranojë gjithë atë që është e logjikshme dhe jam kundër gjithë asaj që është e pakuptimtë dhe jologjike.

Andaj Islami konsideron se hixhreti është një princip i jetës së njeriut. Ç'do të thotë kjo? Kjo don të thotë gjallërim dhe zhvillim i personalitetit njerëzor. Kjo është një luftë me njërin prej shkaqeve themelore të nënçmimit dhe robërimit të njeriut, e që thotë: o njeri mos u bën rob i rrethit ku je lindur

dhe mos u bën rob i tullave dhe malterit.<sup>39</sup> Njeriu duhet patjetër t'i sigurojë vetes aq liri, dinjitet dhe pavarësi që mos të bëhet as rob i hapsirës dhe rrethit e as të robërohet nga traditat dhe sjelljet e këqia që i janë imponuar nga ana e rrethit ku ai jeton. Muhaxhir është ai që është në gjendje ta mënjanojë të keqen, vetitë dhe sjelljet e këqia. Hixhret don të thotë të larguarit nga gjërat e liga që e rrethojnë njeriun.

Nga kjo mund të konkludojmë se hixhreti është një faktor edukues.

Tani ta analizojmë çështjen e xhihadit: Xhihad don të thotë luftë e përlëshje, madje edhe kur mendohet në kuptimin shpirtëror të këtij termi, xhihad është edhe të luftosh kundër dëshirave vetanake. Njeriu ballafaqohet me barikada, pengesa dhe probleme. A thua, vallë, njeriu gjithnjë duhet të jetë rob dhe i nënçmuar? Jo, ashtu si nuk guxon të bëhet rob i rrethit ku ai jeton, nuk guxon të bëhet rob as i pengesave. O njeri, je i krijuar që me duart tua të mënjanojë pengesat-barikatat nga rruga yte.

<sup>39</sup> Imam Sadiku a.s. një herë hyri në shtëpinë e një shokut të vet. Ai njeri jetonte në një shtëpi shumë të vogël që nuk ishte e përshtatshme për familjen e tij. Imami e dinte se ai njeri është i pasur. Islami pohon: “Një prej lumturive të njeriut është të jetojë në një shtëpi të madhe e të gjerë. Secili që ka mundësi të ketë shtëpi të madhe dhe nuk e bën këtë, ka bërë padrejtësi ndaj bashkëshortes dhe fëmijëve të vet”. Imam Sadiku e dinte se ky njeri ka pasuri dhe përkundër saj jeton në një shtëpi të vogël. E pyeti: “Pse po jeton këtu? Ti ke mundësi ta zgjerosh shtëpinë tënde për shkak të bashkëshortes tënde dhe fëmijëve.”. Njeriu u përgjigj: “Kjo është shtëpia e babait tim, e unë jam lindur në të. Babai dhe gjyshi im, gjithashtu, kanë lindur në këtë shtëpi dhe këtu kanë jetuar. Nuk dua ta lë shtëpinë e babait”. Imam Sadiku shumë qartë i tha: “Të supozojmë sikur babai dhe gjyshi yt s'kanë qenë të mençur, a do të dëshiroje ti të paguajsh haraçin e marrëzisë së tyre? A thua, vallë, fajin për këtë e kanë gruaja dhe fëmijët?! Braktise këtë shtëpi! E pakuptimtë është të thuash: “këtu jam lindur”, “këtu jam mësuar”, “këtu janë lindur babai dhe gjyshi im”.

Në ajetin 100 të sures en-Nisa, para fjalisë: “Atij që del nga shtëpia e vet dhe shpërngulet për hirë të All-llahut dhe të Dërguarit të Tij.., qëndron: “Ai që shpërngulet për hirë të All-llahut do të gjejë në tokë shumë vendstrehime...”

Kur’ani këtu përdor një shpjegim të çuditshëm. Në ajetin 97 i sures En-Nisa është ajeti i të nëpërkëmburve dhe të shkelurve: “Kur melekët do t’ua marrin shpirtërat atyre që kanë gabuar ndaj vetvetes do t’u thonë: “Ç’u bë me ju? “Kemi qenë të shtypur në tokë”. Melekët do të përgjigjen: Vallë, a s’është toka e All-llahut e gjerë e të shpërnguleni, të lëvizni nëpër të? Andaj vendi i tyre do të jetë në Xhehennem, sa vendbanim i keq është ai!”

Kur melekët ua marrin shpirtin disa njerëzve dhe vërejnë se dosja e tyre është shumë e zezë dhe e errët, do t’i pyesin pse është ashtu. Ata do të përgjigjen: “Jemi një grup njerëzish të paafte që kemi jetuar në një mjedis ku nuk kemi pasur asnjëfarë mundësie. Mjedisi ynë nuk na lejonte edhe shumë gjëra të kota të ngjashme”. Melekët thonë: “Këto arsye nuk janë për njerëz. Këto arsye janë për ndonjë dru. Druri është ai që nuk mund ta luajë vendin e vetë. Po ta pyesim një dru se pse i janë nxirë gjethet përreth rrugës, ai do të përgjigjet: Po a nuk e shihni se si automjetet e autobusët bëjnë tym?! Ky dru nuk ka faj sepse nuk mund ta ndërrojë vendin e vet, apo, për shembull, të shkojë në ndonjë livadh që të gjethërojë. Ky dru, kjo krijesë, është e lidhur me rrënjët e saja për toke dhe nuk mund të lëvizë.

As te gjallesat nuk aplikohet një lloj i tillë i robërisë. Ka një numër të madh shtazësh që shpërngulen sikur që janë dallëndyshet, patat e të ngjashme. Madje edhe disa peshq shpërngulen. Ato janë shpërngulje verore e dimërore. Shtazët nuk janë të lidhura për toke dhe guri, por këtë e bën njeriu ashtu që po të pyetet: “Pse je aq i ndytë, i prishur e i parre-

gullt?” Njeriu i tillë përgjigjet: “Mjedisi ynë ka qenë i prishur, i pamoralshëm, i korruptuar dhe... kështu të detyron mjedisi. Atëherë i thuhet: “Çfarë absurditetesh janë këto?! Po a nuk mundesh ta braktisish atë mjedis e të kërkosh më të mirë se ai?” Njerëzit e tillë pohojnë: “Ne në këtë mjedis jemi të shtypur”, ndërkaq dëshirojnë të thonë: “Ne kemi qenë muslimanë, por mjedisi ynë ka qenë e prishur. Armiku gjithnjë na ka mundur”. Ata marrin përgjigjen: “Këtu keni qenë në këtë gjendje. Nëse këtu s'mund të bëni gjë, atëherë shpërnguluni dhe kërkoni vetes ndonjë mjedis tjetër. Kur'ani thotë:

***“Ai që shpërngulet për hirë të All-llahut, do të gjejë në tokë shumë vendstrehime e liri”.*** (4:10)

Kjo don të thotë se gjithëkush që shpërngulet për hirë të All-llahut, do të vijë gjer te një tokë ku do të gjejë strehim, pra, atje do të luftojë kundër armikut. Nëse armiku të ka mundur një herë, munde edhe ti atë një herë. E gjithë kjo don të thotë luftë, pra xhihad.

***“Ai që shpërngulet për hirë të All-llahut, do të gjejë në tokë shumë vendstrehime e liri. Atij që del nga shtëpia e vet e emigron për hirë të All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe i vjen vdekja, i është garantuar shpërblimi i All-llahut, sepse All-llahu është i Mëshirshëm dhe fal shumë”.*** (4:100)

Kjo s'ka një kuptim edhe në komentimin e xhihadit në aspekt shpirtëror. Disa e kanë bërë shprehi që kur t'ua përmendish disa çështje morale, thonë se nuk mundet. Për shembull, nëse dikuj i thuash: “Mos rrej!”, përgjigja është: “Nuk është e mundur. Po a ka mundësi që njeriu të mos rrejë”. Apo i thoni: “Mos shiko gratë e huaja! “ Përgjigja do të jetë: ”Po a mundet të mos shikohet”. Në një ligjeratë kam thënë që vargjet e Hajamit që vijojnë, mohojnë njeriun e si të tillë nuk mund të jenë krenaria jonë:

“O Zot, ti je Fytyrëbukur

i hijeshuar me aromë zymbyli  
Pastaj urdhëron, të mos shikojnë në atë  
Ashtu që ky rregull mbetet i përgjysmuar”.

Po t’i themi: “Zotëri, gjatë kohës sa gjendesh në namaz, mendo vetëm në Atë dhe në namaz!” Dëgjojmë përgjigjen: “S’ka mundësi!” Të këtillëve duhet t’u themi: “Mos të ishte e mundur nuk do të na urdhërohej ta bëjmë këtë. Problemi qëndron në atë se nuk ke kontroll mbi veprat tua. Po të kishe kontroll, atëherë gjatë namazit mund të jeshë i matur dhe të mendosh vetëm në All-llahun. Kij kontroll, atëherë do të mund t’i kontrollosh edhe mendimet tua, e kjo don të thotë se edhe mendimet tua janë nën kontroll e mos të flasim për gjymtyrët e tjera të trupit”.

Pse njeriut i duhet të jetë nën kontrollin e huaj? All-llahu nuk ka urdhëruar që njeriu të jetë nën kontrollin e cilës do qenie tjetër. All-llajhu i ka dhuruar njeriu ashtu liri që nëse dëshiron mund të lirohet nga gjithëçka dëshiron dhe t’i mbisundojë të gjitha gjërat. Por kjo kërkon luftë. Njeriu patjetër të ndeshet edhe me vetveten dhe me dëshirat e me epshet e veta. Me siguri, nëse nuk lufton, do të jap llogari. Prandaj njeriu i ka dy rrugë prej të cilave i duhet ta zgjedh një: luftën me nefsin (egon) dhe me dëshirat fizike dhe t’i mposhtë ato e t’i futë nën kontrollin e vet, ndërsa tjetra është që aspak të mos luftojë kundër një shpirti të tillë, por të bëhet rob i tij. Veset e shpirtit të keq qëndrojnë në atë se, poqese njeriu nuk e mposhtë e ta vërë nën kontrollin e vet, ai do ta sundojë e do ta robërojë atë.

Cila ishte filozofia e devotshmërisë së hazreti Aliut a.s. dhe logjika e tij në filozofinë e heqjes dorë nga bota? Ajo është liri. Aliu a.s ashtu sikur që nuk ka dashur ta humbasë luftën nga armiqtë e Islamit, aq edhe më tepër nuk ka dashur të pësojë disfatë nga ligësitë dhe pangopsitë e shpirtit. Një

herë kaloi hazreti Aliu a.s pranë një mishtoreje. Mishshitësi i tha: “O udhëheqës i besimtarëve! Kam sjellë shumë mish të mirë, nëse dëshironi merrni”. Aliu a.s. tha: “Tani nuk kam para”. Mishshitësi u përgjigj: “Do t’u pres (për pagesën - sh.p.)”. Udhëheqësi i besimtarëve tha: “Unë do t’i them stomakut tim të pres. Kur nuk do të mund t’i them stomakut tim të presë, atëherë do të kërkoj prej teje të më presish! Mirëpo unë do t’i them stomakut tim të presë”.

Në një vend tjetër hazreti Aliu a.s.thotë: “Po të kisha dashur, kam mundur të shkoj rrugës që çon drejt pastërtisë, edhe pse i ushqyer mirë dhe i veshur në të mëndafshita, por nuk ka mundur të ndodh që të më sundojnë pasionet e mia”.<sup>40</sup> Udhëheqësi i besimtarëve i drejtohet botës dhe në mënyrë shumë të bukur:

“Sa më larg meje, oj botë! Litari yt është në shpatullat tua, meqë jam çliruar nga kthetrat tua, kam shpëtuar nga rrjeti yt, dhe unë jam larguar të mos eci nëpër terrenet tua rrëshqitëse”.<sup>41</sup>

Kjo quhet luftë e vërtetë, luftë kundër egos e pasionit, epshit.

---

<sup>40</sup> Shtegu i elokuencës, Fedul-islam, letra 45.

<sup>41</sup> Po aty.

## SHKOLLA E HUMANITETIT

Temë e këtij kapitulli është, pra, shkolla e humanitetit. Njeriu, që e njohim si qenien e vetme në botë që gjurmon dhe hulumton, ai njëkohësisht është lëndë e këtij studimi. Kjo don të thotë se njeriu gjithnjë është njëra nga temat rreth të cilave vetë njeriu diskuton.

Termi humanitet (njerëzshmëri) gjithnjë është definuar si diçka e bekuar, e shenjtë dhe fisnike, sepse disa veti të veçanta të njeriut sikur që janë shkenca, drejtësia, vetëdija e lirë dhe morale, konsiderohen si veti të bekuara. Shkurt thënë, njeriu dhe humaniteti janë trajtuar dhe vazhdojnë të trajtohen ende si një faktor i bekuar. Edhe pse një numër i madh i vetive të bekuara e kanë sjellë njeriun në pikëpyetje, madje disa prej tyre (vetive) mohohen, si duket ende s'është paraqitur ndonjëfarë shkolle që praktikisht do t'i nënçmojë dhe mposhtë disa veti të veçanta të njeriut, pra aspektet joshhtarake të njeriut.

Këtu duhet të theksojmë që një pjesë e letërsisë, qoftë ajo fetare apo laike, është e orientuar kah çështja e humanitetit (njerëzores) dhe lëvdatave për të. Kjo më së tepërmi aplikohet në letërsinë islame, arabe ose persiane, ku ekziston një numër i madh veprash që hanë të bëjnë me këtë temë.

Humaniteti në shekujt e fundit, krahas zhvillimit të madh të shkencës, e ka humbur pozitën e tij të shenjtë, të bekuar që e posedonte te gjeneratat e mëhershme. Kjo rënie është shumë e madhe, sepse sa më shumë ngrihet një qenie, kur të bjerë, normalisht, ajo rënie do të jetë më e rrezikshme. Njeriu para dy-tre shekujve gati arriti pozitën gjysëmhyjnore.



Mirëpo, gjatë këtyre dy-tre shekujve të fundit, me të madhe ka rënë nga ajo pozitë e lartë që ia shpiku vetes, e rënia e tillë pati një karakter të fuqishëm destruktiv. Zbulimet e para të njeriut kishin të bëjnë me astronominë, sepse përnjëherë u ndryshua ajo që njeriu më parë mendonte për Tokën kur mendonte se ajo gjendet në qendër të botës dhe se yjet dhe planetet e tjera sillen rreth saj. Mandej e kuptoi se Toka është një planet i vogël i cili e ka patjetër të rrotullohet rreth diellit, ndërsa ky yll as vetë s'është aq shumë me rëndësi në botën e yjeve. Atëherë seriozisht erdhi në pyetje dhe u mohua pohimi se njeriu është qendra e rrethit të mundësive dhe qëllim i krijimit, dhe askush më nuk ka marrë guxim të flasë për atë. Njerëzit filluan të flasin: “Jo, nuk është njeriu ashtu siç e kemi paramenduar”. Me këtë grusht shkencor ai e humbi atë bindje të tij të vjetër se është qendër e botës, ndërkaq kjo ide shkante krahas bindjes se Toka është qendra e yjeve dhe galaktikës. Pastaj njeriu mori edhe grushta të tjerë të mëdhenj. Njëri prej grushtave të tillë ishte që njeriu e konsideroi veten si qenie qiellore, si mëkëmbës dhe shpirt i Zotit, e që është krijuar duke u frymëzuar nga Shpirti hyjnor.

Studimet biologjike nga lëmi i evolucionit, menjëherë gjenezën e njeriut e lidhën me shtazët, ashtu që njeriu u nënçmua. Në studimet e këtilla thuhej: “O njeri! Ti i takon racës së majmunit, madje edhe sikur të paramendonim që nuk i takon racës së majmunëve, gjithësesi ke prejardhje shtazarake dhe i takon llojit të shtazëve. Me këtë njeriu i është marrë dimenzioni hyjnor i personalitetit të tij dhe ky ishte grushti i dytë kundër njeriut dhe hyjnisë së tij.

Grushti tjetër efikas ishte ai që i ra të kaluarës dhe të arriturave të saja famoze dhe trashëgimisë. Don të thotë se njeriu në veprimet e veta e ka paraqitur veten ashtu që mund të veprojë vetëm në mënyrën e pastër e hyjnore, se motivi i tij

është kryekëput dashuria ndaj All-llahut, se akcionet e tij janë të orientuara kah fitimi i veprave të mira dhe mëshirës dhe se nuk posedon asnjë aspekt shtazarak e të thjeshtë. Përnjëherë u paraqitën teori që flitnin për atë se veprimi dhe aktiviteti i njeriut nuk janë të shenjta ashtu sikur që pikërisht i paraqet ai. Të gjitha aktivitetet të cilat njeriu i definon si dashuri ndaj shkencës, shkuarje drejt gjurmave të shkencës, arti, e bukura, morali, këshilla, shenjtëria, metafizika e të ngjashme, i takojnë grupit të aktiviteteve të njëjta që i praktikojmë te shtazët, me atë se te njeriu paraqiten me një mekanizëm e fenomen më të komplikuar. Dikush ka thënë se “stomaku” është burim i të gjitha aktiviteteve të njeriut.

Saadiu (poet iranian) konsideron se stomaku është burim i argëtimit të njeriut”. Të tjerët, megjithatë, kanë thënë jo vetëm që është burim argëtimi por edhe bazë e të menduarit të tij. Kështu që me këta grushta janë prishur dhe rrënuar dosiet e shkëlqyeshme dhe aktivitetet admiruese të njeriut.

Gradualisht parashtrohej çështja: Le ta studiojmë e analizojmë këtë qenie (njeriun). Në realitet, ç’është njeriu i cili e quajti, një kohë, veten si qendër e botës, bartës të shpirtit hyjnor, pra si një qenie që konsideron se veprat e tij janë të shenjta dhe fisnike? Prej çka përbëhet trupi i tij? Edhe një herë është paraqitur teoria se nuk ekziston dallim në mes të kësaj qenie arrogante dhe bimës. Në bazë të kësaj teorie “ekzistojnë dallime në pikëpamje të strukturës dhe formës në mes të njeriut dhe të qenieve tjera, por nuk ekziston dallim në pikëpamje të përbërjes dhe materies prej të cilës është krijuar njeriu. Kjo është sikur dallimi në mes mbulesës së trashë nga leshi dhe stofit elegant. Të dy prodhimet janë të endura nga leshi, përpos që stofi prodhohet prej endjes së fijeve shumë të holla të leshit. Po, ka dallim në mes njeriut dhe bimës në strukturë dhe konstruksion, por materia nga e cila janë të

përbërë është e njëjtë. Më nuk ka shpirt hyjnor e frymëzim. Njeriu është një makinë sikur dhe makinat e tjera, pra i takon një rregulli të makinës. Natyrisht, edhe pse ora e xhepit dallohet nga biçikleta, e anija kozmike nga automobili, të gjithë në realitet janë makina, dhe në bazë të kësaj janë të njëjta, pra të gjitha kanë karakter makine, s'ka dyshim në këtë". Si duket se ky ishte grushti i fundit ndaj njerëzisë.

Megjithatë, pa marrë parasysh pohimet e këtilla, vlerat njerëzore aspak nuk janë të gjykuara në përjashtim të disa filozofive dhe sistemeve filozofike, që përqeshin ca kuptime, siç janë: paqja, liria, shpirtërorja, drejtësia dhe dhembshuria.

Prej nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë e gjer më sot përsëri paraqitet humanizmi, sërish e merr origjinalitetin e vet, përsëri paraqiten shkollat humaniste ideologjike, madje edhe në formë të njeriut hyjnor. Njeriu në të kaluarën nuk ka qenë simbol i adhurimit, ai ishte një sinjal i madh dhe dritare e madhe kah shpirtërorja. Nuk ka dyshim se edhe sipas Kur'anit njeriu është argumenti më i qëlluar për shpirtëroren, njohjen e All-llahut dhe metafizikën.

***“Ne do t’u tregojmë argumentet Tona në horizont si dhe në vetë ata”.*** (41:53).

***“Argumentet në tokë janë për të bindurit. Si dhe në vetë ju. A nuk e shihni!”*** (51: 20-21)

E njëjta qenie, e cila në të kaluarën ka qenë si një argument i madh dhe derë për kalimin e njeriut prej vetvetes kah shpirtërorja hyjnore dhe besimi në botën e padukshme dhe në qiell, përsëri u bë çështje e diskutueshme, por këtë herë në një mënyrë tjetër, sikur të duket që nuk ka arritur t’u shpëtojë kontradiktave e ky është problem kryesor dhe një çështje e rëndësishme. Kjo don të thotë se njeriu përsëri don ta gjejë hyjnoren e vet, nderin dhe pozitën fisnike, ashtu sikur qëllimi final të ishte qëllimi i aktiviteteve, dhe me atë rast për

te të mos shfrytëzohen kriteret e vjetra, të mos fitojë aspekti hyjnor apo johyjnor, të mos flitet për atë se gjithëçka ekziston në tokë është e krijuar për njeriun,<sup>42</sup> as lidhur me atë se Zoti i ka dhënë njeriut nga shpirti i Tij,<sup>43</sup> pra, diçka që s'është nga kjo botë e që njeriu është manifestim i të Lartëmadhërishmit. Madje mos të flitet as për aspekte nxitëse njerëzore dhe për motive të tij të brendshme, e që në të njëjtën kohë njeriu dhe inteligjencia e tij të jetë e bekuar - e shenjtë dhe e respektuar. Tani jemi dëshmitarë që secili njeri i takon një ideologjie të caktuar. Njeriu deklaron: unë jam ithtar i paqes, jam ithtar i lirisë, jam human, jam ithtar i drejtësisë dhe jam ithtar i të drejtave. Madje edhe deklarata për të drejtat e njeriut fillon me fjalinë: “Me respekt ndaj autoritetit të natyrshëm dhe qenësor dhe prestigjit të njeriut”. Kjo don të thotë që njeriun e përcakton autoriteti qenësor e i natyrshëm dhe prestigji që është i shenjtë e i respektuar në mënyrë që më vonë edukimi të jetë në të njëjtën bazë, ashtu që unë respektoj dhe besoj autoritetin tuaj të natyrshëm dhe qenësor, saqë edhe pse kam mundësi t'ua cenoj të drejtat dhe lirinë tuaj, përsëri nuk do ta bëj atë, e kjo vlen edhe për ju. Një numër i madh i atyre që shkojnë pas filozofisë humaniste, shkojnë pas një filozofie që nuk është e bazuar në kriteriumet e vjetra. Megjithatë këtu paraqitet problemi kryesor e i rëndësishëm e që është kontradikta e madhe në jetë, në mendimet dhe logjikën e njeriut të sotëm, kjo është një logjikë që aspak nuk mund të ketë bazë.

Nuk besoj se mund të gjendet ndonjë studiu në botë që do ta definonte dhe shpjegonte humanizmin në atë mënyrë që të quhej paqe e përgjithshme. Natyrisht, ka edhe njerëz të atillë të thjeshtë e të padijshëm të cilët, posa të flasish për

---

<sup>42</sup> “Ai është i Cili ka krijuar për ju gjithëçka ka në tokë” (2:29).

<sup>43</sup> “...dhe pasi që i kam dhënë fizionomi dhe i kam dhënë edhe shpirt”. (15:29).

humanitet dhe njerëzi, thonë se të gjithë duhet të jenë njerëz, andaj të gjithë njerëzit duhet t'i trajtojmë njësoj. I pyesim ata se ç'mendojnë për vlerat njerëzore? Njerëzit nuk janë njësoj në posedimin e vlerave njerëzore. Dikush është shkencëtar, tjetri është analfabet (pa marrë parasysh shkaqet e analfabetizimit të tij), dikush është i pastër e pa gabime, ndërsa tjetri është i ndytë, dikush është zullumqar e tjetri i shkelur, dikush njerëzve u dëshiron të mira, tjetri u dëshiron të liga. Po a mundet atëherë në bazë të filozofisë së humanizmit të themi se të gjithë janë njerëz dhe se ata për ne janë njësoj? Ne e respektojmë njeriun pa marrë parasysh se ky njeri është shkencëtar apo analfabet, besimtar apo jobesimtar, i pastër apo gabimtar, i ndërgjegjshëm apo i degjeneruar! Ne patjetër të jemi humanistë dhe ithtarë i një paqe të përgjithshme dhe gjithpërfshirëse. Sipas mendimit tonë, përkatësia e një njeriu, e cilësdo fe apo ideologji qoftë, nuk guxon të krijojë ndasi në mes tyre! Nëse ashtu flasim, atëherë e kemi mashtruar dhe tradhëtuar njerëzimin.

Njeriu dallohet nga gjallesat e tjera me një dallim themelor e ajo është që njeriu, më tepër se çdo gjallesë, posedon potenciale aftësishë, por më pak aktive e të dukshme. Ç'do të thotë kjo? Për shembull, një kalë është kalë dhe i posedon të gjitha vetitë aktive e të dukshme që duhet t'i posedojë kali. Natyrisht, kali ka shumë pak veti që mund të zhvillohen me anë të ushtrimeve. Kjo ka të bëjë edhe me të gjitha gjallesat e tjera. Megjithatë, njeriu lind apsolutisht si qenie potenciale. Kjo don të thotë që kur lind, nuk e di se ç'do të bëhet në të ardhmen. Mbase në të ardhmen do të bëhet sikur ujk, e mbase sikur dele, edhe pse mban pamjen e njeriut. Ekziston mundësia të jetë edhe njeri. Mulla Sadra, filozof i madh iranian ka thënë se gabim është ajo që njerëzit mendojnë se të gjithë i takojnë një lloji-xhinsi. Ai thotë se numri i llojeve të

njerëzve është i barabartë me numrin e njerëzve në botë në përgjithësi, ngase kualitet është njeriu dhe njerëzimi e jo lloji. Natyrisht, Mulla Sadra është filozof e jo biolog. Biologu që analizon vetëm organet dhe trupat, konsideron se të gjithë njerëzit i takojnë një lloji. Por, kur një filozof e studion njeriun dhe konsideron se e vërteta mbi njeriun varet nga shprehjet e tij të mira dhe nga ajo që quhet njerëzi, atëherë nuk mund të besojë se të gjithë njerëzit i takojnë një lloji, andaj edhe thotë se aq lloje në botë ka sa edhe vetë numri i njerëzve. Prandaj patjetër të theksojmë që vlerat njerëzore janë vlera potenciale. Disa njerëz arrijnë gjër te ajo pozitë e vërtetë njerëzore, ndërsa shumë të tjerë nuk mund të arrijnë. Si ka thënë hazreti Aliu a.s.: “Pamjen e ka të njeriut, por zemrën e ka shtazarake”.<sup>44</sup> Kjo do të thotë, vetëm i përgjanë njeriut, por në shpirt është gjallesë e egër.

Theksuam se bota, përsëri, është hapur ndaj shkollës së humanizmit. Don të thotë se janë paraqitur disa filozofi të quajtura filozofi omanistike, dhe mbase është më shumë për t’u habitur se në botë është paraqitur një fe e cila quhet “Feja e omanizmit” të cilën e shpiku dhe e themeloi August Konti nga mesi i shekullit nëntëmbëdhjetë. Ky njeri u gjend në një qorsokak të çuditshëm në mes logjikës e të kuptuarit në një anë dhe vetëdijes, në anën tjetër. Andaj edhe shpiku diçka siç është “feja e omanizmit”. Ai thotë: “Feja është e patjetërsueshme për njeriun, e të gjitha veprat e liga që vërehen në shoqëri, paraqiten si rezultat i dobësimit të fesë në shoqëri. Feja e mëparshme (fjalën e ka për katolicizmin) s’ka mundësi të bëhet fe e botës së sotshme”. Konti i definon tri periudha: periudhën metafizike dhe hyjnore, periudhën filozofike dhe mendore, periudhën shkencore e hulumtuese (siç e quan ai: periudha pozitive). Ai shton se katolicizmi i takon mënyrës së

---

<sup>44</sup> Shtegu i elokuencës, Fejzul-islam, letra 86.

të menduarit metafizik të njeriut, por sot është kohë e shkencës ku njeriu nuk e pranon më të menduarit metafizik. Ai njeri e paramendoj një fe pa gjenezë metafizike e hyjnore (është çudi që feja si fe të mos ketë prejardhje metafizike e hyjnore), por i pranoi të gjitha traditat, ceremonitë fetare, ritualet dhe dispozitat që ekzistonin.

Madje, për fenë e vet caktoi prift, e vetë u bë profet i asaj feje, mirëpo profet pa Zot. Bile thuhet se i ka kopjuar ceremonitë dhe traditat e katolicizmit dhe i ka shfrytëzuar në fenë e njerëzisë ose (Fenë e omanizmit). Disa protestuan dhe i thanë: “Ne nuk do ta pranojmë fenë që nuk ka gjenezë hyjnore. Ti nuk e pranon katolicizmin, atëherë pse po i merr ceremonitë dhe ritualet e saja të cilat, sipas mendimit të disa shkencëtarëve, bile mund të duken si besim i kotë? Ti nuk e pranon Zotin, atëherë si i pranon dhe i kryen ceremonitë dhe lutjet e Tij?!” Mirëpo, ai në një anë kishte të drejtë të pranonte që njeriut i duhet t’i kryejë disa rituale e ceremoni, andaj ai e sollti një fe e cila nuk ka gjenezë hyjnore, por ka një mori ritualesh, lutjesh dhe dispozitash. Kam lexuar në disa libra se ai në Amerikë dhe Evropë ka një numër të madh ithtarësh, madje në këto libra theksohet se feja e tij sot ka shumë ithtarë, të cilëve shtëpia e tij u është bërë tempull-faltore. Kam lexuar në një libër që është përkthyer në gjuhën arabe se Konti kishte një dashnore, burri i së cilës ishte i dënuar me burg të përjetshëm. Konti u dashurua në të, por ajo vdiq para se të bëheshin bashkë dhe nuk e harroi atë gjer në vdekje. Disa thonë se Konti për këtë shkak e braktisi botën e logjikës e iu kthye botës së ndjenjave dhe emocioneve dhe në fund e shpiku omanizmin. Në librin e lartpërmendur, gjithashtu, shkruan se ithtarët e tij konsideruan se dashnorja e tij, për këtë fe, luan rol të njejtë sikur hazreti Merjemja a.s. që ka në krishterizëm, don të thotë aq sa e duan të krishterët

hazreti Merjemen a.s. aq edhe ithtarët e Kontit e konsiderojnë dashnoren e tij si grua të shenjtë.

Mirëpo, më vonë, çështja e shkollës së humanizmit u pozicionua ndryshe. Lidhur me çështjen e njeriut dhe origjinalitetit të tij ka një mori problemesh. Këtu, në formë pyetjesh, shkurtimisht do të përmendi disa prej tyre:

Njëra prej tyre ka të bëjë me çështjen e lirisë, vullnetit, përgjegjësisë dhe obligimeve të njeriut. A thua vërtetë njeriu është qenie e lirë që posedon vullnet? A ka ndonjë përgjegjësi dhe obligime që duhet patjetër t'i kryejë? Natyrisht, nëse kërkon përgjigje në aspekt të logjikës islame, patjetër të themi: Absolutisht po! Në Kur'an ka një sure që e mban emrin "El-Insan" (njeriu), gjegjësisht "Ed-Dehr". Shkaku se pse kjo sure quhet "njeriu" është se në të flitet për njeriun, për autorizimet dhe të drejtat e tij, për lirinë dhe përgjegjësitë e tij. Kjo sure fillon me ajetet:

*"A mos i ka kaluar njeriut ndonjë pjesë e kohës kur nuk i është shpallur kurgjë? Ne e kemi krijuar njeriun nga përzierja e farës për ta sprovuar dhe e kemi bërë që ai të dëgjojë dhe të shohë: ne e kemi udhëzuar njeriun në rrugë të drejtë, qoftë si mirënjohës apo mohues". (36:1-3)*

Andaj njeriu nuk është qenie e detyruar te All-llahu. Çka kërkon Krijuesi i gjithësisë nga njeriu? Ai për të kërkon lirinë. All-llahu (xh.sh.) atë e ka krijuar si një qenie të lirë dhe me përgjegjësi që ka obligimet dhe detyrat e veta. Madje shpjegimi më i bollshëm për njeriun është dhënë në Kur'an ku theksohet se njeriu është "mëkëmbës i All-llahut". Me siguri se asnjë libër sikur Kur'ani nuk e ka lëvduar njeriun:

*"Dhe kur u tha Zoti yt melekëve: "Unë në tokë po caktoj një mëkëmbës"! Ato i thanë: A po bën aty dikë që do të bëjë turbullira e gjakderdhje, kurse ne Ty të madhërojmë e të lëvdojmë dhe të lartësojmë? Unë di - tha Ai - atë çka ju*



*s'e dini. Dhe ia mësoi Ademit emërtimet e të gjitha sendeve dhe pastaj ua prezentoj melekëve dhe u tha: “Më informoni për emrat e tyre, nëse flisni të vërtetën!” Ato i thanë: Qofsh lartësuar! Ne nuk dijmë përveç asaj që na ke mësuar Ti. Pa dyshim Ti je i Gjithëdijshtëm, i Urtë”. (2: 30-32)*

Sidoqoftë, shpjegimi më i madh i njeriut në aspekt të obligimeve, lirisë dhe vullnetit është ajo që All-llahu xh.sh. e konsideron njeriun si mëkëmbës të vetin, i cili e përmbush të ekzistuarit dhe jetën. Njeriu është manifestim i aktivitetit dhe krijimit të All-llahut (xh.sh.)

Çështja tjetër që ka të bëjë me njeriun është fati dhe kënaqësitë e tij. Çka duhet të gjurmojë? A duhet të gjurmojë kënaqësinë në një mjedis të jashtëm, në vete apo edhe në vet-vete edhe në botën e tij të jashtme, dhe atë në çfarë aspekti?

Shumë njerëz kërkojnë kënaqësinë jashtë qenies së tij dhe në mjedisin e jashtëm dhe vazhdimisht hulumtojnë për t'u kënaqur në jetë dhe duke e shfrytëzuar atë. Ata janë njerëz që nuk e konsiderojnë veten njerëz, pra nuk pranojnë se janë qendër kryesore të kënaqësisë dhe gëzimit (që gjenezën e kanë jashtë njeriut), ku dëshirojnë të gjejë kënaqësinë dhe lumturinë? Në lypje apo në drogë?

Me siguri se jo! Natyrisht, nuk është në rregull që njeriu ta braktisë botën e tij të jashtme dhe si ndonjë sekte e Indisë të pohojë se të gjitha kënaqësitë, kryesisht, t'i kërkojnë brenda vetvetes. Mevlana, poeti madh iranian thotë:

“Dije, rruga që çon drejt kënaqësive është në ty, jo jasht  
Dije, s'është mençuri ta kërkosh atë nëpër pallate kala.  
Dikush është i lumtur e i kënaqur në një skaj të burgut,  
tjetri është i pakënaqur duke vjelur fruta në kopsht”.

Mevlana nuk mendon këtu që ne ta braktisim botën tonë të jashtme dhe gjithë atë që gjendet në të. Ai mendon se nëse njeriu kërkon kënaqësi, nuk guxon të mendojë se të

gjitha kënaqësitë gjenden në materialen jashtë qenies së tij. Qendra kryesore e kënaqësisë gjendet në vetë njeriun, andaj duhet të krijojmë një baraspeshë në mes botës së jashtme dhe asaj të brendshme të vetë njeriut.

Ideologjia dhe shkolla që veten e quan “shkolla e humanitetit” duhet të përgjigjet në disa pyetje. Nëse ka mundësi të përgjigjet, atëherë mund të jetë shkollë e vërtetë dhe ideologji e njerëzimit. Siç theksova, njeriu është dritare e derë e botës shpirtërore. Në të vërtetë, njeriu në bazë të të ekzistuarit të vet ka zbuluar botën e shpirtërores. Shpirtërorja e njerëzorja, feja dhe njerëzorja janë faktorë të pandarë. Kjo don të thotë që patjetër duhet, ose ta braktisim njerëzoren dhe fenë së bashku, ose nëse e pranojmë fenë, patjetër ta pranojmë edhe njerëzoren dhe anasjelltas. Këto janë do faktorë të pandashëm. Kjo është ajo kontradiktë për të cilën pohojmë se ekziston te shkollat omaniste.

Realitet është se njerëzorja përjetoi një rënie në të kaluarën, e që ishte një rënie e gabueshme. Kjo don të thotë se ndryshimet në sistemin e Ptolomeut nuk guxojnë të jenë arsye për të dyshuar në pozitën e lartë të njeriut si qëllim e orientim i krijimit. Njeriu është qëllimi i jetës - botës, pa marrë parasysh atë se Toka është apo s’është qendër e botës. Ç’do të thotë ajo që njeriu është qëllim i botës? Kjo don të thotë se natyra në drejtimin e saj evolutiv shkon drejt asaj që njeriu është qëllim i botës, pa marrë parasysh se a është ai njeri që është krijuar për një herë apo u takon llojeve tjera të gjallesave.

Ky fakt nuk do të ndryshojë pa marrë parasysh se a do të konsiderojmë që njeriu posedon shpirt hyjnor apo jo.

Ju të cilët për filozofi tuajën keni zgjedhur filantropinë-njeridashjen, ndërkaq lëndë e besimit tuaj është njerëzimi, po ju pyesim: a ekziston te njeriu ndjenja të cilën mund ta

quajmë mirësi, mëshirë, ose ndihmë ndaj tjetrit, apo jo? Nëse shprehen se aspak nuk ekziston, atëherë është gabim të thirret njeriu t'i kryejë ato punë, njëjtë sikur të thirret një gurë apo një shtazë! Mbase dikush do të thotë se ndjenja për ndihmë ndaj tjetrit e cila gjendet në ne, në realitet, është një lloj ndryshimi i vendit. Ç' do të thotë kjo? Po të shohim dikend në rrugë që ka nevojë për ndihmë, ne mendojmë se në ne forcohet ndjenja e filantropisë për t'i shkuar në ndihmë atij që ka nevojë dhe për t'iu vënë në shërbim. Ata thonë: Po ta analizojmë mirë situatën, do të shohim se njeriu e ka venduar veten në vendin e tyre. Së pari mendon ta vendojë atë në klasën e vet, gjegjësisht të vëdojë veten në klasën e tij. Më pastaj mendon se ai njeri, në të vërtetë, është vetë në vendin e tij, e më vonë tek ai paraqitet ndjenja e egoizmit që patjetër të mbrohet dhe kështu do t'i ndihmojë personit tjetër. Përndryshe te njeriu s'gjendet diçka që posedon ndjenjën burimore që njeriu patjetër t'i ndihmojë një të pafti e ta mbrojë atë.

Omanizmi (shkolla e humanizmit) doemos të përgjigjet në pyetjen: A thua vallë ekziston një ndjenjë e tillë apo jo? Ne pohojmë se një ndjenjë e tillë ekziston:

***“Dhe i kemi trasuar (njeriut) dy rrugë”*** (90:10).

Meqë njeriu si mëkëmbës i All-llahut në tokë, është manifestim i mëshirës së All-llahut, njëherit është edhe manifestim i të mirës dhe mirësisë. Don të thotë se njeriu krahas asaj që është egoist dhe që është i obliguar t'i orientojë aktivitetet e tij drejt qëllimit të koekzistencës dhe për hirë të vetvetes, ekzistenca e tij nuk është vetëm egoizëm, por ajo përfshinë edhe mirësinë, njerëzinë, dëshirën për ndërtimin e botës si dhe të ngritjes së vetëdijes morale.

Çka paraqesin këto ndjenja te njeriu? Ato janë manifestim i njerëzisë dhe paraqesin origjinalitetin dhe burimoren e njerëzisë. Në realitet ç'është ndjenja e falënderimit ndaj të

mirëve dhe fisnikëve dhe ndjenja e urrejtjes ndaj të këqinjve, edhe pse ata janë njerëz të së kaluarës? Kur e dëgjojmë emrin e Jezidit dhe Shimrit me te gjitha veprat e liga që i kanë bërë, ndërkaq në anën tjetër dëgjojmë emrat e shehidëve të Kerbelasë me gjithë sakrificën që dhanë, ndjejmë urrejtje ndaj grupit të parë, ndërsa respekt ndaj grupit tjetër. Ç'është kjo? A thua edhe kjo është sikur ndërrimi i vendeve dhe i klasëve që të shihemi në klasën e shehidëve të Kerbelasë, e armiq të tanë në grupin tjetër?

Me fjalë tjera, a është urrejtja ndaj Jezidit dhe ndaj Shimrit sikur ndjenja e urrejtjes ndaj armiqve tanë, në të vërtetë, respekti ndaj shehidëve është mëshirë dhe respekt ndaj vetvetes. Nëse është ashtu, atëherë nuk dallohet nga ti as ai që e konsideron për armik. Sepse edhe ai (në bazë të kësaj mënyre të të menduarit) ka të drejtë, për shembull, ta falënderojë Jezidin dhe Shimrin dhe t'i respektojë ata, ndërkaq në anën tjetër t'i urrejë shehidët e Kerbelasë, meqë veten e konsideron në grupin e Shimrit dhe Jezidit të cilët për atë edhe i çmon dhe nderon, ndërsa në anën tjetër i urren shehidët meqë i takojnë grupit të armikut.

Kjo nuk është ashtu. Ju, shqyrtonie temën në fjalë, nga aspekti tjetër, i cili nuk është individual por human e i lidhur me botën humanitetit dhe detin e njerëzisë. Në këtë shqyrtim më nuk ekziston fjala "unë" dhe "urrejtje" por flitet për të vërtetën. Në këtë aspekt fjala "unë" nënkupton tërësinë dhe llojin, e nuk ka të bëjë ajo me individin. Omanizmi (shkolla e njerëzisë) patjetër e ka borxh të përgjigjet në pyetjen: Ç'është ajo dhe nga po paraqitet? Gjithashtu duhet të përgjigjet edhe në pyetjet e tjera siç është dashuria e sinqert e njeriut ndaj falënderimit. Njeriu ka dëshirë t'i falënderohet atij që i bën ndonjë të mirë. Kur do të arrijmë ta gjejmë burimoren dhe

originalitetin e vlerave njerëzore, atëherë mund t'i parashtrohet ndonjë pyetje vetë njeriut. Këtu dua vetëm të theksoj:

A thua vërtetë ju mendoni se aspekti i brendshëm i njeriut me atë burim të margaritarëve dhe vlerave është ashtu sikur pohon materializmi se njeriu është një lloj makine? Për çdo makinë, pa marrë parasysh se sa është e komplikuar ose e madhe, vetëm mund të themi se është madhështore, e madhe, mahnitëse dhe... a kemi mundësi të themi se kjo makinë është fisnike, gjegjësisht e shenjt? Jo, nëse cilado makinë është edhe një milion herë më e madhe se Apolo, edhe më tej është mahnitëse dhe e jashtëzakonshme e të ngjashme me të. Asnjë herë s'mund të arrijë gjer në atë shkallë për t'i thënë se është fisnike, e shenjtë, dhe se posedon një krenari të brendshme (shpirtërore). Ithtarët e deklaratës mbi të drejtat njerëzore si dhe filozofët komunistë që, në shumë lëmenj, janë ithtarë të omanizmit, si kanë mundësi të flasin për fisnikërinë dhe shenjtërinë e njeriut e të mos hulumtojnë shpirtin hyjnor që është i frymëzuar në njeriun. Kur do ta kenë të qartë burimin dhe prejardhjen e atyre vlerave, atëherë do ta kenë të qartë edhe burimin e origjinalitetit të vetë njeriut. Në këtë fazë duhet shkurtimisht të parashtrojmë edhe një pyetje:

Filluam nga origjinaliteti, burimorja dhe prejardhja e vlerave njerëzore dhe arritëm gjer te origjinaliteti dhe burimorja e vetë njeriut. A është ky njeri i vetmi në këtë botë që gjendet në një errësirë të pafund? Dhe, si thotë një evropian: - a mos vallë ky zotëri u krijua rastësisht si një pikë e ëmbël? Apo kjo pikë e ëmbël paraqet një oqean të ëmbël? A thua kjo shkëndijë drite paraqet botën e dritës? Këtu bëhet e qartë lidhja në mes origjinalitetit dhe burimores së njeriut me All-llahun (xh.sh.). Kjo do të thotë se janë të pandashëm.

***“All-llahu është burim i qiejve dhe tokës!” (24:35).***

Në momentin kur të thoni se All-llahu është i Pari dhe i Fundit, i Dukshmi e i Padukshmi (57:3), përnjëherë bota juaj ndryshon, sepse të gjitha origjinalitetet që i ndjeni në vete do të kenë kuptim e domethënie. Do të paraqitet qëllimi. Do ta kuptoni se nëse jeni gjurmë drite, arsyeja është që ekziston një botë drite, e nëse jeni një pikë e ëmbël, arsyeja është se ekziston një oqean i ëmbël i paskajshëm, meqë në ju gjendet një rreze e dritës së tij.

Islami është një shkollë humane që është themeluar në peshojat njerëzore. Kjo don të thotë se në Islam nuk ekzistojnë ato gjëra të cilat janë themeluar për diskriminime të gabuara në mes njerëzve. Me fjalë tjera, në Islam nuk ekzistojnë racat, vendi, regjioni, gjuha, sepse sipas Islamit këto s'janë peshoja për matjen e vlerave njerëzore. Në Islam vlerat njerëzore janë peshojë e vlerave të njerëzve. Islami që është shkollë e humanitetit dhe që e respekton humanitetin, konsideron se burimore janë edhe vlerat njerëzore, meqë konsideron se njeriu është burimor, origjinal. Ai konsideron se njeriu është origjinal meqë konsideron se edhe bota është origjinale, e kjo don të thotë se e pranon të Gjithëfuqishmin e të Lartëmadhërishmin Zot:

***“Ai është All-llahu i Cili, nuk ka tjetër zot përveç Atij, Sunduesi absolut, i Pastër, Paqedashës, garanton siguri, në kujdesin e të Cilit është çdo send: i Forti, i Madhërishmi Krenar. Qoftë i Lartësuar All-llahu nga ata që i përshkruajnë shok!”*** (59:23)

Islami, në bazë të kësaj, është e vetmja shkollë humane e cila mund të ekzistojë në bazë të logjikës së shëndoshë, ndërkaq shkollë tjetër humane nuk ekziston në botë.

## Përmbajtja

FJALA E PËRKTHYESIT .....	3
LIRIA SHPIRTËRORE I.....	5
LIRIA SHPIRTËRORE II.....	20
IBADETI DHE DUAJA I.....	37
IBADETI DHE DUAJA II.....	55
TEUBEJA I (Pendimi).....	75
TEUBEJA II.....	94
SHPIRTMADHËSIA DHE FISNIKËRIA .....	114
BESIMI NË BOTËN E PADUKSHME (GAJB) .....	127
CILA ËSHTË PESHOJA E NJERËZISË-HUMANIZMIT.....	142
HIXHRETI DHE XHIHADI I.....	153
HIXHRETI DHE XHIHADI II.....	164
HIXHRETI DHE XHIHADI III.....	172
SHKOLLA E HUMANITETIT.....	184
PËRMBAJTJA .....	199



*Maqata*

*Fladi*